

Mbasi që e lexova këtë libër, jam i bindur se është një punim me një rekomandim të lartë. Mendoj se ky libër duhet të arrijë në çdo shtëpi. Duhet të jetë pjesë e prikës (pasuri) së nuseve të sapomartuara. Duhet t'u prezantohet bashkëshortëve të sapomartuar dhe duhet të jetë në raftin e librave të çdo familjeje. Ky libër duhet ta zbukurojë tavolinën pranë shtratit në dhomën e gjumit të çdo qifti dhe, do të jetë një referencë e dobishme dhe udhëzim për rritjen e duhur të fëmijëve.

PRINCIPET E RITJES SË FËMIJËVE

AJATULLAH IBRAHIM AMINI

AJATULLAH IBRAHIM AMINI

PRINCIPET E RITJES SË FËMIJËVE

Prizren 2008

کتابخانه کلاسیک اسلامیہ
پریزن 2007

Ajatullah Ibrahim Amini

Principet e rritjes së fëmijëve

Prizren 2007

Titulli i originalit: Principles of Upbringing Children
Autori: Ajatullah Ibrahim Amini
Përktheu: Gëzim Gërgi
Lektor: Ilam Berisha
Botuesi: Sh.F. "Ehli Bejti"
Shtypshkronja: Prizren Graf
Tirazhi: 1000 copë

Parathënie

Ekziston një dallim i theksuar ndërmjet arsimimit dhe formimit gjatë rritjes së fëmijës. Arsimit, do të thotë ngulitja e diturisë në mendjen e një personi apo dhënia e kuptimit të programit mësimor. Por, rritja është formimi i personalitetit sipas përvijimeve të dëshiruara. Shoqëria mund të transformohet përmes formimit të duhur të popullatës së vet.

Është thelbësore që rritja (formimi) të jetë e bazuar në një program të menduar mirë, në mënyrë që ta sigurojmë shkallën e suksesit të dëshiruar. Rritja nuk është vetëm predikimi dhe qortimi, por kërkon edhe krijimin e mjedisit të duhur drejt arritjes së rezultatit të dëshiruar.

Parimet e domosdoshme për formimin e duhur, mund të radhiten në këtë mënyrë:

1- **Mentori** duhet ta njohë mirë studentin, me formimin e të cilit është i caktuar që të merret. Ai duhet ta familjarizojë veten me gjendjen mendore dhe fizike të studentit.

2- **Mentori** duhet t'i definojë qëllimet e programit trajnues të studentit. Qëllimi përfundimtar i procesit të formimit duhet të jetë zhvillimi i studentit në një person human.

3- **Programi** trajnues duhet t'i përfshijë kriteret dhe kushtet e dëshiruara për arritjen e rezultateve më të mira. Atëherë mentori mund të presë rezultatet pozitive gjatë kohës.

Periudha më e mirë për fillimin e formimit apo trajnimit është fëmijëria e studentit. Fëmijëria është periudha në të cilën mund të ushtrohet më së shumti ndikimi në jetën e një personi. Në këtë periudhë më delikate dhe më me përgjegjësi, prindërit mund të luajnë rolin vendimtar. Por, rritja e fëmijëve të vegjël nuk është një punë e thjeshtë dhe e lehtë, dhe kërkon njohurinë për identifikimin, diturinë, përvojën, përcaktimin dhe këmbënguljen e mentorit apo të prindërve. Është brengosës fakti se shumica e prindërve nuk kanë dituri për artin e rritjes së fëmijëve. Kjo është arsyeja që shumica e fëmijëve nuk formësohen sipas përvijimeve të dëshiruara dhe ata rriten sikur fidanët që nuk mbështeten askund.

Në vendet përparimtare të Lindjes e të Perëndimit rritja e fëmijëve po e merr rëndësinë parësore. Ata kanë bërë hulumtime të shumta në këtë drejtim. Janë botuar libra të shumtë e të dobishëm në lidhje me këtë temë dhe ata kanë ekspertë të shumtë në këtë fushë. Ndërkaq, në vendin tonë nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme ndaj kësaj çështjeje shumë të rëndësishme. Ne kemi vetëm disa persona që kanë njohuri në këtë fushë dhe vetëm disa libra në lidhje me këtë temë, që janë absolutisht të pamjaftueshme. Disa libra janë përkthyer prej gjuhëve tjera, por këta libra që vijnë nga Lindja dhe Perëndimi, kanë dy zbrazëtira të mëdha.

- Zbrazëtira e parë është se, ata libra i trajtojnë vetëm nevojat materiale të studentëve dhe theksi është vënë mbi arsimimin botëror (material) të tyre. Të gjitha hulumtimet sillen vetëm rreth këtyre aspekteve dhe janë plotësisht të pazëshme ndaj aspekteve shpirtërore të jetës së njeriut, duke i injoruar të gjitha referencat që kanë të bëjnë me konceptin e botës tjetër.

Në Perëndim, objektiv i vetëm është formimi i fëmijëve, në mënyrë që mendjet dhe trupat e tyre t'i arrijnë

komforet dhe kënaqësitë e kësaj bote, që kur të rriten t'i kenë në dispozicion kushtet ideale të jetesës. Dhe, nëse këta libra merren me temën e moralit, ata kufizohen vetëm me formimin e virtyteve që janë specifike vetëm për përfitimet e kësaj bote dhe janë plotësisht të pazëshëm në lidhje me shpërblimin apo ndëshkimin që mund të përfitojë ndonjëri duke u bazuar në veprat e tij që i ka kryer gjatë jetës së kësaj bote.

- Zbrazëtira e dytë është se, në Perëndim zgjidhja e problemeve të formimit është e varur vetëm prej përvojave të kaluara dhe statistikave. Nuk ka gjurmë të “Besimit” në këtë proces. Prandaj, këta libra nuk kanë leverdi gjithëpërfshirëse për njerëzit e besimit Islam. Në sytë e myslimanëve, qenia njerëzore i ka dy aspekte të theksuara – i pari është trupi dhe i dyti është shpirti. I pari ka të bëjë me jetën e kësaj bote dhe i dyti me jetën e botës tjetër. Duke pasur parasysh këtë, autori i këtij libri ka vendosur t'i studiojë e t'ua hulumtojë dhe më pas t'ua prezantojë kërkuesve të diturisë përfundimet (konkluzionet) për këtë temë në formë të një libri. Për shkrimin e këtij libri, burimi kryesor i informatave ka qenë Kurani i Shenjtë, librat e traditës (synetit) dhe veprat që kanë të bëjnë me shkencën e moralit. Referencat janë drejtuar edhe ndaj veprave në gjuhën arabe dhe perse, e që kanë të bëjnë me formimin e fëmijëve, psikologjinë e tyre, shëndetin, etj. Janë marrë parasysh edhe librat e shkruar nga ana e dijetarëve iranianë në lidhje me rritjen e fëmijëve. Edhe përvoja personale e autorit ka qenë gjithashtu e dobishme në këtë përpjekje. Shpresohet se ky prezantim modest do të jetë i dobishëm për mentorët që kanë të bëjnë me formimin e mendjeve të ndjeshme të komunitetit mysliman.

Ibrahim Amini Naxhafabadi
Janar 1980

Kapitulli i parë Përgjegjësia e prindërve

Në sytë e Islamit, pozita e babës dhe e nënës është shumë e lartësuar. Allahu, I Dërguari i Shenjtë dhe Imamët e pagabueshëm, i kanë këshilluar njerëzit në lidhje me këtë. Ekzistojnë ajete të shumta në Librin e Shenjtë që kanë të bëjnë me këtë temë. Mënyra e sjelljes shembullore të fëmijëve ndaj prindërve të tyre, është vlerësuar si njëra ndër adhurimet më të mira.

Allahu thotë:

“Zoti yt të ka urdhëruar që ti të adhurosh vetëm Atë dhe të sillesh në mënyrë bamirëse ndaj prindërve” (Kuran, 17:23).

Imam Xhafer Sadiku bën vërejtje:

“Tri vepra janë më të mira: Falja e pesë namazeve të obliguara në kohën e duhur, sjellja e mirë ndaj prindërve dhe lufta në rrugën e Allahut” (Usul al Kafi, libri 2, f. 158).

Tani shtrohet pyetja, pse Allahu ua ka dhënë prindërve besimtarë këtë pozitë aq të lartë dhe a është dhënë kjo pozitë pa ndonjë arsye të posaçme? Çfarë vepër të madhe kryejnë prindërit për fëmijët e tyre që të meritojnë atë pozitë aq të lartësuar? Babai, si rezultat i kënaqjes së dëshirës trupore, e bart spermën e tij në mitrën e nënës ku bashkohet me vezoren e nënës dhe një qenie e re fillon të zhvillohet, që mbas nëntë muajve arrin në këtë botë si një foshnje e dobët. Nëna e ushqen me gji dhe ia jep ushqimin tjetër të nevojshëm. Kohë pas kohe e pastron dhe ia ndërron pelenat; ajo kujdeset për lagështinë dhe thatësinë e saj. Gjatë kësaj kohe, babai kujdeset për shpenzimet që janë të nevojshme për rritjen e fëmijës. A nuk kanë prindërit ndonjë përgjegjësi tjetër përveç kësaj? A është ajo, që për shkak të këtyre përgjegjësive prindërve u është dhuruar kjo pozitë aq e lartë? A kanë vetëm prindërit të drejtë ndaj

pasardhësve të tyre dhe athua edhe fëmijët nuk kanë të drejta për ta? Sipas mendimit tim askush nuk do të pranojë ndonjë privilegj të tillë të njëanshëm. Traditat e të Pagabueshmëve të familjes së të Dërguarit të Shenjtë na bëjnë me dije për këtë:

I Dërguari i Shenjtë i Islamit ka thënë: “Sikur që babai yt ka të drejtë për ty, ashtu edhe fëmijët tuaj kanë të drejta të ngjashme për ty” (Maxhma al zavaid, v. 8, f. 146).

I Dërguari, gjithashtu, ka thënë: “Sikur që fëmijët përjashtohen nga trashëgimia për shkak të mosdëgjimit të tyre, ashtu edhe është e mundur që prindërit të mohohen nga ana e fëmijëve për shkak të mospërmbushjes së të drejtave që u takojnë” (Bihar al-anvar, v. 19, f. 93).

Dhe, i Dërguari ka thënë: “Allahu i mallkon ata prindër që bëhen shkak i përjashtimit të fëmijëve të tyre nga trashëgimia” (Makarim al ahlak, f. 518).

Imam Sexhadi ka thënë: “Fëmijët tuaj kanë të drejtë ndaj teje për faktin që ti i konsideron ata se a janë të mirë apo të këqij. Ti ke qenë shkaktar i lindjes së tyre dhe bota i njeh ata si pasardhësit e tu. Është përgjegjësia jote që ti t’ua mësosh atyre sjelljen e mirë dhe t’i udhëzosh drejt njohjes dhe nënshtrimit ndaj Allahut. Sjellja jote ndaj fëmijëve tuaj duhet të jetë sikur i një personi që beson se veprat e mira do të pranojnë shpërblimin e përshtatshëm, ndërsa trajtimi i keq do të pasohet me ndëshkim” (Makarim al ahlak, f. 484).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë: “Keni kujdes, sjellja juaj mund të pasqyrohet në familjen tënde dhe te të afërmit tuaj, siç pasqyrohet sjellja e njerëzve që e meritojnë ndëshkimin” (Gurar al hukm, f. 802).

I Dërguari ka thënë: “Kushdo që dëshiron që të sigurohet se fëmijët e tij nuk do të përjashtohen prej trashëgimisë, duhet t’u ndihmojë atyre përmes kryerjes së veprave të mira” (Maxhma al zavaid, v 8, f. 158).

I Dërguari, gjithashtu ka thënë: “Çdonjërit që i lind një vajzë, duhet t’ia mësojë normat e sjelljes së mirë dhe të bëjë përpjekje për edukimin e saj. Përpiquni që ajo të bëhet shkak i shpëtimit tuaj prej zjarrit të xhehenemit” (Maxhma al zavaid, v 8, f. 158).

Mbi të gjitha, në Kuranin e Shenjtë, Allahu thotë:

“O besimtarë. Shpëtoni veten dhe familjet tuaja prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët” (Kuran, 66:6).

Koha kur fëmija është në procesin e adaptimit të mënyrës së jetës, që mund ta bëjë atë të virtytshme apo të ligë, është koha më e mirë kur mund të ndikohet tek ai, që ai të ndryshohet në një qenie të përkryer njerëzore apo një shtazë e degraduar dhe e egër. Virtytshmëria apo ligësia e një personi do të varet nga formësimi që do të pranojë edhe kjo përgjegjësi mbi supet e prindërve. Në fakt, prindërit janë instrumente që ia japin formën qenies njerëzore, fëmijët të jenë të mirë apo të këqij. Shërbimi më i madh që prindërit mund t’ua japin fëmijëve të tyre është se ata i përgatisin fëmijët që të përfitojnë sjelljet e mira, të jenë të dashur, të shoqërueshëm me të tjerët, të kuptueshëm, liridashës, guximtarë, të drejtë, të urtë, fisnikë, të besueshëm, përgjegjëses, punëtorë dhe të edukuar. Prindërit duhet t’i formojnë fëmijët e tyre në atë mënyrë që ata të jenë të suksesshëm në këtë dhe në botën tjetër. Vetëm njerëzit e tillë janë të dhuruar me një pozitë të lartësuar të prindërve dhe jo ata që me plotësimin e dëshirave të tyre trupore e kanë shkaktuar lindjen e fëmijës dhe pastaj e kanë lënë fëmijën në mbrojtje të vetvetes, duke u bërë shkaktar të mundshëm të shkuarjes së fëmijës në rrugë të gabuar.

I Dërguari i Shenjtë ka thënë: “Gjëja më e mirë që babai mund të sigurojë për fëmijën e tij është sjellja e mirë dhe formimi i moralit të tij” (Maxhma al zavaid, v. 8, f. 159).

Nëna ka një funksion më të rëndësishëm për të kryer në lidhje me rritjen e fëmijëve. Madje, edhe gjatë shtatzënisë, mënyra e ushqimit të nënës dhe sjellja e saj ndikojnë në zhvillimin e virtyteve të fëmijës në të ardhmen.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Fatlum është ai që baza e virtyteve të tij është formuar në mitrën e nënës dhe i pafat është ai ligësia e të cilit i ka bazat në mitrën e nënës” (Bihar al-anvar, v. 77, fq. 115-133).

“Xheneti është nën këmbët e nënës” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f 38).

Prindërit që nuk i kushtojnë vëmendjen edukimit dhe formimit të fëmijëve të tyre, do të bëhen fajtorë për shkak të kësaj pakujdesie. Prindërit e tillë duhet të pyeten se athua ata kanë bërë marrëveshje me fëmijët e pafajshëm vetëm që t’i lindin dhe pastaj t’i braktisin, sikur dhentë dhe bagëtitë. Tani që ti je bërë shkak i ekzistencës së tij, duke u mbështetur në parimet e religjionit dhe të urtësisë njerëzore, edukimi dhe formimi i tij është përgjegjësia jote obliguese.

Prindërit kanë përgjegjësi edhe ndaj shoqërisë. Fëmijët e sotshëm do të jenë burra e gra, qytetarë të së nesërmes. Fabrika e shoqërisë do të formohet prej këtyre individëve. Çfarëdo mësimi që e mësojnë sot, të nesërmen do ta zbatojnë në praktikë. Nëse formimi i tyre sot është i përkryer, shoqëria e së nesërmes do të jetë e patëmetë. Dhe, nëse gjenerata e sotme e pason programin e gabuar të formimit, është e paevitueshme që shoqëria e nesërme do të bëhet fatkeqe dhe e prishur.

Personalitetet e fushës së politikës, edukimit dhe të shoqërisë, do të shfaqen prej këtyre elementeve. Fëmijët e sodit janë prindërit e së nesërmes. Fëmijët e sodit mund të bëhen reformuesit e së nesërmes. Nëse kanë pranuar trajnimin e mirë nga duart e prindërve të tyre, si rezultat i

kësaj ata mund të vazhdojnë këtë praktikë me fëmijët e tyre. Nëse prindërit punojnë me vullnet, ata mund të bëhen instrumente të reformave të shoqërisë në të ardhmen, ndërsa nëse neglizhohen, ata mund të shkaktojnë shkatërrimin e shoqërisë. Duke ua dhënë fëmijëve të tyre trajnimin e duhur, prindërit mund t'i japin kontribut të madh shoqërisë së tyre.

Edukimi dhe formimi nuk duhet të trajtohen si çështje të parëndësishme. Përpjekjet që prindërit i bëjnë për t'i edukuar fëmijët e tyre dhe vuajtjet që i pësojnë në këtë drejtim, rezultojnë me krijimin e mijëra profesorëve, doktorëve dhe inxhinierëve. Janë prindërit ata që orvaten të ndërtojnë qenien e përkryer njerëzore, mentorët e aftë dhe besimtarë, si dhe profesionistët tjerë.

Posaçërisht, nënat bartin më shumë përgjegjësi për rritjen e fëmijëve. Shumicën e kohës së fëmijërisë, fëmijët i kalojnë me nënat e tyre. Bazat e drejtimit të ardhmërisë së fëmijëve si dhe kufijtë e tyre shtrihen në këtë fondacion. Pra, çelësi i veseve apo i virtyteve të një personi dhe lartësimit apo rënies së një shoqërie, varet prej nënave të shoqërisë. Vendi i nënës nuk është dyshemeja e dyqanit dhe pozitat ministrore apo administrative. Këto funksione nuk e përcaktojnë sa duhet rëndësinë e gruas si një nënë. Nënat i rrisin qeniet e përkryera njerëzore. Ministrat e drejtë, juristët dhe profesorët këto pozita ia kanë borxh kujdesit të përzemërt që e kanë pranuar prej nënave të tyre gjatë viteve kur janë bërë hapat e para të formimit të personalitetit të tyre.

Prindërit që i rrisin fëmijët e sigurtë dhe besimtarë, jo vetëm që bëhen të dobishëm për fëmijët e tyre dhe për shoqërinë, por gjithashtu formojnë një vend të ngrohtë për vetveten në shoqëri. Këta fëmijë do t'u ndihmojnë prindërve të tyre në pleqërinë e tyre të thyer. Nëse prindërit nuk bëjnë përpjekje drejt edukimit dhe rritjes së fëmijëve të

tyre, ata do t'i mbledhin frytet e mundimeve të tyre edhe gjatë kohës së jetës së tyre në këtë botë.

Aliu, Urdhëruesi i besimtarëve thotë:

“Pasardhësi i lig është ndër vuajtjet më të rënda për prindërit” (Guraral hukm, f. 189).

“Pasardhësi i lig shkakton humbjen e respektit për prindërit, ndërsa trashëgimtarët janë të turpëruar” (Guraral hukm, f. 780).

I Dërguari i Islamit ka thënë:

“Allahu le t'i bekojë prindërit që i trajtojnë fëmijët e tyre që të sillen me drejtësi ndaj tyre” (Makarim al ahlak, f. 517).

Prandaj, ata që arrijnë të bëhen prindër, bartin një përgjegjësi të madhe mbi supet e tyre. Kjo përgjegjësi është ndaj Allahut të Gjithëfuqishëm, ndaj qenieve tjera njerëzore dhe ndaj fëmijëve të tyre. Nëse e kryejnë përgjegjësinë në mënyrë të duhur, ata do të shpërblehen në këtë dhe në botën tjetër. Por, nëse dështojnë në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, atëherë vetë ata do të bëhen humbës dhe do të jenë baras me ata që i kanë mashtruar fëmijët e tyre dhe shoqërinë, dhe do të bëhen ndër ata që e kanë kryer mëkatin e pafalshëm.

Kapitulli i dytë

Dituria dhe kooperimi i dyanshëm i edukuesve

Formimi dhe rritja e fëmijës nuk është një detyrë e lehtë dhe e thjeshtë që prindërit mund ta kryejnë me një përpjekje të vogël apo pa u përpjekur fare. Kjo detyrë, në fakt, kërkon trajtim delikat dhe karakter. Ekzistojnë një mori të çështjeve delikate që duhet të merren në konsideratë në mënyrë që të arrihet sukcesi përmes përpjekjeve. Mentori duhet ta lidhë veten me shpirtin e fëmijës. Ai nuk mund të kryejë detyrën pa i njohur hollësisht shpirtërore, psikologjike, edukuese dhe praktike të punës. Bota e fëmijës është një botë në vete dhe imagjinata e fantazia e tij do të jetë unike për të. Kjo nuk mund të krahasohet me procesin mendor të të rriturve. Shpirti i fëmijës është shumë delikat dhe i ndjeshëm. Fëmija është një qenie njerëzore në miniaturë që ende nuk e ka arritur identitetin e përhershëm por ka kapacitet që të arrijë këtë ndryshim. Mentori i fëmijës duhet të jetë i aftë që të kuptojë dhe identifikojë qenien njerëzore, si dhe të identifikojë mendjen e fëmijës. Ai duhet të ketë syrin e mprehtë për t'i vërejtur ndërlikimet e procesit të rritjes. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm për aftësitë dhe dobësitë njerëzore. Ai duhet të ketë ndjenjën e përgjegjësisë dhe interesimin e fortë për këtë punë. Ai duhet të jetë i durueshëm dhe i qëndrueshëm në mënyrë që puna e vështirë mos ta mbizotërojë atë. Përveç kësaj, rregullat e trajnimit nuk duhen të jenë të ashpra dhe nuk mund të zbatohen njëjtë në të gjitha rrethanat. Në fakt, këto rregulla të trajnimit duhet të modifikohen dhe të zbatohen për çdo fëmijë duke u bazuar në aftësitë fizike dhe mentale të tyre. Prindërit duhet të vërejnë mirë ndërtimin trupor të fëmijës dhe ta edukojnë atë duke e pasur parasysh këtë faktor.

Përndryshe, përpjekjet nuk mund të na çojnë deri te rezultati i dëshiruar.

Burri dhe gruaja duhet të kërkojnë njohuri në lidhje me edukimin dhe trajnimin e fëmijës para lindjes së tij. Edukimi i fëmijës fillon me lindjen e tij, në të vërtetë, prej kohës kur nëna ka mbetur shtatzënë. Gjatë kësaj kohe, vendosen themelet e natyrës së fëmijës dhe natyra, sjellja dhe procesi i të menduarit të tij fillojnë ta marrin formën.

Nuk është e drejtë që prindërit të rrinë duarkryq gjatë kësaj periudhe që në dukje është një periudhë e përgjumur.

Ata e shtyjnë fillimin e formimit të atij që do të arrijë deri në momentin kur të arrijë aktualisht. Ata mundohen ta mbajnë anash këtë detyrë derisa fëmija të jetë i aftë të dallojë sjelljen e mirë nga e keqja. Është shumë më lehtë të korrigjohen mangësitë e sjelljeve në kohën më të hershme, përderisa mund të jetë më vështirë apo ndoshta e pamundur që këto sjellje të korrigjohen njëherë kur veç formohet shprehia e tij.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:

“Puna më e vështirë është ndryshimi i shprehive të njerëzve” (Guroral Hukm, f. 181).

“Shprehitë vendosen te njerëzit” (Guroral Hukm, f. 580).

“Shprehitë bëhen natyra e dytë e njerëzve” (Guroral Hukm, f. 260).

Evitimi i shprehive është aq vështirë saqë veprimi në këtë drejtim konsiderohet si një ndër adhurimet më të mira.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:

“Evitimi i shprehive të këqija është ndër adhurimet më dashamirëse” (Guroral Hukm, f.176).

Edhe një faktor tjetër me rëndësi, gjatë dhënies së trajnimit ideal ndaj fëmijëve është koordinimi dhe

kooperimi ndërmjet prindërve dhe mentorëve tjerë, sikur i gjyshit apo gjyshes, në zbatimin e programit trajnues. Përpjekjet e tyre të përbashkëta do të rezultojnë me rezultatet e dëshiruara. Por, nëse ndonjëri prej tyre e mban qëndrimin mospërfillës ndaj procesit të trajnimit, rezultati mund të mos jetë i dëshiruar.

Fëmija duhet të jetë i vetëdijshëm për obligimet e tij. Kur prindërit i japin drejtime të kundërta, fëmija do të hutohet. Posaçërisht, nëse ata insistojnë në pikëpamjet e tyre të kundërta, atëherë ka gjasa të paraqites së rezultatit negativ gjatë procesit të formimit të fëmijës. Vështirësia më e madhe gjatë formimit të fëmijës paraqitet kur babai sjell një vendim në lidhje me fëmijën, ndërsa nëna, gjyshi apo gjyshja, insistojnë në drejtimin e kundërt. Gjithmonë duhet të ketë nevojë për një mirëkuptim ndërmjet mentorëve, që fëmija duhet të jetë i aftë që të kuptojë qartë se çka duhet të bëjë, ndërsa ideja e veprimit në ndonjë mënyrë të kundërt të mos depërtojë në mendjen e tij.

Ndonjëherë ndodh që babai është i edukuar mirë dhe se është i matur, ndërsa nëna e fëmijës është tëmperamente dhe e paedukuar. Ndonjëherë situata është e kundërt, kur nëna është e pajisur më mirë për të trajnuar fëmijën ndërsa babai nuk është. Shumë familje përballen me këtë problem. Në familje të tilla fëmijët nuk e pranojnë formimin e duhur. Por, kjo nuk do të thotë se prindërit duhet t'i ngrijnë duart lart nga formësimi i drejtë i fëmijëve të tyre.

Në këto situata të vështira, përgjegjësia bëhet më e theksuar. Në situata të tilla, duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe programit të edukimit të fëmijës. Prindërit duhet të bëjnë përpjekje më të sinqerta në mënyrë që ta tejkalojnë zbrazëtirën në karakterin dhe sjelljen e tyre, dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje fëmijës së tyre. Me vepra të mira prindërit mund ta tërheqin vëmendjen e fëmijës dhe

të vendosin shembullin e dëshiruar para tij. Vepra e prindërve duhet t'i ndihmojë fëmijës që të vendosë se çka është e mirë për të dhe çka nuk është. Nëse mentori është i mençur, duke qenë i kujdesshëm dhe i durueshëm, mund të evitojë ndikimin negativ të sjelljes së gruas së tij në trajnimin e fëmijës. Padyshim që kjo është një detyrë e vështirë, por nuk ka tjetër rrugëdalje.

Një intelektual, ka thënë:

“Familja do të jetë ideale nëse babai dhe nëna mendojnë njëjtë në lidhje me rritjen e fëmijëve dhe janë të aftë të formojnë karakterin dhe veprat e tyre në përputhje me ndikimin në ndjenjat e fëmijëve. Qeliza familjare është një shoqëri e vogël në të cilën karakteri moral i fëmijëve merr formën përfundimtare. Në përgjithësi, familja në të cilën anëtarët e saj sillen në mënyrë miqësore ndaj fëmijëve, fëmijët janë zemërbutë, kanë respekt për vetveten dhe janë të matur. Përkundër kësaj, familja ku prindërit kanë shprehinë e kundërshtimit të njëri tjetrit, fëmijët e tyre do të jenë moralisht të mangët, pretendues dhe nervozë.

Formimi përmes veprave, jo vetëm përmes fjalëve

Shumica e prindërve mendojnë se këshillat gojore të rastit në lidhje me ato se çka duhet bërë apo nuk duhet bërë, janë të mjaftueshme për një rritje të mirë të fëmijëve. Ata mendojnë se në këtë mënyrë janë kujdesur për rritjen e fëmijëve dhe se nuk kanë të bëjnë asgjë tjetër me rritjen e tyre që kanë të bëjnë me pozitat tjera shoqërore. Kjo është arsyeja se pse prindërit e tillë ndjejnë se nuk kanë nevojë të mendojnë për rritjen e fëmijëve përderisa fëmija është shumë i vogël. Ata thonë se fëmija është ende i vogël dhe nuk është në gjendje të kuptojë asgjë lidhur me rritjen. Kur fëmija e arrin moshën e të kuptuarit, tek atëherë ata fillojnë të mendojnë për rritjen e tij. Kjo është periudha e jetës së

fëmijës kur ai fillon të dallojë të mirën nga e keqja. Kjo mënyrë e të menduarit është e gabuar, sepse fëmija është i gatshëm të trajnohet që nga dita kur vjen në këtë botë. Ai formohet në çdo çast dhe natyra e tij modelohet në një mënyrë të veçantë. A janë të vetëdijshëm prindërit për këtë apo jo, fëmija nuk pret për ndonjë iniciativë nga ana e tyre. Mendja aktive e fëmijës dhe ndjenjat tjera janë sikur kamera që i incizon e i rruan imazhet e asaj se çka po ndodh në rrethinën e tij. Fëmija i moshës prej pesë deri në gjashtë vjet, do të përfitojë një karakter të caktuar. Shprehitë e mira dhe të këqija do të rrenjosen në natyrën e tij dhe do të jetë një punë e vështirë të bëhen ndryshimet rreth sjelljes së tij. Fëmija, në të vërtetë është një imitues. Ai mundohet t'i imitojë prindërit e tij dhe ata që e rrethojnë atë. Fëmija i shikon prindërit me një dozë të respektit dhe mundohet të kopjojë stilin e jetës së tyre. Veprimet e tyre bëhen masë matëse për veprat e mira dhe të këqija. Natyra e fëmijës nuk është e derdhur në një kallëp por atë e pranon prej prindërve të tij si një shembull që i pason. Fëmija varet më tepër prej sjelljeve të prindërve që i merr si një model për veprat e tij, sesa prej ndonjë sasive të predikimit.

Vajza e vështrohet nënën e saj dhe mëson hollësisht e mbajtjes së shtëpisë. Ndërsa edhe babanë e shikon duke e kuptuar natyrën e meshkujve. Djali merr mësimet për jetën nga veprat e babait, ndërsa për natyrën e femrave ai mëson nga sjelljet e nënës.

Prandaj, është e domosdoshme që njerëzit e përgjegjshëm ta reformojnë vetveten që në fillim dhe nëse kanë të meta në sjelljet e tyre, duhet t'i evitojnë ato. Thënë shkurt, ata duhet ta transformojnë veten në një qenie të sjellshme humane para se të nisen në rrugën e prindërve.

Prindërit duhet të mendojnë për atë se çfarë pasardhës kanë dëshirë t'i japin shoqërisë. Nëse mendojnë se fëmija i tyre duhet të jetë një person që është moralisht i

lartësuar, i sjellshëm, human, liridashës dhe i përgjegjshëm, atëherë edhe ata duhet t'i zotërojnë këto karakteristika, në mënyrë që të jenë një shembull për ata në këtë drejtim. Nëse nëna dëshiron që vajza e saj të jetë një person me përgjegjësi, e dashur dhe e përmbajtur, që i respekton ndjenjat e bashkëshortit të saj, atëherë vetë ajo duhet të mundohet që ta përshtatë veten brenda këtyre normave. Vajza do të vështrojë modelin e sjelljes së nënës dhe në mënyrë automatike do ta formojë veten në të njëjtën mënyrë. Nëse nëna është një person temperament, përtace, e parregullt, e shkujdesur dhe egoiste, atëherë nuk mund të presim që ajo ta formojë vajzën e saj vetëm përmes predikimeve për normat e mirësjelljes. Vetëm ata persona që kanë pasur formim të ngjashëm për veten gjatë fëmijërisë së tyre, mund t'i formojnë fëmijët e tyre në mënyrë të duhur. Ata do të kuptojnë më mirë natyrën dhe psikologjinë e fëmijëve. Prindërit që kanë pasur mospajtime dhe që janë grindur për shkak të gjërave të parëndësishme, do të jenë të paaftë për edukimin dhe rritjen e fëmijëve. Ngjashëm, edhe edukuesit profesionalë që kanë pranuar detyrën e trajnimit vetëm për shkak të shpërblimit material, që janë të padurueshëm, nervozë dhe që nuk kanë mirëkuptim për natyrën dhe psikologjinë e fëmijëve, nuk do të jenë në gjendje t'i zbatojnë trajnimet në mënyrën e duhur.

Dr. Xhelali shkruan:

“Çdokush që e bart përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve, duhet që herë pas here ta bëjë analizën e karakterit dhe të sjelljes së tij, t'i kuptojë përgjegjësitë e tij dhe të mundohet t'i korrigjojë dështimet”.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:

“Personi që udhëheq duhet së pari ta reformojë vetveten dhe pastaj të mundohet t'i korrigjojë të tjerët. Para se t'ua mësojë të tjerëve normat e mirësjelljes, ai duhet vetë

të bëhet shembull. Njëri që e edukon veten me mësim dhe sjellje, meriton më shumë respekt sesa ai që vetëm ua mëson të tjerëve normat e mirësjelljes” (Nehxh-ul Belaga).

“Respektoji të vjetrit tuaj, që fëmijët tuaj të të respektojnë ty” (Guroral Hukm, f. 546).

“Nëse dëshironi t’i reformoni të tjerët, atëherë filloni me reformimin e vetvetes. Nëse keni dëshirë t’i korrigjoni të tjerët, ndërsa veten ta mbani me të meta, atëherë kjo do të jetë njolloksja më e madhe” (Guroral Hukm, f. 278).

“Kur gjuha që flet është e heshtur në predikim dhe veprat e predikuesve flasin për veten, atëherë asnjë vesh nuk mund të mos e dëgjoj këtë predikimin dhe asgjë nuk është më e dobishme sesa kjo” (Guroral Hukm, f. 232).

Një grua, shkruan në një letër:

“...karakteri i prindërve të mi më ka lënë përshtypje të thellë për mua. Ata kanë qenë gjithmonë të sjellshëm ndaj fëmijëve të tyre. Unë kurrë nuk kam gjetur ndonjë të metë në fjalët apo veprat e tyre. Edhe ne e kemi përfituar këtë karakter. Nuk mund të harroj karakterin dhe sjelljen e tyre të mirë. Tani që edhe vetë jam bërë nënë, përpiqem të mos bëj diçka që konsiderohet jo e mirë në prezencën e fëmijëve. Karakteri i prindërve të mi, është një karakter shembull të cilin e pasoj gjatë jetës sime. Mundohem që edhe fëmijët e mi t’i trajtoj në mënyrë të njëjtë.”

Një grua tjetër, shkruan në letrën e saj:

“Kur e mendoj moshën time të mëhershme, më kujtohet se si nëna ime kishte shprehur të grindet dhe të bërtasë për gjërat e parëndësishme. Tani që edhe vetë jam bërë nënë po ndiej se me një ndryshim të vogël gjendja ime është përafërsisht e njëjtë me atë të nënës sime. Të gjitha sjelljet e saj të këqija janë bërë pjesë e karakterit tim. Është e çuditshme se sado që mundohem të reformoj vetveten, nuk jam në gjendje të bëj ndonjë përparim të madh në këtë

drejtim. Është vërtetuar në mënyrë definitive në rastin tim se, karakteri dhe sjellja e prindërve kanë efekte me ndikim afatgjatë në formimin e karakterit të fëmijëve të tyre. Prandaj, është e vërtetë thënia se nëna që i trajnon mirë fëmijët mund ta ndërrojë botën.”

Kapitulli i tretë

Përmbajtja nga dallimet ndërmjet bashkëshortëve

Për fëmijën, shtëpia është sikur foleja. Ai e ndien veten shumë të lidhur me të. Zemra e tij është gjithmonë e lidhur për të. Nëse prindërit e tij sillen mirë ndaj tij, foleja e tij do të mbetet e qëndrueshme sikur një prehër e ngrohtë. Në një shtëripi të tillë fëmija e ndjen veten të sigurt dhe të kënaqur. Fillimi i rritjes në një atmosferë të tillë të pëlqyeshme do të ndikojë që të vijë në shprehje kualitetet dhe aftësitë e fshehura të fëmijës dhe kjo do të tregojë rezultate të dobishme. Por, nëse prindërit janë persona nervozë dhe grindavecë, atëherë fëmija do ta humbë qetësinë dhe kënaqësinë dhe do të bëhet i shqetësuar dhe nervoz. Prindërit që fjalosen dhe grinden nuk i vërejnë ndjenjat e fëmijëve të gjorë. Në një situatë të tillë, fëmijët frikësohen dhe me zemra të thyera ata kërkojnë një qoshe që ta fshehin veten duke u pyetur se pse prindërit e tyre sillen në atë mënyrë. Në të kundërtën, ata kërkojnë rrugët e ikjes prej folesë që ka qenë aq e dashur për ta dhe kërkojnë strehim në ndonjë rrugicë apo treg. Kujtimet më të hidhura të fëmijëve janë momentet kur prindërit e tyre janë urreyer, janë fjalosur me zë të lartë dhe janë grindur. Fëmijët nuk mund t'i harrojnë skenat e tilla deri në moshën e thyer të jetës së tyre. Këto ngjarje mbesin të gdhendura në psikologjinë e tyre dhe kanë efekte të dëmshme në natyrat e tyre.

Fëmijët e tillë i kanë zemrat e dobëta dhe psikologjinë e vonuar. Ata do të bëhen zemërthyer dhe do të jetojnë jetën e të pafatit. Është e mundur që vajzat e prindërve të tillë të fitojnë një përshtypje se të gjithë meshkujt janë të vrazhdë e të ashpër, ashtu siç është babai i saj. Kjo mund të çojë deri te shkaktimi i neverisë te ajo kur të mendojë për martesën. Gjithashtu, është e mundur që

djemtë e shtëpive të tilla të mendojnë se të gjitha gratë i kanë sjelljet e këqija sikur nënat e tyre dhe ndodh të vendosin që të mbeten të pamartuar gjatë tërësjetës së tyre. Në një mjedis të tillë, fëmijët bëhen të pabindur dhe fillojnë t'i urrejnë prindërit, ndërsa gjërat vijnë deri aty, që disa fëmijë bëhen edhe hakmarrës. Statistikat na tregojnë se shumë nga fëmijët bredhës, alkoolistë dhe antisocialë, janë bërë të tillë si pasojë e atmosferës së çrregulluar në shtëpi.

Nëse ndonjëri mendon për ngjarjet e hidhura të fëmijërisë, kur prindërit e tyre kanë pasur dallime të hidhura, atëherë ai do të ndjejë se përkundër kalimit të viteve të shumta, kujtimet e pakëndshme do të mbesin të gdhendura në mendjen e tij.

Një intelektual shkruan:

“Prindërit duhet të dinë faktin se kur ndodh një fjalosje apo grindje në mes më të vjetërve të shtëpisë, kjo do të ketë efekte të dëmshme në psikologjinë e fëmijëve. Lloji i marrëdhënieve që të vjetrit i kanë në mes veti, do të kenë efektin e caktuar në zhvillimin e fëmijëve...nëse atmosfera e unitetit dhe e paqes mungon në shtëpi, atëherë nuk është e mundur të zbatohet trajnimi i duhur ndaj fëmijëve. Kur më të vjetrit bëhen më grindavecë dhe më të shqetësuar, ata harrojnë se fëmijët e ndjeshëm janë me ta dhe se ata janë që e bartin përgjegjësinë për rritjen e tyre. Në një atmosferë të tillë, fëmijët nuk i marrin mësimet e mira. Fëmijët bëhen të izoluar dhe me karakter të sëmurë. Posaçërisht, fëmijët më të rritur e gjejnë veten në një situatë shumë të rëndë. Zemrat e tyre vajtojnë për shkak të sjelljes së babait. Ata janë të paafte të vendosin se cilën anë duhet të mbajnë. Në disa raste të tilla, ata i kundërshtojnë të dy prindërit.

Një person tjetër, shkruan një letër:

“...prej incidenteve më të pakëndshme të fëmijërisë që më kanë mbetur, në mendjen time më së shumti janë të

gdhendura ato kur prindërit e mi fjaloseshin në mes veti me një gjuhë fyese të ndërsjellët. Gjatë këtyre incidenteve, unë bashkë me vëllanë dhe motrën time qëndronim në një kënd të dhomës duke u dridhur. Përderisa grindja vazhdonte, ne i shikonim pa pasur mundësi të kërkojmë ndihmë. Më kujtohet kur motra ime qante gjatë kohës sa zgjatnin grindjet dhe këto kriza zgjatnin shumë. Ajo tani është viktimë e streseve nervore. Si duket, grindjet e prindërve tanë, kanë lënë efekte shumë të këqija në shpirtin e motrës sime...”

Një person tjetër, shkruan:

“...mendimet për ngjarjet e pakëndshme nuk e lënë të qetë mendjen time. Babai im ka pasur sjelljet e këqija, ka qenë nervoz dhe egoist. Ai i shpikte arsyetimet për t’u grindur në shtëpi dhe bërtiste në çdonjërin. Prindërit tanë kishin bërë shprehi grindjen dhe këtë e bënin çdo ditë. Çuditë se si nuk janë lodhur apo mërzitur prej një gjëje të tillë. Grindja bëhej zakonisht për gjërat e parëndësishme. Nuk ka pasur net që unë kam shkuar në shtrat pa derdhur lot. Kjo ka qenë arsyeja se pse nervat e mia ishin dobësuar. Unë jam person i frikshëm dhe i shoh ëndrrat e këqija. Jam konsultuar me mjekë të cilët më kanë thënë se arsyeja e një gjendjeje të tillë qëndron nën ndikimin e atmosferës së shtëpisë sime. Ai thotë se nuk ka shërim për këtë përveç pushimit të qetë në shtëpi. Ditët e mia të lumtura filluan kur u martova dhe u largova prej shtëpisë së prindërve. Tani, edhe pse jeta ime është e qetë, kam ndjenjë se jam një person i shkatërruar dhe se nuk mund të bëj ndonjë përparim në jetë. U bëj thirrje prindërve, **Në emër të Zotit, nëse keni mosmarrëveshje, mos u grinduni përpara fëmijëve tuaj!**”

Më tutje ai vazhdon në letrën e njëjtë:

“Incidenti më i rëndë në jetën time kishte ndodhur kur i kisha tetë vjet. Atë ditë prindërit e mi qenë grindur

keq. Të gjithë fëmijët vrapuam nëpër qoshe. Ngjarja la ndikim shumë të keq në shpirtin tim dhe për një kohë shumë të gjatë nuk mund ta fshija nga kujtimi. Isha i mërzhitur nga familja dhe nga vetvetja. Mendoja edhe atë që nga shkolla të mos kthehesha në shtëpi. Kisha zakon të bëja lutje të fshehtë Zotit që të vdes prej ndonjë sëmundjeje të rëndë. Shumë herë mendoja edhe në vetëvrasje. Disa herë kam parë ëndërr se isha martuar dhe grindesha me gruan time. Gjatë ëndrrave të tilla planifikoja strategjinë për mbrojtjen e të drejtave të mia. Mbasi që u martova, disa herë fillova të grindem me gruan time në mënyrë që t'i demonstroj asaj se jam një person nervoz. Për fat të mirë, gruaja ime e kishte natyrën e qetë. Ajo më trajtoi me dashuri dhe më bindi përmes fakteve të mira dhe këshillave. Ishte fati im i mirë që sjellja e keqe nuk zgjati shumë kohë në mua. Kur i përkujtoj gabimet e prindërve të mi, ia bëj vetes një analizë për gabimet e mia, në mënyrë që të mos i përsërisja të njëjtat edhe unë, dhe kështu, mundohesha fort që ta përmirësoj natyrën time. Tani jam duke jetuar një jetë të qetë.”

Një zotëri tjetër, shkruan:

“...Kur isha nëntëvjeçar, prindërit e mi u ndanë për shkak të dallimeve të mëdha që kishin në mes veti. Ata më lanë mua, motrën dhe vëllanë tim nën kujdesin e gjyshit. Për shkak të kësaj ngjarjeje, shumë shpesh qanim. Gjatë vizitave që i bënte nëna, kisha zakon të shoh në ëndërr se nuk kisha dëshirë të shkoja në shtëpinë e babait. Mbas një kohe të shkurtër, të afërmit dashamirës, intervenuan dhe ia arritën që të ribashkohen prindërit e mi. Nëna u kthye në shtëpinë tonë. Gjatë asaj kohe të shkurtër, kjo kishte ndikuar në shpirtin tim aq shumë sa që ende ndihem i pikëlluar në lidhje me këtë rast. Tani jam duke u përpjekur sa më shumë që sa herë të lajmërohen dallimet në mes meje

dhe gruas sime, të mos i shfaq ndjenjat e mia përpara fëmijëve”.

Në një letër tjetër, lexojmë:

“...ekzistojnë shumë kujtime të hidhura në lidhje me fëmijërinë time dhe shumë pak të këndshme. Kur i kujtoj ato ditë, bëhem i pikëlluar dhe nuk jam në gjendje t’i kontrolloj lotët që rrjedhin prej syve të mi. Arsyeja e këtij pikëllimi është se prindërit e mi gjithmonë janë fjalosur e janë grindur. Në këtë mënyrë, e vështirësuan jetën time, të vëllezërve e të motrave të mia. Tani, ne jemi një familje prej tetë fëmijëve. Unë kurrë nuk jam fjalosur me burrin tim, në mënyrë që të mos bëhem shkaktare e hidhësisë së burrit dhe të fëmijëve të mi.”

Në një letër tjetër, shkruan:

“Moshë pesëvjeçare është moshë më e mirë e fëmijërisë. Kur isha në këtë moshë, u shfaqën dallimet e hidhura në mes të prindërve. Babai im solli gruan e dytë. Për shkak të këtyre dallimeve nëna u shkurorëzua prej babait tim. Ne ishim gashtë, vëllezër e motra. Një ditë ishte fatkeqe për mua. Isha duke luajtur me njërin prej vëllezërve, kur nëna jonë erdhi për të na thënë lamtumirën. Zoti e di se sa ishim të pikëlluar ne fëmijët. Nëna jonë u largua dhe ne mbetëm me nënën tonë të re (njerken). Ne qëndruam larg nënës sonë të re për dy vjet duke e bartur neglizhencën që babai ynë pat treguar ndaj nesh. Një ditë erdhi nëna jonë dhe më mori mua bashkë me një vëlla tjetër në shtëpinë e saj. Ajo kishte trashëguar një pronë nga nëna e saj. Me atë trashëgimi ajo na mbajti dhe na ka rritur. Më vonë, edhe vëllezërit dhe motrat tjera na u bashkuan. Nëna kujdesej për ne edhe si nënë edhe si baba. Ne kurrë nuk mund të harrojmë guximin dhe sakrificën e saj.”

Një grua tjetër, shkruan:

“...prindërit e mi kishin zakon të grindeshin dhe për këtë arsye në shtëpinë time kishte çrregullime. Isha tetë

vjeç kur nëna shkoi dhe të gjitha motrat dhe vëllezërit i la nën kujdesin tim. Motrat dhe vëllezërit ishin të moshës dy, katër dhe gjashtë vjeçare. Unë u mundoja të kujdesem për ta me të gjitha aftësitë e mia. Ndonjëherë babai më rrihte. Përkundër të gjitha vështirësive, unë u mundohesha ta vazhdoja shkollimin por nuk arrita të shkoja rregullisht në mësim. Mësuesit e mi ishin të vetëdijshëm për vështirësitë që i kisha. Unë iu dhimbshesha atyre dhe ata më qitnin nota kaluese. Në rrethana të tilla, arrita ta përfundoja vetëm shkollën e mesme të ulët. Tani edhe vetë jam nënë. Përpiqem me gjithë fuqinë time që dallimet mos të më shqetësojnë mua dhe familjen time”.

Prindërit që i ndiejnë përgjegjësitë e tyre dhe që kanë interesim për rritjen e mirë të fëmijëve të tyre, përmbahen prej shkaktimit të dallimeve dhe grindjeve në familje dhe ata me çdo kusht u shmangen fjalosjeve dhe grindjeve përpara fëmijëve. Ata nuk janë në gjendjen më të keqe sesa prindërit e tyre që i kanë shqetësuar fëmijët përmes zënkave në prezencën e tyre dhe pastaj i kanë braktisur ata. Nëse ata i kuptojnë ndjenjat e fëmijëve gjatë mungesës së tyre, sado të shkurtra të jenë ato, ata kurrë nuk do të grindeshin më. Ngjarjet e tilla do të mbesin në kujtimet e çdonjërit deri në fund të jetës së tij. Sidoqoftë, është i vogël numri i familjeve ku nuk paraqiten dallimet në mendime. Por, në jetën martesore gjithmonë ka nevojë për rivendosje të marrëdhënieve. Qiftet e mençura i zgjedhin dallimet e tyre me diskutime të qeta e të ftohta. Nëse fëmijët kuptojnë për dallimet ndërmjet prindërve të tyre, ata duhet ta zgjedhin këtë çështje me urtësi, t'i bindin fëmijët se çështja është zgjidhur dhe nuk ka nevojë më të brengosen. Prindërit duhet të kujdesen dhe të mos flasin për shkurorezimin në vendet ku mund të dëgjojnë fëmijët. Kjo, jo vetëm që ndikon në jetën e tyre martesore, por mund të shkaktojë edhe dëme në mendjet e tyre delikate. Ndarja e

burrit dhe e gruas është një padrejtësi e rëndë për fëmijët. Ata ndiejnë se foleja e tyre po gremiset dhe jeta e tyre është duke u shkatërruar. Kjo është e natyrshme, sepse fëmijët i duan të dy prindërit dhe nuk mund të paramendojnë që ndonjëri prej tyre t'i braktisë ata. Nëse fëmijët mbesin nën mbikëqyrjen e babait mbas shkurorëzimit dhe ai martohet me një grua të dytë, prej fëmijëve do të kërkohet të jetojnë pa dëshirën e tyre nën kujdesin e njerkes. Sado e mirë dhe e butë të jetë njerka, ajo nuk mund ta zërë vendin e nënës së vërtetë. Vëreja e përgjithshme është se njerkat nuk kujdesen aq shumë për fëmijët e burrit. Gazetat shkruajnë shumë tregime për keqtrajtimet e fëmijëve që gjenden në duart e njerkave. Nëse fëmijët i kthehen kujdesit të nënës së vërtetë, ata prapë do të ndiejnë zbrazëtinë e krijuar nga mungesa e babit. Dhe, nëse prindërit janë aq të pavëmendshëm dhe fëmijët ua lënë prindërve që i birësojnë, kjo do të jetë shumë dëshpëruese për fëmijët.

Sidoqoftë, burri dhe gruaja janë të lirë përderisa nuk kanë fëmijë. Por duhet ta shtojnë përgjegjësinë në kohën kur të vijnë fëmijët dhe kjo është koha kur duhet të bëjnë përpjekje të sinqerta që t'i evitojnë dallimet serioze në mes tyre. Ata duhet ta mbrojnë atmosferën e mirë të shtëpisë dhe të mos bëhen shkaktarë të brengës për fëmijët. Në të kundërtën, do të japin përgjegjësi dhe do të bëhen subjekt i ndëshkimit në Gjyqin e Allahut.

Kapitulli i katërt

Fillimi i jetës si nënë

Kur sperma e mashkullit futet në mitrën e femrës dhe bashkohet me vezoren (ovuli), nis procesi i pjelljes (fekondimit) dhe femra fillon të bëhet nënë. Vezorja e pllenuar fillon metamorfozën e shpejtë dhe në fund arrin formën përfundimtare të qenies njerëzore. Në fakt, mosha e një personi mund të llogaritet prej ditës kur ka filluar procesi i pllenimit.

Një intelektual, shkruan:

“Kur një person të arrijë në këtë botë, ai veç i ka kompletuar nëntë muaj të moshës së tij. Në këta nëntë muaj paraprakë, ai kalon përmes një metamorfoze që ia përcakton formën përfundimtare të një qenieje njerëzore komplete që do të jetojë një jetë të plotë.”

Kur femra mbetet shtatzëne, prej atij momenti ajo bëhet nënë. Ajo e bart përgjegjësinë për zhvillimin e fëmijës në mitrën e saj. Është fakt se mikroorganizmi (embrioni) i babës ka ndikim në trashëgiminë ligjore dhe në pamjen psikologjike e fizike të personit, por e ardhmja e fëmijës varet më shumë nga kujdesi i nënës. Mikroorganizmi i babës është sikur fara por zhvillimi i tij varet më shumë nga mjedisi në të cilin mbillet.

Një intelektual tjetër, shkruan:

“Prindërit e fëmijës mund të sigurojnë mjedisin për zhvillim, që është ideale për përparimin e tij, por mund edhe të ofrojnë një mjedis që është edhe i mangët për zhvillimin optimal. Nëse mjedisi për zhvillim nuk është i përshtatshëm, kjo nuk është e pëlqyeshme për shpirtin e pavdekshëm të pasardhësit. Për këtë arsye, prindërit bartin përgjegjësinë e madhe për rritjen e fëmijës.”

Mbarëvajtja, sëmundja, fuqia, dobësia, pamja, karakteri i çdo personi e merr formën e vet në mitrën e

nënës. Themelet e moralit dhe të fatit të fëmijëve vendosen në mitrën e nënës.

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Fati, i mirë apo i keq i një personi, përcaktohet kur ai gjendet në mitrën e nënës.” (Bihar al-anvar v. 77, f. 115).

Shtatzënia është një periudhë shumë delikate dhe ia përcjell një përgjegjësi të madhe nënës. Gruaja që është e vetëdijshme për përgjegjësinë e saj, nuk e konsideron shtatzëninë si një kohë të zakonshme dhe nuk duhet të jetë e pakujdesshme për sjelljen e saj. Ajo e di se edhe një pakujdesi e vogël, do të ketë ndikim në shëndetin e saj, dhe foshnja që e bart mund të dëmtohet keq. Ky dëmtrim mund të jetë aq i rëndë sa që fëmija mund të vijë në këtë botë me defekte të përhershme, dhe këto defekte, ky person mban gjatë tërë jetës.

Një intelektual tjetër, shkruan:

“Trupi i nënës dhe zhvillimet që janë të lidhur me të kanë një ndikim në fëmijën që e bart. Fëmija në mitrën e nënës është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve që i pëson trupi i saj. Kjo, për arsye se trupi i nënës bashkë me embrionin në mitër është një tërësi e vetme dhe fëmija brenda saj është në zhvillim e sipër për të marrë formën përfundimtare. Prandaj, detyrë e çdo nëne që është duke pritur foshnjën, është që, ta mbajë gjendjen sa më të mirë në mitrën e saj. Ajo mund të arrijë sukses në këtë nëse di se cilat zhvillime mund të kenë ndikim pozitiv dhe cilat jo të fëmija. Nëna e kujdesshme mund të sigurojë gjendjen e mirë për një zhvillim ideal të fëmijës në mitrën e saj. Një gjendje ideale për një fëmijë gjatë kohës së shtatzënisë dhe menjëherë mbas lindjes është një utopi. Prindërit e bëjnë më të mirën në mënyrë që t’i afrohen sa më shumë gjendjes së përkryer. Nga ana tjetër, rastësitë e paditurisë nuk mund të përjashtohen. Nëse njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për pasojat e pakujdesisë, ata mund të ballafaqohen me

probleme gjatë shtatzënisë dhe mbas lindjes së fëmijës.
Çdokush duhet ta ketë të qartë se ardhja e tij në këtë botë
pa të meta fizike është e drejtë e çdo qenieje njerëzore

Kapitulli i pestë

Mirëqenia e embrionit (fetusit) varet nga të ushqyerit e nënës

Në mitrën e nënës fetusi nuk është një pjesë integrale e trupit të saj, edhe pse e merr ushqimin dhe substancat tjera prej gjakut të saj. Ushqimi i nënës shtatzënë duhet të planifikohet dhe të harmonizohet në mënyrë të duhur, sepse duhet të ushqehet jo vetëm nëna por edhe fetusi.

Prandaj, marrja e ushqimit të gruas shtatzënë duhet të planifikohet në mënyrë të përpiktë. Përndryshe, gjithmonë ekziston rreziku që mungesa e vitaminave dhe e mineraleve të caktuara në ushqim ta dëmtojë shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

Në sytë e Islamit, ushqimi i gruas shtatzënë është i rëndësishëm parësor, dhe kjo deri në atë masë sa që ajo mund edhe të lirohet nga agjërimi obligues gjatë muajit të Ramazanit. Asaj i është dhënë liria që këtë obligim ta përmbushë mbas lindjes së foshnjës.

Hulumtimet dëshmojnë se 80 % të çrregullimeve fizike dhe mendore të fëmijëve gjenetikisht të deformuar janë shkaktuar nga ushqimi i papërshtatshëm gjatë kohës së shtatzënisë. (Aijaz e hurakiah, f. 220).

Dr Xhezairi, një mjek eminent i të ushqyerit, shkruan:

“Është e njohur që nga kohët e lashta se për zhvillimin e fetusit dhe të foshnjës para lindjes, si dhe gjatë ushqimit me qumështin e nënës, është shumë e rëndësishme se çfarë ushqimi pranon nëna. Nëna duhet të kujdeset që proteinat, vitaminat, karbohidratet, yndyra dhe materiet tjera thelbësore që janë të nevojshme për zhvillimin e fetusit, të merren me sasi të mjaftueshme dhe në intervale të caktuara kohore. Fetusi, kur gjendet në fazën e

metamorfozës në mitër, kërkon të gjitha këto elemente themelore për zhvillimin e duhur dhe të shëndetshëm. Mund të ndodhë gjatë shtatzënisë, që nëna të shihet e shëndoshë nga pamja e jashtme, por për shkak të mungesës së vitaminave të caktuara, fetusi të zhvillohet në mënyrë jonormale.” (Jetëshkrimi para lindjes, f. 182)

Karneri thotë:

“Ndonjëherë, shkak i gjendjes jonormale të të sapolindurit qëndron në faktin se edhe pse fara ka qenë e mirë, gjendja e mitrës nuk ka qenë e përshtatshme. Ndonjëherë tjetër mund të ndodhë e kundërta, pra mjedisi i mitrës të jetë i përshtatshëm dhe fara të jetë e dobët. Nën këto kushte foshnjat lindin me disa deformime, si: buzët e çarë, sytë e vegjël e të fundosur dhe shputa apo tabanët e rrafshët. Më herët është menduar se këto defekte janë të natyrës gjenetike, por hulumtimet kanë treguar se ato janë shkaktuar nga mungesa e elementeve, si oksigjeni, gjatë shtatzënisë. Rrethina që e rrethon dhe në të cilën jeton gjatë shtatzënisë, për një grua konsiderohet si shkak i paraqitjes së defekteve të lindura si p.sh gjymtyrët paraplegjikë, etj.”

Në një traditë, Imam Xhafer Sadiku thotë: “Çfarëdo që nëna shtatzënë ha apo pi, fetusi ia tërheq substancat e tyre” (Bihar al-anvar, v 6, f. 342).

Kapitulli i gjashtë

Efektet e ushqimit të nënës në fetus

Lloji i ushqimit që merret gjatë shtatzënisë nga ana e nënës ka efekte të dukshme në natyrën, inteligjencë dhe aftësinë e fëmijës. Kjo për arsye se truri i fëmijës reagon sipas kualitetit të ushqimit që i sigurohet fetusit gjatë zhvillimit të tij. Islami ka definuar në mënyrë të qartë se ushqimin që e merr nëna gjatë shtatzënisë, ka një ndikim të madh në karakterin e fëmijës. Ja disa tradita në lidhje me këtë:

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Nënat duhet të sigurojnë se gjatë fazës finale të shtatzënisë të hanë hurma, në mënyrë që fëmijët e tyre të bëhen të butë e të matur.” (Mustadrak al-vasail, v. 3, f. 113).

“Përpiqu që gruaja jote shtatzënë t’i hajë farat e ftonjve. Fëmijët e grave të tilla do të lindin të shëndoshë dhe me karakter të mirë.” (Mustadrak al-vasail, v. 3, f. 116).

Imam Riza, ka thënë:

“Kur një grua shtatzënë ha farat e ftonjve, kjo ia rrit inteligjencën dhe urtësinë e fëmijës.” (Makarim al ahlak, v. 1, f. 196).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Gruaja shtatzënë që ha pjepër do të lindë fëmijë të bukur e të sjellshëm” (Mustadrak al-vasail, v. 3, f. 635).

Kapitulli i shtatë

Ushqimi i nënës

Hulumtimi i llojeve të ndryshme të materialeve ushqyese nuk është qëllimi i këtij libri, as që mund t'i numërojmë kualitetet e të gjithë materieve, sepse është një temë shumë e gjatë. As autori nuk është ndonjë ekspert i temës së ushqimit. Për fat të mirë, shumë libra të dobishëm janë botuar në lidhje me këtë temë dhe lexuesit e interesuar mund t'i studiojnë në detaje ata libra. Por, nuk do të jetë e tepërt nëse ia hedhim një shikim sipërfaqësor kësaj teme.

Edhe pse ushqimi që e konsumon gruaja shtatzënë gjatë kohës shtohet, është një çështje për të cilën duhet të brengosemi sepse ëndja (oreksi) e tyre, në përgjithësi zvogëlohet nën këto kushte. Shumë prej tyre ndihen të dobët dhe të plogësht. Në një gjendje të tillë ato duhet të planifikojnë konsumimin e koncentreve që janë ushqim me më pak të rëndë për tretje dhe që kanë më shumë vlera ushqyese. Ushqimi i nevojshëm për trupin e njeriut duhet të ketë materie të ndryshme ushqyese. Prandaj, përdorimi i llojeve të ndryshme të ushqimeve, grave shtatzëna ua zgjeron fushën e formimit të një programi ushqyes ideal për të.

Ekspertët e kësaj fushe kanë shkruar:

“Për të mbajtur trupin e shëndoshë nuk duhet të merret parasysh vetëm konsumimi i ushqimit por materiali i përzier dhe i planifikuar ushqimor të merret në intervale të planifikuara kohore” (Ilm o zindagi, f. 462).

Nëna duhet të marrë vitamina plotësuese dhe minerale gjatë ngrënies së ushqimit të mëngjesit dhe të darkës, gjë që do t'i ndihmojë fetusit kur ndodhet në muajin e shtatë. Kjo jo vetëm që do të ndihmojë zhvillimin e duhur të dhëmbëve, por edhe të disa eshrave të rëndësishëm të trupit. (Biografi Pesh uz tavallud, f. 80).

Dr. Gjasuddin Xhezairi shkruan:

“Konsumimi i kosit dhe i djathit gjatë shtatzënisë, u siguron grave vitamina e yndyrë, dhe e parandalon atë nga konsumimi i gjërave tjera të panevojshme, që përndryshe ajo, ka prirje t’i hajë. Sidoqoftë, ajo duhet të shmanget nga kosi i thartë dhe nga djathi bajat. Për mëngjes duhet të pijë një gotë me qumësht dhe supë prej tërshëre. Vitamina B përmbahet me bollëk në mëlçi, veshkë dhe zorrë, gjë që janë ushqime të dobishme dhe këto duhet të jenë pjesë e ushqimit të gruas shtatzënë.” (Aijaz hurakia, f. 223).

Më së miri është që gruaja shtatzënë të pijë qumësht në intervale të rregullta kohore. Ky është ushqimi i pasur që edhe të Dërguarit e mëhershëm e kanë përdorur këtë ushqim.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Qumështi është ushqimi i të Dërguarve” (Bihar al-anvar).

Dr. Gjasuddin Xhezairi shkruan:

“Shumë gra ndiejnë dhimbje në gjymtyrë dhe në shpinë për shkak të mungesës së kalciumit gjatë shtatzënisë. Po ashtu, thonjtë e tyre thyhen gjatë kësaj periudhe. Prandaj, ato këshillohen të hanë pemë dhe perime që janë të pasura me kalcium. Po ashtu, duhet rregullisht ta pinë supën e bërë nga eshtrat e dhurve dhe lëngun e limonit” (Aijaz hurakia).

Në përgjithësi, për njerëzit dhe në veçanti për gratë shtatzënë, perimet e ziera dhe të paziera, dhe pemët konsiderohen si ushqim i mirë. Bimët e marrin ushqimin prej tokës, ujit, ajrit dhe diellit dhe këtë ushqim e ruajnë për ne. Të gjitha pemët kanë vlera të mira ushqyese por posaçërisht të dobishme janë: mollët, ftonjtë, dardhat dhe hurmat. Vitamina dhe minerale i sigurohen trupit nga ana e pemëve, perimeve dhe drithërave të ndryshme. Personi që dëshiron të kujdeset për ushqimin e tij, duhet të hajë pemë

dhe perime të ndryshme, dhe të provojë që të hajë pemë sezonale, qoftë edhe herë pas here. Veçanërisht, gratë shtatzënë duhet të përziejnë me kujdes materialet e ndryshme ushqyese. Islami i nxit pjesëtarët e tij dhe gratë shtatzënë që të hanë pemë dhe perime. Për të vërtetuar këtë, do t'i përmendim disa tradita:

Imam Sadiku thotë:

“Çdo vend e ka stolinë e tij dhe stolia e sofrës janë pemët.” (Mustadrak al-vasail, v 3, f. 148).

Një ditë Imam Riza u ul për të ngrënë drekën dhe vërejti se po mungon sallata prej perimeve. Ai i tha shërbëtorit të tij: “Ti e di se unë nuk e ha ushqimin pa sallatë. Të lutem më sill sallatën”. Kur e solli sallatën, Imami filloi të drekojë.”

Është regjistruar se I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Hani ftua sepse jua përmirëson inteligjencën, largon brengat dhe fëmijët i bën më të butë” (Makarim al ahlak, v. 1, f. 196).

I Dërguari, gjithashtu ka thënë:

“Hani ftua dhe dhurojuni shokëve tuaj, sepse jua përmirëson të shikuarit dhe i bën zemrat më të buta. Edhe gruaja shtatzënë ka shumë dobi prej kësaj peme, dhe fëmijët e saj do të bëhen të bukur dhe të shëndoshë.” (Makarim al ahlak, v 2, f. 116).

“Gjatë muajve të fundit të shtatzënisë gruaja duhet të hajë hurma, në mënyrë që fëmijët e saj të kenë natyrën e vetëpërmbajtur.” (Makarim al ahlak, v. 3, f. 113).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Hani hurma, sepse ato i shërojnë të gjitha dhimbjet.” (Makarim al ahlak, v. 3, f. 112).

Ekzistojnë tradita të panumërta të Të Dërguarit dhe të Imamëve që hedhin dritë në vlerën e madhe ushqyese, të pemëve dhe të perimeve të ndryshme. Mjekët e të ushqyerit mund të sajojnë lista të ndryshme të të ushqyerit që i

përfshijnë sasi të duhura të këtyre pemëve dhe perimeve për nevoja të ndryshme. Këshillimi me mjekët e të ushqyerit do të jetë shumë i dobishëm.

Kapitulli i tetë

Përdorimi i duhanit

Gratë shtatzëna këshillohen të mos e përdorin cigaren dhe llojet tjera të prodhimeve të bazuara në duhan. Pirja e duhanit është e dëmshme jo vetëm për shëndetin e saj por do të ketë efekte të dëmshme edhe për fetusin. Në lidhje me këtë, do të përmendim një citat nga një gazetë që është botuar në një revistë të huaj. Ju ftojme ta lexoni me vëmendje:

“Është bërë një studim në Suedi dhe aty janë përfshirë 6363 gra shtatzëna. Ky studim na ka treguar se gratë që pinë duhan i kanë lindur foshnjat e tyre në peshën mesatare për 170 gramë më të lehtë sesa foshnjat e lindura të grave që nuk pinë duhan. Ky dallim në peshë është regjistruar te 50%-shi i grave shtatzëna që kishin shprehur të pinë cigare. Kokat dhe fshikëzat e foshnjave të nënave që pinin duhan, është vërejtur se ishin më të vogla në krahasim me nënat që nuk konsumonin duhan. Edhe mortaliteti i foshnjave të nënave që përdornin duhan, ka qenë për 6 herë më i lartë sesa i grupit tjetër. Foshnjat e nënave që pinin duhan, kishin më tepër gjasa të lindin foshnjat me defekte fizike sesa nënat që s’përdornin duhan. Përdorimi i cigareve shkakton mungesën e oksigjenit në gjakun e fetusit, prandaj shkakton prodhimin e tepërt të hemoglobinës. Sëmundjet e zemrës lajmërohen për 50% më shumë te foshnjat e nënave që pinë duhan. Statistikat na dëshmojnë se fëmijët e nënave që e përdorin duhanin janë më të dobët edhe në shkollë nga ata të grupit tjetër. Intensiteti i këtij kushti varet prej sasisë së cigareve që i ka pirë nëna gjatë shtatzënisë, ngas duhani shkakton reduktimin e qelizave të trurit të fetusit. Kjo çka është thënë, është vetëm një pjesë e dëmit që mund t’i shkaktohet foshnjës së nënës që përdor duhanin. Ndoshta ekzistojnë

edhe dëme më serioze që i shkakton duhani të cilat nuk janë zbuluar deri më sot. Prandaj, të gjitha nënat që brengosen për shëndetin e fëmijëve të tyre duhet t'i shmangen duhanit” (Maktab Islam, Viti 15, numër 6).

Dr. Xhezairi shkruan:

“Pirja e duhanit është e dëmshme për nënën dhe për fëmijën që rritet në mitrën e saj. Edhe pijet alkoolike janë shumë të rrezikshme për nënat shtatzëna. Si shtesë, për efektin helmues të alkoolit, mund të themi se ai i shkatërron edhe vitaminat që janë nevoja esenciale për nënën dhe fetusin. Gratë e tilla e bartin rrezikun e lindjes së foshnjës me të meta. Pirja e duhanit dhe konsumi i fermentit të birrës janë të rrezikshme për foshnjën” (Aijaz hurakia, f. 215).

Dr. Xhelali shkruan:

“Alkooli, droga dhe narkotikët e tjerë depërtojnë në rrjedhjen e gjakut të prindërve dhe lëvizin deri te mitra, gjë që ndikon dëmshëm në zhvillimin e fetusit. Disa ekspertë janë të mendimit se kur gruaja shtatzënë pi cigare, zemra e fetusit do të ngacmohet dhe do të fillojë të rrahë në mënyrë jonormale.” (Rushinasi Kudak, f. 222).

Kapitulli i nëntë

Të sëmurët e gruas shtatzënë

Kur gruaja shtatzënë ka nevojë për të marrë ilaçe, si pasojë e ndonjë sëmundjeje, ajo duhet të ushtrojë kujdes të madh për ilaçet që i përdor, sepse në përgjithësi ilaçet janë të prodhuara për të rriturit. Ato mund të mos jenë të përshtatshme për fetusin e ndjeshëm dhe të ndikojë dëmshëm në të. Nuk mund të parashikohet se si do të ndikojnë ilaçet te fetusin. Për këtë arsye, gruaja shtatzënë duhet të përmbahet maksimalisht nga përdorimi i ilaçeve. Fillimisht, ajo duhet të rri larg prej ilaçeve, por nëse gjendja e saj shëndetësore keqësohet dhe mjekimi bëhet i domosdoshëm, atëherë duhet të shkojë te eksperti për të marrë këshilla të nevojshme që do t'ia sugjeronin dozën dhe trajtimin e duhur mjekësor.

Kur sëmundja është e rrezikshme për nënën dhe për fëmijën, nëna shtatzënë duhet të sigurojë mendimin mjekësor të ekspertit dhe trajtimin e duhur, përndryshe mund të shkaktojë dëme të paparashikueshme për fetusin.

Një ekspert shkruan:

“Është e mundur se disa viruse dhe mikrobe të caktuara të depërtojnë prej nënës apo babait në fetusin e pambrojtur dhe ta infektojnë me ndonjë sëmundje nga e cila vuanin edhe prindërit.”

Në një vend tjetër shkruan:

“Çdo ndryshim në shprehinë ushqyese të nënës, ilaçet që duhet t'i marrë dhe sëmundjet që do ta kaplojnë, të gjitha këto do të ndikojnë në embrion. Çdo gjendje e sëmundjes që mund të ndikojë në embrion gjatë fazës fillestare të shtatzënisë, në vazhdim do të keqësohet në mënyrë progresive. Prandaj, është e domosdoshme që gratë shtatzëna ta ruajnë veten nga sëmundjet. Ndonjëherë,

sëmundjet mund të shkatërrojnë aftësitë e tyre mendore në të ardhmen.”

Ai, gjithashtu shkruan:

“Janë disa materiale joushqyese qëkur të konsumohen nga gratë shtatzëna, do të ndikojnë dëmshëm në zhvillimin e fetusit. Shumica e ilaçeve janë për të rriturit dhe eksperimentet e tyre janë zhvilluar te të rriturit para se të aplikohen për përdorim të gjerë. Edhe viruset, bakteret dhe mikrobet në trupin e nënës ndonjëherë mund të ndikojnë në vetë fetusin. Ndonjëherë, fetusi fillon t’i pranojë simptomat e njëjta të sëmundjes apo ndonjë zhvillim anormal lajmërohet te fetusi për shkak të infeksionit.” (Biografia Pish az tavalud, f. 182).

Kapitulli i dhjetë

Ndikimet e gjendjeve psikologjike të nënës në embrion

Ekspertët e kanë shqyrtuar faktin se a ndikon gjendja psikologjike e nënës në embrionin që e ushqen. Disa ekspertë thonë se nëse nëna përballet me ndonjë frikë apo ankth të tepërt, atëherë fetusi do të ndikohet nga kjo gjendje. Ekzistojnë gjasa të madhe që fëmija do të bëhet i turpshëm dhe tendenca e natyrës xheloze dhe keqdashëse e nënës do të kalojë të fëmija. Vlen edhe e kundërta, natyra e mirë, humaniteti, singëriteti, guximi dhe dashuria e nënës do të kenë ndikim pozitiv në natyrën e pasardhësit. Ekspertët janë të mendimit se fëmija në mitrën e nënës është në fakt një pjesë e saj, prandaj do të jetë e ndikuar nga mendimet dhe psikika e nënës. Por, disa ekspertë të gjenetikës dhe psikologë të fëmijëve e kundërshtojnë këtë teori. Ata mendojnë se nuk është e domosdoshme që kushtet psikologjike dhe mendimet e nënës të kenë ndikim në mendjen e të porsalindurit në mënyrë të përhershme.

Dr. Xhelali shkruan:

“Nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë në mes nënës dhe fetusit, përveçse me kërthizë, e cila nuk zotëron kurrfarë ndjenjash dhe brendësia e kërthizës është e përbërë prej nervave që e bartin gjakun. Prandaj, mendimi i mëhershëm se kushtet psikologjike të nënës ndikojnë në mendjen e fëmijës mund të mos jetë i saktë.” (Rovan shinashi kudak, f. 188).

Por, e vërteta është me shkencën, gjegjësisht nuk mund të thuhet se mendimet dhe kushtet psikologjike të nënës ndikojnë në mënyrë indirekte në mendjen e fëmijës. Nuk është e drejtë të themi se mendimet e nënës nuk kanë aspak ndikim të drejtpërdrejtë në mendjen e fëmijës. Kjo pikëpamje është ilustruar përmes argumenteve në vijim:

1) Mendja dhe shpirti i njeriut janë të lidhur njëra me tjetrën. Sëmundja dhe shëndeti i mirë i trupit të njeriut, fortësia e nervave dhe potenciali fizik apo dobësia, madje edhe ëndja (oreksi)apo mungesa e saj, kanë lidhje me të menduarit dhe moralin e personit. Personaliteti morali i një individi dhe natyra e tij kanë lidhje edhe me zhvillimin e trurit të tij. Është e mundshme që mungesa apo mospasja e ushqimit të mund të ndikojë në nervozizmin dhe mendimet amorale të trurit.

2) Embrioni e shfrytëzon ushqimin, që së pari përgatitet në mitrën e nënës dhe pastaj arrin te fetusin. Për aq sa qëndron fëmija në mitrën e nënës, për aq do të varet prej ushqimit të saj. Prandaj, natyra ushqyese e nënës ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Dr. Xhelali shkruan:

“Çfarëdo që është e dobishme për nënën, e njëjta është e dobishme edhe për fetusin. Nëse ushqimit të nënës i mungon kalciumi, kjo mungesë do të ndikojë në zhvillimin e eshtrave dhe të dhëmbëve të fëmijës. (Rovan shinashi kudak, f. 188).

3) Është e njohur mirë se shqetësimi i madh dhe lodhja i shkaktojnë personit mostretje, kapllëk dhe e dëmton trupin e tij. Pikëllimi i tepërt apo frika ia zvogëlojnë ëndjen (oreksin) e personit dhe sistemi i tij i tretjes dobësohet. Gjëndrat tretëse nuk funksionojnë normalisht.

Duke u bazuar në këto tri argumente, mund të themi se edhe pse mendimet dhe gjendja shpirtërore e nënës nuk përcillen në mënyrë të drejtpërdrejtë në trurin dhe nervat e foshnjës, fëmija është në relacion me funksionin tretës, që së fundi mund të ndikojë në zhvillimin fizik dhe psikologjik të tij.

Brejtja e ndërgegjes së nënës, mbas zemërimit apo shqetësimit, do të ndikojë në natyrën e saj të përgjithshme

dhe do ta çrregullojë sistemin e saj tretës. Kjo gjendje do të dëmtojë si trupin e nënës ashtu edhe fetusin.

Është e mundur që fëmija në mitrën e tillë të nënës të ndikohet nga ndonjë sëmundje që do të manifestohet në moshën e vonshme të tij.

Dr. Xhelali shkruan:

“Brejttjet e tepërta të ndërgegjes që i vuan nëna shtatzënë dhe ndodhitë e pakëndshme në rrethinën e saj, janë përfundimisht të dëmshme për zhvillimin dhe natyrën e fëmijës. Kushtet e tilla formojnë probleme dhe ua hapin rrugën gjëndrave të padëshiruara. Për këtë shkak, sistemi tretës nuk është në gjendje të funksionojë normalisht. Ndoshta kjo është arsyeja që disa fëmijë kanë sëmundje të ndryshme nervore. Këto kushte, po ashtu mund të jenë përgjegjëse për abortimin e fetusit. (Rovan shinashi kudak, f. 222).

Nën kushtet normale fizike dhe mendore, fetusit i gruas shtatzënë do të jetë në gjendje të mirë shëndetësore. Mjedisi i tillë i qetë është ideal për zhvillimin e përkryer të fëmijës në mitrën e nënës. Në të kundërtën, fetusit i një gruaje xheloze, ziliqare, nervoze dhe me sëmundje mendore nuk do të ushqehet si duhet dhe mund të ndikohet nga sëmundjet e ndryshme mendore dhe trupore.

Duke marrë këtë parasysht:

“Ekspertët e psikologjisë kanë vërtetuar se 26 % e fëmijëve me sëmundje psikologjike i kanë trashëguar gjendjet e tyre prej nënave. Prandaj, nëse nëna është e fortë dhe e shëndetshme, atëherë edhe fëmija do të jetë zotëruese e gjendjes së mirë fizike. Nëse nëna dëshiron që fëmija i saj të jetë i shëndoshë, atëherë ajo duhet të kujdeset mirë për vetë gjendjen e saj fizike dhe psikologjike gjatë shtatzënisë. Ndikimet e mjedisit në zhvillimin e fëmijës gjithnjë janë të shprehura.”

Kapitulli i njëmbëdhjetë

Këshilla për nënat shtatzëna

Gratë shtatzëna këshillohen të mos ngrijnë barrë të rëndë. Po ashtu, duhet të shmangen nga detyrat e mundimshme. Nëse gruaja shtatzënë e lodh veten, ka mundësi që ta lodhë edhe foshnjën. Në raste të tilla paraqitet rreziku i dështimit të shtatzënisë.

Edhe udhëtimi gjatë muajve të fundit të shtatzënisë nuk është i këshilluar. Nëse nuk ka ndonjë nevojë urgjente për të udhëtuar, më mirë është të mos marrin ndonjë rrugë në këtë periudhë. Sidoqoftë, puna e lehtë dhe lëvizjet e kufizuara nuk janë të dëmshme dhe, në fakt janë të dobishme për shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

Dr. Xhelali shkruan:

“Lodhja e tepërt te gratë shtatzëna ndikon në shpërndarjen e substancave të helmuara në gjak. Mbasi që gjaku është burimi i ushqimit për fetusin, mund të ndikojë në mënyrë të dëmshme në zhvillimin e fëmijës.” (Rovan shinashi kudak, f. 222).

Kapitulli i dymbëdhjetë

Mjedisi i pastër

Fëmija që rritet në mitrën e nënës, ka nevojë për oksigjen, edhe pse vetë fetusit nuk mund të marrë frymë. Por, e shfrytëzon oksigjenin që e pranon nëna nga atmosfera. Nëna, jo vetëm që e konsumon oksigjenin për vetveten si mjet të jetesës, por ia siguron edhe fetusit. Nëse nëna merr frymë në një atmosferë të pastër dhe higjienik, ajo mund të sigurojë shëndetin e vet dhe të fëmijës që e bart. Nëse mjedisi i nënës është i ndytë dhe merret ajri i helmuar, atëherë ka rrezik që sëmundja të ndikojë në shëndetin e saj dhe të fëmijës. Prandaj, gratë shtatzëna këshillohen t'i kushtojnë kujdes të veçantë mjedisit në të cilin jetojnë. Ato duhet të kalojnë në një mjedis të pastër e të pandotur, ku mund të marrin frymë lirisht. Gratë shtatzëna duhet të shmangen edhe prej qëndrimit të vonshëm gjatë natës, gjë që mund t'i lodhë ato shumë.

Gjatë shtatzënisë, gruaja duhet të qëndrojë larg prej duhanit dhe ta mbrojë veten nga qëndrimi në rrethana të ndotura. Gjatë fjetjes duhet t' i mbajnë dritaret e dhomës së gjumit të hapura, ashtu që të mund të hyjë ajri i pastër në dhomë. Duhet të cekim se mungesa e oksigjenit mund të jetë shumë e dëmshme për fetusit.

Në vazhdim do të përsërisim edhe një herë paragrafin e Dr. Xhelalit, që e kemi cekur më herët në këtë libër, për vëmendjen tuaj:

“Më herët është menduar se defektet e ndryshme të trupit, si: buzët e çarë, sytë e vegjël e të fundosur dhe shputa apo tabanët e rrafshët, janë të natyrës gjenetike. Hulumtimet kanë treguar se këto defekte janë shkaktuar nga mjedisi rrethues dhe posaçërisht prej mungesës së elementeve, si oksigjeni gjatë shtatzënisë.

Kapitulli i trembëdhjetë

Aborti

Në Islam nuk ka vërejtje për kontracepsionin apo planifikimin e familjes që bëhet me pëlqimin e dyanshëm të bashkëshortëve. Nëse gruaja dhe burri dëshirojnë të mos kenë më fëmijë, ata mund të parandalojnë shtatzëninë përmes hapave të parrezikshme, injeksioneve dhe metodave tjera kontrceptive. Por, parandalimi i lindjes që veç ka zënë fill është i padëshirueshëm në Islam. Islami dëshiron që të shtohet numri i fëmijëve të pasuesve të tij. Kur qelizat mashkullore dhe femërore janë bashkuar për të formuar embrionin, kjo paraqet pikën fillestare të qenies njerëzore, kështu që abortimi i tij është i ndaluar në Islam. Edhe pse embrioni është një objekt i vogël, ai ka të drejtën e plotë për ekzistencë. Është një ekzistencë që zhvillohet shpejt drejt formimit të qenies së plotë njerëzore. Kjo krijesë e vogël kërkon nënën e saj që të sigurojë mjedisin e përshtatshëm për zhvillimin dhe ardhjen në këtë botë si një qenie e plotë njerëzore. Nëse ndonjëri e parandalon formimin e një ekzistence të tillë, ai ka bërë një vrasje dhe kjo vepër do të jetë shkaktar për ndëshkimin e prindërve në Ditën e Gjykimit.

Feja Islame, që është ruajtëse e të drejtave të të gjithëve, ka ndaluar plotësisht abortimin dhe ndërprerjen e shtatzënisë. Is-hak bin Amari thotë: “E pyeta Imam Musa bin Xhaferin se në rast se gruaja frikohet që të mbetet shtatzënë, a lejoni të marrë medikamente që e shkaktojnë abortimin.” Imami u përgjigj: - “Jo, nuk mund të jap një leje të tillë!”

Transmetuesi i hadithit pyeti prapë: “Cila është koha kur llogaritet se shtatzënia është në fazën fillestare?”

Imami iu përgjigj: - “Zhvillimi i njeriut fillon me formimin e embrionit. Allahu në Kuran thotë: *“Në Ditën e*

Gjykimit prindërit do të pyeten: Për çfarë faji i keni mbytur fëmijët tuaj?” (Kuran, 81:8-9).

Abortimi i fetusit është një akt shumë amoral që Islami e ka ndaluar. Përveç kësaj, këto operacione janë tepër të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e nënës. Dr. Pak Nagar, duke mbajtur fjalim në një seminar në lidhje me abortin, ka thënë:

“Është vërtetuar se abortimet e zvogëlojnë moshën e gruas. Gjithashtu, hulumtimet shkencore kanë vërtetuar se abortimi shqetëson baraspeshën psikologjike të mendjes së gruas.” (Maktab e Islam, Viti 13, Numër 8).

Prej vitit 1951 deri në vitin 1953, sipas statistikave të qytetit të Nju-Jorkut, 2601 gra kanë vdekur gjatë abortimit. Në dhjetë vjetët e ardhshme, fatkeqësia e kësaj llogarie është shtuar në 42%. Në Kili, 39% e vdekjeve të grave ishin në llogari të abortimit.

Një shkak i nxitjes së zbatimit të abortit është varfëria. Disa prindër mbytjen e fëmijëve të pafajshëm e arsyetojnë me varfërinë e tyre.

Nuk ka dyshim se shumë familje janë viktimë e varfërisë. Po ashtu, nuk ka dyshim se është mjaft vështirë mbajtja e familjes gjatë varfërisë. Islami nuk e pranon arsyetimin për abortimin e fëmijëve për shkak të kushteve të varfërisë dhe mjerimit. Në Kuran, Allahu thotë:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të frikës nga varfëria. Ne i furnizojmë ata dhe juve. Mbytja e fëmijëve është padyshim një mëkat i madh” (Kuran, 17:31).

Kur fetusi veç është formuar, prindërit duhet të marrin guximin për të menduar se ka mundësi që ky fëmijë të bëhet ndonjë person i madh dhe ta nderojë familjen dhe shoqërinë. Ndoshta ky fëmijë mund të bëhet shkaktar i mbarëvajtjes ekonomike të familjes dhe ata do të mund të shpëtojnë nga varfëria.

Janë përmendur edhe arsyetimet tjera për abortim, sikur aktivitetet jashtë shtëpisë, përgjegjësitë zyrtare dhe se, mjaft kanë fëmijë. Këto nuk janë arsye të vlefshme për lejimin e abortit nga ana e Jurisprudencës Islame dhe të mendjes praktike.

Jo vetëm që abortimi është i paligjshëm në sytë e Islamit, por është caktuar edhe ndëshkimi për këtë akt mëkatar, që varet prej moshës së fetusit që është abortuar.

Imam Sadiku thotë:

“Nëse fëmija i abortuar është në formën e embrionit, atëherë shpagesa e gjakut është e barabartë me 20 dinarë prej ari. Nëse shtatzënia ka zënë formën e copës së mishit, shpagesa e gjakut arrin 40 dinarë prej ari. Nëse shtatzënia ka arritur formën e mishit dhe të *muzga*-së, shpagesa e gjakut do të jetë 60 dinarë prej ari, dhe nëse fetusit i janë formuar eshtrat, shpagesa do të jetë 80 dinarë prej ari. Nëse fetusi ka arritur formën njerëzore, shpagesa është njëqind dinarë prej ari. Nëse fëmija i abortuar është aq shumë i zhvilluar, madje edhe që e ka shpirtin brenda, atëherë ndëshkimi është një jetë njerëzore.” (Vasail al-shia, v. 19, f. 169).

Zonja Asfar al Maluk Amili ka shkruar një poemë të bukur në këtë temë:

“Fëmija i dobët i abortuar m’u shfaq në ëndërr dhe më tha:

Nëse e takon nënën time, pyete atë

Çfarë faji ka gjetur te unë që ka derdhur gjak pa nevojë

Unë isha duke jetuar qetë si fëmijë, pse ata urdhëruan mbytjen time?

Ju i keni mprehur kthetrat dhe dhëmbët tuaj, dhe e keni ngjyrosur jakën tuaj me gjak

Unë isha mysafiri i sapoardhur te ju dhe nuk do t’ju shkaktoja ndonjë dëm

*Mysafirët janë për t'i mirëpritur, jo për t'i mbytur
Ju e kishit brengën e shpenzimeve të mia dhe për
këtë e keni shuar ekzistencën time!
Nënë, unë do ta sillja furnizimin me vete, por sa keq
që nuk besove në këtë!
Pëlqeve të mbash veten të lirë dhe të lëvizësh
lirshëm, në vend se të kujdesesh
Në këtë mënyrë e vendose themelin për krim!
Nëna për fëmijët është shpresa dhe me të kënaqen
Sikur të mund të shikoja fytyrën tënde dhe të
mbledhja lule nga kopshti yt i bukur
Sikur të mund të pija qumësht nga gjiri yt dhe të
lehtësojë pikëllimin tënd
Sikur të mund të pija qumështin dhe veshi im të
dëgjonte zërin tënd
Mendoja se kur do ta dëgjosh qeshjen time do të
rrije afër meje në shtrat
Shpresoja se do të më çojë në shkollë dhe të më
jepje mësimet për drejtësinë
Kur të kthehesha nga shkolla do të recitoja vjershat
e çerdhes
Sikur të kisha arritur rininë, atëherë ti do të kishe
kuptuar vlerën time
Nëse e arrin moshën e thyer unë do të kisha
ndihmuar
Tani unë jam në Xhenet sikur një shpirt i pastër dhe
vendi im është me hyritë
Tani duhet të pendohesh, ndoshta Allahu i
Mëshirshëm do të të falë
Afsar, kërkesa ime prej teje është që të bartësh këtë
porosi te të gjitha nënat.*

Kapitulli i katërbëdhjetë

Lindjet e vështira

Shtatzënia zakonisht zgjat nëntë muaj e dhjetë ditë. Periudha e shtatzënisë është shumë e ndjeshme dhe plot me rreziqe sepse ka lidhje me të ardhmen e fetusit që rritet. Fëmija në këtë periudhë e kalon jetën brenda asaj rrethine të mbyllur mbi të cilin nuk ka kurrfarë kontrolli dhe mund të rrezikohet në mënyrë fizike dhe psikologjike. Fëmija nuk ka aftësi që vetë të konfrontohet dhe të ballafaqohet me këto rreziqe. Mbasi t'i kompletojë me sukses nëntë muaj në mitrën e nënës, ai duhet të kalojë përmes një faze tjetër të rrezikshme, dhe ajo është lindja. Procesi i lindjes nuk është i lehtë dhe i thjeshtë, por është shumë i ndjeshëm dhe i vështirë.

Fëmija rritet në gjatësi gjatë nëntë muajve dhe veçanërisht koka e tij në këtë fazë është shumë më e madhe sesa pjesët tjera të trupit, gjë që e vështirëson lindjen, sepse duhet të kalojë nëpër një kalim të ngushtë të mitrës. Gjithmonë ekziston mundësia që gjatë lindjes eshtrat e foshnjës të thyhen apo të lakohen. Po ashtu, ka mundësi që truri të dëmtohet për shkak të presionit gjatë lindjes.

Një ekspert, shkruan:

“Procesi i lindjes mund të shkaktojë të meta psikologjike te fëmija. Psikologët janë të mendimit se procesi i lindjes së fëmijës ka lidhje të rëndësishme me tërë jetën e tij. Sipas mendimit të tyre, lindja është një ndryshim revolucionar për mjedisin dhe jetën e fëmijës, dhe e ndan atë prej sigurisë dhe qetësisë që e ka gëzuar përderisa ishte në mitër. Gjatë kohës së lindjes, frika dhe shqetësimi bëhen një pjesë e psikikës së personit. Njeriu jetën e kalon duke menduar për problemet dhe ndodhitë e panjohura që mund ta godasin atë. Jeta e kaluar në fetus ishte pa brenga dhe

lindja është arritja në brengat e kësaj bote. (Biografia Pish az tavallud, f. 160).

Dr. Xhelali, shkruan:

“Kur fëmija arrin në këtë botë, do të jetë nën presion për disa orë dhe ndikimi më i madh do të ushtrohet në kokën e tij, që është pjesa më e madhe e trupit gjatë lindjes. Nëse lindja nuk është normale, atëherë do të paraqiten vështirësitë dhe përveç rrezikut të mjedisit, fëmija duhet të ballafaqohet me rrezikun e instrumenteve mekanike që i përdorin gjatë lindjes. Në raste të tilla ka gjasa që të humbë jetën foshnja e sapolindur. Sëmundjet si, çmenduria dhe paraliza të fëmijët mund të jenë rezultat i lindjes së vështirë.” (Ruvan shinashi kudak, f. 193).

Pra, lindja e fëmijës nuk është një proces i thjeshtë dhe kërkon kujdes të veçantë dhe aftësi që sigurojnë sigurinë e nënës dhe të fëmijës. Një pakujdesi e vogël nga ana e atyre që e bëjnë lindjen, do të mund t'i shkaktojë dëm të madh nënës dhe fëmijës, e ndonjëherë mund të rezultojë edhe me vdekjen e njërës apo të dyjave. Por, ditëve të sodit aftësitë e mjekëve dhe të specialistëve janë më të përparuara dhe është zvogëluar shumë mundësia e dëmtimit të fëmijës apo nënës.

Gratë shtatzëna këshillohen që nëse kanë mundësi për të ardhur në kontakt me ndonjë gjinekolog apo shtëpi të shëndetit, të konsultohen me ata para lindjes së fëmijës. Ato duhet të përcaktojnë datën e pritur të lindjes dhe të kërkojnë pranim në spital para lindjes, në mënyrë që të kujdesen për ato më mirë sesa që mund të kujdesen për to në shtëpi. Përparësia më e madhe në këto raste është se aty janë në dispozicion mjekët dhe motrat e medicinës (infirmieret), dhe nëse paraqitet ndonjë urgjencë, ato mund të intervenojnë aty për aty, pa humbur aspak kohë. Përndryshe, nëse qëndron në shtëpi, në raste urgjente gruaja

shtatzënë mund të arrijë me vonesë te mjeku dhe kjo mund të rezultojë me paraqitjen e rrezikut për fëmijën dhe nënën.

Një arsye tjetër për të dërguar gruan shtatzënë në shtëpinë e lindjes para lindjes së fëmijës është se nuk mund të sigurohet mjedisi sanitar dhe kujdesi i personelit mjekësor në shtëpinë e saj sikur në shtëpinë e lindjes.

Edhe një përparësi tjetër e shtëpisë së lindjes është se aty do të jenë larg prej mendimeve dhe ndërhyrjeve të padëshiruara të grave tjera të familjes. Në përgjithësi, mendimet e tilla nuk janë të përshtatshme dhe mund të jenë të dëmshme.

Edhe burri ka përgjegjësi të madhe gjatë shtatzënisë dhe gjatë kohës që e bën lindjen gruaja e tij. Nga aspekti moral dhe religjioz, gjatë kësaj kohe delikate dhe të rrezikshme është detyrë e tij që të sigurojë ndihmë, t'i japë kurajë gruas dhe të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshme për të siguruar lindjen e sigurt të fëmijës. Pakujdesia në anën e burrit ndonjëherë mund të rezultojë me humbjen e nënës dhe të fëmijës apo me mbetjen e tyre me dëmtime fizike dhe psikologjike. Burri i tillë i pavëmendshëm do të shihet si kriminel në sytë e religjionit e të shoqërisë dhe ai do të jetë përgjegjës në Ditën e Gjykimit. Ata do të vuajnë edhe nga brejtja e ndërgjegjës nëse për shkak të pakujdesisë apo të mospërfilljes ata nuk e kanë treguar kujdesin e duhur ndaj gruas shtatzënë. Ndonjëherë, për shkak të neglizhencës së treguar gjatë kohës së duhur, burri do të bëjë më shumë shpenzime për të shpëtuar nga dëmi i paraqitur.

Nëse familjet e grave shtatzëna nuk mund të arrijnë deri te shtëpitë e lindjes, ato duhet t'i përdorin shërbimet e dadove kompetente që i zotërojnë aftësitë e nevojshme për lindjen e fëmijëve. Në lidhje me këtë, duhet të merren këto masa paraprake:

1. Temperatura e dhomës së lindjes duhet të jetë mesatare dhe nuk duhet të jetë shumë e ftohtë. Kjo është me rëndësi sepse gratë shtatzëna do të jenë nën presionin e madh dhe për shkak të kohëzgjatjes së dhimbjeve të lindjes gjendja e saj shëndetësore do të dobësohet dhe do të djersitet. Kjo gjendje do të mund të shkaktojë edhe ftohjen e foshnjës si dhe mund t'u ekspozohet disa sëmundjeve tjera. Nëse dhoma e lindjes ftohet mbas lindjes, ka gjasa që nëna do të ftohet. Era e ftohtë është shumë e dëmshme për foshnjën e sapolindur ngase mjedisi i mitrës së nënës ishte më i ngrohtë (duke pasur parasysh se temperatura normale e trupit të njeriut është 37,5 C) ndërsa temperatura e dhomës është më e ulët. Trupi i foshnjës mbas lindjes nuk është i qëndrueshëm që të mund t'u përshtatet ndryshimeve. Foshnjat e tilla zakonisht sëmuren dhe trajtimi i tyre është i vështirë, kështu që, edhe mortaliteti i foshnjave të tilla është më i madh.

2. Është e domosdoshme që në dhomën e lindjes të parandalohet ndotja e ajrit me tym nga djegia e qymyrit apo naftës. Frymëmarrja në një mjedis të tillë është e dëmshme si për nënën ashtu edhe për fëmijën.

3. Është e këshilluar që në dhomat e lindjes të mos hyjnë e të dalin shumë vizitorë. Vizitorët e panevojshëm nuk duhet të hyjnë në këtë dhomë. Vizitorët e tillë mund ta shqetësojnë gruan shtatzënë dhe mund të bartin infeksione kur të vijnë nga jashtë. Në Islam është e ndaluar që gratë tjera t'i shikojnë pjesët e trupit të një gruaje. Gjatë lindjes, gruaja shtatzënë nuk do të ketë mundësi t'i mbulojë pjesët e turpshme të trupit. Imam Sexhadi ka urdhëruar që gratë tjera të dalin nga dhoma e lindjes me rastin e gruas shtatzënë e cila është duke lindur dhe kur i hapen pjesët e turpshme të trupit të saj. (Vasail al-shia, v. 10, f. 119).

Gruaja shtatzënë e përgjegjshme duhet të ushtrojë tërë kujdesin gjatë shtatzënisë dhe lindjes në mënyrë që t'ia

dorëzojë shoqërisë një fëmijë të shëndoshë, që ky fëmijë të bëhet një anëtar i dobishëm i shoqërisë. Për Allahun, ky është një shërbim më i mirë që një grua mund të bëjë dhe gruaja e tillë do të fitojë shpërblim për këtë. Një ditë, i Dërguari ishte duke folur për temën e xhihadit. Një grua e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! - A mund të fitojë një grua shpërblimin e xhihadit?”. I Dërguari u përgjigj: “Edhe gratë do të fitojnë shpërblimin e xhihadit, edhe atë në kohëzgjatjen prej momentit që mbetet shtatzënë deri te momenti i lindjes dhe pastaj kjo kohë do të vazhdojë deri te ndarja e foshnjës prej gjirit. Tërë kjo kohë për një grua do të llogaritet sikur të qëndrojë në fushën e betejës duke bërë xhihad. Nëse gruaja vdes gjatë kësaj periudhe, ajo do të arrijë shkallën e martirëve.” (Makarim al-ahlak, v. 1, f. 268).

Kapitulli i pesëmbëdhjetë

Mbas lindjes

Kur lind fëmija, ajri hyn në mushkëritë e tij dhe fillon të marrë frymë. Pas marrjes së frymës së parë, fëmija do të qajë për herë të parë. Qarja bëhet për shkak të reaksionit ndaj ajrit që i hyn në brendi të mushkërive të tij. Nëse foshnja nuk qan dhe nuk merr frymë, duhet të mbahet për këmbë me kokë teposhtë dhe të goditet lehtë në mënyrë që t'i ndihmohet për të filluar frymëmarrjen. Pastaj i lidhet kërthiza dhe prehet me gërshërë të dezinfektuara. Mbas kësaj, foshnja lahet me sapun dhe ujë të vakët. Për një kohë foshnja nuk ka nevojë për ushqim. Pastaj merret një lugë me ujë dhe i qitet pakëz sheqer, përzihet dhe i jepet foshnjës.

Në përgjithësi, foshnja e sapolindur do të jetë në gjendjen e ëndërrimit. I duhet të pushojë shumë sepse ka kaluar nëpër një ndryshim të brendshëm dhe të jashtëm. Më herët ishte e varur prej ushqimit të nënës, por tani e ka sistemin e vet tretës që ka filluar të funksionojë.

Gjatë shtatzënisë fëmija varet prej oksigjenit që e merr nëna përmes frymëmarrjes, por mbas lindjes fillon të funksionojë sistemi respirator i tij. Tash vetë do të marrë oksigjenin prej atmosferës dhe do ta nxjerrë jashtë dyoksidin e karbonit gjatë frymëmarrjes. Funksionimi i tij i brendshëm ka pësuar një ndryshim të madh, si dhe kushtet dhe rrethanat e tij të brendshme janë tërësisht të ndryshuara. Më herët, në mitrën e nënës temperatura ishte 37,5 C, por tani gjendet në një mjedis që i ka kushtet e ndryshueshme të temperaturës. Edhe gjatë lindjes, fëmija është subjekt i presionit dhe do të kërkojë një pushim. Në këtë kohë fëmija do të jetë sikur një pacient që sapo ka kaluar nëpër një operacion dhe të cilit i duhet të pushojë shumë. Do të jetë sikur një makinë e re, që sapo ka dalë

prej dyshemesë së dyqanit dhe që ka nevojë për një trajtim të kujdesshëm. Nën këto rrethana, gjëja më e mirë që mund t'i bëhet fëmijës është sigurimi i mjedisit të rehatshëm që do t'i ndihmojë atij për t'u çlodhur nga mundimet që i ka pasur gjatë procesit të lindjes.

Dr. Xhelali shkruan:

“Gudulisja e fëmijës për të qeshur, ngritja poshtë e lartë në mënyrë të përsëritur, ndërrimi i shpeshtë i veshjes dhe të treguarit e tij të tjerëve, janë gjëra të papëlqyeshme nga të cilët duhet të përmbahemi. Fëmija nuk është një lodër dhe i duhet pushimi dhe qetësia. Mundohu të mos flasësh me zë të lartë në prezencën e tij dhe përmbahu nga ngritja e tij poshtë e lartë me qëllim të qetësimit të tij. Përqafimi dhe puthja e foshnjës, po ashtu nuk është një është gjë e mirë për të.” (Ruvan shinashi kudak, f. 223).

Edhe nënës i duhet pushimi dhe qetësia. Gjatë nëntë muajve të shtatzënisë ka kaluar përmes shumë dhimbjeve. Posaçërisht, mbas lindjes ajo është shumë e dobët sepse ka humbur mjaft gjak nga trupi i saj. Gjatë kësaj kohe, burri i kujdesshëm duhet t'ia sigurojë të gjitha rahatitë e mundshme dhe me një të ushqyer të mirë të mundohet t'ia kthejë shëndetin që e ka pasur. Nëse ka nevojë për përkujdesje dhe trajtim mjekësor, ai duhet ta sigurojë atë pa humbur fare kohë. Nëse burri është i pavëmendshëm në këtë periudhë, atëherë gruaja do të mbetet e dobët dhe e zbehur, dhe ai duhet t'i bartë përgjegjësitë.

Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë

Qumështi i nënës - Ushqimi më i mirë

Qumështi i nënës është ushqimi më i mirë dhe më i dobishëm për fëmijën. Në shumë mënyra mund të preferohet në vend të shumë produkteve ushqimore që janë në dispozicion, si p.sh.: qumështi i lopës, i dhisë apo qumështi i prodhuar në fabrikë.

1. Qumështi i nënës, sa i përket vlerës së tij ushqyese, është i përshtatshëm në mënyrë ideale për organizmin e fëmijës. Është shumë në pajtim me nevojat e foshnjës sepse ka tërhequr ushqimin prej nënës për nëntë muaj gjatë shtatzënisë dhe do të vazhdojë të pranojë përmbajtjen e njëjtë prej qumështit të siguar nga ana e saj.

2. Qumështi i nënës është i prodhuar nën kushtet natyrore dhe i ruan vlerat e veta ushqyese. Përkundrazi, qumështi i lopës duhet të vlohët para se të përdoret dhe shumë vlera ushqyese do të shkatërrohen gjatë këtij procesi.

3. Nga pikëpamja e shëndetit të foshnjës, qumështi i nënës është më i pëlqyeri. Është më së paku i kontaminuar me mikrobe, ngase rrjedh në gojën e foshnjës drejtpërsëdrejti nga gjiri i nënës. Qumështi tjetër kalon përmes shumë mjeteve dhe enëve të ndryshme dhe gjatë këtij procesi mund të infektohet me mikrobe.

4. Qumështi i nënës është gjithmonë i freskët, përderisa qumështi tjetër mund të prishet gjatë qëndrimit dhe ruajtjes.

5. Nuk ka gjasa të falsifikimit të qumështit të nënës, ndërsa për qumështin tjetër ekziston një rrezik i tillë.

6. Qumështi i nënës është i pastër nga sëmundjet që i shkaktojnë mikrobet, ndërsa qumështi tjetër e ka rrezikun e bartjes së organizmave të tillë.

Qumështi i nënës është ushqimi më i sigurt për të sapolindurit. Fëmijët që ushqehen me qumështin e nënës janë më të shëndetshëm sesa ata fëmijë që ushqehen nga burimet tjera. Po ashtu, edhe vdekshmëria e foshnjave që ushqehen me qumështin e nënës është më e vogël sesa i grupit tjetër.

Edhe një përparësi e të ushqyerit të foshnjës me qumështin e nënës ngase edhe periudhat e saj të menstruacioneve vonohen dhe gjasat për të mbetur shtatzëne edhe njëherë shtyhen për aq kohë.

Islami e thekson rëndësinë e qumështit të nënës për fëmijën dhe e emërton si e drejta natyrale e fëmijës për ushqim.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Për fëmijë asnjë qumësht tjetër nuk është më i mirë sesa qumështi i nënës” (Vasail al-shia, v. 15, f. 175).

Në sytë e Islamit, qumështi i nënës ka një rëndësi të tillë saqë çdo herë që nëna e ushqen fëmijën me të, ajo fiton shpërblime për Botën e Ardshme.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Sa herë që nëna i jep gji foshnjës, aq herë shpërblimi për të do të jetë i barabartë me shpërblimin e personit që e ka liruar një rob prej fisit të Ismailit. Kur foshnja të arrijë moshën e ndarjes nga gjiri, një engjëll do ta vërë dorën në krahun e nënës dhe do të thotë: Fillo jetën rishtazi, të gjitha mëkatet e tua të deritanishme të janë falur” (Vasail al-shia, v. 15, f. 175).

Në një seminar që është mbajtur në Universitetin e Shirazit, të gjithë ekspertët janë pajtuar se asnjë ushqim tjetër apo kombinim i vitaminave nuk mund ta zëvendësojë qumështin e nënës.

Dr Simee Vakifi thotë:

“Është brengosës fakti se shumë nëna, duke i pasuar në mënyrë të verbër perëndimorët, i detyrojnë

foshnjat ta braktisin gjirin më herët, duke ua dhënë pluhurin e qumështit të dehidruar dhe ushqime tjera sintetike. Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesat ushqyese të foshnjave dhe nuk është zëvendësim për qumështin e nënës, që është më superiore në çdo aspekt. (Behdasht xhismi ravafi kudak, f. 63).

Një ekspert tjetër shkruan:

“Qumështi i nënës është ushqimi i vetëm që natyra ua ka siguruar foshnjave dhe asnjë ushqim tjetër nuk mund ta zëvendësojë atë. Prandaj, duhet bërë çdo përpjekje që nëna të mund të ushqejë foshnjën me qumështin e saj. Nëse qumështi i nënës fillon të shteret, ajo duhet të kujdeset në veçanti për ushqimin e vet në mënyrë që të mos e humbë qumështin e gjirit.” (Aijaz hurakia, f. 258).

Nënat e vëmendshme dhe të përgjegjshme që janë të interesuara për mirëvajtjen e fëmijëve të tyre, duhet të mos i privojnë foshnjat e tyre prej dhuntisë që Allahu ua ka siguruar atyre. Këto gra e dinë mirë ndikimin e qumështit në trupin dhe mendjen e fëmijës, ndikim i cili është në rritje e sipër. Prandaj, duhet të sakrifikojnë nga luksi i tyre për hir të shëndetit dhe mirëvajtjes së fëmijëve të tyre. Vetëm gratë e tilla meritojnë të quhen nëna dhe jo ato tjerat që janë injorante dhe egoiste që, përkundër asaj që kanë qumësht në gji, ato e shterin atë dhe i rrisin fëmijët me pluhurin e thatë të qumështit.

Gratë që nuk i ushqejnë fëmijët e tyre me qumështin e tyre mund të bëhen viktimë e disa sëmundjeve të rënda fizike dhe psikologjike. Kanceri i gjinjve është një sëmundje e rëndë që dominon te këto gra.

Këtu është e përshtatshme që t’ua bëjmë me dije nënave që i ushqejnë fëmijët me qumështin e tyre, që të kujdesen mirë për ushqimin e tyre personal. Ushqimin që nëna e merr ka lidhje të drejtpërdrejtë në vlerën ushqyese të qumështit që e prodhon. Ushqimi i nënës duhet të jetë i

kombinuar, i balancuar i pemëve, perimeve dhe i drithërave të ndryshme.

Lëngjet dhe ushqimet e lëngëta janë të dobishme. Nënati nuk duhet të mendojnë se vetëm ushqimi i shtrenjtë mund të jetë ushqimi i mirë. Ato mund të planifikojnë me maturi ushqimin e balancuar që është i pasur në përbërje dhe në të njëjtën kohë nuk është i shtrenjtë. Ato mund t'i referohen librave të mirë që kanë të bëjnë me mënyrat e ushqimit, për të bërë planifikimin në këtë drejtim. Në një libër të tillë, shkruan:

“Ekspertët e të ushqyerit këshillojnë që nënati gjithënjë, duhet të konsumojnë kombinime të produkteve ushqyese që u janë në dispozicion atyre. Në veçanti, në ushqimin e tyre ato duhet të përfshijnë drithërat, qumështin, gjalpin e freskët, arrat e kokos, ullirin, arrat, bajamet, pemët e ëmbla dhe të lëngshme si, shalqirin, pjeprin, pjeshkën, etj.” (Aijaz hurakia, f. 251-256).

Imam Sadiku thotë:

“Nëse e ke angazhuar ndonjë grua hebrej apo të krishterë për t'i dhënë gji foshnjës sate, kërko nga ajo të mos përdorë mishin e dërrit dhe pijet alkoolike.” (Mustadrak al-vasail, v2, f. 224).

Nëse nëna gji-dhënëse sëmuret dhe duhet të marrë ilaçe, duhet të ketë ndërmend se qumështi i saj mund të ndikohet nga ilaçet që i merr. Prandaj, nëna gjithënjë duhet të këshillohet me mjekun kompetent para përdorimit të çfarëdo lloji të ilaçeve.

Kapitulli i shtatëmbëdhjetë

Shtojca qumështit të nënës

Ushqimi themelor i foshnjave padyshim që është qumështi i nënës, por është më mirë nëse i shtohet edhe vaji i peshkut në një sasi të vogël dhe ekstraktet e pemëve. Kjo do të sigurojë kompletimin e ushqimit të fëmijëve dhe rritjen më të mirë të tyre. Me rritjen e fëmijës rritet edhe nevoja për ushqim. Kështu do të arrijë në një fazë kur qumështi i nënës bëhet i pamjaftueshëm për fëmijën. Në këtë fazë, materialet e tjerë përfshihen në ushqimin e fëmijës ashtu që të sigurojnë nivelin optimal të të ushqyerit. Katër muaj mbas lindjes, apo më së shumti gjashtë, fëmija duhet të mësohet për të pranuar edhe ushqimin tjetër. Është me rëndësi që ushqimi i foshnjës të jetë i butë dhe i lëngshëm. Lëngjet apo pemët e ndryshme janë ideale në këtë fazë. Uji i pemëve të ziera është një burim i mirë i ushqimit të foshnjës. Edhe supat janë të mira për rritjen e fëmijës. Kur fëmijës fillojnë t'i dalin dhëmbët, ushqimi i tij mund të përmbajë patate të ziera, ve të ziera, biskota, djathë të freskët, bukë, gjalpë dhe pemë të freskëta.

Kapitulli i tetëmbëdhjetë

Ndërprerja e qumështit nga gjiri i nënës

Janë disa kohë të caktuara kur fëmijët duhet të mos e pinë qumështin e nënës:

1. Koha kur nëna është goditur nga ndonjë sëmundje infektive.

2. Kur nëna është goditur nga ndonjë sëmundje e rëndë, si p.sh. sulmi i zemrës, dhe mjeku e këshillon që të mos japë gjë fëmijës.

3. Kur nëna është e sëmurë në pikëpamje mendore apo vuan nga epilepsia.

4. Kur nëna vuan nga anemia dhe dhënia e gjirit foshnjës, do të ishte e dëmshme për të dyja.

5. Kur nëna është lidhur për drogë apo alkool, sepse materiet helmuese mund të depërtojnë përmes qumështit të saj deri te foshnja dhe do ta dëmtojnë atë.

Nën këto kushte, kur ekziston rreziku i infektimit të foshnjës apo i transferimit të materieve helmuese përmes qumështit, është më mirë që të anulohet dhënia e gjirit. Nëse nëna gjidhënëse mbetet shtatzënë, atëherë duhet t'i japë gjë foshnjës në kohë të caktuara dhe njëkohësisht të ushqehet edhe vetë.

Kapitulli i nëntëmbëdhjetë

Orari i dhënies gj

Ekspertët kanë sugjeruar dy metoda për ushqimin e foshnjave. Disa janë të mendimit se për ushqimin e foshnjës duhet të përgatitet një program i të ushqyerit dhe të ushqyerit e saj të bëhet në përpikëri me atë program dhe në kohë të caktuara. Në mes të dy kohëve të ushqimit të foshnjës, disa kanë thënë se duhet të ekzistojë një pauzë prej tri orësh, ndërsa disa tjerë kanë sugjeruar katër orë. Gjatë kësaj periudhe është rekomanduar të mos ushqehet foshnja.

Disa ekspertë tjerë nuk e përkrahin këtë lloj të programit. Ata besojnë se ushqimi i foshnjës duhet të bëhet sipas indikacioneve të ëndjes së foshnjës. Ata thonë se sa herë që foshnja tregon dëshirë për ushqim, duhet t'i jepet.

Disa mjekë tjerë të të ushqyerit janë të mendimit se metoda e dytë e ushqimit është më e përshtatshme sepse ata besojnë se foshnja duhet të pijë qumësht sa herë që është i uritur. Sidoqoftë, të dy metodat i kanë përparësitë dhe mangësitë, sikur që është ilustruar më poshtë:

1. Uria apo etja e foshnjës nuk mund të përcaktohet konkretisht, ngase foshnja nuk mund t'i shprehë nevojat e tij në mënyrë të qartë. Në fazën fillestare të ushqimit do të jetë pirja e qumështit për të ngopur oreksin, ndërsa, pasi që të ngopet, do të vazhdojë me taitje të gjirit. Në situata të tilla, foshnja qan jo pse është i uritur porse, ka dëshirë të tajsisë gjirin e nënës. Pastaj, nëna i jep qumësht ngase foshnja nuk pushon së qari. Shpesh fëmija qan pa pasur ëndje për ushqim, por nëna i jep gjë duke menduar se ai është i uritur. Pra, foshnja e pi qumështin e nënës kur ka uri dhe ndonjëherë edhe kur nuk ka uri. Është një fakt i përcaktuar mirë se marrja e qumështit në intervale të

parregullta kohore nuk është mirë për shëndetin e fëmijëve. Kjo shprehi mund të çrregullojë sistemin tretës të foshnjës.

Për këtë arsye, të ushqyerit e paplanifikuar të foshnjave është i mbushur plot me rreziqe të sëmundjeve për ta.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Ngrënia e tepërt dhe ngrënia mbas ngopjes, duhet të evitohet. Ata që hanë shumë, kanë mundësi të sëmuren” (Mustdarak al-vasail, v. 3, f. 82).

2. Fëmijët që e pinë qumështin pa ndonjë orar të kontrolluar, do ta kenë jetën e paorganizuar që prej fillimit dhe më vonë do të bëhen fëmijë të rritur me program të çrregulluar të ngrënies.

3. Është praktikë e përgjithshme që sa herë foshnja të qajë, nëna i jep gjë pa u munduar që ta përcaktojë shkaku e qarjes. Fëmijët e tillë e fitojnë shprehinë e kërkesës përmes qarjes dhe do të mendojnë se qarja dhe britma janë mënyra të vetme për t’i bërë gjërat ashtu siç dëshirojnë ata. Ata nuk do të tregojnë durim apo guxim për të bërë diçka. Ata dëshirojnë të arrijnë menjëherë atë çka kërkojnë, edhe nëse duhet të qajnë pa u ndalur në këtë drejtim dhe ata nuk turpërohen fare gjatë bërjes së sjelljeve të tilla..

4. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, janë gjithnjë të shqetësuar për shkak të fëmijëve të tillë.

Për fëmijët e tillë, Dr. Xhelali, shkruan:

“Nëse programi ushqyes i fëmijës është i caktuar, në konsultim me ndonjë pediatër, atëherë fëmija do të mësohet me këtë orar dhe nënat do të kuptojnë se kur fëmija është i uritur dhe kur është i ngopur.

Së dyti, njerëzit i kryejnë detyrat e tyre ditore në bazë të një force të zakonshme. Ngjashëm, edhe ushqimi i fëmijës do të bëhet një shprehje dhe do të bëhet në mënyrë

automatike sipas orarit të caktuar. (Ruvan shinasi kudak, f. 224).

Ruseli thotë:

“Ditëve të sodit, një grua e zakonshme i njeh normat e rritjes së fëmijëve. Ajo e di se është e rëndësishme të ushqejë foshnjën në intervale të caktuara kohore dhe jo kur të qajë ajo për çfarëdo arsye. Ajo e di se një regjim i tillë është përcaktuar për shkak të mbajtjes së sistemit tretës të foshnjës në një gjendje të rregullt... Kur fëmija e kupton se po e miratojnë kërkesën e tij sipas të qarës së tij, atëherë do të krijojë një shprehi të dytë dhe do të qajë edhe për çdo arsye më të vogël. Ndodh edhe që episodet e përsëritura të të qarës gjatë një intervali të gjatë kohore të bëhen shkaktar i zemërimit të prindërve. Kur fëmija e kupton këtë, ai bëhet i zymtë dhe bota i duket e vrazhdë dhe e ftohtë.” (Dar Tarbiat, f. 78).

Vëmendja duhet t’u kushtohet edhe disa çështjeve:

1. Është e pamundur që të gjithë fëmijët ta përkrahin programin e njëjtë të të ushqyerit. Çdo fëmijë i ka nevojat e veta ushqyese dhe tretëse. Gjithashtu, edhe kërkesat për ushqim të çdo fëmije janë shumë dinamike. Sistemi tretës i të sapolindurit do të jetë shumë delikat në 40 deri 50 ditët e para prej lindjes. Prandaj, sistemi tretës i tij mund të ruajë vetëm një sasi të vogël të qumështit dhe të pranojë vetëm një sasi të vogël të qumështit. Për këtë arsye do të ndiejë uri shpesh dhe gjatë kësaj periudhe, të ushqyerit duhet të bëhet brenda intervaleve më të shkurtra kohore, p.sh. një orë e gjysmë apo dy orë. Me rritjen e fëmijës, periudha kohore në mes dy racioneve duhet të rritet, p.sh në tri deri në katër orë, apo më shumë.

2. Të gjithë fëmijët nuk i kanë kushtet fizike dhe kapacitetet tretëse të njëjta. Prandaj, duhet të zhvillohet programi individual për çdo fëmijë posaçërisht. Disa fëmijë ndiejnë uri më shpesh dhe disa më pak. Nën at e

kujdesshme i vërejnë këto dhe kujdesen që të formojnë një orar të të ushqyerit për fëmijët e tyre në konsultim me ekspertët.

3. Sa herë që qumështi i jepet foshnjës, duhet të kujdesemi se a është plotësisht i kënaqur me të ushqyerit. Nënata duhet të kenë kujdes ngase foshnjat e sapolindura i merr gjumi gjatë pirjes së qumështit. Në raste të tilla, foshnja mund të mos ngihet plotësisht dhe nëna duhet ta zgjojë atë për të kompletuar të ushqyerit.

4. Kur të përgatitet programi komplet i të ushqyerit të fëmijës, duhet të zbatohet në praktikë me kujdes. Distanca kohore në mes të racioneve duhet të zbatohen në mënyrë të përpiktë. Në mes të dy racioneve të programuara sipas orarit, nuk duhet t'i jepet qumësht fëmijës edhe nëse qan. Kjo detyrë kërkon durimin dhe vendosmërinë e nënës në mënyrë që të sigurojë që fëmija t'i përshtatet regjimit, kështu që fëmija do të zgjohet në kohën e caktuar për të marrë ushqimin e tij. Durimi dhe vetëpërmbytja do të jenë pjesë e natyrës së fëmijës së tillë.

5. Orari i ushqimit të fëmijës duhet të përgatitet në mënyrë të tillë dhe, që nga mesnata deri në mëngjes, të mos ushqehet fare. Kur fëmija të pranojë këtë shprehje, nëna dhe fëmija do të kenë pushim të mirë gjatë natës.

6. Gjnjtë duhet të pastrohen me një pëlhurë të pambuktë mbas çdo dhënieje të gjirit. Kjo është esenciale për shëndet dhe higjienë, dhe do të parandalojë mundësinë e dëmtimit të gjirit.

7. Kur foshnja e thith qumështin e nënës, bashkë me qumështin depërton edhe një sasi e ajrit nën aparatit e tretjes së foshnjës dhe e bën të parehatshëm. Prandaj, mbas çdo ushqimi foshnja duhet të ngrihet pakëz dhe të goditet lehtë shpina e tij, në mënyrë që ajri të dalë jashtë sistemit tretës.

8. Foshnja duhet të ushqehet nga të dy gjinjtë e nënës. Kjo bëhet për arsye të evitimit të tharjes së qumështit, që mund të rezultojë me dhimbjen e atij gjiri. Një grua tregon: “Imam Sadiku më tha të mos e ushqej fëmijën vetëm me një gj, në mënyrë që të sigurohesh se e ka pranuar ushqimin e plotë.” (Vasail al-shiah, v15, f. 176)

9. Gratë gjdhënëse duhet të kujdesen që të mos kryejnë detyra të rënda fizike dhe të mos zemërohen. Sepse, këto gjëra ndikojnë në kapacitetin e saj për të prodhuar qumësht, që padyshim do të jetë e dëmshme për foshnjën.

Kapitulli i njëzetë

Nëse nëna nuk ka qumësht të mjaftueshëm

Nëse nëna nuk mund ta kënaqë ëndjen (oreksin) e foshnjës, ajo nuk ka të drejtë ta privojë atë prej qumështit të saj. Ajo duhet ta ushqejë me tërë qumështin që e ka në dispozicion dhe ta plotësojë me qumështin dhe ushqimin tjetër. Nëse nëna nuk ka aspak qumësht, që rastet e tilla janë të rralla, ajo mund ta ushqejë me qumështin e lopës, që sipas kualitetit është shumë i ngjashëm me qumështin e nënës. Kur të kalohet në qumështin e lopës, duhet të keni ndër mend këto gjëra:

1. Qumështi i lopës është më i dendur dhe më i rëndë sesa qumështi i nënës. Prandaj, duhet të përzihet me ujë të vluar para se t'i jepet foshnjës, në mënyrë që dendësia e tij të jetë e përafërt me dendësinë e qumështit të nënës. Qumështi duhet që të përzihet pakëz edhe me sheqer.

2. Qumështi i lopës duhet të vlohët përafërsisht 15 minuta, që të sigurohet se mikrobet janë të shkatërruara.

3. Qumështin që e pi foshnja nuk duhet të jetë as shumë i nxehtë as shumë i ftohtë. Temperatura e qumështit duhet të jetë sa më e përafërt me temperaturën e qumështit të nënës.

4. Çdoherë që foshnjës i jepet qumështi, duhet të sigurohemi se shishja me të cilën e pi qumështin të jetë e larë mirë dhe e pastër që të mos shkaktojë infektim të ndryshme.

5. Duhet bërë përpjekje që të sigurohemi se lloji i duhur i qumështit përdoret për ushqim.

Nëse nëna dëshiron të përdorë pluhurin e tharë të qumështit për të ushqyer foshnjën, atëherë është e domosdoshme të konsultohet me pediatrin, në mënyrë që ta përdorë ushqimin e përshtatshëm për fëmijën e saj. Në treg

gjenden disa lloje të prodhimeve që i përgjigjen nevojave specifike të fëmijëve sipas moshave dhe kushteve fizike të tyre, dhe vetëm një ekspert mund të vendosë se cili prodhim është i përshtatshëm për cilën fëmijë.

Nëse qumështi i rekomanduar nga ana e mjekut është parë se nuk është i përshtatshëm, atëherë nëna duhet të shkojë prapë te mjeku për të marrë tjetër rekomandim.

Kapitulli i njëzetënjëtë Ndarja e fëmijës prej gjirit

Shikuar në mënyrë ideale, foshnja duhet të pijë qumështin e nënës për një periudhë dyvjeçare. Çdo fëmijë ka të drejtë të ushqehet përmes gjirit dy vjet, për të cilën gjë Allahu thotë në Kuran: *“Nënat duhet t’i japin gjë fëmijës dy vjet”* (2, 233).

Nëse nëna duhet ta ndajë fëmijën pa i mbushur dy vjet, asaj i lejohet kjo por jo pa i mbushur 21 muaj të të ushqyerit.

Imam Sadiku thotë:

“Periudha minimale për ushqimin e fëmijës me gjë është 21 muaj. Nëse ndokush e ushqen fëmijën për një periudhë më të shkurtër se kjo, do t’i shkaktojë mundim fëmijës.” (Vasail al-shiah, v 15, f. 177).

Mbas dy vjetësh të ushqimit përmes gjirit, fëmija do të mësohet dalëngadalë për të konsumuar llojet tjera të ushqimit. Në këtë periudhë nëna mund të zvogëlojë dhënien e gjirit dhe ta zëvendësojë me ndonjë ushqim tjetër. Mbasi të plotësohet kjo periudhë, fëmija ndahet prej gjirit plotësisht. Tani është i gatshëm të pranojë lloje tjera të ushqimit. Nënat e kujdesshme dhe të informuara mirë e dinë se me çfarë lloji të ushqimit mund të ushqehen fëmijët e tyre. Këto ushqime duhet t’i përshtaten natyrës së fëmijës dhe duhet të përmbajnë vlera të mira ushqyese.

Sidoqoftë, ndarja e fëmijës prej gjirit nuk është detyrë e lehtë. Ai do të qajë për disa ditë dhe do të kërkojë gjirin e nënës. Në këtë kohë, nëna duhet të tregohet e durueshme dhe e përmbajtur. Nënat ndonjëherë mundohen që përmes lyerjes së materialit të hidhur apo ngjyrosjes së gjirit me ngjyrë të zezë, të zhvillojnë një neveri te fëmija, në mënyrë që të mos ndjejnë dëshirë për gjirin e saj. Por, duhet pasur kujdes që të mos frikësohet fëmija. Fëmija nuk

duhet të fitojë kompleksin e frikës gjatë ndarjes prej gjirit, gjë që mund të ndikojë dëmshëm në shëndetin dhe psikologjinë e tij.

Kapitulli i njëzetedytë Vajzë apo djalë

Sapo gruaja të mbetet shtatzënë, fillojnë spekulimet për atë se a do të bëhet djalë apo vajzë. Ajo fillon të lutet që të lindë djalë. Kur të afërmit vijnë për ta vizituar, ata thonë se sipas pamjes së fytyrës ajo do të lind djalë. Kundërshtarët e saj i thonë se sipas syve të saj, ajo do të lindë vajzë. Edhe burri dëshiron që bashkëshortja t'i lindë djalë. Kohë mbas kohe edhe ia shpreh këtë dëshirë gruas. Para lindjes, të afërmit e rrethojnë shtëpinë e lindjes duke pritur se a do të lindë djalë apo vajzë. Kur e kuptojnë se i sapolinduri është vajzë, përnjëherë ata i kaplon një qetësi. Por, nëse është djalë, do të ndihen britmat e gëzimit të përnjëhershëm. Kur babai dëgjon se i ka lindur djalë, ai gëzohet së tepërmi. Ai do të nxitojë t'u shpërndajë vizitorëve ëmbëlsira e pemë. Mandej, fillon të japë udhëzime se si duhet kujdesur për foshnjën që të mos ftohet. Fillon ta llastojë gruan duke u shpërndarë dhurata dados e pjesëmarrësve. Nëse i sapolinduri është vajzë, pamja e tij do të zbehet. Do të shkojë dhe do të qëndrojë në një qoshe. Do të fillojë të mallkojë fatin e tij. Në këtë mënyrë do ta bëjë të hidhur ekzistencën e tij. Ai do ta neglizhojë gruan e cila sapo ka filluar të marrë veten dhe ndonjëherë edhe flet për shkurorëzimin. Kjo është gjendja e shoqërisë sonë të degjeneruar. Por, gjithnjë ekzistojnë edhe rastet e veçanta. Ekzistojnë prindër që e pranojnë vajzën me duar të hapëta dhe dashuri, sikur të kishte qenë djalë. Megjithatë, familjet e tilla janë të pakta.

Të dashur baballarë dhe nëna!

Çfarë dallimi bën për ju nëse keni djalë apo vajzë? A është vajza më pak njeri se djali? A nuk ka vajza aftësi për të rritur dhe për të përparuar? A nuk mund të bëhet ajo një person i vlefshëm dhe i dobishëm? A nuk është vajza

pasardhësi juaj? Çfarë përparësie të posaçme i nxjerrin prindërit prej djalit që vajza nuk mund ta sigurojë atë? Sikur vajza të mos ishte e rëndësishme në sytë e Allahut, atëherë pasardhësit e të Dërguarit të Shenjtë nuk do të kishin ardhur përmes vajzës së tij Fatimetu Zehrasë. Nëse e rrit vajzën tënde në mënyrë të duhur, atëherë ajo nuk do të bëhet më pak e dobishme se djali. Nëse i shikon faqet e historisë, do të vësh shumë referenca për gratë që kanë genë më të afta se mijëra meshkuj. Pse ekziston ky mendim përbuzës për vajzat në shoqërinë tonë që e ka përlulur statusin e femrës? Këtu ka nevojë për të bërë një xhihad kundër kësaj të keqeje. Ka nevojë që të largojmë mendimin për dallimet në mes vajzës dhe djalit. Vajza mund të jetë një person i dobishëm dhe efikas sikur edhe djali. Lajmin për lindjen e fëmijës, qoftë djalë apo vajzë, duhet ta pranosh me gëzim të njëjtë. Duhet ta falënderosh Zotin, sepse është një dhuratë prej Tij që të ka dhënë ty. Është pjesë e ekzistencës sate që ka ardhur në këtë botë.

I Dërguari dhe Pasardhësit e tij të Shenjtë gjithmonë e kanë mbajtur këtë qëndrim kundrejt jetës. Sa herë që Imam Sexhadi e morri lajmin për lindjen e fëmijës, ai kurrë nuk kërkonte të dinte se a është djalë apo vajzë. Në vend të kësaj, ai e falënderonte Allahun kur dëgjonte se i sapolinduri ishte i shëndoshë dhe i mirë. (Vasail al-shiah, v. 15, f. 143).

Një ditë i Dërguari ishte duke biseduar me disa shokë, kur mbërriti njëri dhe e informoi atë se Allahu ia kishte dhuruar një vajzë. Ai u gëzua shumë dhe e falënderoi Allahun. Por, kur i shikoi fytyrat e shokëve, ato ishin të ngrysura, I Dërguari u shqetësua dhe tha: “Çfarë ka ndodhur ndërmjet jush? Allahu më ka dhënë një lule, aromën e së cilës unë do ta marr. Allahu ia ka siguruar edhe asaj furnizimin siç do t’ia kishte siguruar edhe për djalin!” (Vasail al-shiah).

Allahu e ka dënuar diskriminimin në mes djemve dhe vajzave, duke thënë:

“Kur të dëgjojnë lajmin se u ka lindur vajzë, fytyrat e tyre nxihen nga turpi. Zemërimi i pushton ata dhe i fshehin fytyrat e tyre prej të tjerëve (Kuran, 16:58-59).

Kapitulli i njëzetetretë Emërtimi i foshnjës

Njëra ndër përgjegjësitë parësore të prindërve është zgjedhja e emrit për foshnjën e sapolindur. Këtë çështje nuk duhet ta trajtojnë si të parëndësishme. Individët dhe familjet njihen sipas emrave të tyre. Nëse emrin e ka të dashur, ai do të pranohet mirë nga ana e njerëzve. Personat me emra të pakëndshme nuk do të pranohen mirë nga ana e njerëzve, e ndonjëherë edhe mund të tallen me ata. Personat me emra të papërshtatshëm do të jenë viktimë e kompleksit të vlerës së ulët. Prandaj, Islami kërkon nga prindërit të kenë kujdes të veçantë gjatë zgjedhjes së emrave për fëmijët e tyre.

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Është përgjegjësi e çdo babai që të zgjedhë një emër të mirë për fëmijën e tij” (Vasail al-shiah, v. 2, f. 618).

“Fëmijët kanë tri të drejta nga ana e prindërve a baballarëve të tyre. E para është dhënia e emrit të mirë; e dyta është dhënia e edukimit të mirë dhe e treta që t’i ndihmojnë fëmijës për të gjetur bashkëshorten e mirë.” (Vasail al-shiah, v. 104, f. 92).

Imam Kusa Kadhimi, ka thënë:

“Mirësia e parë që babai ia bën djalit të vet është zgjedhja e një emri të denjë për të” (Vasail al-shiah, v. 15, f. 122).

Në anën tjetër, emri i një personi ka edhe rëndësinë e madhe sociale. Është emri i tij që e identifikon një person se ai i takon një familjeje të ndershme. Nëse prindërit kanë respekt të madh për ndonjë poet të njohur, ata do ta emërtojnë djalin e tyre sipas tij. Nëse prindërit janë të dashuruar për të studiuar, ata do ta emërtojnë fëmijën sipas ndonjë mendimtari të famshëm. Prindërit fetarë do ta

emërtojnë fëmijën sipas të dërguarve, Imamëve dhe personaliteteve tjera religjioze. Nëse prindërit dëshirojnë që fëmijët të luftojnë për çështje të fesë, ata i emërtojnë me Muhamed, Ali, Hasan, Hysejn, Abu Fazl, Abbas, Hamza, Xhaffar, abu Dherr, Ammar, Saeed, etj.

Nëse prindërit janë të dashuruar në ndonjë sport, ata do t'i emërtojnë fëmijët e tyre sipas lojtarëve të atij sporti. Ngjashëm, nëse prindërit e çmojnë artin e ndonjë këngëtari, ata mund të pëlqejnë emrin e tij për fëmijën e tyre.

Kur natyra e prindërve është tiranike, ata krenohen duke i emërtuar fëmijët e tyre sipas personaliteteve historike si, Aleksandri, Xhengiz Kani, Timuri, etj. Është vërejtur se gjatë emërtimit të fëmijëve, në përgjithësi prindërit e lidhin veten me njerëz dhe grupe të caktuara të së kaluarës. Kjo do të ketë ndikim të caktuar në natyrën dhe të menduarit e fëmijës kur të rritet.

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Caktojini emrat e mira, sepse në Ditën e Gjykimit ju do të thirreni vetëm përmes këtyre emrave. Do të thuhet ‘o filan, ngrihu dhe shoqëroju me dritën tënde’; ose, ‘o filan, dëgjo se nuk ka dritë për ty që do të të udhëzojë’” (Vasail al-shiah, v. 15, f. 123).

Një person i tha Imam Sadikut: “Ne i emërtojmë fëmijët tanë sipas emrave tuaj dhe emrave të paraardhësve të nderuar. A ka ndonjë dobi nga kjo për ne” Imami iu përgjigj: “Po, për Allahun. A nuk është besimi diçka tjetër pos dashurisë ndaj besimtarit dhe urrejtjes ndaj jobesimtarit!”

Për përhapjen e besimeve të tyre, njerëzit mundohen të përfitojnë nga çdo rast, duke u dhënë edhe projekteve emrat e tyre. Ata i emërtojnë qytetet, rrugët dhe vendet e tjera sipas personaliteteve të rëndësishme. Edhe myslimani i devotshëm dhe përgjegjës përfiton nga rasti për t'i

përjetësuar emrat e personaliteteve të mëdha të Islamit dhe ndër aktet e tilla është emërtimi i fëmijëve sipas tyre.

Po, Hasani, Hysejri, Abu Fazli, Ali Ekberi, Huri, Kasimi, Hamza, Xhaferi, abu Dherri, Amari, etj, janë ndër emrat që e gjallërojnë shpirtin, që t'i kujtojnë aktet trimëruese të personave të mëdhenj dhe i inkurajojnë gjeneratat e ardhshme që këta t'i marrin si model. Kur një person emërtohet sipas një të dërguari të madh si, Ibrahim, Musa, Isa ose Muhamed, ai është i nderuar me ndjenjën se ai duhet të mundohet të bëhet njeri i drejtë, aq sa ka mundësi për një gjë të tillë. Kur një person emërtohet sipas shokëve dhe të përkushtuarve të Ehli Bejtit të ndershëm, sikur abu Dher, Maithum dhe Ammar, ai do të kuptojë rëndësinë e veprave të atyre njerëzve të mëdhenj. Një mysliman inteligjent nuk duhet t'i emërtojë fëmijët e tij sipas emrave të tiranëve dhe armiqve të Islamit.

Imam Bakiri thotë:

“Ruajuni nga shejtani. Kur ai dëgjon se ndonjëri emërtohet si Muhamed apo Ali, ai shkrihet siç shkrihet plumbi, dhe kur të dëgjojë se ndonjëri emërtohet sipas armiqve tanë, ai pushtohet nga gëzimi.” (Vasail al-shiah, v. f. 127).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kushdo që i fiton katër djem dhe nuk e emërton asnjërin sipas meje, ai ka bërë mizori ndaj meje” (Vasail al-shiah, v. f. 127).

Imam Muhamed Bakiri, ka thënë:

“Emrat më të pashoqë janë emrat e të Dërguarve”.

I Dërguari i Shenjtë u ka kushtuar rëndësi të madhe emrave saqë, nëse nuk e ka pëlqyer emrin e ndonjë shoku apo vendi, ai e ndërroi menjëherë atë emër. Ai e ndërroi emrin e Abd al Shamsit në Abd al Vahab, Abd al Uzzan (robi i idhullit Uzza) e ndërroi në Abd Allah., Abd al Haris

(tigrî) në Abd ar Rahman dhe Abd al Ka'aba në Abd
Allah.”

Kapitulli i njëzetekatërtë

Shëndeti dhe higjiena

Rrobat e fëmijëve duhet të dizajnohen në atë mënyrë që t'i përshtaten kohës dhe klimës në të cilën jeton. Rrobat duhet të jenë të tilla që fëmija as të mos djersitet gjatë kohës së nxehtë, as të mos e ndiejë të ftohtin gjatë dimrit. Pambuku i butë dhe i thjeshtë është ideale për fëmijën. Rrobat nuk duhet të jenë të ngushta, ngase mund të pengojnë lëvizjen e fëmijës. Veshja e rrobave të ngushta për fëmijët është e papërshtatshme dhe nëna do të ketë vështirësi gjatë veshjes dhe zhveshjes së tyre. Është praktikë e përhapur në mesin e njerëzve që foshnjat të vishen me rrobat e ngushta, dhe gjymtyrët e tij të mos lëvizin. Praktika e tillë pengon zhvillimin normal të fëmijës.

Një autor perëndimor, shkruan:

“Mbas lindjes së fëmijës, pra mbas daljes së tij prej mitrës së nënës, ai do të dëshirojë t'i lëvizë gjymtyrët dhe do të kënaqet në lirinë e tij. Në këtë kohë, nënat i veshin me veshje të ngushtë. Ato, së pari e shtrijnë foshnjën në tokë, ia drejtojnë gjymtyrët, e mbështjellin me shumë pëlhura dhe e lidhin me një rripë përreth saj, dhe foshnja nuk është në gjendje aspak të lëvizë. Në këtë mënyrë, zhvillimi i fëmijës, që në këtë fazë duhet të jetë dinamik, ngadalësohet shumë dhe pastaj edhe frenohet. Në vendet ku kjo praktikë jociivilizuese nuk zbatohet, fëmijët e kanë zhvillimin normal dhe njerëzit e atij vendi zakonisht janë të fortë e të shëndoshë. Përkundrazi, në vendet ku foshnjat lidhen mbas lindjes, do të vijë deri te paraqitja e deformimeve si, çalimi, trupshkurtësia, etj. A mundet ndokush të paramendojë ndikimin e një zhvillimi të tillë në mendjen dhe shpirtin e fëmijëve? Mendimi i parë që do të vijë ne mendjen e fëmijës është, se ai është i zënë rob, sepse nuk mund të

lëvizë lirshëm. Gjendja e fëmijës së tillë do të jetë më e keqe sesa i një të burgosuri. Fëmijët e tillë do të bëhen nervozë dhe do të fillojnë të qajnë dhe të bërtasin. Çfarë do të bënit ju sikur t'juua kishin lidhur gjymtyrët? A nuk do të qanit e nuk do të bërtitnit edhe ju?!”

Edhe fëmija është një qenie njerëzore që ka ndjenja. Edhe ai ka dëshirë të ketë lirinë dhe rahatinë e tij. Kur liria e tij frenohet duke e lidhur me një rrip prej pëlhere, natyrisht që do të ndjejë dhimbje. Por, ai nuk mund ta mbrojë veten dhe reaksioni i vetëm që mund të bëjë është të fillojë të qajë. Kjo krijon një presion në mendjen e fëmijës dhe e bën nervoz, grindavec dhe me karakter jo të plotë. Rrobat e fëmijës duhet gjithmonë që të mbahen të pastra. Sa herë që i lag pelenat, duhet të ndërrohen menjëherë. Këmbët e fëmijës duhet të lahen kohë mbas kohe dhe duhet t'i bëhet masazh me vaj të ullirit, që të mos i thahet lëkura. Mbas disa urinimeve, fëmija duhet të lahet. Në këtë mënyrë, fëmija do të parandalohet prej shumë sëmundjeve. Fëmija i tillë do të duket i pastër dhe tërheqës në sytë e atyre që e shikojnë.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Islami është feja e pastërtisë. Ju duhet të përpiqeni për ta mbajtur veten të pastër sepse vetëm të pastërtit do të hyjnë në Xhenet.” (Maxhma al-zavaid, v. 5, f. 132).

“Pastrojini fëmijët nga papastërtitë, ngase të tillëve u merr erë shejtani. Nëse nuk i pastroni, ata do të shohin ëndrra të frikshme dhe engjëjt do të shqetësohen prej tyre” (Bihar al-anvar, v. 104, f. 95).

Synetia e fëmijëve mashkull në Islam, është një zakon i detyrueshëm. Kjo është shumë e rëndësishme për shëndetin dhe higjienën e fëmijës. Ky operacion do të parandalojë fëmijën nga infeksionet e mundshme të organit gjenital mashkullor. Synetia mund të shtyhet derisa fëmija të rritet, por është më mirë nëse kryhet mbas disa ditëve të

para prej lindjes. Islami rekomandon që synetia duhet të bëhet në ditën e shtatë nga lindja e fëmijës mashkull.

Imam Xhafer Sadiku, thotë:

“Bëjini synet fëmijët tuaj në ditën e shtatë mbas lindjes sepse kjo është më së miri për të. Po ashtu është e leverdishme për zhvillimin dhe rritjen e drejtë të tij. Sigurisht që toka neveritet nga urina e atij që nuk është bërë synet.” (Vasail al-shiah, v.15, f. 171).

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“I sapolinduri duhet të bëhet synet në ditën e shtatë mbas lindjes, që të ketë zhvillimin dhe rritjen e shëndoshë.” (Vasail al-shiah, v. 15, f. 175).

Prerja e flokëve të foshnjës në ditën e shtatë është rekomanduar në Islam. Një ekuivalent i peshës së flokëve të prerë në ar apo argjend duhet të jepet si lëmoshë. Në ditën e njëjtë duhet të prehet edhe një dash si kurban (*akika*) dhe mishi i tij duhet t’u shpërndahet të varfërve dhe atyre që kanë nevojë. Ata munden edhe të thirren për të marrë pjesë në gostinë e rastit. Akika është një lëmoshë e mirë dhe do të largojë çfarëdo të keqe prej fëmijës.

I sapolinduri është shumë i ndjeshëm. Atij i duhet kujdesi dhe vëmendja e prindërve. Themeli i shëndetit dhe i lumturisë do të vendoset në fëmijërinë e hershme. Përgjegjësia për këtë bie mbi supet e prindërve. Prindërit që janë shkaktarët e ardhjes së fëmijës në këtë botë, e mbajnë përgjegjësinë e rritjes së fëmijës në një qenie të fortë e të shëndoshë njerëzore. Nëse prindërit e lënë mbas dore këtë obligim, ata do të jenë përgjegjës për pasojat (konsekuencat).

Fëmija është gjithmonë i rrethuar me mundësinë e disa sëmundjeve. Ai mund të parandalohet prej tyre nëse i kushtohet kujdesi i mirë. Sëmundjet që mund të dëmtojnë fëmijën janë paraliza e fëmijëve, lunga (çibani) në trup, fruthi, difteria (gryka e bardhë), spazma, etj. Foshnjave u

jepen vaksinimet parësore parandaluese kundër sëmundjeve të tilla. Në përgjithësi, spitalet e pediatriisë i kanë mjetet për dhënien e vaksinave parësore pa pagesë për fëmijët kundrejt sëmundjeve të tilla. Prindërit nuk kanë kurrfarë arsytimi për pakujdesinë e tyre nëse nuk i parandalojnë me kohë këto sëmundje. Nëse ndonjë sëmundje ndikon tek ata për shkak të pakujdesisë së tyre, ata do të jenë përgjegjës para Allahut dhe ndërgjegjja e tyre do t'i mallkojë ata përgjithmonë. Prindërit duhet të kuptojnë se është përgjegjësi e tyre që të kujdesen për shëndetin dhe mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre, në mënyrë që ata të rriten dhe të bëhen njerëz të shëndoshë.

Kapitulli i njëzetepestë

Gjumi i fëmijëve dhe liria e lëvizjes

Gjatë javëve të para mbas lindjes, shumicën e kohës fëmija e kalon në gjumë. I sapolinduri fle për afërsisht 20 orë në ditë, dhe dalëngadalë shtohet kohëzgjatja e orëve që rri i zgjuar. Nevoja për pushimin dhe gjumin e plotë duhet të merret parasysh plotësisht. Zhurma dhe trazirat e shumta e shqetësojnë dhe nuk e lënë të pushojë fëmija. Ai preferohet të flejë në një mjedis të qetë që të mund të flejë rehatshëm. Shtrëngimet, përqafimet, puthjet dhe kalimi prej duarve të një personi në tjetrin, si dhe ardhja e shumë vizitorëve për të parë foshnjën, do të prishë rehatinë e tij. Mjedisi i zhurmshëm, zëri kumbues i televizorit dhe i radios mund të ndikojnë në nervat delikate të foshnjës. Gjumi i foshnjës nuk duhet të shqetësohet nga sjelljet e pakujdesshme. Nuk duhet të sillemi rreth e rrotull pa ndonjë nevojë. Nëse kjo praktikë vazhdohet për një periudhë kohore, fëmija do të bëhet i padurueshëm, nervoz dhe grindavec.

Foshnjat e sapolindura nuk e pëlqejnë rrethinën e zhurmshëm dhe lëvizjen rreth tyre. Kujdesi duhet të ushtrohet që mjedisi rrethues të mbahet i qetë dhe afër fëmijës të lëvizet vetëm kur është e domosdoshme. Fëmija ka dëshirë të qëndrojë në prehrin e nënës apo në djepin e tij duke u lëkundur lehtë, gjë që e bën veten ta ndjejë të rehatshëm. Me lëvizjen e djepit foshnja ndjen se një person që kujdeset për të, gjendet në afërsinë e tij. Nëse është qetësia e plotë dhe nëse nuk ka lëkundje, fëmija do ta ndiejë veten të vetmuar. Kjo është kështu sepse mitra e nënës është sikur djepi në të cilin fëmija është gjithnjë në lëvizje dhe kur të vijë në këtë botë, fëmija ka dëshirë të lëvizë. Edhe ninullat e ëmbla të nënës e rehatojnë foshnjën.

Viti i parë i fëmijës në këtë botë, është periudha e ushtrimit të trupit dhe gjymtyrëve të tij. Fëmija i pëlqen lëvizjet dhe për këtë arsye edhe i lëviz rreth e rrotull duart dhe këmbët. Prandaj, edhe veshja e foshnjës duhet të jetë jo e ngushtë dhe nga pëlhura e hollë. Lidhja e foshnjës përmes shumë shtresave të rrobave, do të pengojë lëvizjen e tij të lirë dhe do të ketë ndikim në nervat e tij. Fëmijët e tillë nuk kanë zgjidhje tjetër përveç se të qajnë, që është pararendës i natyrës së zemëruar dhe të pabindur.

Kapitulli i njëzetegjashtë

Periudha më e ndjeshme (delikate) e jetës

Periudha më e ndjeshme dhe vendimtare e jetës së një njeriu është fëmijëria. Themeli për personalitetin e ardhshëm të një individi vendoset në këtë periudhë. Edhe pakujdesia më e vogël mund të shkaktojë dëm të pakthyesëm për personalitetin dhe temperamentin e ardhshëm të fëmijës. Në të vërtetë, tri vitet e para të jetës së fëmijës luajnë rolin vendimtar për formimin e personalitetit dhe të karakterit të tij. Ndoshta shumica apo edhe të gjithë njerëzit nuk e vërejnë këtë aspekt shumë të rëndësishëm të rritjes së fëmijës. Në përgjithësi, ata thonë:

“Fëmijët e vegjël, dhe posaçërisht foshnjat, nuk kanë kapacitet për t'i kuptuar gjërat. Ata nuk mund të flasin prandaj janë të paaftë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ata janë të pafuqishëm dhe nuk kanë aftësi për të mësuar diçka nga vetvetja.”

Me një qëndrim të tillë, prindërit e shkapërderdhin periudhën e hershme të fëmijërisë. Kjo është periudha më e ndjeshme dhe më ndikuese e jetës së fëmijës. Gjatë kësaj periudhe, në dukje e jo e komplikuar, e marrin formën instinktet morale, kulturore dhe fetare të fëmijës.

Në këtë periudhë të hershme trevjeçare, fëmija i pranon disa qindra fjalë dhe mësohet me kuptimet e tyre. Ai do të fillojë për të dalluar të mirën dhe të keqen, miqësinë dhe armiqësinë, të bukurën dhe të shëmtuarën; po ashtu do të fitojë aftësinë e identifikimit të ngjyrave të ndryshme dhe shijen e ushqimit. Do të zhvillohet aftësia e vrojtimit dhe e të folurit. Do të fillojë të tregojë bazat e procesit të të menduarit. Do të mësojë të zvarritet dhe të ecë. Do të mësojë të qajë dhe të qeshë. Gjatë këtyre tri vjetëve, do të përjetojë mijëra ngjarje që mund të ndikojnë

në psikikën e fëmijës dhe që kanë lidhje me temperamentin e ardhshëm.

Përkundër gjithë kësaj, njeriu e ka shumë vështirë të mbajë në mend ngjarjet e tri vjetëve të para të jetës së tij. Të gjitha ndodhitë e kohës do të jenë nën ndikimin e harresës. Por, ato kujtimet e harruara veç kanë bërë ndikimin e tyre të madh në natyrën dhe personalitetin e individit. Disa sëmundje psikologjike si, frika, traumat, zemërimi, etj janë produkt i ngjarjeve të tri vjetëve të para të jetës së një personi.

Një psikolog shkruan:

“Nëse fëmija nuk e zhvillon personalitetin e fortë në tri vjetët e para të hershme të jetës së tij, atëherë ai nuk do të ketë aftësi për të bartur përgjegjësitë e rënda me të cilat do të përballlet në të ardhmen. Ai do të bëhet viktimë e disa defekteve psikologjike. Prandaj, është vërejtur se origjina e defekteve nervore te një person mund të hulumtohet në fëmijërinë e tij... Sa herë që ndonjë psikolog hulumton shkaqet e sëmundjes mendore, ai vjen në përfundim se në fëmijërinë e hershme të tij ka pasur rrethana të tilla që e kanë dëmtuar mundësinë e ikjes së tij nga problemet ekzistuese psikologjike.” (Ruvan shinasi Khudak o baligh, f. 106).

Dr. Xhelali shkruan:

“Themelet e sjelljeve të para shoqërore të fëmijëve vendosen në tri vjetët e para të jetës së tij... Prirjet e mendjes së tij bëhen të qarta vetëm gjatë kësaj periudhe.” (Ruvan shinasi Khudak o baligh, f. 302).

Për këtë arsye, prindërit e përgjegjshëm nuk e shpërfillin këtë periudhë delikate dhe me ndikim të jetës së fëmijës. Ata nuk e vonojnë formimin e fëmijës për të ardhmen. Në të vërtetë, formimi dhe rritja e fëmijës fillon me lindjen e tij.

Disa intelektualë, vërejnë:

“Fëmija fillon të formohet prej lindjes. Kujdesi që të mëdhenjtë dhe fëmijët tjerë përreth tij ia kushtojnë atij, do të jenë hapat e parë të formimit të tij. Ngjashëm edhe skenat dhe anekdotat që fëmija i përjeton dhe zërat që i dëgjon, do të kenë ndikim në ndërdijen e tij dhe do të jenë të lidhur me përvojën e tij të të mësuarit. Disa shprehi dhe përvoja, që janë tullat e ndërtimit të karakterit të personit, janë të lidhur me fëmijërinë e tij. Çfarëdo qëndrimi që prindërit e miratojnë ndaj fëmijëve të tyre prej lindjes, do të ketë ndikimin kryesor në rritjen dhe edukimin e tij” (Ilm al nafs al Tarbi, f. 19).

“Koha e fillimit të formimit moral është momenti i lindjes së personit. Kjo është koha kur formimi fillon pa ndonjë mundësi të dështimit. Nëse formimi fillon më vonë, do të ketë gjasa që fëmija ta përvetësojë qëndrimin negativ.” (Dar tarbiat, f. 79.).

Aliu i ka thënë djalit të tij Hasanit:

“Mendja e fëmijës është sikur toka e papunuar. Çfarëdo që të mbjellësh në të, ai do të pranojë. Prandaj, para se zemra e fëmijës të bëhet e ashpër dhe tërheqëse, ndërmerr hapat për zbutjen e saj.” (Vasail al-shia, v?, f. 197).

Kapitulli i njëzeteshtatë I sapolinduri dhe ngritja morale

Kur fëmija arrin në këtë botë, ai është shumë i dobët. Ai ka mendje por nuk mendon. Ai sheh me sy, por nuk i njeh objektet rreth tij. Nuk ka aftësi t'i identifikojë ngjyrat dhe fytyrat. Nuk ka ide për largësinë. I dëgjon zërat, por nuk është në gjendje t'i kuptojë ato. Ngjashëm do të jetë edhe gjendja e ndjenjave tjera. Përkundër të gjitha këtyre fakteve, fëmija ka aftësi t'i shfrytëzojë të gjitha këto ndjenja dhe përmes përvojës do të mësojë përdorimin e tyre.

Në Kuranin e Shenjtë, Allahu thotë:

“Allahu ju ka nxjerrë prej barkut të nënës suaj në një gjendje të tillë që ju nuk keni ditur asgjë dhe ju ka dhënë veshë, sy dhe zemra. Ndoshta do të jeni falënderues.” (16:78).

Veprimet kryesore të foshnjës do të jenë: ngrënia, fjetja, luajtja me gjymtyrët, qarja dhe kryerja e nevojës. Për disa javë, foshnja është në gjendje t'i kryejë vetëm këto veprime. Edhe pse veprimet e të sapolindurit janë të pakta dhe të thjeshta, ai vendos një raport me anëtarët tjerë të familjes, duke bërë eksperimente, duke formuar shprehje dhe duke kërkuar njohuri për veten dhe mjedisin përreth tij. Këto janë kontaktet dhe përvojat që ndërtojnë moralin e personit të ardhshëm.

Aliu, ka thënë:

“Me kalimin e ditëve, të panjohurat shturen” (Guraraal-hukm, f. 47).

Fëmija është një individ social i dobët. Pa ndihmën e të tjerëve nuk mund të mbijetojë as të gjejë furnizim. Nëse të tjerët nuk i ndihmojnë dhe nuk ia plotësojnë kërkesat, ai do të mbarojë. Personat që kujdesen për

foshnjën janë përgjegjës për rritjen e saj të plotë, duke përfshirë formimin moral dhe religjioz.

Prindërit e kujdesshëm, përmes qëndrimit të tyre të planifikuar mirë, i plotësojnë nevojat e foshnjës dhe ia sigurojnë mjedisin ideal për zhvillimin e trupit dhe shpirtit të saj. Ata ia japin fëmijës moralet dhe karakteret e mira. Përkundrazi, prindërit e painformuar, përmes veprave të pamenduara formojnë karaktere të padëshiruara te fëmijët.

Foshnja e sapolindur ndjen uri dhe kërkon ushqim. Ai e ndien nevojën e tij dhe shikon kah Qenia e Lartë për plotësimin e nevojave të tij. Kjo është arsyeja që foshnja qan; ajo dëshiron të tërheqë vërejtjen e nënës në mënyrë që t'i plotësohen nevojat e veta. Nëse ushtrohet kujdesi i mirë për plotësimin e nevojave të foshnjës, në bazë të një programi të planifikuar mirë, ajo do të flejë e rehatshme dhe do të zgjohet në kohën e saktë kur duhet të pranojë ushqimin. Nervat e një foshnje të tillë janë të qeta. Ato mësohen me karakteret e mira dhe normale. Në këtë fazë, kur foshnjat nuk e njohin askënd, do të përqendrohen vetëm në dy gjëra – dobësinë e paaftësinë e tyre, dhe vëmendja e tyre do të përqendrohet në Fuqinë Superiore, që është Siguruesi i të gjitha nevojave. Ata qajnë për të pranuar ndihmë prej Fuqisë së Fshehtë e të Padukshme që është Krijuesi i të gjitha gjërave. Foshnjat, duke u bazuar në dobësinë dhe pafuqinë e tyre, e lidhin veten me Fuqinë që është tepër Bujar. Nëse kjo ndjenjë përjetësohet te foshnja, atëherë ajo do të bëhet themeli i Besimit, Fesë dhe i lumturisë Shpirtërore në të ardhmen e tyre.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Asnjëherë mos i rihni foshnjat nëse qajnë. Plotësojini kërkesat e tyre. Sepse, për katër muajt e parë të jetës së foshnjës, të qarat e tij janë dëshmi për Ekzistimin dhe Njëjësinë e Allahut të Gjithëfuqishëm.” (Bihar al-anvar, v 104, f. 103).

Për katër muajt e parë të jetës së tij, foshnja e sapolindur nuk e ka fituar ende ekzistencën shoqërore. Ato nuk e njohin askënd, as nënën e saj. Kjo është periudha e vetme kur vëmendja e foshnjës është e fokusuar në Një Fuqi të padukshme. Por, ato foshnja që janë viktime të pakujdesisë së nënave të tyre, qajnë të pambrojtura në mënyrë që të tërheqin vëmendjen për ndihmë. Nervat e foshnjave të tillë do të jenë të shqetësuara dhe shumica e tyre janë të zemëruara. Gjatë kohës, zemërimi i foshnjave të tilla bëhet natyra e tyre e dytë. Atyre (foshnjave) do t'u mungojë vetëbesimi dhe do të bëhen të padisiplinuara dhe grindavece.

Kapitulli i njëzetetë

Ngritja religjioze e të sapolindurve

Është fakt se foshnjat e sapolindura nuk janë në gjendje të kuptojnë se çka u thuhet atyre, por ato janë plotësisht të aftë të identifikojnë rrethinën e tyre. Ato i dëgjojnë zërat dhe ndjenjat dhe në mendjet e tyre i regjistrojnë ato. Prandaj, nuk është e drejtë të themi se foshnjat e sapolindura nuk i pranojnë mbresat nga ajo që shohin dhe dëgjojnë në fëmijërinë e hershme. Edhe pse të sapolindurit nuk janë të aftë të kuptojnë të folurit që bëhet rreth tyre, zërat e fjalëve regjistrohen në mendjet e tyre dhe në faza ata fillojnë të kuptojnë kuptimet e tyre duke bërë pjesë të fjalorit të tyre. Edhe në mesin e më të rriturve është vërejtur se i regjistrojnë në memoriet e tyre vetëm fjalët që u lënë mbresë më së shumti. Më të rriturit i njohin më lehtë personat e njohur e të famshëm sesa personat e rastit. Ngjashëm, edhe foshnja, duke jetuar në një mjedis shpirtëror, duke dëgjuar recitimin e Kuranit, duke i ardhur fjalët e Allahut në veshin e saj dhe duke i parë prindërit që falen në prezencën e saj, gjatë kohës do të zhvillohet në një person religjioz. Në anën tjetër, foshnjat që janë të rrethuara nga personat jofetarë, dëgjojnë zërin e gjuhës së pasjellshme dhe fyese, që i janë të ekspozuar muzikës dhe këngës amorale, padyshim që do të rriten në persona të ngjashëm me të cilët janë të rrethuar.

Prindërit e matur e të kujdesshëm nuk do të humbin asnjë rast për t'i mësuar fëmijët e tyre. Ata kujdesen maksimalisht që fëmija të dëgjojë vetëm zëra të mirë dhe të shohë gjëra të mira.

Edhe i Dërguari i Islamit ka dhënë pikëpamjen e tij lidhur me këtë trajnim të rëndësishëm të fëmijëve. Ai ka thënë:

“Sapo të lindë fëmija, recitojani ezanin në veshin e djathtë, ndërsa ikametin në veshin e majtë.”

Aliu transmeton nga i Dërguari i Shenjtë:

“Kur të lindë një fëmijë në një familje, ezani duhet të recitohet në veshin e djathtë të fëmijës, ndërsa ikameti në veshin e majtë, kështu që fëmija do të jetë i mbrojtur nga të këqijat e shejtanit. I Dërguari i dha udhëzimet e njëjta gjatë lindjes së Hasanit dhe Hysejnit. Ai kërkoi të lexohet edhe ajeti i Kursiut, tri ajetet e fundit të sures Hashr, suret Ihlas, Nas dhe Felek në veshin e fëmijës.” (Mustadrak al-vasail, v2, f. 619).

Në disa hadithe, është transmetuar:

“Vetë i Dërguari i Shenjtë, mbas lindjes së Imam Hasanit dhe të Hysejnit e kishte lexuar ezanin dhe ikametin në veshin e tyre.”

Po. I Dërguari ishte i vetëdijshëm se foshnja nuk është në gjendje ta kuptojë kuptimin e ezanit dhe të ikametit të lexuar në vesh, por shqiptimi i atyre fjalëve në veshin e të sapolindurit nuk ishte i kotë. I Dërguari kishte vënë theksin në çështjen se këto fjalë fetare do të kenë ndikim të dobishëm në mendjen dhe shpirtin e të sapolindurit. Ndoshta, I Dërguari i Shenjtë kishte për qëllim udhëzimin e prindërve për rritjen e duhur të fëmijëve të tyre, që ata të fillojnë detyrën e tyre menjëherë prej lindjes së fëmijës. Kur prindërit e matur (të ngritur) ia lexojnë ezanin në veshin e fëmijëve të tyre, atëherë ata janë duke deklaruar se fëmijën e tyre e kanë bashkuar me grupin e adhuruesve të Allahut.

Ndikimet që fëmija i pranon që nga ditët e hershme të tij nuk kanë të bëjnë vetëm në shqisën e të dëgjuarit. Mund të thuhet se çfarëdo që fëmija zbulon përmes shqisave tjera, e njëjta do të ndikojë edhe në mendjen dhe memorien e tij. P.sh. nëse fëmija është dëshmitar i ndonjë

vepre amonale, edhe pse nuk do të kuptojë domethënien e saj, padyshim që do të ketë ndikim në psikikën e tij.

Kjo është arsyeja që i Dërguari i Shenjtë ka thënë:

“Nëse foshnja në djep është duke shikuar, mashkulli duhet të përmbahet nga kryerja e aktit seksual me gruan e tij.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 546).

Kapitulli i njëzetënëntë

Ndjenja e varshmërisë

Foshnja e sapolindur do të jetë një identitet delikat që nuk mund të jetojë pa mbështetje prej të tjerëve. Kur ishte në mitrën e nënës, ai kishte një kënd të nxehtë e të rehatshëm për vete, ku ushqimi dhe nxehtësia furnizoheshin nga ana e nënës. Ajo nuk kishte asnjë brengë për ndonjë nevojë. Tani që ka arritur në këtë botë, ajo ka filluar ta ndjejë veten të varur. Nevoja e parë që foshnja e ndien është, ndoshta, nevoja për ngrohtësi, sepse mjedisi në të cilin ka mbërritur është më i ftohtë. Pastaj, ajo e ndjen nevojën për plotësimin e urisë. Për herë të parë ajo do të dijë se për ngrohtësi dhe ushqim do të duhet që të mbështetet te tjerët. Në këtë fazë nuk e njeh askënd që mund t'i ndihmojë. Sipas natyrës, ajo është e vetëdijshme për nevojat e veta dhe e përqendron vëmendjen në një Fuqi të padukshme për plotësimin e nevojave të veta. Që nga fillimi i jetës së vet, foshnja është e pushtuar me ndjenjën e varshmërisë dhe kjo ndjenjë do të jetë e pranishme gjatë tërë jetës së saj. Kur foshnja ndien uri apo etje, ajo qan. Ajo do të kapet për gjirin e nënës dhe do të ndihet e qetësuar nga ninulla e kënduar për fëmijën. Nëse foshnja e fiton ndjenjën se ka ndonjë rrezik rreth vetes, ajo kapet për përparësen e nënës.

Kjo ndjenjë e varshmërisë, më vonë do ta manifestojë veten në shprehinë e pasimit (*taklid*) të udhëheqjes së të tjerëve. Fëmija i modelon (zhvillon) moralin dhe sjelljet sipas moraleve dhe sjelljeve të personave të rrethit të ngushtë. Po ashtu, kjo ndjenjë e varshmërisë më vonë do t'i ndihmojë atij që të krijojë shoqëri dhe të luajë me shokët e tij. Miqësia dhe dhembshuria drejt bashkëshortit dhe fëmijëve të tij janë vazhdimësia natyrore e ndjenjës së varshmërisë. Ky

zhvillim për fëmijën është pararendës i natyrës shoqërore të qenies njerëzore. Prandaj, ndjenja e varshmërisë që fëmija e ka, nuk është diçka e parëndësishme dhe është pikëpamja kryesore e strukturës së shoqërisë njerëzore. Fëmija zhvillon aftësinë e shpresës dhe të përmbajtjes. Ai do të zhvillojë ndjenjën e atmosferës shoqërore kundrejt të tjerëve, do të mendojë mirë për të tjerët dhe do të presë kooperimin e tyre. Kur mendimi i tij për shoqërinë është i mirë, atëherë ai do të shtrijë dorën e tij të mbështetjes dhe do të bëjë sakrificën e duhur në këtë drejtim. Njerëzit e shoqërisë do ta konsiderojnë atë si dashamirës të tyre.

Në të kundërtën, nëse ndjenja e varshmërisë shtypet dhe nuk përdoret në mënyrë të drejtë, atëherë fëmija mund të devijojë nga rruga e drejtë që Zoti ia ka caktuar atij. Mendimi i psikologëve është se fëmija, në shumë faza, bazuar në ndodhitë përreth tij, do të mund të fitojë bazat e ndjenjës së frikës, nervozizmit, mungesës së mirëbesimit, turp, vetmisë, pikëllimit dhe madje qëllimeve vetëvrasëse.

Nëse dëshironi të kënaqni ndjenjën e varshmërisë së fëmijës në mënyrë të drejtë, atëherë gjithmonë provoni të bëheni mbështetës i tij. Kur është i uritur, ushqejeni. Siguroni mjetet e rehatisë për të. Nëse fëmija është i parehatshëm apo ka dhimbje, provoni ta përmirësoni atë. Mbajeni programin e tij të gjumit dhe të ushqimit nën kontroll, që të mos ndjejë shqetësim.

Përmbahuni të mos i rrihni fëmijët. Fëmija nuk di asgjë veçse për nevojat e veta të tanishme. Ai i beson vetëm Fuqisë së Padukshme dhe duke qarë kërkon ndihmë prej Tij. Mos e nxirrni zemërimin tuaj duke iu drejtuar fëmijës dhe duke e rrahur atë.

I Dërguari i Shenjtë, ka thënë:

“Mos i rrihni foshnjat kur qajnë, sepse kur foshnja më e vogël se katërmuajshe qan, ajo dëshmon për Njëjësinë e Allahut.” (Bihar al-anvar, v. 104, f.104).

Mbështeteni fëmijën tuaj nën çdo rrethanë, edhe nëse nuk jeni në gjendje të kryeni ndonjë detyrë për të, mundohuni ta trajtoni me dashuri dhe kujdes. Nëse fëmija është i parahatshëm, mundohuni ta largoni shkakun e parahatisë. Asnjëherë mos e qortoni fëmijën dhe mos e kërcënoni se do të shkoni dhe do ta leni të vetëm. Gjatë sjelljeve të tilla mund të dëmtoni psikologjinë e fëmijës. Fëmija pret që prindërit ta trajtojnë si bebëzën e syrit. Nëse prindërit nuk e tregojnë këtë kujdes ndaj fëmijëve, ata do të shqetësohen. Fëmijët gjithnjë do të mundohen të fitojnë dashurinë dhe dhembshurinë e prindërve. Disa prindër e keqpërdorin këtë qëllim dhe i thonë atij se nëse nuk i dëgjojnë, ata nuk do ta duan më atë. Ata duhet të mos pretendojnë në këtë mënyrë. Këto dredhi mund të dëmtojnë edhe psikikën e fëmijës gjatë fazave. Nëse fëmija qan, ai mund ta bëjë këtë për ta tërhequr vëmendjen e prindërve. Prindërit duhet t'i trajtojnë fëmijët me durim dhe maturi. Nëse fëmija është i qortuar apo i rrahur, ai mund të qetësohet për një moment, por kjo do të jetë qetësia e zhgënjimit që mund të ketë ndikim negativ në mendjen e tij. Fëmija është gjithnjë i lumtur me prindërit rreth tij dhe është i parahatshëm kur ata largohen. Prindërit nuk duhet të flasin për vdekjen e tyre në prezencën e fëmijëve, sepse ata do të shqetësohen shumë. Prindi i sëmurë nuk duhet asnjëherë të përmendë mundësinë e vdekjes në prezencën e fëmijëve. Nëse njëri prind duhet të udhëtojë larg prej fëmijëve për një periudhë më të gjatë kohore, duhet t'i përgatis fëmijët për këtë ndarje. Përderisa është larg, prindi duhet t'i mirëmbajë kontaktet rregullisht.

Kur fëmija refuzon për të pranuar ilaçet, mos e frikësoni duke i thënë se nëse nuk e merr do të vdesë. Mbani një qëndrim pozitiv dhe mundohuni ta bindni për të marrë ilaçin, duke i thënë se do t'i bëjë mirë. Nëse fëmija është duke vuajtur nga ndonjë sëmundje e rëndë, mbajeni

veten të qetë e të përmbajtur në prezencën e tij. Prindërit duhet gjithnjë të mundohen të bëhen shokë të mirë dhe dashamirës të fëmijëve gjatë tërë jetës së tyre.

Duhet të gdhendet në mendjen e prindërve se shprehja e dashurisë dhe e kujdesit për fëmijën duhet të bëhet në mënyrë të përmbajtur. Llastimi i fëmijës për një kohë të gjatë mund të jetë i dëmshëm për të. Sa herë që fëmija nuk është në gjendje të kryejë ndonjë detyrë, prindërit duhet t'i ndihmojnë. Por, kur fëmija është i aftë për ta kryer vetë, prindërit duhet ta lënë ta përfundojë. Ndonjëherë, fëmija mundohet të tërheqë vërejtjen e të tjerëve duke qarë, përkundër asaj që ka aftësi për të kryer atë detyrë, në raste të tilla duhet nxitur por jo me dhunë, vetë ta kryejë detyrën.

Ruselli shkruan:

“Nëse fëmija qan pa ndonjë arsye, atëherë ai duhet të lihet në ndërgjegjen e tij dhe të lejohet të qajë deri në fund. Nëse veprohet ndryshe në rrethana të tilla, atëherë fëmija mund të bëhet diktatorial dhe të sillet keq edhe më shpesh. Sa herë që fëmija qan për ndonjë nevojë të arsyeshme, nuk duhet t'i kushtohet vëmendje e tepruar, dhe të mos vijë deri te llastimi i tij.”

Kapitulli i tridhjetë

Kur fëmija fillon të shohë botën përreth tij

Fëmija është një njeri në miniaturë dhe natyra e tij është sociale. Ai ka nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e të tjerëve për të jetuar. Ai do të ketë kujdesin e tij të fokusuar te të tjerët; ai përfiton dobi prej tyre dhe të tjerët përfitojnë dobi prej tij si kundërshpërblim. Muajt e parë të jetës së tij, i sapolinduri nuk i njeh të tjerët dhe nuk është i aftë t'u kushtojë vëmendje atyre. Mbasi të mbushen katër muaj, fillojnë të shihen bazat e natyrës shoqërore në sjelljet e tij. Prej kësaj kohe fillon t'ia kushtojë vëmendjen rrethinës dhe fillon t'i vështrojë sjelljet e nënës së vet. Fillon të reagojë ndaj veprimeve të të tjerëve. Nëse nëna qeshet, edhe ai ia kthen të qeshurën. Nëse nëna i luan vetullat, edhe ai e bën të njëjtën. I shikon lodrat me interesim dhe buzëqeshje. Fillon t'i masë ndjenjat e lumturisë dhe të zemërimit të të tjerëve

Kur të përballet me faqen e lumtur dhe të gëzuar, përnjëherë kërcen drejt tyre. Ai dëshiron të ulet dhe ta vështrojë botën përreth tij.

Në këtë fazë, prindërit duhet të kujdesen për atë se fëmija i ka zhvilluar disa ndjenja të rrethinës dhe se është anëtar i plotë i familjes. Fëmija është në gjendje t'ua kushtojë vëmendjen të tjerëve në familje dhe, deri në një masë, t'i kuptojë ndjenjat e tyre. Gjatë katër muajve të parë të jetës së tij, fëmija ka kaluar përmes disa përvojave dhe ka formuar një memorie për gjërat rreth tij. Ky është agui i jetës shoqërore të tij. Nëse prindërit janë të matur në tentimet për të ushqyer instinktin e fëmijës, ai mund të ndihmohet dhe të zhvillohet e të bëhet një anëtar i dobishëm i shoqërisë. Përndryshe, fëmija do të fillojë të bëhet i pavëmendshëm ndaj botës së jashtme dhe do të kufizohet vetëm me fushën e botës së tij të brendshme. Ai

mund të shndërrohet në një person të turpshëm dhe të tërhequr nga bota. Ai do të bëhet viktimë e kompleksit të vlerës së ulët.

Prindërit bartin një përgjegjësi të madhe. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se fëmija ka ndjenja dhe është nën ndikimin e sjelljes së tyre. Ata duhet ta mbajnë vëmendjen e fokusuar në të. Ata duhet të vijnë në prezencën e fëmijës me buzëqeshje dhe me fytyrë të këndshme. Me fëmijën duhet të flasin me dashuri. Duhet që t'i sigurojnë fëmijës lodra edukuese që të njihet me botën e jashtme me lehtësi dhe me rehati.

Nëse nevojat dhe dëshirat e fëmijëve janë të plotësuara, ata do të ndjehen të rehatshëm. Ata do të fillojnë të ndjejnë se të tjerët ia donë të mirën dhe se janë mirëbërësit e tij. Kur të trajtohet mirë, fëmija përgatitet të bëhet anëtar i mirë i shoqërisë. Prindërit e mirë dhe të vëmendshëm nuk i rrahin fëmijët e tyre dhe nuk i trajtojnë ashpër. Ata janë të vetëdijshëm se një sjellje e tillë do të ketë efekt të kundërt në mendjen e fëmijës dhe do ta shndërrojnë atë në një person me karakter të humbësit dhe që është i turpshëm.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Respektojini fëmijët tuaj dhe mundësojuni një rritje të mirë, që Allahu t’ju bekojë.” (Makarim al-ahlak, f. 255).

Kapitulli i tridhjetenjtë

Dashuria

Njeriu është gjithmonë i etshëm për dashuri dhe dhembshuri. Dashuria i jep zemrës jetë. Një person që e do një person tjetër dëshiron që edhe të tjerët të kenë ndjenja të ngjashme për të, ndaj për këtë ai ndjen kënaqësi në zemrën e tij. Kur një person ndjen se askush në këtë botë nuk e do atë, ai do të ndihet i dëshpëruar dhe fatkeq. Prandaj, do ta ndjejë veten të pikëlluar dhe në rënie shpirtërore. Edhe fëmija është një njeri në miniaturë dhe, në fakt, ka më shumë nevojë për dashuri dhe dhembshuri sesa të rriturit. Ashtu siç ka nevojë për ushqim, ashtu ka nevojë edhe për dashuri. Fëmija nuk mërzhitet se a jeton në ndonjë pallat apo kasolle, por e di shumë mirë se a është duke pranuar dashurinë e të afërmeve të tij apo jo. Prej ndjenjës së dashurisë dhe kujdesit, fëmija vazhdon të lëvizë në rrugën e rritjes dhe të mbarëvajtjes. Burimi i karakterit të mirë është dashuria dhe dhembshuria. Nën pasqyrimin e dashurisë, ndjenjat dhe mendimet e fëmijëve mund të ushqehen në mënyrë të drejtë që ta bëjnë atë qenie të mirë shoqërore.

Fëmija që pranon dashuri të bollshme, do ta ketë shpirtin dhe zemrën e lumtur. Ai nuk do të jetë viktimë e zhgënjimit. Ai do të bëhet një person që ka besim në vetvete, i përzemërt dhe që e respekton vetveten. Ai nuk do të jetë viktimë e problemeve psikologjike. Fëmijët që kanë pranuar dashuri të bollshme prej më të vjetërve, janë të përgatitur më mirë për t'u përballur me realitetin e ashpër dhe problemet e jetës së të rriturve.

Një vajzë që ka pranuar dashuri dhe dhembshuri nga prindërit e saj, nga familja, dhe që është e pajisur me aureolën e dashamirësisë, nuk do të dorëzohet aq lehtë ndaj uverturave (fillim i bisedave) të djemve në rininë e saj, gjë që mund të ndikojnë në jetën e saj të ardhshme. Një djalë

që është rritur në një atmosferë të dashurisë së vërtetë dhe të dhembshurisë, nuk do të bëhet viktimë e të këqijave si, droga dhe pirja e alkoolit.

Edhe nga pikëpamja psikologjike, është vërtetuar se fëmijët që kanë pranuar dashuri dhe dhembshuri të bollshme nga prindërit e tyre, gjatë rritjes së tyre janë më inteligjentë dhe më të shëndoshë sesa njëri që është rritur në një konvikt larg nga prindërit e tij. Është një gjë tjetër që fëmijët e shkollave me konvikt të mund të kenë ushqimin dhe kujdesin shëndetësor më të mirë.

Ata që janë rritur në një atmosferë mekanike, që u mungon ndjenja e dashurisë dhe e dhembshurisë, dhe që nuk e kanë provuar rehatinë e afërt të prindërve, mund të mos kenë ndjenja natyrore të dhembshurisë kundrejt të tjerëve.

Fëmija që nuk e ka pranuar plotësisht dashurinë dhe dhembshurinë e prindërve të tij, do të bëhet viktimë e ndjenjave të humbjes dhe të vlerës së ulët. Në të shumtën e rasteve, shkakun i zemërimit, paturpshmërisë, padurueshmërisë, depresionit, etj gjenden në mungesën e dashurisë dhe të dhembshurisë gjatë fëmijërisë së atij personi.

Personat që bëhen të këqij, si vjedhës apo vrasës, në të shumtën e rasteve kanë qenë nga ata që u ka munguar dashuria dhe dhembshuria prindërore në jetën e tyre të hershme. Ata sillen sikur rebelët në shoqëri. Ata mund të kenë edhe tendenca vetëvrasëse. Gazetat dhe magazinat janë plot me tregime të personave të tillë të pafat. Dr Hasan Ahdi, drejtori i Departamentit të Psikiatrisë në Shoqërinë Kombëtare për përkujdesjen e fëmijëve, ka kryer një eksperiment me pesëqind banorë të konviktit dhe ka ardhur në përfundim se krimet e para këta persona i kanë kryer ndërmjet moshës dymbëdhjetë e trembëdhjetë vjeç. Shkakun

kryesor për kundërvajtje ka qenë mungesa e dashurisë dhe e dhembshurisë nga familjet. Ai thotë:

“Bazat e shumicës së problemeve psikologjike mund të gjurmohen në fëmijëri. Edhe fëmijët më të balancuar kanë problemin e zbutjes së emocioneve.” (Daily Kihan, Issue 42).

Një person i ri, shkruan:

“Sytë e mi i kam hapur në një familje të varfër të një fshati të vogël. Mirëvajtja ime dhe e dy motrave të mia ishte jashtë interesimit të familjes sime. Mua më mori gjyshja në shtëpinë e saj. Kushtet e saja ishin më të mira dhe ajo më donte shumë. Kishte zakon të më blinte roba të mira dhe gjëra të tjera për mua. Por këto gjëra nuk e zëvendësonin dashurinë dhe dhembshurinë e nënës dhe babait tim për të cilët kisha nevojë. E ndjeja veten sikur të kisha humbur diçka. Shumë herë strukesha në ndonjë qoshe dha qaja larg nga shikimet e të tjerëve. Isha në klasën e tretë të shkollës fillore, kur erdhi një ditë babai për të më parë. Ai kërkoi të shkoja në shtëpi me të. Unë u gëzova shumë kur e mora këtë ftesë dhe u përgatita menjëherë për të shkuar. Për një moment mendova se të gjitha problemet e viteve të mia të gjata kishin përfunduar. I këshilloj të gjithë baballarët dhe nënat të mos i ndajnë fëmijët e tyre nga afërsia, dashuria dhe nga dhembshuria e tyre, pa marrë parasysh situatën dhe kushtet në të cilat ndodhen. Ata duhet të kuptojnë se kjo ndarje e fëmijëve prej tyre dhe prej dashurisë së tyre do të jetë shumë e rëndë për fëmijët. Kjo zbrazëti nuk mund të plotësohet me asnjë rehati.”

Një person tjetër, shkruan:

“Unë isha privuar nga dashuria dhe dhembshuria e prindërve të mi. Kjo është arsyeja që unë tani jam një person zemërthyer dhe xheloz. Unë jam një person frikacak dhe i zemëruar. Në fëmijëri unë ikja nga shkolla. Me

vështirësi arrita deri në klasën e gjashtë të shkollës fillore dhe pastaj e braktisa.”

Feja e shenjtë - Islami, që ushtron kujdesin e madh ndaj rritjes së fëmijëve, e vë theksin e veçantë ndaj dashurisë dhe dhembshurisë për fëmijët. Kurani dhe Tradita përmbajnë pjesë të shumta në lidhje me këtë temë. Këtu do t'i përmendim vetëm disa prej tyre:

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

Për shkak të dashurisë së tyre të thellë që prindërit kanë për fëmijët e tyre, Allahu do t'i përfshijë në Mëshirën e Tij.” (Vasail al-shia, v.15, f. 98).

Allahu i ka thënë të Dërguarit (në një hadith kuds): “Dashuria ndaj fëmijëve është ndër veprat më të mira, sepse qëllimi i krijimit të tyre është adhurimi i Allahut dhe dëshmimi i Njëjesisë së Allahut. Nëse fëmijët vdesin në fëmijërinë e tyre, ata do të hyjnë në Xhenet.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 615).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Dashurojini fëmijët tuaj dhe bëhuni të sjellshëm ndaj tyre.” (Bihar al-anvar, v. 104, f. 92).

“Puthini fëmijët tuaj sa më shumë, sepse çdoherë që e puthni fëmijën, Allahu do t'jua lartësojë pozitën tuaj në Xhenet për një shkallë.” (Bihar al-anvar, v. 104, f. 92).

Një person i tha të Dërguarit:

“Unë nuk kam puthur asnjë nga fëmijët e mi deri më sot.”

Kur u largua ky person, i Dërguari i tha shokëve:

“Sipas meje, ky njeri është ndër banorët e Xhehenemit.” (Bihar al-anvar, v. 104, f. 99).

“Personi që nuk është i sjellshëm ndaj fëmijëve dhe nuk i respekton më të vjetrit, nuk na përket neve.” (Bihar al-anvar, v. 75, f. 147).

Duke përpiluar testamentin e tij, Aliu tha:

“Silluni mirë ndaj fëmijëve dhe respektojini më të vjetrit.” (Bihar al-anvar, v. 75, f. 146).

Kapitulli i tridhjetedytë

Shprehja e dashurisë dhe e dhembshurisë

Dashuria e çdonjërit për fëmijët e tij është një instinkt natyral. Ndoshta ka prindër të tillë që nuk i duan fëmijët e tyre nga thellësia e zemrave të tyre, por vetëm dashuria nga zemra nuk është e mjaftueshme për formimin e fëmijëve. Fëmija ka nevojë për dashuri që është e pasqyruar përmes veprave të prindërve. Fëmija dëshiron të puthet, të përqafohet dhe të shikohet me buzëqeshje. Kur prindërit i këndojnë ninullat, fëmija i shijon ëmbëlsitë e tyre. Fëmija dëshiron që prindërit të luajnë e të lodrojnë me të. Këtë fëmija e trajton si një shenjë të dashurisë. Zemërimin dhe konfliktet i konsideron si shenjë të pavëmendjes. Sa herë që prindërit e shikojnë fëmijën në kohëra të ndryshme, ai do vërejë se a po e shikojnë me dashuri në fytyrat e tyre apo jo.

Janë disa prindër që e shfaqin dashurinë e tyre të madhe vetëm përderisa fëmija është foshnje, por, me rritjen e fëmijës, në mënyrë graduale e zvogëlon shprehjen e dashurisë, dhe kur fëmija e arrin pjekurinë, ata heqin dorë plotësisht nga ai, madje thonë se shprehja e dashurisë mund ta dëmtojë atë. Ky nuk është një qëndrim i drejtë. Fëmija pret dashurinë prej prindërve gjatë tërë jetës së tij. Ai ndjen kënaqësi nga shprehja e dashurisë së prindërve të tij dhe nëse e sheh se ata po e injorojnë atë, ai do të ketë ndjenjën e lëndimit. Posaçërisht mosha e pjekurisë është një periudhë shumë kritike e jetës së një personi, kur mbështetja dhe udhëzimi i prindërve është më së shumti e nevojshme. Është pikërisht kjo neglizhencë e prindërve ndaj adoleshentit që ndikon më së shumti në vetëvrasjet e kësaj grupmoshe. Janë edhe rastet kur personat e tillë zhduken në vende të panjohura. Nuk do të jetë e tepërt nëse

këtu i citojnë disa rreshta nga ditari i Nazninit, një tinejxher:

“Kur mendoj për nënën dhe babanë tim, nuk mund të përmbahem së qeshuri, edhe pse ata meritojnë më shumë të vajtohen sesa të qeshen. Nëna është e zënë në botën e vet, e okupuar me detyrat e veta ditore. Ajo ka dëshirë të rrijë dhe të përgojë me orë të tëra me hallën Vizri dhe Zonjën Hamida. Nëse ndonjë nga vëllezërit apo nga motrat arrijnë në mes të bisedës për ndonjë porosi, ajo e urrente ndërprerjen. Ajo nuk vërente se gjatë përgojimit në lidhje me atë se a janë origjinale këpucët dhe fustanet e ndonjërit, ajo më bënte të ndjeja veten si ndonjë zog që vërtitej rreth e rrotull ndonjërit për t’i zbrazur ndjenjat e zemrës. Nëna dhe babai janë të zënë duke u shtyrë me fjalë njëri me tjetrin apo duke ndenjtur në ndonjë shoqëri dhe përgojuar të tjerët. Apo, përndryshe nuk janë në shtëpi. Edhe unë jam i zënë tërë ditën në shkollë, prej mëngjesit deri në mbrëmje. Që prej disa ditëve unë i kam drejtuar sytë kah babai im. Arsimitari i Letërsisë është psikolog. Sot ai foli për efektin që një baba mund të ketë në psikikën e vajzës së tij. Fjala e tij ishte ngulitur në zemrën time. Ai kishte të drejtë kur tha se unë konsiderohem i rritur në sytë e të gjithëve. Por, unë e ndiej nevojën e udhëzimit të babait tim më shumë sesa ndonjë gjë tjetër në jetë. Gjithnjë ekziston nevoja për fuqinë morale të ndonjë të urti dhe të sjellshmi. Por, si duket, babai im nuk ka kohë për një gjë të tillë.” (Daily Itallaat, Nr 14112, Muaji Hurdad 1358).

Vendi më i mirë për trajnimin e fëmijëve, posaçërisht në fazën e hershme të jetës së tij, është shtëpia e tij. Në këtë periudhë fëmija pranon kujdesin e plotë, mirësjelljen dhe dashurinë e prindërve. Këshillohen prindërit që sa të kenë mundësi të mos u besojnë çerdheve të fëmijëve lidhur me edukimin. Ndoshta këto çerdhe mund të jenë të pajisura më mirë për nga higjiena dhe ushqimi,

por ato sigurojnë një jetë të ftohtë dhe të huaj për fëmijët. Vendi i tillë do të jetë si një burg për fëmijët, që dëshirojnë shoqërimin e prindërve më shumë se çdo gjë tjetër në jetë. Vetëm mjedisi i mirë dhe ushqimi nuk mund ta plotësojnë zbrazëtirën të krijuar nga mungesa e dashurisë dhe e kujdesit të prindërve.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Nëse e pëlqeni ndokënd, tregoni ndjenjat tuaja ndaj tij. Kjo shprehje e dashurisë ju afron më tepër ndërmjet veti. (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 67).

I Dërguari kishte shprehi të luajë me fëmijët dhe nipat e tij për çdo mëngjes, duke shprehur dashurinë dhe dhembshurinë ndaj tyre. (Mustadrak al-vasail, v. 104, f. 99).

Kapitulli i tridhjetetretë

Dashuria, jo si një instrument i arritjes së qëllimeve

Për shkak të nevojës së fëmijëve për dashuri dhe dhembshuri, disa prindër e shfrytëzojnë këtë nxitje të fëmijëve të tyre për t'i arritur qëllimet e veta. Ata kërkojnë nga fëmijët e tyre t'i bëjnë gjërat e caktuara ose përndryshe nuk do t'i duan ata. Padyshim që, një shkallë e kontrollit mund të ushtrohet ndaj fëmijës në këtë drejtim. Por, nëse vazhdohet me këtë strategji për një kohë më të gjatë, kjo mund të jetë e dëmshme, sepse, fëmija mund të fitojë shprehinë e kryerjes së gjërave vetëm për të kënaqur prindërit dhe jo për të fituar leverdi për vete dhe për shoqërinë. Ai fillon të vendosë lidhur me arsyen e punës duke marrë për bazë kënaqjen e ndonjërit. Ai nuk është i ndërgjegjshëm për atë se veprat e tij do të shndërrohen në mbarëvajtjen e shoqërisë dhe të njerëzimit në përgjithësi. Janë shumë prindër që e vlerësojnë përfitimin personal më shumë se të mirën e shoqërisë. Fëmijët e tyre bëhen lajkatarë, hipokritë dhe mashtrues, sepse qëllimi i tyre në jetë bëhet kënaqja e të tjerëve me çdo kusht. Prandaj, mentori i mençur dhe i matur nuk do të shfrytëzojë dashurinë dhe dhembshurinë e fëmijëve për qëllime personale egoiste.

Kapitulli i tridhjetekatërtë

Dashuria nuk duhet të bëhet pengesë për një rritje të mirë

Janë disa prindër që i duan fëmijët e tyre deri në një masë, sa që nuk e vërejnë se çka është e mirë dhe çka është e keqe për rritjen e tyre. Kur ata vërejnë se fëmija e tyre është duke vepruar gabim, apo kur ndonjëri ua bën me dije atyre për ndonjë gabim të fëmijës, ata nuk e marrim parasysh atë vetëm që të mos e bezdisin apo irritojnë fëmijën. Ju sigurisht keni parë fëmijë të tillë që i fyejnë fëmijët tjerë, i bezdisin të tjerët, i thyejnë xhamat e fqinjëve dhe e përdorin gjuhën fyese me të tjerët. Prindërit e fëmijëve të tillë, jo vetëm që nuk mundohen t'i korrigjojnë, por edhe e mbajnë një buzëqeshje të gjakftohtë në fytyrat e tyre kur fëmijët e tyre bëjnë ndonjë gabim të tillë. Në këtë mënyrë ata i nxisin veprat e padëshiruara të fëmijëve dhe më këtë ata i shkaktojnë një dëm të madh fëmijëve të tyre. Kjo mospërfillje e rritjes së duhur nuk është e falshme në sytë e Allahut. Dashuria ndaj fëmijëve nuk do të thotë që prindërit t'i mbyllin sytë ndaj normave të rritjes së duhur. Prindërit e mirë janë ata që bëjnë përzierjen e shkathët të dashurisë dhe të rritjes së mirë. Ata i duan fëmijët e tyre dhe e mbajnë syrin realist mbi sjelljen e fëmijës së tyre. Ata mundohen në mënyrë të shkathët që t'i korrigjojnë gabimet e fëmijëve. Ata e bëjnë që fëmija t'i vërejë se ai nuk është i lirë në kryerjen e veprave të gabuara. Fëmijës i është dhënë në dije fakti se nëse prindërit e duan atë për shkak të gjërave të mira që i bën, ai gjithashtu edhe mund të dënohet për ndonjë gabim të kryer. Prindërit duhet të kuptojnë se fëmija do të rritet në një adoleshent dhe do të bashkëveprojë me të tjerët në shoqëri. Nëse, për shkak të dashurisë së tepërt për fëmijët e tyre, ata i shpërfillin detyrat e tyre të formimit me anë të normave të mirësjelljes,

fëmija nuk do të jetë i mirëseardhur në shoqëri dhe të tjerët do të largohen prej tij apo do ta urrejnë dhe ndiejnë neveri ndaj tij. Duhet që të ngulitet në mendjen e fëmijëve se të tjerët nuk do të jenë sikur prindërit që i mbyllin sytë ndaj çdo gabimi të tyre dhe të vazhdojnë për t'i dashur ata. Në shoqëri, personi do të pranohet vetëm për shkak të sjelljes së mirë së tij.

Imam Muhamed Bakiri thotë:

“Babai më i keq është ai që i do fëmijët e tij përtej kufijve.” (Yakubi, Tarih, v. 2, f. 320)

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Janë zvogëluar gabimet e atij që ia kanë mësuar sjelljet e mira.” (Girar al-hukm, v. 2, f. 645)

Imam Muhamed Bakiri thotë:

“Babai im i nderuar kishte parë një person duke shkuar me djalin e tij. Djali i pasjellshëm kishte hipur mbi krahët e babait të tij. Babai im, Imam Zejnel Abidini, ishte shqetësuar shumë prej këtij djali të paturpshëm sa që deri në fund të jetës së tij nuk kishte folur me të.”

Kapitulli i tridhjetepeshtë

Fëmija i llastuar

Është një realitet që çdo fëmijë kërkon dashuri dhe dhembshuri; por tejkalimi i dashurisë kufizohet me llastimin. Dashuria është sikur ushqimi dhe masa optimale e saj është shumë e dobishme, por teprimi i saj do të jetë i dëmshëm në shumë mënyra. Llastimi i tepërt do të ndikojë negativisht në rritjen e fëmijës. Fëmija nuk është një lodër për prindërit dhe as nuk duhet që të trajtohet si një burim i argëtimit nga ana e tyre. Fëmija, në fakt, është paraardhësi i njeriut në të ardhmen. Ai duhet që të rritet me kujdes dhe në mënyrë sistematike. Përgjegjësia për rritjen, trajnimin dhe edukimin e fëmijës u takon prindërve. Fëmija zhvillohet në një person të rritur dhe duhet që të bëhet pjesë e shoqërisë. Ai duhet që të ballafaqohet me baticat dhe zbaticat e jetës, sukseset dhe dështimet, lumturinë dhe pikëllimet e saja. Mentori i mirë do t'i merr parasysh të gjitha këta faktor dhe do ta bëjë fillestarin të aftë që të konfrontohet me të gjitha këto teste dhe pengesa me të cilat mund të konfrontohet. Prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se dashuria dhe dhembshuria është thelbësore për edukimin e mirë të fëmijës, por teprimi i këtyre mund t'ua mbyllë rrugën rezultatit të dëshiruar. Fëmijët që pranojnë dashurinë dhe dhembshurinë e tepruar kanë mundësi që të llastohen me konsekuenca të dëmshme.

Kur fëmija vëren se prindërit e duan së tepërmi dhe se i lejojnë që gjithnjë të bëjë sipas dëshirës së tij, atëherë natyrisht që kërkesat e tij do të rriten përtej kufijve. Ai do të fitojë natyrën e urdhërimit dhe do të presë pëlqimin e nënkuptuar prej prindërve për çdo veprim, të cilët nuk do ta kundërshtojnë atë në asnjë mënyrë. Me kalimin e kohës, te fëmijët e tillë do të shtohet tendenca e despotizmit. Kur një person i tillë hyn në radhët e shoqërisë, do të presë

pranimin e njëjtë prej bashkëqytetarëve, sikur që e kanë bërë prindërit e tyre bashkë me anëtarët e tjerë të familjes. Njerëzit nuk i duan personat egoistë dhe nuk e pranojnë përgjegjësinë e plotësisimit të dëshirave të tyre. Ky qëndrim i njerëzve lëndon shpirtat e njerëzve egoistë dhe ata bëhen viktimë e ndjenjave të disfatës dhe të mërzisë. Ata e zhvillojnë ndjenjën e fortë të kompleksit të vlerës së ulët dhe kanë prirje për vetminë. Në situatat kritike ata mendojnë për vetëvrasjen, si ikje prej presionit psikologjik që shkon matanë njohurisë së tyre. Edhe jeta martesore e njerëzve të tillë në përgjithësi lëkundet. Personat e tillë presin dashuri të tepërt prej bashkëshortit apo bashkëshortes dhe presin të pajtohen me të gjitha dëshirat e tyre, sado që ato mund të jenë të paarsyeshme. Por, në jetën praktike, gjithnjë ka nevojë për lëshim të dyanshëm dhe rrallë janë ata bashkëshortë që mund t'i dorëzohen drejtimit njëkatësh në jetën e tyre. Ekzistojnë gra të panumërta që rrehen nga ana e burrave të tyre për shkak të qëndrimit të paarsyeshëm që i mbajnë burrat e tyre. Rezultati është ankthi në shtëpi. Ngjashëm edhe vajza e llastuar, kur të martohet, pret dashuri më të madhe nga burri i saj sesa nga prindërit. Ajo pret që ai do t'i plotësojë të gjitha kërkesat e saj pa menduar fare për arsyen e tyre. Në përgjithësi, njerëzit nuk pajtohen me të gjitha kërkesat e grave të tilla qaramane. Natyrisht që rezultati është grindja e vazhdueshme në familje. Gratë dhe burrat e tillë shihen edhe në moshën e tyre të mëvonshëm duke vazhduar gjithnjë me shprehitë fëmijërore të grindjes. Personat e tillë janë aq të papjekur sa që vazhdojnë të sillen si fëmijë edhe në moshën e tyre të pjekur.

Prindërit e fëmijëve që rriten me butësi të tepërt e të llastuar, në përgjithësi e kanë natyrën delikate dhe psikikën e brishtë. Në përgjithësi, ata kërkojnë mbështetjen e të tjerëve dhe nuk janë të pavarur. Sapo të ballafaqohen me

ndonjë vështirësi, ata kërkojnë rrugët e ikjes. Atyre u mungon guximi për të pranuar detyra të mëdha e të vështira. Nëse ballafaqohen me vështirësi, kërkojnë ndihmë prej të tjerëve në vend se të mbështeten në Allahun dhe në vetveten.

Personat që janë rritur me butësi të tepërt, në përgjithësi janë egoistë dhe egocentrikë. Ata që i kanë pranuar lëvdatat sipërfaqësore në ditët e tyre të hershme, do të marrin ajrin e rremë të ndjenjës së rëndësisë në ditët e tyre të pjekurisë. Ata nuk janë në gjendje t'i dallojnë dështimet e veta dhe, përkundrazi, ata mendojnë se ato gjëra të kota që i kryejnë janë meritat e tyre. Ata punojnë nën ndjenjën e rreme të krenarisë, që në vetvete është një sëmundje e rëndë psikologjike.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Egoizmi është gjëja më e keqe.” Girar al-hukm, v? f. 446).

“Personi që është egoist dhe që jeton brenda vetvetes do të bëhet i vetëdijshëm për dështimet dhe të metat e veta.” (Girar al-hukm, v? f.685).

Personi i tillë pret që të tjerët ta mbulojnë atë me lëvdata të rreme. Për këtë arsye do të ketë lajkatarët rreth vetes. Personat e çiltër dhe të vërtetë nuk do të kenë vend në shoqërinë e tij. Në vend se të fitojë besnikërinë e të tillëve, egoisti përfiton zemërimin e tyre.

Imam Aliu, ka thënë:

“Çdo egoist do të përballet me shumë vështirësi.” (Girar al-hukm, v? f.659).

Fëmijët që pranojnë dashuri dhe kujdes të tepruar dhe që prindërit e tyre i privilegjojnë së tepërmi, me kalimin e kohës do të dominojnë mbi prindërit. Kur të rriten, ata do të këmbëngulin me trajtimin dominues dhe pritjet e tyre do t'i tejkalojnë mjetet materiale të prindërve.

Nëse prindërit e shprehin pamundësinë e tyre, ata do t'i drejtohen zhurmës dhe rrapëllimës për të arritur deri te qëllimi. Fëmijët e tillë janë të vetëdijshëm për përmbushjen e dëshirave nga ana e prindërve, prandaj edhe e përdorin rrenën për të marrë atë çka dëshirojnë. Gjatë kohës prindërit do të vijnë deri në një ngushticë saqë, përveç dashurisë së tyre, do të heqin dorë nga parimet e rritjes së mirë dhe do t'i plotësojnë teket dhe ëndrrat e fëmijës. Ata do t'i mbyllin sytë ndaj dështimeve të fëmijës dhe do të shpërfillin nevojën për reformimin e tij. Për t'ia bërë qejfin, ndonjëherë prindërit i mbyllin sytë edhe ndaj normave fikse të religjionit (sheriati).

Imam Muhamed Bakiri, ka thënë:

“Babai më i keq është ai që e tejkalon dashurinë për fëmijët e tij në mënyrë të paarsyeshme.” (Girar al-hukm, v?, f.659).

Fëmija duhet gjithnjë të jetojë ndërmjet shpresës dhe frikës nga Zoti. Ai duhet të ketë ndjenjën se ai është i dashuri i prindërve dhe se ata do ta ndihmojnë kur ka nevojë. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se për ndonjë gabim të bërë nga ana e tij, prindërit do të kërkojnë llogari nga ai.

Dr. Xhelali, shkruan:

“Nëse fëmija jeton në një rrethinë ku është i llastuar, gjithmonë të tjerët ia mbajnë anën, i mbyllin sytë ndaj veprave të këqija dhe ai nuk kujdeset për realitetin e ashpër të së ardhmes. Ai do të bëhet subjekt i shumë vështirësive si anëtar i shoqërisë. Që nga lindja, fëmija duhet të mësohet se ai duhet të ekzistojë me të tjerët në shoqëri dhe se dëshirat e tij duhet të jenë në harmoni me dëshirat e të tjerëve në shoqëri.” (Ruvan shinashi kudak, f. 354).

Dr. Xhelali, po ashtu shkruan:

“Dashuria për fëmijët është thelbësore. Por, nuk është e drejtë ndjenja të fëmija se prindërit e kalojnë tërë kohën duke ia bërë qejfin. (Ruvan shinashi kudak, f. 461).

Nëse fëmija qan pa nevojë dhe e shpreh zemërimin për të fituar vëmendjen e prindërve, që t’ia plotësojnë dëshirat e tij të padrejta, atëherë prindërit duhet me vendosmëri dhe taktikë ta refuzojnë kërkesën e tij. Ata duhet ta lënë vetëm për një kohë përderisa të kuptojnë se nuk mund të bëhet çdoherë sipas mënyrës së tij. Nëse prindërit ushtrojnë durim në situata të tilla, fëmija do të qetësohet mbas një protestimi.

Nëse fëmija rrëzohet në tokë, nuk është e nevojshme ta çojmë apo ta ngushëllojmë. Lëreni që fëmija të ngrihet vetë kur të rrëzohet. Mësojeni të mos rrëzohet edhe një herë. Kur fëmija godet kokën rastësisht në mur, nuk është e nevojshme ta puthni apo ta llastoni. Në vend të kësaj, ai duhet të mësohet që të kujdeset dhe të ruhet prej ndodhive të tilla në të ardhmen. Kur fëmija sëmuret lehtë, duhet t’i bëhet trajtimi mjekësor. Kujdes i përshtatshëm duhet t’i kushtohet sëmundjes së fëmijës, por detyrat e përditshme duhet të trajtohen si të zakonshme. Prindërit duhet të mundësojnë që fëmijët të pushojnë, të flenë dhe të ushqehen sa më normalisht që munden, duke mos humbur tërë kohën e tyre afër shtratit dhe duke e mbajtur në krah fëmijën e sëmurë. Kjo sjellje e kujdesit të tepruar nuk ndihmon në asnjë mënyrë, përkundrazi mund të keqësojë shprehinë e fëmijës për tërheqjen e vëmendjes së prindërve.

Një grua shkruan:

“Mbas dy vajzave të para, prindërit e mi fituan djalin e parë. Nuk mund të harroj atmosferën festive të nënës sime në atë kohë. Prindërit e mi e llastuan aq shumë vëllanë tim, sa që në moshën dyvjeçare ai filloi të na rrahë neve motrat. Ai na rrihte dhe ne nuk kishim kurajë ta mbrojmë vetveten. Çfarëdo që dëshironte, bëhej e

mundshme për të, pa ndonjë bujë. Ai kishte shprehi të sillej keq me fëmijët tjerë. Për të shkuar në shkollë ai tregonte kënaqësi, por për kryerjen e detyrave të shtëpisë tregonte përtaci. Ai kurrë nuk i kushtonte as më të voglin kujdes për arsimtarët. Ai kurrë nuk përparoi dhe dalëngadalë e braktisi shkollën. Tani që është një person i rritur, ai është një person i paedukuar dhe i vetmuar. Ai nuk ndien asnjë interesim për asnjë punë dhe është bërë shumë nervoz. Ai nuk ndien kurrfarë dashurie për motrat e tij.

Vëllai ynë i dashur është bërë viktimë e rritjes së gabuar dhe e tolerancës së tepruar të prindërve tanë.”

Kapitulli i tridhjetegjashtë

Thithja e gishtit të madh

Thithja e gishtit të madh është një shprehi e përbashkët e fëmijëve të vegjël. Zakonisht, këtë fillojnë ta bëjnë prej muajit të tretë nga lindja dhe vazhdojnë për një kohë të caktuar. Shkaku natyral i kësaj shprehie mund të jetë ushqimi i fëmijës përmes gjirit të nënës. Kur është i uritur, ai e thith gjirin e nënës ose cuclën. Fëmija ndjen se thithja ia jep një rehati dhe gjatë kohës mëson se mund të thithë gishtin kur gjiri i nënës nuk është në dispozicionin e tij. Kjo është një pjesë e procesit mësimor të fëmijës. Ai e vëren dobishmërinë e thithjes së gishtit dhe mësohet me këtë shprehi. Kjo shprehi i shkon për dore fëmijës kur është i uritur dhe ushqimi nuk është në dispozicion; po ashtu, mund të aludojë në thithjen e gishtit nëse ka ndonjë shqetësim apo parehati. Shumë prindër mendojnë se thithja e gishtit nuk është një shprehi e mirë dhe shpikin mënyra për të ndaluar fëmijën nga ky veprim. Këtu duhet të përmendim se ortodontët (dentistët) konsiderojnë se thithja e gishtit ndikon negativisht në trajtën natyrale të dhëmbëve dhe të gojës. Shumë dentistë dhe mjekë janë të mendimit se thithja e gishtit të fëmijët nuk është e dëmshme.

Një ekspert, thotë:

“Shumë psikologë dhe pediatër janë të mendimit se shprehia e thithjes së gishtit të fëmijët nuk është e dëmshme në asnjë mënyrë dhe në rastin më të keq nuk është shkaktar i shumë defekteve të gojës. Ata, po ashtu thonë se kjo shprehi do të zhduket automatikisht me daljen e dhëmbëve të qumështit.” (Ruvan shinashi kudak, f. 172).

Sidoqoftë, është e mundshme që kjo shprehi të mund të shkaktojë disa probleme shëndetësore, sepse në përgjithësi gishtat e fëmijëve i janë ekspozuar atmosferës dhe mund të bartin disa materie infektuese brenda gojës.

Për këtë arsye shumë prindër nuk duan që fëmija i tyre të pranojë këtë shprehi.

Siç duket, thithja e gishtit nuk është ndonjë problem serioz dhe nëse fëmija mësohet me këtë, kjo shprehi do ta braktisë fëmijën kur të rritet. Por, nëse prindërit dëshirojnë, ata mund të ndër marrin hapa që të parandalojnë këtë shprehi që në fazën fillestare. Parandalimi i fëmijës nga thithja e gishtit është shumë më lehtë sesa ta ndalojë atë mbasi ta fitojë atë shprehi.

Kur të vërejnë prindërit mësymjen e thithjes së gishtit të madh te fëmija, ata duhet të provojnë për të gjetur arsye, t'i japin më shumë qumësht nëse nuk ngihet dhe nëse bëhet i uritur në mes të dy kohëve të caktuara të ushqimit, atëherë duhet t'i jepet ndonjë lëng të pemëve apo biskotë. Nëse shkaku i thithjes së gishtit është ndonjë parehati, atëherë duhet të hulumtohet mirë dhe të shërohet shkaku. Nëse fëmija nuk heq dorë nga kjo shprehi, përkundër të gjitha hapave paraprake, atëherë do të jetë vështirë për të shqyrtuar dhe për të shmangur shprehinë. Edhe një metodë tjetër për shqyrtimin e kësaj shprehie është dhënia e lodrave të buta e të mira, me qëllim të devijimit të mendjes së tij nga thithja e gishtit të madh. Nëse fëmijës i shoqërohet ndonjë fëmijë tjetër për të luajtur, ai mund të mos e thithë gishtin gjatë kohës sa është duke luajtur. Një mjet tjetër alternativ për mënjanimin e thithjes së gishtit është dhënia e cuclës për të thithur. Por, edhe këtu ka gjasa që fëmija të pranojë shprehinë e thithjes së cuclës për një periudhë të caktuar kohore. Sidoqoftë, prindërit duhet të tregohen të durueshëm dhe të jenë të përmbajtur gjatë shqyrtimit të kësaj shprehie te fëmijët, si dhe nuk duhet ta ndëshkojnë fëmijën deri në masën e dëmtimit të psikikës së tij. Prindërit duhet ta kenë ndërmend se sado e fortë të jetë shprehia e thithjes së gishtit te fëmija, ai do ta braktisë atë në moshën katër apo pesëvjeçare.

Kapitulli i tridhjeteshtatë

Frika

Frika është një fenomen universal. Çdo krijesë njerëzore e ka instinktin e frikës në masë të vogël apo të madhe. Në termet veçuese, frika është thelbësore për sigurinë e qenies njerëzore. Personi që nuk e ka instinktin e frikës, në pikëpamje psikologjike nuk është person normal. Kjo është frika e cila bën që njeriu të ikë nga fatkeqësitë e rrezikshme dhe ta shpëtojë vetveten nga vdekja. Prandaj, frika është një begati që Zoti ia ka ndërfutur natyrës së qenies njerëzore. Kjo begati është e dobishme vetëm kur njeriu e shfrytëzon në mënyrë të matur, përndryshe, do të sjellë rezultate të dëmshme. Ekzistojnë dy lloje të frikës.

1. Frika e pakuptimtë: e gabuar dhe imagjinare dhe
2. Frika e kuptimtë: e arsyeshme dhe e drejtë

Frika e pakuptimtë

Kategoria e parë e frikës së gabuar mund të jetë frika nga djalli, nga shpirti i keq, nga errësira, nga shtazët e parrezikshme si, macja, bretkoşa, deveja, kali, etj. Frika nga vjedhja, kufoma, arkivoli (tabuti), frika nga mjeku dhe injeksioni, frika nga vetëtima, nga fjetja e vetmuar, frika nga provimi, frika nga sëmundjet dhe nga vdekja. Ekzistojnë shumë frika të tilla të pabaza që mund të bëhen fatkeqësia e njeriut nëse nuk mund ta mposhtësh atë. Ai është gjithmonë i preokupuar me frikën dhe ndonjëherë zgjohet prej gjumit duke bërë titur, si rezultat i shikimit të ëndrrave të këqija. Frika e panevojshme dhe tensioni është një sëmundje psikike që mund të kenë efekte shumë të dëmshme në jetën e ardhshme të fëmijës. Njeriu të turpshëm do t'i mungojë guximi dhe gjatë marrjes së vendimeve të mëdha ai do të jetë subjekt i presionit të madh. Ai do t'i shmanget takimit me njerëzit dhe gjithnjë

do të jetë i brengosur dhe kokulur. Ai do të qëndrojë larg nga shoqërimet dhe do të preferojë ekzistencën e vetmuar. Disa sëmundje psikike burojnë nga frika e tillë e pakuptimtë e një personi.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Frika është fatkeqe.” (Gharar al hukm, f. 8).

Prandaj, mentori i mirë do të përpiket të shohë që fëmija të mos fitojë ndonjë frikë të pabazë. Këtu do t'i përmendim disa sugjerime që duhet të marrin në konsideratë mentorët:

1. Parandalimi i frikës është shumë më mirë sesa shërimi i saj. Mundohu që të sigurohesh që fëmija nuk i është nënshtruar situatave të frikës së pabazë që e bën atë person të turpshëm. Psikologët vërejnë se zëri i lokomotivës në lëvizje, vetëtima, bubullima, zëri i alarmit dhe zërat tjerë afër kokës së fëmijës mund të bëhen shkaktarët iniciues të frikës të fëmija. Mbrojini fëmijët për aq sa keni mundësi prej gjërave të tilla.

2. Frika është infektive. Fëmija sipas natyrës nuk është i turpshëm, por, nëse prindërit dhe të tjerët në rrethinën e tij janë të turpshëm, atëherë edhe fëmija do të pranohet këtë shprehje. Nëse dëshironi që fëmija juaj të mos bëhet i frikshëm, atëherë kërkoni shërim për vetë frikët tuaja. Mos e shprehni frikën për rastet e pabaza të frikës.

3. Shikimi i filmave me temën e krimin dhe të ndëshkimit, shikimi dhe dëgjimi i tregimeve të tmerrit në televizor dhe radio, leximi dhe dëgjimi i tregimeve misterioze, madje edhe leximi i raporteve të ngjarjeve frikësuese nëpër gazeta dhe magazina, mund të jenë të dëmshme për fëmijët. Mundohuni që t'i mbani fëmijët sa më larg prej gjërave të tilla. Kurrë mos ju flisni fëmijëve për xhinët dhe zanat. Nëse kanë dëgjuar nga të tjerët për këto, bindi se ekzistimi i xhinëve është i konfirmuar me

Kuran, porse edhe ata e çojnë jetën e tyre sikur njerëzit dhe se nuk na lëndojnë neve.

4. Hiqni dorë prej frikësimit të fëmijëve me qëllim të formimit të tij. Mos e frikësoni duke e përmendur shejtanin dhe shpirtrat e ligë. Këto metoda mund të jenë efektive për momentin, por mund ta shndërrojnë fëmijën në një person të turpshëm. Si ndëshkim për keqbërje, fëmija nuk duhet asnjëherë të mbyllet në ndonjë kënd të errët. Disa nëna të pamatura artikulojnë zërin e maces apo të qenit mbrapa murit, në mënyrë që ta qetësojnë fëmijën që është duke qarë. Ato nuk e dinë se çfarë dëmi mund të shkaktojë një gjë e tillë në mendjen e ndjeshme të fëmijës së vogël.

Një person shkruan në ditarin e tij:

“Gjyshja jonë kishte shprehi të shkonte në dhomën tjetër të shtëpisë dhe të bërtiste me një ton tjetër, duke thënë: ‘Unë jam shejtani dhe kam ardhur në shtëpinë tuaj për t’ju ngrënë’. Ne përnjëherë heshtnim të frikësuar dhe besonim se ishte me të vërtetë shejtani në dhomën tjetër. Mbas një periudhe kohore unë u shndërrova në një person të turpshëm. Kjo është arsyeja që unë nuk mund të dal i vetëm jashtë shtëpisë. Tani jam një i rritur i turpshëm dhe nervoz.”

Një grua shkruan:

“Isha në moshën pesëvjeçare. Një ditë isha duke luajtur në oborr me kushëririn tim. Papritmas e vërejtëm një fantazmë të tmerrshme. Kishte kokë të madhe, sytë e shndritshëm, dhëmbët e gjatë, rroba të gjata dhe këpucë të zeza e të mëdha në këmbë. Duke lëshuar zëra të pazakontë donte të na gëlltisë. Ne filluam të bërtasim dhe ikëm në tavanin e errët. Unë e çjerra murin aq fort sa që edhe gishtërinjtë m’u mavijosën. E humba vetëdijen për shkak të frikës. Më dërguan te mjeku me shpejtësi. Për një kohë të gjatë fshihesha nëpër kënde, i frikësuar dhe madje edhe

trazimi më i vogël i shqetësonte nervat e mia. Edhe tani i kam nervat e shkatërruara dhe nuk jam në gjendje të koncentrohem në asnjë aktivitet. Më vonë mësova se ajo fantazmë ishte një shaka e një kushërيره tjetër. Ajo kishte vendosur një enë prej dheu mbi kokë që të na frikësojë me zgjuarsi. Ajo është bërë shkaktarë e gjendjes sime nervoze.”

5. Nëse fëmija juaj është i turpshëm për shkak të pakujdesisë suaj apo për ndonjë shkak tjetër, atëherë mos e shpërfillni më tepër gjendjen e tij. Mundohuni ta korrigjoni situatën sa më shpejt. Nëse fëmija kupton se frika e tij është e pabazë, vetvetiu do të kthehet në gjendjen normale. Bërtitja dhe përqeshja e tij, si dhe turpërimi i tij në prani të të tjerëve, nuk është zgjidhja e problemit. Aktet e tilla nga njëra anë nuk e largojnë frikën e fëmijës dhe nga ana tjetër e bëjnë atë më të vrazhdë dhe më të dëshpëruar. Ai nuk dëshiron të mbetet i turpshëm. Pakujdesia dhe shkaqet tjera e kanë bërë atë të turpshëm. Mundohuni t’i gjeni shkaqet e frikës së tij me durim dhe maturi, pastaj kërkoni shërimin. Nëse fëmija frikësohet prej djalleve dhe shpirtrave të ligë imagjinarë, bindeni atë se nuk ka gjëra të tilla. Tregoni se xhinët nuk kanë të bëjnë asgjë me njerëzit. Nëse fëmija frikohet prej shtazëve të parrezikshme, demonstroni praktikisht se ato shtazë janë të parrezikshme. Nëse fëmija frikohet prej errësirës, njoftojeni atë me vende të dritës së dobësuar. Kur jeni bashkë me fëmijën, fikeni dritën për një moment. Pastaj, dalëngadalë rriteni kohëzgjatjen e errësirës. Kur jeni në dhomën e njëjtë me fëmijën në një distancë të vogël, përsëriteni eksperimentin e fikjes dhe të ndezjes së dritës. Përsëriteni këtë eksperiment me durim përderisa të largohet frika nga errësira prej mendjes së fëmijës. Mbajeni në mend, asnjë metodë e ashpër nuk duhet të përdoret për të korrigjuar kompleksin e frikës së fëmijës. Detyrimi i fëmijës për të shikuar gjërat prej të cilave

frikohet, do të japë rezultat negativ. Nëse fëmija ka frikë nga shkuarja te mjeku dhe marrja e vaksinës, atëherë bindeni me dashuri dhe dhembshuri për nevojën e trajtimit. Ndonjëherë, situata kërkon që fëmija të dërgohet në spitalin e pediatriisë. Do të jetë një kohë e vështirë sepse fëmija nuk ka dëshirë të rrijë larg prindërve. Nëse fëmija detyrohet të rrijë në spital kundër dëshirës së tij, kjo mund të bëhet shumë vështirë për të. Ndonjëherë, është e dobishme që fëmija të njoftohet me mjedisin e spitalit. Kur fëmijët shkojnë për të vizituar ndonjërin në spital, është mirë të marrin me vete edhe fëmijën, në mënyrë që të njoftohet me mjedisin. Takimi me mjekët dhe motrat medicinale të sjellshme në spital, do të largojë frikën nga mendja e fëmijës dhe nëse paraqitet nevoja për t'u shtrirë në spital, ai do të pajtohet pa ndonjë shqetësim të madh. Para se ta dërgojnë fëmijën në spital, prindërit duhet ta bindin se shëndeti ka nevojë për kujdesin e mjekëve e të motrave medicinale të sjellshme dhe se ai duhet të shkojë në spital për t'u bërë më mirë dhe për t'u kthyer. Tregoni se do ta vizitoni atë bashkë me anëtarët e tjerë të familjes. Kurrë mos i thoni të pavërteta fëmijës. Kur duhet ta vendosni atë në shtratin e spitalit, mos i thoni atij se duhet të flejë dhe se ju do të qëndroni ulur afër tij. Mos ia jepni shpresën e rreme se nuk do t'i jepen ilaçet. Bindeni se ai është i sëmurë dhe se trajtimi në spital është i domosdoshëm për shërimin më të shpejtë të tij.

Frika e kuptimtë

Sa i përket frikës së kuptimtë të fëmijës, mentori duhet të adaptojë një qëndrim të matur e të zgjuar kundrejt tij. Përmendjani situatat e rrezikshme dhe diskutoni për shërimin e tyre. Informoni për rrjedhat e këqija të pakujdesisë. Demonstrojani atij përdorimin korrekt të shkrepëses, pajisjet që punojnë me gaz dhe me rrymë

elektrike, dhe rrezikun nga këto gjëra. Mësojani kalimin e duhur të rrugës së zënë dhe njoftojeni me rregullat e trafikut për këmbësorë. Singërisht përmendni rreziqet me të cilat mund të konfrontohet në jetën e tij të përditshme. Njoftojeni për masat e sigurisë dhe krijoni te ai besimin në vetveten dhe në Allahun. Ai duhet më mirë të përgatitet që të ballafaqohet me sfidat e jetës së përditshme, sesa të frikësohet prej rreziqeve që e rrethojnë atë.

Edhe një frikë e kuptimtë është frika nga vdekja. Por, frika e tepërt nga vdekja shndërrohet në një sëmundje psikike. Kjo sëmundje ia merr qetësinë dhe rehatinë shpirtërore të personit dhe ia topit aftësitë fizike. Prandaj, është e domosdoshme që të merren masat preventive kundër këtij lloji të frikës. Në fazën fillestare fëmija nuk e ka të njohur kuptimin e vdekjes, prandaj është më mirë që mentori të mos flasë për këtë fenomen në këtë fazë. Por, ndonjëherë fëmija mëson për këtë kur të vdesë ndonjëri prej të afërmeve të tij. Është mjaft e mundshme që në situata të tilla fëmija të parashtrijë pyetje për vdekjen. Nëse fëmija ka arritur fazën e të kuptuarit, atëherë prindërit duhet t'ia zbulojnë të vërtetën. Ata duhet t'i tregojnë atij se vdekja nuk është asgjë e posaçme veçse kalimi prej kësaj bote në botën tjetër. Në atë botë ai do të fitojë shpërblim për vepra të mira dhe ndëshkim për vepra të këqija që i ka kryer në këtë botë. Një ditë çdokush duhet të vdesë. Allahu në Kuran, thotë: "Të gjithë njerëzit do të vdesin". Vdekja nuk është e rëndësishme por veprat e kësaj bote janë të rëndësishme dhe Gjykimi i botës tjetër bëhet në pajtim me veprat e kryera të personit në këtë jetë.

Mendimi i tepërt për vdekjen nuk është i mirë dhe nuk duhet të hyjë në sferën e frikës që sillt vërdallë. Kjo do të jetë e dëmshme.

Edhe një aspekt pozitiv i frikës është frika nga Zoti dhe nga Dita e Gjykimit. Këto frika nuk duhet të jenë të

forta që të rezultojnë me tendosje shqetësuese të personit. Këto frika e inkurajojnë personin të kryejë vepra të mira dhe e ndalojnë të kryejë vepra të këqija. Prandaj, Allahu thotë në Kuran:

“Nëse jeni ndër ata që besojnë, mos kini frikë prej askujt përveç Meje.” (Kuran, 3:175)

Po ashtu, Kurani i përshkruan vështirësitë dhe ndëshkimet e Ditës së Gjykimit. Prandaj, mentori i zgjuar e besimtar do të fusë idenë e shpërblimit dhe të ndëshkimit të Botës së Ardhsme në mendjen e ndjeshme të nxënësit të tij.

Këtu është mirë të përmendim se mentori i mirë nuk duhet tërë kohën të flasë për Xhenetin dhe Xhehenemin dhe fëmija të fitojë përshtypjen se Zoti është i ashpër ndaj krijesave të Tij. Mentori duhet ta njoftojë më shumë fëmijën me mëshirën e Allahut të Gjithëfuqishëm.

Kapitulli i tridhjetetë Loja dhe argëtimi

Si frymëmarrja, ashtu edhe argëtimi dhe loja janë të domosdoshme për fëmijët. Në nivelin fillestar dhe të mesëm shkollor, aktivitetet kryesore të fëmijëve janë sporti, lojërat dhe argëtimi. Me vazhdimin e programit mësimor, këto aktivitete reduktohen. Përkundër ngarkesës së detyrave shkollore, fëmijët duhet të ndajnë kohë edhe për sport. Pjesëmarrja në lojërat jashtë shtëpisë është një aktivitet i rëndësishëm fizik që është thelbësore për shëndetin e mirë të fëmijës. Fëmijët që nuk marrin pjesë në këto aktivitete jashtështëpiake, në përgjithësi nuk janë të shëndoshë. Islami është i vetëdijshëm për këtë kërkesë natyrore, prandaj këshillon që fëmijët të mbahen fizikisht të lirë.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Lërimi fëmijët të luajnë lirisht deri në moshën shtatëvjeçare.” (Vasail al-shiah, v. 15, f. 193).

I Dërguari i Islamit thotë:

“Lërimi të luajnë; toka është fusha e lojës së fëmijëve” (Maxhma az zavaid, v. 8, f. 159).

Loja është ushtrimi natyror i fëmijëve. Kjo do t'i forcojë gjymtyrët. Aftësitë mendore do të zhvillohen dhe do të bëhen më të forta. Në vendin e lojës fëmija do të vijë në kontakt me bashkësinë me të cilët do t'i ndajë përgjegjësitë e jetës me të tjerët.

Psikologët kanë mendime të ndryshme gjatë vlerësimit të rëndësisë së sportit. Ne nuk do të hyjmë në detaje për këtë. Për ne është e mjaftueshme se loja dhe ushtrimi fizik është një aspekt i rëndësishëm për rritjen e fëmijëve. Prandaj, mentori nuk duhet ta konsiderojë këtë si një aktivitet i shtuar i programit mësimor që duhet të trajtohet lehtë. Fëmija njoftohet me botën e jashtme gjatë

lojës. Ai mëson për kryerjen e detyrave. Ai praktikon largimin nga rreziqet; kooperon dhe koordinon me anëtarët tjerë të ekipit. Në lojërat ekipore ai mëson të respektojë të drejtat e të tjerëve dhe mëson për rregullat e lojës.

William Asterni shkruan:

“Lojërat janë burimi i zhvillimit të aftësive natyrore të fëmijëve. Ato janë ushtrime për disipinat dhe aktivitetet e ardhshme të një personi.” (Ruvan shinashi kudak, f. 331).

Alexi Maximi shkruan:

“Lojërat ua sigurojnë fëmijëve të kuptuarit e jetës dhe janë mjete të ushtrimit për trupin. Lojërat ndihmojnë fëmijën që fëmija të njihet me normat shoqërore. Loja i forcon ndjenjat e fëmijëve. Në lojëra, fëmija ndërton shtëpi, fabrikë, ndërmerr një ekspeditë në polin verior, fluturon në gjithësi dhe i ruan kufijtë e vendit të tij.”

Anton Semonowich Makarno, ekspert i famshëm rus për rritjen e fëmijëve, thotë:

“Nëse personi është i mençur në lojë gjatë fëmijërisë, ai do të pasqyrojë kualitetet e njëjta në jetën e tij kur të rritet. Loja e mirë është sikur puna e mirë. Çdo lojë kërkon shfrytëzimin e aftësive mendore dhe fizike. Vështroni një fëmijë duke luajtur dhe zbuloni se si e ka formuluar strategjinë e tij që të arrijë sukses në atë rast. Gjatë lojës, ndjenjat e fëmijëve do të jenë burimore. Të moshuarit duhet ta vëzhgojnë këtë.” (Ruvan shinashi kudak, f. 130).

William Mc Dougal shkruan:

“Para se natyra të manifestohet në fushën e aktiviteve, loja e pasqyron prirjen e mendjes së personit.” (Ruvan shinashi kudak, f. 332).

Edhe pse në lojë fëmija nuk është duke kryer ndonjë punë specifike, ajo nuk është më pak sesa kryerja e ndonjë pune fizike apo mendore. Gjatë lojës, prirjet e aftësive natyrore dhe personale të fëmijëve do të manifestohen

vetvetiu. Gjatë lojës, karakteri i fëmijës e pranon formën për të ardhmen e ndritshme.

Kujdestarët nga ana e prindërve mund të kategorizohen në disa mënyra:

- Disa konsiderojnë se loja me lodra dhe lojërat është një kohë që kalohet pa nevojë dhe ata mundohen t'ua kthejnë mendjen e fëmijëve nga aktivitetet e tilla.

- Të tjerët nuk janë kundër lojës së fëmijëve dhe ua japin lirinë e plotë të zgjedhin lodrat dhe lojërat sipas zgjedhjes së tyre.

- Kategoria e tretë e kujdestarëve nuk i japin lojës aq rëndësi dhe sipas tyre loja është mbajtja e fëmijëve të preokupuar. Ata i porosisin lodrat dhe lojërat pa ndonjë qëllim objektiv. Lodrat për ata nuk janë asgjë tjetër veçse sigurimi i disa mjeteve me të cilat fëmija do të preokupohet plotësisht. Fëmija luan me lodra, thyen dhe kur të lodhet i gjuan ato. Lodrat e bukura ua tregojnë edhe fëmijëve tjerë.

- Kategoria e katërt e kujdestarëve janë ata që jo vetëm që i sigurojnë mjetet e lojës për fëmijët, por edhe i vëzhgojnë se si i përdorin ato. Nëse fëmija has në vështirësi gjatë përdorimit të lodrës së re, ata vullnetarisht do të ndihmojnë për të zgjedhur problemin. Kujdestarët e tillë e frenojnë instinktin e zgjedhjes së problemit të fëmijët dhe ata mësohen të varen prej ndihmës së më të vjetërve në të gjitha çështjet.

Asnjëri nga këto katër kategori nuk është në nivelin e duhur të sigurimit të përvojës së mirë studiuëse për fëmijët përmes lojës.

Qëndrimi më i mirë që një kujdestar mund të përvetësojë është se pikësëpari ai duhet t'i lërë të lirë fëmijët që të luajnë në akordim me natyrën dhe zgjedhjen e tyre. Së dyti, ai duhet të sigurojë një varg të lodrave dhe lojërave edukuese për fëmijët që ia shtojnë inteligjencën dhe aftësitë kreative të fëmijës. Edhe një aspekt teknik që

kujdestari duhet të ketë ndërmend gjatë zgjedhjes së lodrave dhe lojërave është se duhet t'ia zgjojë fëmijës interesimin për aktivitetet konstruktive të tij, të familjes dhe të shoqërisë. Është për keqardhje që shumica e lodrave në treg kanë vlerë të vogël edukative. P.sh. nëse ndonjëri blen një tren që operon me bateri apo rrymë, fëmija do të jetë i zënë tërë ditën duke e shikuar atë. Ai nuk do të mësojë asgjë që mund të jetë i dobishëm për të në të ardhmen.

Lodrat më të dobishme janë ato që vijnë në gjendje të shpërndarë dhe pastaj fëmija duhet t'i bashkojë ato përmes metodës së gabimit dhe të të provuarit. P.sh. një grumbull i blloqeve që mund të bashkohet në një ndërtesë, pikturat e pakompletuara, loja me bashkim pjesësh të figurave, materiali i thurur e i ngatërruar, veglat prej druri, etj.

Prindi duhet ta vëzhgojë fëmijën gjatë lojës, në mënyrë që të mund të sigurojë udhëzimin e duhur në kohën e duhur. Vetë vëzhgimi i fëmijëve duke luajtur është një aspekt shumë i rëndësishëm i trajnimit dhe i rritjes.

Mësuesi i mirë do të sigurojë lodrat dhe lojërat për fëmijët dhe do ta lërë të pavarur në përdorimin e tyre, por do ta mbajë syrin e mprehtë rreth aktiviteteve të fëmijës për të cilat është udhëzuar dhe do t'i vështrojë gabimet që i bën fëmija gjatë përdorimit të materialit.

Sikur t'i jepet fëmijës një automobil lodër apo tren lodër, ai do të pyetet për funksionin e këtyre makinave. Nëse fëmija thotë se ato shërbejnë për bartjen e njerëzve dhe të materialeve prej një vendi në një vend tjetër, atëherë ai mund të lihet vetëm për të luajtur me lodrën. Nëse lajmërohet ndonjë prishje gjatë lojës, lëreni që fëmija ta evitojë vetë sado që të mundet ta bëjë këtë. Fëmija mund të udhëzohet në këtë drejtim që ai ta zhvillojë vetëbesimin në kryerjen e detyrës. Nëse blini ndonjë kukull për vajzën tuaj, nuk duhet të jetë në formën komplete. Ju duhet ta udhëzoni

atë që t'i përgatisë rrobat për kukullën. Ajo do ta veshë kukullën, do ta mbajë të pastër dhe do të luajë sikur po e lan dhe po e ushqen atë. Vajza do të këndojë ninulla që kukulla të flejë dhe do ta zgjojë e do ta marrë me vete kur të shkojë ndokund. Duke i imituar prindërit, vajza do t'ia mësojë kukullës mirësjelljen.

Ju do të vëreni se fëmija do t'i vërë në praktikë me kukullën ato çka ka dëgjuar prej më të vjetërve. Shumicën e gjërave fëmija e kryen përmes imitimit të veprimeve të prindërve dhe motrave e vëllezërve më të vjetër. Lodrat janë të dobishme kur fëmija i mëson gjërat e dobishme të jetës së përditshme duke luajtur me to. Fëmija duhet të inkurajohet të luajë me lodrat sesa t'i ruajë ato në vitrinë dhe t'ua tregojë shokëve të tij. Duhet të ekzistojë një vend i përshtatshëm ku fëmija duhet t'i vendosë lodrat mbasi të luajë me to. Fëmija duhet të inkurajohet që atë vend ta mbajë të pastër e të rregulluar.

Fëmija nuk duhet të ketë shumë lodra brenda kohës së njëjtë. Kjo mund ta hutojë fëmijën dhe të vështirësojë zgjedhjen. Lodrat nuk duhet të jenë të shtrenjta dhe shumë tërheqëse.

Lojërat e fëmijëve mund të ndahen në këto kategori:

- a. Lojërat me të cilat fëmija luan vetë;
- b. Lojërat me të cilat luajnë dy apo më tepër fëmijë;
- c. Lojërat edukative që i stimulojnë aftësitë mendore të fëmijëve;
- d. Lojërat jashtë shtëpisë që sigurojnë zhvillimin e psikikës së fëmijëve;
- e. Lojërat që e përkrahin aftësinë e fëmijëve për mbrojtje dhe sulmim;
- f. Lojërat që e përkrahin shpirtin e kooperimit në mes të fëmijëve.

Në fillim, fëmija luan vetëm. Ai duhet që të lihet për të luajtur vetëm, por njëkohësisht edhe duhet të

vëzhgohet. Prindërit duhet të bëjnë zgjedhjen e duhur të lodrave. Ndonjëherë fëmija ka dëshirë ta thyejë lodrën dhe ta bashkojë prapë. Fëmija duhet të lejohet të bëjë eksperimente të tilla. Vetëm kur fëmija has në vështirësi gjatë këtyre detyrave, të vjetrit duhet të intervenojnë.

Mbas një kohe fëmija fillon të pëlqejë shoqërimin me fëmijët tjerë. Tani, ai duhet të njoftohet me lojërat që mund të luajnë me më shumë se një fëmijë. Prindërit duhet ta inkurajojnë fëmijën që të luajë me fëmijët e tjerë. Edhe në këtë fazë prindërit duhet të kujdesen që fëmija të luajë lojërat e dobishme ekipore. Lojërat ekipore në përgjithësi janë: futbollli, volejbollli, basketbollli, etj. Në përgjithësi, fëmijët i luajnë këto lojëra gjatë kohës së lirë të tyre dhe në lagjen e tyre. Këto lojëra ndihmojnë në zhvillimin e psikikës së fëmijëve, por janë shumë konkurruese dhe i bëjnë më temperamentë dhe agresivë. Gjatë luajtjes së lojërave të këtilla, fëmijët gjithnjë do të kenë ndërmend korrijen e fitores kundër ekipit kundërshtar. Lojërat më agresive sesa këto janë boksi dhe mundja. Këto lojëra janë përkujtime të kohërave primitive të racës njerëzore. Është për keqardhje që lojërat e tilla ende vazhdojnë të luhen.

Russeli shkruan:

“Njerëzimi i ditëve të sodit, kur të krahasohet me epokat e mëhershme, e ka kundërshtarin më të madh në materializëm, prandaj njeriu bën lutje për më shumë maturi dhe kooperim të dyanshëm. Njeriut nuk i duhet armiqësia, rezistenca dhe urrejtja, sepse këto gjëra ndonjëherë e pushtojnë atë dhe ndonjëherë ai i nënshtron ato.” (Dar Tarbiat, f. 121).

Është brengosës fakti se nuk mendohet për këtë çështje fare dhe ato lojëra që i nxisin tendencat agresive të fëmijët janë duke fituar përkrahje dhe inkurajim të vazhdueshëm. Do të ishte më mirë sikur udhëheqësit e shkollave dhe të kolegjeve të mendojnë mirë për këtë

çështje dhe t'i konsultojnë ekspertët me qëllim të gjetjes së lojërave të dobishme për fëmijët.

Si përfundim të këtij diskutimi, mund të themi se, edhe pse loja është thelbësore për rritjen e fëmijës, orari i lojërave duhet të kufizohet. Mentori i aftë e formon orarin e lojës në mënyrë të tillë që fëmija i rikthehet aktiviteteve konstruktive menjëherë mbas lojës. Mentorët e tillë nuk u lejojnë fëmijëve të luajnë së tepërmi.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Ai që është i dhënë mbas lojës, nuk do të bëhet i suksesshëm.” (Gharar al hukm, f. 854).

Në lidhje me këtë, Russeli shkruan:

“Është një shenjë e dobësimit të vlerave shoqërore kur ne gjykojmë një person bazuar në zotësinë e tij për të luajtur. Ne nuk kemi kuptuar se për të jetuar në botën moderne dhe të komplikuar kemi nevojë për dituri dhe maturi.” (Dar Tarbiat, f. 142).

Një disfatë e lojës ekipore është se ato mund të krijojnë te fëmija ndjenjën e xhelozisë e të konfliktit. Në situata të tilla, mentori duhet të intervenojë dhe ta evitojë mosmarrëveshjen në kënaqësi të të gjithëve.

Ndonjëherë prindërit përfshihen në konfliktin ndërmjet fëmijëve. Pa i njohur mirë shkaqet e konfliktit, ata e mbajnë anën e fëmijëve të tyre dhe situata del jashtë kontrollit. Qëndrimet e tilla të pamatura u japin fëmijëve ndjenjën se ata mund të shpëtojnë prej çdo situatë të ndërlikuar.

Kapitulli i tridhjetenëntë

Mendjemadhësia apo krenaria

Mendjemadhësia dhe mburrja është e pranishme te çdo individ, më shumë apo më pak. Çdo person ka dëshirë ta paraqesë veten duke treguar ndonjë aftësi apo diçka tjetër. Ai mundohet ta tërheqë vëmendjen e të tjerëve përreth tij përmes këtyre veprimeve. Këto qëllime të fëmija fillojnë të manifestohen vetvetiu në moshën njëvjeçare. Fëmija dëshiron të lëvizë rreth e rrotull dhe të tërheqë vëmendjen e të tjerëve përmes sjelljeve të tija të çuditshme. Ai do t'i përsërisë veprimet me të cilat do të gëzohen dhe do të qeshin prindërit dhe të tjerët. Do të ndjejë kënaqësi me reaksionin e prindërve dhe do të ndjejë një mburrje të lehtë që ka arritur t'i gëzojë ata. Ndonjëherë, fëmija e shpreh kënaqësinë e tij përmes gjesteve të ndryshme dhe në këtë mënyrë dëshiron të tregojë rëndësinë e saj.

Mburrja vetvetiu nuk është një veçori negative. Në fakt, kjo ndjenjë e ngacmon një individ që të përpiqet për të arriturat më të mëdha me një shpirt konkurrues. Fëmija mundohet shumë të arrijë gradën e lartë në klasën e vet. Ai mundohet të zhvillojë aftësitë oratorike apo të bëhet piktor i shkathët. Është kjo dëshirë konkurruese te fëmija që e dëshmon paralajmërimin e poetëve, artistëve, autorëve dhe shkencëtarëve të mëdhenj të së ardhmes.

Prezenca e kësaj veçorie të mburrjes te fëmija nuk është për t'u brengosur. Me rëndësi është se duhet të shfrytëzohet pozitivisht për leverdinë e fëmijës. Nëse udhëzohet në drejtimin e duhur, mund të vijmë deri te rezultatet e dobishme. Në fazën fillestare fëmija nuk mund të dallojë ndërmjet të mirës e së keqes. Ai i vëzhgon reaksionet e prindërve në mënyrë që të arrijë deri në një përfundim. Mentori i kujdesshëm do të inkurajojë veprimet e pëlqyera të fëmijës duke e shprehur gëzimin për to.

Mentori mund të inkurajojë sjelljet e mira të fëmija duke e shprehur pakënaqësinë e tij për veprimet e papëlqyeshme.

Disa prindër të pakujdesshëm, përveç dashurisë së tyre për fëmijën, e mbulojnë fëmijën me lajka dhe lëvdata të tepërta pa menduar se a është i pëlqyer apo jo veprimi i fëmijës. Në këtë mënyrë ata ia vendosin themelin e sjelljeve të këqija të fëmija në mënyrë të paqëllimtë. Në lajkat e tyre ndaj fëmijës, ata i zmadhojnë kualitetet e mira dhe e lëvdojnë fëmijën së tepërmi. Ka shumë gjasa që fëmija i tillë të bëhet mendjemadh dhe dalëngadalë të bëhet egoist dhe arrogant. Ai do të fillojë të presë lajkat e të tjerëve sikur nga prindërit. Kur fëmija dështon në marrjen e përgjigjes së dëshiruar, ai bëhet i shqetësuar. Ai fillon ta shprehë mllefin e tij kundrejt të tjerëve dhe në rastin më të keq mund edhe të mendojë për t'u shkaktuar ndonjë dëm atyre në fazat e mëvonshme.

Prindërit duhet ta kenë ndërmend se ata duhet të kujdesen për të menduarit e fëmijëve, në mënyrë që t'i udhëzojnë në rrugën e të sinqertëve. Pastaj, do të vijë faza kur fëmijët do ta ridrejtojnë mendjen e fëmijës kundrejt Zotit. Tani e tutje, për çdo vepër që e shohin të gabuar, në vend se të thonë se babai nuk e pëlqen këtë, duhet t'u thuhet se Zoti nuk e pëlqen këtë.

Kapitulli i dyzetë

Imitimi (*taklid*)

Instinkti për imitim është karakteristika më e fortë e natyrës njerëzore. Njëkohësisht, është edhe veçoria më e dobishme dhe më e vlefshme. Kjo i ndihmon fëmijës të përparojë me procesin e të mësuarit të tij si, ngrënia, veshja, të folurit dhe ndodhitë tjera shoqërore të rrethinës së tij. Qenia njerëzore është një imitues natyral dhe e bën këtë gjatë tërë jetës së tij, por fëmijët deri në moshën pesëvjeçare e bëjnë këtë më shpesh. Për një kohë më të gjatë, aftësitë e fëmijës nuk janë aq të zhvilluara, kështu që ai nuk është në gjendje të vendosë për rrjedhën e veprimit krye në vete. Në këtë periudhë ai imiton atë çka prindërit dhe të tjerët bëjnë para tij.

Fëmijët e dëgjojnë fjalën “ujë” nga prindërit dhe mundohen ta përsërisin. Pastaj mundohen ta kuptojnë domethënien e fjalës dhe ta përdorin atë fjalë në kohën e duhur. Vajza e vëzhgon nënën e vet duke e pastruar dhomën dhe duke i larë teshat. Edhe ajo mundohet të kryejë ndonjë punë të përditshme. Ajo sheh se nëna e vet i kushton vëmendjen përdorimit të zjarrit dhe i lanë pemët para se të hiqen lëvozhgat dhe të hahen. Edhe ajo i imiton këto veprime. Ajo sheh se prindërit dhe motra e vëllezërit më të vjetër i rregullojnë gjërat e shtëpisë. Edhe ajo mundohet t’i kopjojë ata në veprimet e tyre. Ajo vëren se prindërit e saj flasin butë me të tjerët, prandaj edhe i kultivon sjelljet e mira. Ajo vëren se prindërit dhe motra e vëllezërit më të vjetër janë duke i ndihmuar njëri-tjetrit në kryerjen e punëve të shtëpisë. Edhe ajo mundohet t’ua ofrojë dorën e ndihmës. Kur ajo e sheh se prindërit e saj po e kalojnë rrugën në mënyrë të rregullt, në vendin e caktuar për këmbësorë, edhe ajo e mëson ta bëjë këtë. Kur djali e sheh babanë e tij duke punuar në kopsht, oborr apo është duke

riparuar ndonjë pajisje të shtëpisë, edhe ai do të mundohet të mësojë detyrën e njëjtë. Në fillim mundohet t'i bëjë këto gjëra përmes lojës, por me kalimin e kohës ai do të fitojë mjeshtri. Disa prej tyre bëhen aq të aftë, saqë e marrin këtë aktivitet si ndonjë profesion.

Rritja dhe formimi i fëmijës arrihet më mirë duke u treguar atyre ndonjë shembull, sesa të bëhet përshkrimi i tij. Imitimi i veprimeve të më të rriturve është një fenomen automatik te fëmijët dhe atyre nuk ka nevojë t'u thuhet që t'i kryejnë këto veprime. Nëse prindi është i vrazhdë, i pasjellshëm dhe i pacipë, fëmija do t'i pasojë hapat e tij. Kur nëna është grindavece dhe e pandjeshme, atëherë ka gjasa që edhe fëmijët të bëhen si ajo.

Nëse mentori është një person gënjeshtar, qyqar dhe i pandershëm, ai nuk mund të presë që nxënësit e tij të bëhen të sinqertë, guximtarë dhe të ndershëm. Fëmijët nuk iu vënë shumë vëmendjen predikimit të të vjetërve, ata preferojnë më shumë imitimin e tyre. Prandaj, është e domosdoshme shtytja e shprehisë së imitimit te fëmijët. Kujdesi duhet t'i kushtohet asaj që më të vjetrit t'i kryejnë veprimet e tilla në praninë e fëmijëve, që ata të rriten si individë sa më idealë. Për hir të dashurisë ndaj fëmijëve të tyre, prindërit duhet t'i reformojnë shprehitë e tyre në mënyrë që ta sigurojnë një pamje ideale për ata. Prindërit duhet gjithmonë të kenë ndërmend se është shumë vështirë t'i ndalojnë fëmijët nga imitimi i shprehive të tyre, të mira apo të këqija.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Nëse dëshironi t'i reformoni të tjerët, së pari reformojeni veten. Është një gabim i madh nëse ju mundoheni ta korrigjoni ndonjërin përderisa ju vetë keni parregullsi që duhet reformuar.” (Ghara al-hukm, f. 278).

Profeti i Shenjtë i tha Ebu Zerrit:

“Allahu do t’u japë fëmijë dhe nipa të virtytshëm e fisnikë prindërve besimtarë.” (Makarim al ahlak, f. 546).

Mentori i përgjegjshëm nuk do të mbetet indiferent ndaj llojit të shokëve që fëmija i ka. Mendjet e fëmijëve janë shumë të ndjeshme dhe ata kanë prirje të mëdhe për të imituar shprehitë e shokëve të tyre. Prandaj, është shumë me rëndësi të kujdesemi për llojin e shokëve me të cilët fëmija shoqërohet.

Ndonjëherë kur fëmija bëhet dëshmitar i aktit të dhunës në kinema apo në televizor, tek ata mund të zhvillohet tendenca për kryerjen e veprave të tilla. Ju sigurisht keni lexuar nëpër gazeta për aktet e tilla të delikuencës nga ana e fëmijëve. Motivet për akte të tilla zakonisht janë marrë prej skenave të vrasjes dhe të sakatimit, skena këto që janë prezantuar në kinema apo në televizor. Në rrethana të tilla, a është me vend që fëmijët t’u ekspozohen medieve të tilla pa pasur kurrfarë kontrolli ndaj tyre?

Kapitulli i dyzetënjtë Kërkimi për të vërtetën

Kur i sapolinduri arrin në këtë botë, ai nuk është i vetëdijshëm për botën përreth tij. Ai nuk mund të dallojë një gjë prej tjetrës. Ai nuk është në gjendje t'i identifikojë fytyrat, ngjyrat apo personat. Ai do të jetë në gjendje të pranojë ndjenjat prej fytyrave dhe zërave përreth tij, por nuk do të jetë në gjendje të kuptojë dhe të identifikojë personat dhe gjërat. Që nga ky moment ai do të fillojë ta zhvillojë aftësinë e identifikimit të personave dhe të gjërave. Ai do të shikojë tej përtej me shikimin hetues dhe do të shfaqë shprehjen e çudisë së këndshme kur t'i vërejë fytyrat përreth tij. Duke përdorur shqisat e tij dhe instinktin e të mësuarit, fëmija do të përfitojë vazhdimisht njohuri për rrethinën e tij.

Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë:

“Allahu ju ka nxjerrë prej mitrave të nënave tuaja në një gjendje që nuk keni ditur asgjë. Ai ju ka dhënë veshë, sy dhe zemër në mënyrë që t'i identifikoni dhuntitë e Allahut dhe të bëheni falënderues.” (Kuran, 16:78).

Një kohë mbas lindjes, fëmija fillon ta vërejë botën rreth tij. Ai i mban gjërat me dorë, i lëviz dhe i gjuan ato. Ndonjëherë mundohet t'i vërë gjërat në gojë. Ai tërhiqet nga drejtmet e zërit në rrethinën e tij. Ai i vëzhgon veprimet e personave përreth tij me sytë e tij. Në këtë mënyrë, fëmija e ngop instinktin e tij rreth kërkimit të së vërtetës. Allahu u ka dhënë aftësinë e kërkimit dhe të aventurës qenieve njerëzore, që ata të udhëtojnë për të shpaluar misterin e universit. Fëmija e ka këtë instinkt brenda tij dhe fillon të manifestohet tek ai prej ditëve të hershme të tij. Prindërit mund të udhëzojnë e të inkurajojnë këtë instinkt te fëmija dhe ata mund edhe ta frenojnë me veprime negative. Nëse prindërit u sigurojnë fëmijëve

ndihmë që e nxit dëshirën për të hulumtuar dhe ua japin lirinë të kuptojnë për të, ai mund të bëjë përparim të vazhdueshëm në diturinë e tij. Kjo mund të bëhet pararoja për hulumtime dhe zbulime shkencore në të ardhmen. Nëse prindërit janë të pavëmendshëm ndaj ndjenjave të brendshme të fëmijëve dhe e frenojnë dëshirën e tij për të zbuluar në lidhje me gjërat që e rrethojnë, e ndalojnë prej kryerjes së eksperimenteve, atëherë shpirti i tij për hulumtim do të shtyhet. Periudha më kritike e jetës së fëmijës është kur ai fillon të parashtojë pyetje në lidhje me gjërat. Moshë dyvjeçare dhe më lart është mosha kur fëmija ka shumë pyetje për të bërë. Fëmija i pyet prindërit se a do të bëhet baba apo nënë? Pse baballarët dalin jashtë shtëpisë çdo ditë për një kohë? Pse guri është i rëndë dhe uji është i butë? Nuk më pëlqen gjyshja, pse duhet të shkojë në shtëpinë e saj? Pse nuk mund të luaj kur është duke rënë shi? Pse peshqit nuk vdesin në ujë? Pse falesh pesë herë në ditë? Çka është namazi? Ku shkon dielli natën? Prej nga vjen shiu dhe bora? Çka janë yjet dhe kush i ka bërë ato? Çfarë dobie kemi prej peshkut? Kur ka vdekur gjyshi, pse e kanë shti nën dhe? Ku ka shkuar ai? Kur do të kthehet? Çka është vdekja? Pak a shumë, të gjithë fëmijët i parashtojnë pyetjet e tilla. Me rritjen e tyre, ata do të kenë pyetje të ndryshme për të pyetur. Fëmijët inteligjentë do të parashtojnë më shumë pyetje të ndryshme. Me shtimin e diturisë së tyre, do të fillojnë të parashtojnë pyetje më të ndërlikuara. Fëmija provon të mësojë për gjërat rreth tij duke parashtruar pyetje. Ai dëshiron të përfitojë prej diturisë dhe përvojës së të tjerëve. Dëshira për të hulumtuar dhe zbuluar është instinkti më vital i qenies njerëzore që ia mundëson të arrijë lartësitë në të gjitha fushat e aktiviteteve. Njeriu duhet të jetë i aftë t'i shpalosë misteret e universit me përpjekje të patrembura në zbulim dhe hulumtim. Prindërit që janë të vetëdijshëm se instinkti i

fëmijëve për zbulimin e gjërave duhet të nxitet për t'u ndihmuar në përparimin e diturisë që do t'i ndihmojë në të ardhmen, do të zgjerojnë mbështetjen dhe vëmendjen e tyre të plotë gjatë viteve të hershme. Disa prindër, pyetjet e fëmijëve i konsiderojnë si të panevojshme dhe humbje të kohës. Ata u thonë atyre: "O biri im! Mos bën shumë pyetje. Kur të rritesh do të mësosh vetë për këto gjëra që po i pyet tani." Prindërit e tillë e shukatin instinktin më të vlefshëm të fëmijës për shkak të mosdashjes/së tyre që të merren me përgjigjet. Padashur, ata bëhen shkak i ngadalësimit të dëshirës për diturinë të fëmija. Në fazën e mëvonshme ata ankohen se fëmijët e tyre nuk janë të aftë të përballen me studimin e shkencës dhe disiplinave tjera.

Disa prindër, për të kënaqur fëmijët e tyre, u përgjigjen pyetjeve të fëmijëve por ata nuk mërzhiten për saktësinë e përgjigjeve. Qëllimi i tyre është shukatja e fëmijës me ndonjë përgjigje. Kur fëmija mëson më vonë se prindërit ua kanë dhënë informatën e gabuar, do të ndjehet keq. Kjo mund të bëjë që fëmija të dyshojë edhe për të tjerët.

Prindërit e përgjegjshëm e të vëmendshëm e çmojnë detyrën e tyre për të siguruar përgjigjen e duhur ndaj fëmijëve dhe e inkurajojnë instinktin e tyre për të gjetur natyrën e gjërave që i rrethojnë ata. Ata e përgatisin veten për këtë detyrë duke i parashikuar pyetjet që mund t'i parashtrijë fëmija dhe i shqyrtojnë përgjigjet e mundshme të pyetësit. Ata asnjëherë nuk i thonë fëmijës diçka që është në kundërshtim me të vërtetën. Nëse gjatë kohës ata nuk e kanë përgjigjen e duhur për pyetjen e fëmijës, ata thonë se nuk janë në gjendje të japin përgjigje dhe se do të mundohen më vonë për të gjetur përgjigjen e duhur. Në këtë mënyrë ata e mësojnë fëmijën të bëhet i sigurt kur të përballlet me situata të tilla. Disa prindër shkojnë në disa detaje të panevojshme gjatë dhënies së përgjigjeve ndaj

pyetjeve të fëmijëve. Edhe kjo nuk është e dëshirueshme. Përvoja na tregon se fëmija nuk dëshiron të dëgjojë përgjigjet e gjata. Edhe pse dëshiron përgjigje ndaj pyetjes, bisedat e gjata do ta lodhin atë. Prindërit duhet ta inkurajojnë shprehinë e debatit dhe të diskutimit gjatë rritjes së tyre. Aty ku është e nevojshme duhet të ndihmojnë për të eksperimentuar. Fëmija është një qenie njerëzore që mendon dhe që siguron shtytje për procesin e tij të të menduarit, që kapacitetet e fshehura të vihen në përdorim dhe ta përgatisin veten për të ardhmen.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Ai që parashtrohet pyetje në fëmijëri, do të jetë në gjendje t’u përgjigjet pyetjeve kur të rritet.” (Gharar al hukm, f. 645).

“Zemra e fëmijës është sikur toka e butë. Çfarëdo që vendosësh në të, do të pranojë.” (Gharar al hukm, f. 302).

Një grua shkuan në letrën e saj:

“Një natë erdhi babai dhe më tregoi një gjëegjëzë. Ai tha se shokët e tij nuk ishin në gjendje ta zgjidhnin atë. Të gjithë në shtëpi shkuan për të fjetur, por unë vendosa ta zgjidh gjëegjëzën. Mendova për këtë një kohë të gjatë dhe në fund e gjeta zgjidhjen. Isha aq e emocionuar sa që e zgjova babanë prej gjumit. Ai e shprehu gëzimin e tij për përpjekjet e mia që i pata bërë për zgjidhjen e gjëegjëzës. Ai gjithnjë më inkurajonte të zhvilloja intelektin tim. Ai më ka përgatitur mirë për t’u përballur me maturi për problemet e jetës.”

Kapitulli i dyzetedytë Besimi në vetvete

Jeta e njeriut është e mbushur plot me përpjekje, sfida dhe konkurrencë. Çdo njeri kalon nëpër mijëra sfida dhe vështirësi gjatë jetës së tij. Për të jetuar, ai duhet të luftojë përkundër dëshirës së tij me fuqitë e elementeve dhe t'i mbizotërojë ata. Ai duhet të luftojë me sëmundje të ndryshme dhe shkaqet e tyre. Në jetën praktike, sukses do të ketë ai që e ka zemrën e madhe, guximin e gjatë dhe dëshirën e fortë. Fati i mirë apo i keq i personit varet më tepër prej tij. Shkaku i suksesit i të gjithë personave të mëdhenj të botës është besimi i tyre në vetvete, fuqia e dëshirës dhe përpjekjet e palodhura. Njerëzit e mëdhenj dhe me influencë nuk janë frikësuar asnjëherë prej vështirësive. Ata e kanë vetëbesimin dhe Besimin në Allahun që i drejton ata nëpërmes peripecive të jetës. Ata janë të aftë të kryejnër çdo detyrë që u duket e pamundur për të tjerët. Ata nuk janë sikur kashta në oqeanin e gjerë që lundron në sipërfaqen e ujit sipas drejtimit të erës që fryn. Por, ata janë sikur notuesit e shkathët që i kanë krahët e fortë, dëshirën dhe besimin në Allahun e Plotfuqishëm, që u jep atyre aftësi të notojnë përkundër drejtimit të erës. Këta janë ata persona që janë të aftë për të përcaktuar formën e gjërave që do të vijnë në botë. Edhe Islami thotë se sukseksi i kësaj bote dhe sukseksi shpirtëror i një personi varet prej veprimeve dhe përcaktimeve të tij. Kurani i Shenjtë thotë:

“Çfarëdo që njeriu zotëron, është rezultat i përpjekjeve të tij dhe së shpejti ai do të shohë mundin e tij (në formën e plotë).” (Kuran, 59:39-40).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Vlera e çdo individi është e barabartë me kurajën e tij.” (Nahxh al balagha, v 2, f. 163).

Personi që ka durim dhe vetëbesim nuk do të kërkojë nga të tjerët zgjidhjen e problemeve të tij. Në fakt, ai hidhet në arenë me besimin e plotë në vetvete dhe asnjëherë nuk dorëzohet derisa të arrijë qëllimin.

Imam Xhafer Sadiku, thotë:

“Sekreti i respektit dhe i madhësisë së besimtarit (*mumin*) është se ai nuk i kërkon gjërat që janë në duart e të tjerëve.” (Usul al-Kafi, v2, f. 148).

Imam Sexhadi, thotë:

“Virtytet qëndrojnë në atë, që personi të mos rrijë i ulur e të presë ndihmën nga të tjerët,” (Usul al-Kafi, v2, f. 148).

Njerëzve që u mungon vetëbesimi, nuk u besojnë aftësive të veta. Ata e konsiderojnë veten të dobët dhe të ulëë. Ata kanë frikë për t’u ballafaquar me vështirësitë. Ata do të shmangen prej përgjegjësiive. Detyrat e lehta i bëjnë të vështira përmes mendimeve negative dhe mungesës së shpresës. Ata e kalojnë jetën e tyre në dëshpërim dhe hidhërim.

Tani që rëndësia e durimit dhe e vetëbesimit është themeluar, nuk do të jetë e tepërt të përkujtojmë se bazat e këtyre karakteristikave janë trashëguese në natyrën e çdo personi. Ata duhet të trajnohen dhe të zhvillohen. Periudha më ideale dhe më me vend e këtij trajnimi është fëmijëria e hershme e njeriut. Bazat e durimit dhe të vetëbesimit fillojnë të manifestohen që nga fëmijëria e çdo individi. Karakteristikat e kundërta me këto, janë padurimi dhe mungesa e vetëbesimit, dhe bashkë me këto fillon të zhvillohet edhe varshmëria prej të tjerëve për shkak të trajnimit të mangët të prindërve. Prindërit duhet t’i trajnojnë fëmijët e tyre me kujdes, në mënyrë që ata të zhvillohen në individë të dobishëm.

Imam Zejnel Abidini, thotë:

“Trajnioni fëmijët tuaj në atë mënyrë që ata t’u sjellin juve respekt dhe famë.” (Tuhaf al uqul, f. 269).

Periodha prej moshës katërvjeçare deri në moshën tetëvjeçare është periodha më e mirë për formimin e personalitetit dhe qëndrimin e një individi. Në këtë periodhë fëmija do të tregojë prirje për durim e vetëpërmbytje, dhe do ta përgatisë veten për t’u përballur me vështirësitë. Edhe pse fëmija do të jetë i vetëdijshëm për dobësinë e tij dhe nevojën për varshmëri ndaj një superiorit, prapëseprapë do të ketë elementet e durimit dhe të vetëpërmbytjes në natyrën e tij. Ai dëshiron t’i plotësojë nevojat e tij. Do të ndjejë ngazëllim gjatë kryerjes së detyrës së re. Ju sigurisht i keni dëgjuar fëmijët duke i shqiptuar këto fjalë:

- Shiko çka jam duke bërë!
- A ke parë se si kam kërcyer?
- Shiko, mund të vishem vetë!
- Vetë do t’i mbath këpucët.
- Do të pi ujë nga gota.
- Dua të ushqehem vetë me duart e mia.
- Nuk dua t’i të më qesësh çajin për mua!
- Shiko këtë pikturë të bukur që e kam vizatuar!
- Dua të ngjitem në pemë.

Fëmija insiston të harxhojë të hollat e tij sipas dëshirës së tij. Ai dëshiron t’i rregullojë lodrat sipas dëshirës së vet. Ndonjëherë tregon edhe kokëfortësi ndaj prindërve për të vepruar sipas mënyrës së vet. Ndonjëherë fëmija dëshiron t’u ndihmojë prindërve gjatë punëve të përditshme. Vajza e vogël dëshiron t’i lajë enët e kuzhinës dhe rrobat me nënën e saj. Ajo dëshiron të ziejë gjellën dhe të përgatisë tavolinën e bukës. Djali i vogël mundohet ta rregullojë kopshtin. Ai dëshiron të vizatojë piktura, të shkruajë letra dhe të shkojë në treg me babanë. Ai do të insistojë për të blerë rrobat dhe ushqimin për veten. Gjatë

ecjes në rrugë ai do të tregojë preferencën e vet për të dalë përpara prindërve dhe ndonjëherë tjetër për të mbetur mbrapa tyre duke i ndjekur. Ai ka dëshirë të marrë pjesë në rregullimin e mobileve të shtëpisë. Ai refuzon të hajë ushqime të caktuara. Me akte të tilla fëmija demonstroi individualitetin e tij. Fëmija mundohet deri në maksimum të mos jetë i varur prej të tjerëve. Personaliteti i fëmijëve do të jetë reflektimi i natyrës së prindërve. Prindërit duhet t'ia japin fëmijës një shkallë të pavarësisë, që ai të mundë të përparojë me vetëbesim. Ata duhet t'ia shprehin kënaqësinë dhe ngritjen e vlerës kur fëmija të arrijë diçka të re. Ata duhet t'ia përcaktojnë detyrat që i pëlqen ai dhe që i shkon për shtati atij. Me udhëzim dhe inkurajim zhvillon aftësitë e tij. Fëmija do të fitojë vetëbesimin në mënyrë progresive.

Një psikolog shkruan:

“Një person vëren se si një peshkatar i vogël është duke peshkuar me shkathtësi. Ai i zinte peshqit e mëdhenj. Personi ishte i befasuar. Ai i lëvdoi aftësitë e peshkatarit të vogël. Djali e falënderoi dhe i tha: ‘Nuk ka asgjë për t’u çuditur sepse unë jam duke e bërë këtë që nga vegjëlja’ personi e pyeti: ‘Sa vjeçar je’ Ai u përgjigj: ‘Gjashtë’.

Sikur prindërit të mos e kishin inkurajuar atë, apo, përkundrazi, sikur ta kishin bindur të mos e fillojë këtë punë prej vegjëlisë, ai nuk do të ishte në gjendje të përfitojë aftësi të tilla. Prindërit që i admirojnë dhe lajkatojnë së tepërmi fëmijët e tyre, i bëjnë ata të varur prej tyre pa qenë të vetëdijshëm për këtë. Ata nuk i lejojnë fëmijët të kryejnë ndonjë detyrë. Ata mundohen të bëjnë çdo punë të vogël për fëmijët e tyre dhe ata i sjellin të gjitha vendimet për fëmijët e tyre.

Një numër i madh i prindërve nuk i kushtojnë rëndësi nevojës për krijimin e vetëbesimit te fëmijët. Ata e shprehin hidhërimin e tyre për gabimet e fëmijëve nëse ata mundohen të kryejnë ndonjë punë vetvetiu. Atyre nuk u

pëlqen që fëmijët e tyre të hulumtojnë dhe e dekurajojnë atë në çdo hap.

Prindër të dashur, fëmijët duhet të rriten sidoqoftë. Edhe ata do të bartin përgjegjësi në të ardhmen mbi supet e tyre. Ju duhet të përgjigjeni pozitivisht ndaj natyrës së fëmijës për të qenë i pavarur. Dëshira për pavarësi nuk është mangësi. Kjo pavarësi është manifestim i dëshirës për të arritur përkryerje përmes përpjekjes. Ju duhet të siguroni se fëmija është në gjendje të ushtrojë pavarësinë e tij në mënyrë të matur. Ju nuk duhet të insistoni për të sjellë vendime për të kur ai mund të sjellë për vete. Ju duhet t'i shpjegoni anët e mira dhe të këqija, dhe të lejoni që ata të sjellin vendime.

Nëse fëmija fillon të punojë diçka dhe pastaj e lë në gjysmë, mos e turpëroni duke u përzier në mënyrë të pamenduar. Lërjani atij çështjen.

Nëse vajza juaj dëshiron të përgatisë ushqimin për vete, atëherë udhëzoheni që ta bëjë këtë. Mos u përzini përderisa është duke e kryer detyrën. Çfarë të keqe ka nëse e thyen enën njëherë. Mos u bëni kritikë ndaj shkathtësive të saja gjatë zierjes. A mund të paramendoni dëmin që mund të shkaktoni në psikikën e saj gjatë dhënies së kritikës.

Një grua shkruan:

“Çfarëdo që kam provuar të bëja në fëmijërinë time, kam fituar vërejtje – e ke thyer vazon e vlefshme kineze, ke vënë tepër kripë në enë, ke përdorur më tepër ujë sesa që duhet; çka di ti për fshirjen e dyshemesë? Mos fol në praninë e mysafirëve dhe me qindra vërejtje të tilla! Gjatë zierjes kisha shprehi të provoj se mos ka shumë kripë apo ujë në enë. Prapëseprapë, nuk isha e sigurt për rezultatin e gjellës. Kjo është arsyeja që nuk kam mundur ta zhvilloj vetëbesimin në aftësitë e mia. Fillova ta konsideroj veten të dobët e të parëndësishme. Jam shumë e palumtur me

ndjenjën e vlerës së ulët dhe mungesë të vetëbesimit. Tani punoj si përgjegjëse për udhëheqjen e mbledhjeve javore. Sa herë që bëj ndonjë gabim, mendja më trazohet dhe filloj të dyshoj se ndoshta nuk jam në gjendje të kryej këtë punë ashtu si duhet. Zemra ime fillon të shqetësohet. Filloj të mendoj se ndoshta nuk do të mund ta mbaj fjalimin si duhet. Shumë herë i ripërsëris pikat për të cilat do të flas dhe disa prej të cilave i kam folur edhe në mbledhjet e mëhershme. Prapëseprapë, ndjej një mungesë të përgjegjësisë. Filloj të dëshiroj sikur kjo përgjegjësi të mos më ishte besuar mua. Çfarëdo pune që të kryej, filloj të ndjej ngurrim. Kur të vij deri në gjysmën e punës filloj të dëshiroj sikur kjo detyrë të ishte kërkuar prej meje. Mundohem ta largoj nga mendja këtë mungesë të vetëbesimit, por asnjëherë nuk ia arrij.”

Një grua tjetër shkruan:

“Prej fëmijërisë sime nëna mendohej të më ndihmonte. Ajo asnjëherë nuk lejonte që vetë të kryeja ndonjë punë. Gjatë kohës u mësova nga mbështetja dhe varshmëria e të tjerëve dhe kjo u bë pjesë e natyrës sime. Nuk isha në gjendje të shfrytëzoja vetëbesimin dhe aftësinë e zgjidhjes së problemit. Gjithnjë më duhej ndihma e nënës dhe e të tjerëve prej shtëpisë. Varshmëria prej të tjerëve shkoi deri aty sa që edhe për punët më të zakonshme më nevojitej mbështetja nga të tjerët. Kisha një ndjenjë se jam e paaftë për të kryer diçka krye në vete.”

Duhet të përmendim në këtë fazë se disa fëmijëve duhet t’u bëhet me dije për mosmiratimin e disa veprave të tyre të gabuara. P.sh. ata mund t’i dëmtojnë lulet dhe t’i nxjerrin degët e kaçubave, t’i dëmtojnë zogjtë, qentë dhe macet; t’i lëndojnë të tjerët dhe t’ia tërheqin flokët e motrës. Në rastet e tilla, prindërit duhet të reagojnë dhe të mos rrinë pa u përzier. Por, prindërit duhet ta kenë ndërmend se kur fëmijët i bëjnë veprimet e tilla, kjo nuk

është për shkak të asaj se ata ndejnë urrejtje apo armiqësi ndaj ndonjërit. Ai është duke u munduar që ta mbrojë individualitetin e tij. Mënyra më e mirë për ta parandaluar prej gjërave të tilla është shmangia taktike e vëmendjes së tij ndaj gjërave tjera. Bëre të zihet në ndonjë lojë apo të bëjë ndonjë punë të dobishme.

Kapitulli i dyzetetretë

Pavarësia

Ekzistojnë shumë prindër që mendojnë se kufizimi apo ndalimi i ndonjë lirie për fëmijën është një rritje e mirë. Ata mendojnë se fëmijët nuk janë të aftë të dallojnë të mirën nga e keqja. Ata nuk janë mjaft të zgjuar dhe nëse u jepet ndonjë pavarësi, ata mund të devijojnë. Prindërit e tillë fillojnë të mendojnë për fëmijët dhe të sjellin vendime për ata. Ata mundohen të mbajnë kontrollin mbi ushqimin, lojën dhe aktivitetet tjera të fëmijës. Ata dëshirojnë ta modelojnë jetën e fëmijës sipas të menduarit të tyre. Ata besojnë se fëmija nuk ka të drejtë për pavarësi dhe liri. Ai nuk duhet të bëjë asgjë pa kërkuar leje prej prindërve. Çfarëdo që prindërit të vendosin, fëmijët duhet ta zbatojnë pa kundërshtim. Për çfarëdo që prindërit vendosin se është gabim, fëmija të ndalet që ta bëjë atë pa u ankuar fare. Fëmija nuk mund të thotë asgjë kundër programit të prindërve lidhur me rritjen e fëmijës. Më herët, shumica e familjeve kishin shprehur për të ndjekur këtë linjë veprimi për rritjen e fëmijëve të tyre. Ata i rritnin fëmijët me dorën e hekurt. Edhe këtyre ditëve ekzistojnë familje të tilla që e ndjekin këtë praktikë të stërgjyshërve të tyre.

Edhe pse ishte një praktikë e së kaluarës, si dhe përkundër faktit që shumë familje e ndjekin këtë edhe sot e kësaj dite, kjo nuk është një prirje e drejtë. Ka shumë mangësi dhe zbrazëtira. Gjithnjë ekziston mundësia se me një formim të tillë fëmijët mund të mbeten të qetë dhe besnikë ndaj prindërve, por që të rriten në persona të turpshëm që u mungon vetëbesimi. Instinkti i tyre hulumtues dhe zbulues do të mbetet në gjumë. Ata nuk do të kenë kurajë të marrin detyra të rëndësishme dhe të vështira për të kryer. Po ashtu, ata nuk janë të aftë të bëhen liderë. Por, ata do të fitojnë shprehinë e pranimit të

urdhrave dhe do të durojnë trajtimin e ashpër në mënyrë stoike. Kur të rriten, ata nuk janë të aftë të tejkalojnë aq lehtë këtë të metë. Ata bartin një nyje në psikikën e tyre që më vonë mund të bëhet shkaktar i sëmundjeve të ndryshme psikologjike. Ka mundësi që personat e tillë t'i zhvillojnë tendencat sadiste dhe të sillen në mënyrë tiranike me fëmijët e tyre dhe të tjerët. Shumë intelektualë dhe psikologë e kanë filluar një kampanjë kundër praktikës së vrazhdë të rritjes dhe janë duke mbrojtur lirinë e plotë për fëmijët. Ata i këshillojnë prindërit që t'i lënë të lirë fëmijët e tyre për të vepruar sipas dëshirës së tyre. Ata thonë se fëmijët duhen të jenë të lirë për të vepruar sipas dëshirës së tyre, edhe pse nuk mund të duken gjëra të drejta në sytë tuaj. Në këtë mënyrë fëmija do të rritet në mënyrë të pavarur.

Psikologu i famshëm Sigmund Frojd beson në këtë metodë dhe ka shumë pasues në Lindje dhe në Perëndim. Edhe, shumica e prindërve e ndjekin këtë metodë për rritjen e fëmijëve të tyre. Ata ua kanë dhënë lirinë e plotë fëmijëve të tyre dhe nuk u japin kurrfarë urdhra atyre. Por, edhe kjo praktikë nuk është plotësisht e drejtë. I ka disa mangësi. Fëmija e rritur në këtë mënyrë nuk beson në asnjë kufizim gjatë kryerjes së asaj çka ka vendosur për të bërë. Në përgjithësi fëmijët e tillë do të jenë egoistë, nervozë dhe me natyrë të pacipë. Ata mendojnë se të tjerët nuk kanë kurrfarë të drejte. Ata i uzurpojnë të drejtat dhe privilegjet e tyre. Ata i ngacmojnë pa kurrfarë arsyeje vëllezërit dhe motrat e tyre. Fëmijët e tillë do të bëhen bezdisje për fqinjët dhe të tjerët. Për shkak të asaj se dëshirat e tyre kanë shkuar deri te pavarësia totale, ata bëjnë trazira ndaj të tjerëve. Pritjet e tyre e arrijnë atë nivel, sa që ata do të kenë vështirë për t'i plotësuar ato. Kur fëmijët e tillë rriten, ata presin që të tjerët t'i nënshtrohen pa ndonjë ankesë. Ata nuk dëshirojnë të kontrollohen prej të tjerëve. Kur vërejnë se

nuk janë të aftë të bëjnë sipas tyre ndaj të tjerëve, ata bëhen zemërthyer. Mbasi të përballen me refuzimet në shoqëri, ata bëhen të vetmuar, tërhiqen nga bota, apo për t'u hakmarrë ndaj tyre ata i sajojnë dredhitë për vepra tiranike dhe të rrezikshme. Ndonjëherë, liria e pakufizuar mund të bëhet edhe e dëmshme. Ndonjëherë fëmija dëshiron të vrapojë në rrugën e rrezikshme apo të prekë telin elektrik të rrymës. Kështu që, të dy metodat e rritjes, e para që nuk i jep kurrfarë lirie fëmijës dhe e dyta që e rekomandon lirinë e plotë, janë të mbushura plot me të meta verbuese. Rruga më e mirë për të ndjekur në çështjen e rritjes së fëmijës është dhënia e lirisë përzgjedhëse. Allahu e ka pajisur njeriun me instinkte dhe ndjenja të ndryshme, të cilat e formojnë natyrën e njeriut. Disa prej këtyre instinkteve janë dashuria, urrejtja, trimëria, frika, etj. Këto janë ndjenja dhe nocione të brendshme me të cilat janë të pajisur qeniet njerëzore për t'u marrë me problemet me të cilat konfrontohet njeriut. Këto instinkte e formojnë personalitetin individual. Këto instinkte kultivohen në mjedisin e lirë.

Frika është për ikje nga rreziku. Zemërimi ndihmon në vendimin për të sulmuar kundërshtarin. Zelli kërkohet për përfitimin e njohurisë. Personi që nuk e ka instinktin e frikës dhe të zemërimit, në natyrën e tij do të bëhet një person me ndjenjë inferiore. Nuk është e drejtë të shtypen këto ndjenja te fëmija. Në një atmosferë të lirisë, fëmija mund të ketë dobi prej këtyre instinkteve për të përparuar.

Religjioni i Islamit i jep rëndësi të veçantë nevojës për liri. Këtu do t'i cekim disa tradita:

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Mos iu bëni robër të tjerëve sepse Allahu ju ka lindur si persona të lirë.” (Bihar al-anvar, v 77, f. 214).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Personi që i zotëron këto pesë kualitete, do të jetë person i suksesshëm: Besimi, urtësia, morali, liria dhe sjellja e mirë.”

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Fëmija është sundimtar deri në moshën shtatëvjeçare, prej moshës shtatë deri në katërbëdhjetëvjeçare është i nënshtruar dhe mbas moshës katërbëdhjetëvjeçare është këshilltar dhe përfaqësues i prindërve.” (Vasail al-shiah, v 15, f. 195).

Por, liria totale nuk është e mundur në shoqëri. Për shkak të lirisë së një personi nuk mund të komprometohet liria e të tjerëve në shoqëri. Fëmijës duhet t’i bëhet me dije qysh në jetën e tij të hershme se asnjëri nuk mund të jetojë në shoqëri pa asnjë kufizim. Edhe të tjerët i kanë të drejtat dhe privilegjet e tyre. P.sh.: fëmija dëshiron të luajë. Loja është e mirë për formimin e tij. Ai duhet të ketë lirinë për të luajtur lojëra që i përshtaten temperamentit të tij. Por, gjatë lojës fëmija duhet të jetë i vetëdijshëm për të drejtat e të tjerëve. Ai duhet të ketë kujdes që prona e fqinjëve të mos dëmtohet dhe xhamat e dritareve në ndërtesën e fqinjit të mos thyhen. Prandaj, ai e ka lirinë të luajë por liria e tij i ka disa kufizime.

Fëmija mund të ushtrojë instinktin e tij të zemërimit. Ai mund ta mbrojë veten duke treguar zemërimin në kohën e duhur. Por, gjatë këtij ushtrimi të zemërimit ai nuk ka të drejtën e dëmtimit të pronës përreth tij, t’u shkaktojë dëme të tjerëve apo t’i ofendojë të tjerët.

Prindërit duhet të sajojnë një strategji për rritjen e fëmijëve, duke marrë në konsideratë moshën, inteligjencën, fuqinë dhe ndjenjat e tij. Ata duhet t’i ndajnë veprimet e tij në dy kategori:

1. Veprimet që janë të përshtatshme për të;
2. Veprimet që janë të ndaluara për të.

Ata duhet të përcaktojnë kufirin për të dy llojet e veprimeve. Pastaj, ata duhet t'ia japin lirinë e plotë fëmijës për veprimet e përshtatshme, që ata të mund të ushtrojnë plotësisht instinktin e tyre gjatë kryerjes së këtyre veprimeve pa ndonjë kufizim. Fëmija duhet të jetë i lirë për të menduar dhe për të vepruar. Jo vetëm që fëmijës që duhet t'i jepet liria e plotë, por kohë mbas kohe ai duhet të udhëzohet, nëse paraqitet nevoja për një gjë të tillë. Ai duhet të ndalohej plotësisht nga veprimet që janë të ndaluara për të.

Nëse përvetësohet ky qëndrim, as nuk do të frenohet liria e fëmijës, as aftësitë e tij nuk do të pengohen. Ai do të ketë sasinë e duhur të lirisë dhe të kontrollit për të siguruar se instinktet e tij janë duke u shfrytëzuar me leverdi.

Prindërit duhet të përcaktojnë me kujdes veprimet e drejta dhe të gabuara që fëmija mund të bëjë. Veprimet që janë të dëmshme për familjen, që mund t'i shkaktojnë dëm personave apo pronës, që janë kundër normave të shariatit dhe të ligjit, duhet të vihen në listën e zezë dhe fëmija duhet të parandalohet në mënyrë të përpiktë nga kryerja e tyre. Për veprimet e drejta, fëmijës duhet t'i jepet liria e plotë. Gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të drejta, fëmijës duhet t'i lejohet përdorimi i të menduarit dhe intuitës së tij.

Rregullat e mirësjelljes duhet të përcaktohen duke pasur parasysh fuqinë e trupit dhe të mendjes së tij, dhe aftësitë e tija mendore. Kujdesi duhet t'i kushtohet vendosjes së rregullave që nuk janë të ashpra për fëmijët.

Prindërit duhet të jenë të qëndrueshëm e të vendosur ndaj fëmijëve kur i shqiptojnë fjalët si: “Këtë mund ta bësh” dhe “Këtë nuk mund ta bësh.”

Prindërit duhet mbajnë anash ndjenjat dhe emocionet e panevojshme. Ata duhet të përmbahen prej dyshimeve dhe mëdyshjeve, që fëmija t'i kuptojë

përgjegjësitë e tij dhe pastaj nuk do të ketë ndonjë hezitim gjatë plotësimit të detyrave të veta.

Imam Hasan el Askeri thotë:

“Kur fëmija tregon mosbindje ndaj prindërve, dhe është i pacipë ndaj tyre, ai do të rritet në një person të pabindur dhe të panënshtuar.” (Bihar al-anvar, v. 78, f. 374).

Prindërit duhet të koordinojnë njëri me tjetrin dhe të përmbahen prej dallimeve në mendime gjatë sjelljeve me fëmijët. Dallimet në mes të prindërve mund të krijojnë dyshime në mendjet e fëmijëve.

Kapitulli i dyzetekatërtë

Kokëfortësia

Çdo fëmijë ka një shkallë të kokëfortësisë në natyrën e tij që fillon të dallohet prej moshës dyvjeçare. Zakonisht, fëmija kokëfortë insiston që gjërat të bëhen sipas mënyrës së tij. Sa herë që has në rezistencë prej të tjerëve, ai do të qajë dhe do të bërtasë. Do të rrotullohet në tokë dhe do të godasë kokën në mur. Fëmija mundet edhe të refuzojë ushqimin. Do ta gjuajë enën dhe ndonjëherë do të bëhet edhe agresiv dhe do të godasë anëtarët tjerë të familjes. Kjo shprehi e kokëfortësisë, nëse përsëritet, do të vërehet edhe në rininë e tij. Në përgjithësi, prindërit ankohen për mosdëgjim nga ana e fëmijëve dhe kërkojnë zgjidhje për problemin. Sipas përvojës së përgjithshme, për tejkalimin e këtij problemi, prindërit e përdorin njërën prej dy metodave që do të përmendim këtu.

E para: Disa prindër janë të mendimit se nëse fëmija është kokëfortë dhe nëse refuzon të dëgjojë kërkesën e tyre, duhet të merret qëndrimi i ashpër. Këta prindër thonë se fëmija i tyre është bërë shumë kategorik dhe se ata duhet të bëhen të qëndrueshëm në refuzimin e dëshirave të tij. Ata mundohen të korrigjojnë fëmijën duke u bërë të rreptë dhe shkojnë në maksimumin e dënimit dhe të rrahjes së tij. Ata mundohen t'ia imponojnë dëshirën e tyre fëmijës. Sjellja e prindërve të tillë është e barabartë me qëndrimin e “monedhës së njëjtë”. Ky qëndrim nuk është i dëshirueshëm, edhe nëse ata e qetësojnë për momentin fëmijën duke qenë të rreptë. Përkundrazi, ata do t'i shkaktojnë një dëm të madh psikikës së fëmijës me qëndrimin e tyre të rreptë.

Mosha dyvjeçare është mosha e fillimit të vetë-përcaktimit dhe vetëbesimit të fëmija. Sjellja këmbëngulëse e fëmijës është pohimi i natyrës së tij për pavarësi. Në këtë

moshë të ndjeshme, fëmija nuk është në gjendje të kontrollojë dëshirat dhe të paramendojë konsekuencat e plotësismit të tyre. Ai e përcakton mendjen e tij dhe dëshiron që gjërat të bëhen sipas mendjes së tij. Nëse prindërit i refuzojnë kërkesat e tij, kjo do ta dëmtojë psikikën e fëmijës. Fëmijët e tillë mund të rriten në individë të qetë por atyre do t'u mungojë tipari i vetëbesimit dhe i përcaktimit. Kur fëmija vëren se askush nuk brengoset për dëshirat e tij dhe se janë duke e parandaluar atë me forcë për të qenë sipas mënyrës së tij, ai do të jetë i dëshpëruar dhe i hidhëruar. Kjo gjendje e ankthit dhe e frustrimit do të bëhet pjesë e natyrës së tij. Mund të ketë edhe mundësi që me rritjen e tij, ai të bëhet i pabindur dhe të shkojë mbas akteve ekstreme si tirania dhe vrasja, si një shprehje e ndjenjës së tij ekstreme e lëndimit.

E dyta: Disa ekspertë të çështjes së rritjes besojnë se dëshirat e fëmijëve duhet të plotësohen deri në maksimum. Atij duhet t'i lejohej të bëjë atë çka dëshiron. Ata mendojnë se fëmijës duhet t'i jepet një shkallë e pavarësisë. Ata besojnë se me rritjen e fëmijës do të largohet kokëfortësia. Por, edhe kjo metodë i ka të metat e veta.

Janë disa veprime të caktuara që mund të jenë të dëmshme për fëmijët dhe për ata që janë përreth tij, nëse atij i lejojnë një gjë të tillë. Nuk është punë e mençur mbyllja e syve ndaj veprimeve të tilla të fëmijëve. Paramendoni një fëmijë trevjeçar duke provuar për t'u ngjitur shkallëve pa mbrojtëse. Aty gjithmonë do të ekzistojë mundësia e rënies dhe e gjymtimit të përjetshëm të tij. Fëmija mund të provojë ta ndezë furrën pa mbikëqyrje dhe si pasojë e kësaj të shkaktojë një zjarr të madh. Fëmija mund të bjerë me kokë dhe t'u shkaktojë lëndime trupore fëmijëve që ndodhen përreth tij. Të vjetrit duhet gjithmonë t'i parandalojnë prej gjërave të tilla.

Fëmija që është i lirë të veprojë sipas dëshirës së tij dhe veprimet e të cilit gjejnë pranim nga ana e prindërve, gjatë kalimit të kohës me sjelljet e tij të padisiplinuara do të shndërrohet në një individ egoist dhe diktatorial. Ai pret që njerëzit do të përkrahin mendimin e tij pa ndonjë kundërshtim. Ai nuk është përballur me mospranimin e dëshirave të veta gjatë fëmijërisë dhe do të presë qëndrimin e njëjtë prej të tjerëve edhe kur të rritet. Por, kjo nuk ndodh në praktikë. Njerëzit mund të mendojnë ndryshe prej tij. Mbas ballafaqimit me refuzimet e të tjerëve, ai do të frustrohet dhe do të tërhiqet në vete. Vetën do ta konsiderojë si një person që ka pësuar disfatë dhe do të mendojë se të tjerët janë të paarsyeshëm.

Islami e konsideron kokëfortësinë si një veçori negative të një individi, sikur që edhe traditat na bëjnë me dije për këtë.

P.sh, Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:

“Kokëfortësia është shkaku i të ligës.” (Girar al-hukm, f. 16).

“Kokëfortësia i shkakton dëm inteligjencës së njeriut.” (Girar al-hukm, f. 17).

“Kokëfortësia është shkaku i konfliktit dhe i armiqësisë.” (Girar al-hukm, f. 18).

“Kokëfortësia e dëmton personin më së shumti në këtë botë dhe në atë të ardhmen.” (Girar al-hukm, f. 104).

Qëndrimi më i mirë është përmbajtja. Prindërit që e përvetësojnë këtë mënyrë të rritjes së fëmijës së tyre, kokëfortësinë e fëmijëve nuk e konsiderojnë si një devijim dhe janë të vetëdijshëm se kjo është shprehje e individualitetit. Në vend se ta frenojnë këtë instinkt, ata e shfrytëzojnë për formimin dhe rritjen e fëmijës. Ata i konsiderojnë me vëmendje dhe i analizojnë kërkesat dhe veprimet e fëmijëve. Ata i japin liri fëmijës për veprimet e tij që janë të padëmshme dhe në këtë mënyrë e inkurajojnë

zhvillimin e aftësive mendore të tij. Ata bëhen shokë të tij dhe i ndihmojnë në kryerjen e veprimeve të tija.

Fëmijët e tillë e përforcojnë përcaktimin e tyre për kryerjen e veprave dhe e pasqyrojnë individualitetin e tyre. Prindërit e tyre, këta fëmijë i konsiderojnë si shokë dhe jo si persona që në mënyrë të panevojshme i ndalojnë veprimet e tyre. Por, prindërit e tillë e kundërshtojnë dhunën ndaj veprimeve të dëmshme të fëmijëve dhe nuk i kursejnë fjalët që t'u japin si këshillë fëmijëve për t'u përmbajtur nga veprat e tilla. Ata i shpjegojnë në mënyrë të qartë arsyet për ndalimin e fëmijës prej veprimeve të tilla dhe ia drejtojnë mendjen e tij kah aktivitetet tjera të dobishme. Mbase që fëmija ka ndjenja të mira ndaj prindërve, që nuk i vendosim shumë kufizime atij, ai do të pajtohet të mos i kryejë ato veprime që i kërkojnë prej tij që të mos i bëjë. Por, ndonjëherë fëmija insiston të bëjë ndonjë veprim të padëshirueshëm. Atëherë, prindërit duhet t'ia ulin këmbët e tij në tokë dhe ta parandalojnë nga kryerja e atij veprimi. Pastaj, fëmija do të qetësohet mbas një kohe. Fëmija duhet të trajnohet për të kuptuar se nuk bën të bëhesh gjithnjë kokëfortë në jetë. Prindërit duhet të ushtrojnë vetëpërmbajtjen gjatë trajtimit të fëmijës dhe nuk duhet ta rrahin atë. Fëmija nuk duhet të ketë ndjenjën se prindërit e tij janë tiranikë. Fëmijët e tillë mund të bëhen të pabindur me kalimin e kohës.

Në fund të këtij diskutimi është me vend të përmendim pikat më të rëndësishme që duhet të marrë në konsideratë mentori:

1. Sado që ka mundësi, jepini liri fëmijës për veprat e tij. Mos u përzini shumë në veprimet e tij. Mos i flisni vazhdimisht për gjërat që nuk duhet t'i bëjë. Nëse fëmija mundohet të ngjitet në karrige apo në dru, ju kërkoni nga ai të mos e bëjë këtë. Nëse provon ta qërojë pemën, ju e ndaloni duke i thënë se mund ta presë gishtin. Nëse

dëshiron ta lëshojë nxehësen, ju e parandaloni të mos e bëjë atë sepse mund ta djegë dorën. Nëse provon ta derdhë çajin në filxhan, ju thoni se mund të thyejë filxhanin e shtrenjtë kinez. Nëse luan brenda në shtëpi, ju thoni se po bën shumë zhurmë. Nëse lëviz përgjatë rrugës, ju e frikoni se mund ta shkelë ndonjë biçikletë dhe, çka mund të pritni që një fëmijë i vogël mund të bëjë. Edhe ai ka ndjenja njerëzore. Kur ju përziheni aq shumë në veprimet e tij, ai mund të zhvillojë kokëfortësinë. Një arsye për zhvillimin e tiparit të kokëfortësisë te fëmija është përzierja e tepërt e prindërve në veprimet e tij.

2. Kur fëmija bëhet qaraman, mundohuni të gjeni arsyen dhe të gjeni një zgjidhje, atëherë, fëmija do të qetësohet. Nëse është i uritur, ushqejeni. Nëse është i lodhur, futeni në gjumë. Nëse fëmija është shqetësuar prej rrethinës, si p.sh. zhurma e televizorit afër tij apo vizitori i zhurmshëm, rregullojeni rrethinën e duhur përreth tij.

3. Mos e ofendoni apo mos e qortoni fëmijën që mund ta bëjë atë më kokëfortë. Aliu thotë: “Qortimi i jep krahë kokëfortësisë” (Tuhaf al-ukul, f. 80).

4. Ndonjëherë, motrat apo vëllezërit e ngacmojnë fëmijën dhe ai nuk gjen mbështetje. Me këtë rast fëmija do të bëhet kokëfortë dhe i pabindur. Në rastet e tilla duhet të intervenojnë prindërit.

5. Nëse fëmija sillet me kokëfortësi dhe ju nuk jeni në gjendje të gjeni arsyen për këtë, atëherë analizoni se mos kjo sjellje është për shkak të gabimit tuaj.

Kapitulli i dyzetepestë

Puna dhe kryerja e detyrave

Puna dhe përpjekjet për të arritur sukses janë bazat e jetës së njeriut. Përmes punës njeriu i përfiton furnizimet themelore të ushqimit, veshmbathjen dhe strehimin. Këto kërkesa plotësohen përmes përpjekjeve të palodhura që i bëjnë njeriu gjatë jetës së tij. Zhvillimi i industrisë dhe zbulimet mahnitëse janë rezultate të aktiviteteve të vazhdueshme hulumtuese dhe zhvillimore të njeriut. Është plotësisht e qartë se puna dhe dituria e kanë lindur civilizimin në botë. Është madhështia kolektive e njerëzve të një shteti që atyre ua përfiton një vend të spikatur në mesin e bashkësisë së kombeve. Përparimi i një shteti është reflektimi i drejtpërdrejtë i punës së mundimshme të kryer nga ana e njerëzve të atij kombi. Nëse njerëzit e një shteti janë përtacë dhe të pandreqshëm, shteti i tyre do të mbetet mbrapa shteteve tjera në të gjitha sferat e aktiviteteve. Shtetet e tilla nuk do të përparojnë. Kombet e tilla nuk do të jenë produktive dhe gjithnjë do të mbeten në kënetën e prapambetjes. Ngjashëm, edhe përparimi i çdo individi do të varet nga dituria, shkathtësia dhe sinqeriteti i përpjekjes. Bota është një vend i punës së vështirë dhe i përpjekjes. Aty nuk ka vend për njerëzit që dredhojnë dhe shmangen prej detyrave të tyre. Allahu thotë në Librin e Shenjtë:

“Çfarëdo që njeriu zotëron është rezultat i përpjekjes së tij.” (Kuran, 53:39).

Profeti i Islamit thotë:

“I mallkuar është ai që e vë barrën e vet në supet e të tjerëve” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 73).

Po ashtu, Profeti i Islamit thotë:

“Namazi përmban shtatëdhjetë pikëpamje të ndryshme dhe më e lartësuar prej tyre është përpjekja për sigurimin e jetesës së ndershme.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 78).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Përcilljani përshëndetjen time shokëve dhe këshillojini ata të mbeten të devotshëm dhe të përgatisin veten për Ditën e dhënies së llogarisë. Për hir të Allahut, kërkoj prej jush të bëni ato gjëra që unë vetë i bëj përmes punës dhe përpjekjes. Mbas namazit të mëngjesit nxitoni për punë dhe kërkonit jetesën e ndershme. Allahu do t’ju sigurojë ushqimin dhe ndihmën.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 78).

Imam Muhamed Bakiri thotë:

“Unë nuk e dua personin përtac për kryerjen e detyrave të kësaj bote. Personi që është i ngadalshëm në këtë botë, do të jetë i ngadalshëm edhe në botën e ardhshme. (Usul al-Kafi, v. 5, f. 85).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Personi që mundohet të sigurojë furnizimin e familjes së tij do të fitojë shpërblimin e barabartë me atë të xhihadit.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 88).

Po ashtu, Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Bujqit janë deponuesit e njerëzve. Ata e mbjellin farën e mirë dhe Allahu u ndihmon të rritet. Në Ditën e Gjykimit, bujqit do të kenë vendin e mrekullueshëm. Atyre do t’u drejtohen me nofkën mubarakain – të bekuarit.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 201).

Çdo qenie njerëzore përfiton dobi dhe është e varur prej përpjekjes dhe punës së të tjerëve. Qeniet njerëzore nuk mund të jetojnë të izoluar. Prandaj, është detyrë e çdo individi të mundohet sa më shumë për mjetet e jetesës së tij dhe për qeniet tjera si ai. Kështu që, punëtorët mund të klasifikohen si qenie njerëzore më të mira. Ata që kanë fuqi për të punuar por nuk mundohen dhe presin nga të tjerët, do të jenë të privuar nga të mirat e Allahut. Prindërit që dëshirojnë që fëmijët e tyre të rriten në qytetarë të dobishëm e të dëgjueshëm, dhe që dëshirojnë të kontribuojnë në përparimin e kombit të tyre, duhet të

iniciojnë te fëmijët punën e dobishme në moshën e tyre të hershme. Ata duhet t'i mësojnë fëmijët në mënyrë të tillë që tek ata të zhvillohet prirja për punë sa më herët. Në këtë mënyrë, ata do të jenë në gjendje të ngulisin te fëmijët e tyre frymën e dinjitetit të punës. Personat e tillë nuk do të mendojnë për ndonjë punë që është nën dinjitetin e tyre. Shumica e prindërve nuk i kushtojnë aq shumë rëndësi këtij aspekti shumë të rëndësishëm të formimit të fëmijëve të tyre. Ata vazhdojnë të bëjnë gjëra të thjeshta për fëmijët, gjëra të cilat mund t'i bëjnë edhe vetë ata. Me këtë qëndrim ata nuk e ngjallin ndjenjën e përgjegjësisë te fëmija. Ata mendojnë se në këtë mënyrë janë duke i shërbyer fëmijës. Përkundrazi, kjo mund të bëhet një keqtrajtim ndaj fëmijës dhe shoqërisë në të ardhmen. Me një qëndrimin të tillë, ata i formojnë përtacët që do t'i shmangen punës kur të rriten. Fëmija duhet të inkurajohet dhe të ndihmohet të punojë ato punë që i përshtaten moshës dhe aftësive psikike të tij. Në këtë mënyrë do të formohet shprehia e punës te fëmija dhe ai do të ndjejë kënaqësi duke punuar.

Prindërit injorantë, që fëmijëve ua kryejnë çdo punë të vogël, nuk janë duke e kryer detyrën e tyre të trajnimit të fëmijës në mënyrë të duhur dhe janë duke krijuar anëtarë përtacë e të padobishëm për shoqërinë.

Prindërit e përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm e kanë ndër mend moshën e fëmijës, fuqinë fizike dhe aftësitë mendore, dhe e inkurajojnë t'i kryejë detyrat që janë brenda mundësive të tij. P.sh. prej fëmijës së moshës trevjeçare kërkohet t'i veshë çorapet vetë, t'i hedhë vetë mbeturinat apo t'i sjellë gjërat si kripa, biberi, etj. Me rritjen e fëmijës, atij i besohen detyrat më të mëdha si, rregullimi i shtratit të tij, vendosja e tavolinës së bukës, larja e enëve, pastrimi dhe fshirja e dyshemesë, etj. Fëmijët, po ashtu inkurajohen të kujdesen për vëllezërit apo motrat e tyre më të vogla, të kujdesen për kopshtin e shtëpisë dhe për kafshët shtëpiake.

Pastaj, ata mësohen të shkojnë në dyqanin ushqimor për të blerë gjërat e vogla për anëtarët e familjes.

Me rritjen e fëmijës mund t'i besohen edhe detyrat më të vështira. Në lidhje me këtë, janë disa faktorë të rëndësishëm që prindërit duhet të kenë ndërmend:

1. Duke pasur parasysh moshën dhe psikikën e fëmijës, ata duhet t'ia besojnë ato punë që i përshtaten aftësive të tij. Ndonjëherë vetë fëmija e shpreh dëshirën e tij për të punuar ndonjë punë të caktuar. Këto detyra zakonisht i shkojnë për shtati kërkesave të veta personale. Ai duhet të lejohet t'i punojë këto detyra apo përndryshe do të mësohet të jetë i varur prej të tjerëve për çdo gjë të vogël.

2. Fuqia fizike e fëmijës dhe kuraja duhet të merren gjithmonë parasysh dhe detyrat përtej aftësive të tij nuk duhet t'i besohen. Në të kundërtën, fëmija mund të fitojë ndjenjën e mërziisë dhe të refuzojë për të punuar ndonjë punë më vonë. Nëse puna është e lodhshme për fëmijën, ai mund të tregojë kundërshtim për detyrat e tilla.

3. Mundohuni t'ia shpjegoni detyrën fëmijës kur t'ia besoni atij. Ngulitini në mendjen e tij se gjërat nuk ndodhin vetvetiu në shtëpi. Babai punon shumë për ta mbajtur shtëpinë. Edhe nëna punon punët e përditshme të shtëpisë. Edhe fëmijët duhet t'u japin mbështetje anëtarëve të familjes në kryerjen e detyrave për të cilët është i aftë. Në këto raste, prindërit duhet të përmbahen prej përdorimit të forcës gjatë dhënies së detyrave. Fëmija duhet të kënaqet gjatë kryerjes së punëve të vogla të shtëpisë dhe nuk duhet të punojë nën detyrim.

4. Nëse ka mundësi, lejoni fëmijës t'i zgjedhë përgjegjësitë dhe të punojë sipas zgjedhjes së tij. P.sh. atij mund t'i jepet zgjedhja për larjen e enëve apo të fshirjes së dyshemesë.

5. Sasia dhe kufijtë e punës duhet të shpjegohen në mënyrë të duhur fëmijëve. Kjo do ta bëjë atë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tij dhe ai nuk do të ketë mundësi t'i kalojë kufijtë e përcaktuara.

6. Fëmijëve me aftësi specifike duhet t'u besohen detyrat e posaçme. P.sh. një fëmije mund t'i thuhet se ka për detyrë që të sigurojë të ketë në tavolinë sallatë të freskët për çdo kohë të ushqimit. Ai duhet të kujdeset për plotësimin e rezervave të sallatës së freskët dhe të gjërave tjera si, sapuni, pasta e dhëmbëve, detergjenti, etj.

7. Përpjekjet duhet bërë që të besohen detyrat e tilla që i pëlqejnë atij dhe që do t'i kryejë me dëshirë. Por, në disa raste prej fëmijës mund të kërkohen edhe gjërat që nuk i pëlqen. Fëmija duhet të inkurajohet për kryerjen e detyrave të tilla, të cilët do të jenë një trajnim i mirë për të. Aliu thotë: "Caktojini detyrat për çdo person të shtëpisë. Kur t'i kuptojnë përgjegjësitë e veta individuale, ata nuk do të presin që ajo detyrë duhet të kryhet nga ana e ndonjërit tjetër." (Gharar al hukm, f. 124).

8. Nëse keni shumë fëmijë në shtëpi, bëhuni të drejtë gjatë përcaktimit të detyrave.

9. Me qëllim të inkurajimit të fëmijëve që t'i punojnë detyrat në shtëpi, merrni pjesë me ata. Fëmijët do të ndjehen të rëndësishëm kur prindërit punojnë me ata.

10. Nëse ka mirëkuptim të plotë në mes të prindërve për kryerjen e detyrave të përditshme shtëpiake, atëherë ata mund të bëhen shembull të shkëlqyeshëm për imitim nga ana e fëmijëve. Në shtëpitë e tilla fëmijët do të jenë të gatshëm t'i pranojnë me dëshirë përgjegjësitë.

11. Kur fëmijët janë të rritur dhe të aftë për pranimin e detyrave me përfitime ekonomike, atëherë prindërit duhet t'u caktojnë atyre aktivitete të tilla. Në këtë mënyrë, ata do të jenë të zënë dhe njëkohësisht do t'i shtojnë të ardhurat e familjes. Bëjuni përshtypje atyre se

nuk është turp për të punuar por, përkundrazi, është një çështje e krenarisë. Sidoqoftë, nuk duhet bërë presion të madh fëmijëve për të punuar. Atyre duhet t'u sigurohet mundësi dhe kohë e mjaftueshme për lojë dhe rekreacion. Nuk është e drejtë të mendohet se nëse prindërit janë të pasur, atëherë nuk ka nevojë që fëmijët të punojnë. Në këtë mënyrë, fëmijët mund të shndërrohen në individë përtacë dhe bredhës.

Në fund, dëshirojmë t'ju përkujtojmë se themeli i dëshirës për punë është vendosur në vetë fëmijërinë e një individi. Përndryshe, nxitja e një personi të moshës së mëvonshme për të punuar do të jetë një detyrë e vështirë. Prindërit e përgjegjshëm nuk duhet të neglizhojnë këtë aspekt shumë të rëndësishëm të formimit të fëmijës.

Një grua shkruan në memoaret e veta:

“Unë jam një grua shumë përtace, pesimiste dhe kokëfortë. Jam gjithmonë e shqetësuar dhe nën presionin e frikës imagjinare. E kam pezmatimin e zorrëve dhe nuk kam kurrfarë prirje për të punuar. Çfarëdo punë është shumë e vështirë për mua. Shumë përtoj t'i punoj punët e përditshme të shtëpisë dhe ta përgatis gjellën. Kjo është arsyeja e mospajtimeve në mes meje dhe bashkëshortit dhe vjehrrës. Shkaku i gjithë kësaj fatkeqësie është nëna ime. Ajo ishte një grua shumë e sjellshme, e durueshme dhe inkurajuese. Por, ajo asnjëherë nuk më ka besuar ndonjë punë, ndoshta për shkak të dashurisë së saj ndaj meje. Ajo kurrë nuk më ka besuar ndonjë përgjegjësi. Nuk dëshironte të më lodhte me punët e përditshme shtëpiake. Ajo, asnjëherë nuk ka menduar për faktin se prej meje do të kërkohet të mirëmbaj një shtëpi në të ardhmen, për të cilën gjë unë nuk jam mësuar.”

Një grua tjetër shkruan:

“Unë jam motra më e vjetër në familje. Jam plotësisht e kënaqur me jetën time. Nuk ndjej asnjë

mungesë në standardin tim jetësor. Nuk e kam natyrën xheloze. Jam e sjellshme dhe e dobishme ndaj të tjerëve. Stolitë e çmuara dhe pasuria nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë për mua. I kryej përgjegjësitë e mia me dinjitet. Nuk pendohem për asgjë në jetë. Jam duke jetuar një jetë të qetë e të pastër. U jam falënderues prindërve të mi për rritjen e tyre të mirë që më kanë dhënë.

Kur hynte në shtëpi, babai kishte zakon të më thërrasë për të dorëzuar listën blerëse për nevojat e tij. Ai e kishte shprehur të më japë këmishën e tij për t'ia qepur pullat apo më jepte setrën për ta hekurosur. E çmonte punën time dhe më falënderonte. Njëherë pata qepur rroba të reja për të. Ai e shprehu gëzimin e tij dhe më premtoi se do të më blejë një makinë të re të qepjes.

Mbas disa ditëve ai e plotësoi premtimin e tij. Ai kishte blerë një makinë të mirë të qepjes. Prej asaj dite unë isha përgjegjëse për punët e qepjes në shtëpi. Nëna kishte zakon të më jepte rroba të shtrenjta dhe thoshte: 'Mos ke frikë nëse e dëmton materialin. Nëse e dëmton njëherë, herën tjetër do të mësohesh më mirë.'

Për shkak të qëndrimit qetësues të nënës, vetëbindja ime rritej gjithnjë e më shumë. Gjithmonë mundohesha t'i kryeja ato detyra me kujdes. Nuk më kujtohet të kem dëmtuar ndonjë material.

Gjithçka mësova përmes mbështetjes dashurore të prindërve të mi. U mësova t'i pranoj përgjegjësitë dhe t'i kryej detyrat në mënyrë efikase. Dëshira ime është që edhe fëmijët e mi të rriten në mënyrë të njëjtë.“

Kapitulli i dyzetegjashtë

Ndershmëria

Gënjeshtria është një shprehje e neveritshme dhe një prej mëkateve të mëdha. Të gjitha racat e botës e dënojnë gënjeshtren. Personat që rrejnë shikohen si të poshtëruar. Çdo person e di që gënjeshtari nuk ka kurrfarë respekti apo mirëbesimi nga bashkatdhetarët e tij. Personi i mirë dhe fisnik kurrë nuk gënjen. Islami e ka dënuar kategorikisht këtë shprehje të keqe.

Imam Muhamed Bakiri thotë:

“Gënjeshttrat janë shkaktaret e pabesisë.” (Usul al-Kafi, v. 4, f. 32).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Hz Isa ka thënë se kush gënjen vazhdimisht, nuk do të respektohet.” (Usul al-Kafi, v. 4, f. 33).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Nuk ka vepër më të ulët sesa gënjimi” (Mustadarak al-vasail, v. 2, f. 100).

Të gjithë të dërguarit e Allahut dhe çdo reformator u ka bërë thirrje njerëzve të flasin të vërtetën. E vërteta është një instinkt natyral. Të gjithë e duan të vërtetën. Edhe gënjeshtari i pandreqshëm ka dëshirë të dëgjojë të vërtetën. Nëse fëmija i është lënë ndërgjegjes së tij, në natyrën e tij është të thotë të vërtetën. Është ndikimi i faktorëve të jashtëm ajo që e bën personin të adaptojë shprehinë e gënjimit. Fëmija është i paaftë në mënyrë absolute për të gënjyer. Në jetën e mëvonshme kur t’i ekspozohet rrethanave që e detyrojnë atë të gënjejë, ai mund të përfitojë këtë shprehje të keqe. Çdo sasi e predikimit, referencat e ajeteve të Kuranit e të Traditës së të Pagabueshmëve, mund të mos kenë asnjë efekt te personi.

Është obligim i prindërve të sigurojnë që fëmijët e tyre të jenë të sinqertë që nga fëmijëria. Ata duhet të

largojnë me kujdes shkaqet e pavërtetësisë dhe të ndërfutin sinqeritetin në natyrën e tyre. Ata nuk duhet të neglizhojnë përkrahjen e sinqeritetit të fëmija.

Prindërit që janë të interesuar në rritjen e mirë të fëmijëve të tyre dhe që ndjejnë përgjegjësi në këtë drejtim, duhet të marrin në konsideratë këto fakte:

1. Një gjë që do të ketë efektin e dobishëm në rritjen e fëmijës është atmosfera e familjes. Fëmija rritet në mjedisin e tij. Ai i mëson sjelljet e mira nga prindërit dhe nga të tjerët në shtëpi. Nëse atmosfera e shtëpisë është e vërtetësisë dhe e sinqeritetit, dhe nëse prindërit e trajtojnë njëri tjetrin me korrektësi, atëherë fëmija do të pasojë këtë proces. Në të kundërtën, nëse atmosfera e shtëpisë është e pavërtetësisë dhe nëse prindërit gënjejnë njëri tjetrin, atëherë fëmijët e pafajshëm do të marrin disa shprehje. Fëmijët, veshët e të cilëve mësohen të dëgjojnë të pavërtetat përreth tij, nuk mund të presim të mendojnë ndryshe. Disa prindër injorantë, jo vetëm që tregojnë të pavërteta por edhe i inkurajojnë fëmijët e tyre të gënjejnë për të fituar ndonjë përfitim të përkohshëm. Baballarët që rrinë në shtëpi u thonë fëmijëve të tyre se nëse e kërkon atë ndonjëri, le të thonë se nuk është në shtëpi. Kur fëmija nuk shkon në shkollë, prindërit i thonë fëmijës t'i thotë mësuesit se ka qenë i sëmurë. Në këtë mënyrë e inkurajojnë shprehinë e simulimit. Janë me qindra gënjeshtër që sillen rreth shtëpisë çdo ditë. Prindërit e tillë janë duke bërë padrejtësi të madhe ndaj fëmijëve të tyre të pafajshëm e të ndjeshëm. Shqiptimi i rrenës është mëkat dhe mësimi i fëmijëve për të gënjyer është mëkati më i madh.

Prandaj, prindërit që kanë dëshirë që fëmijët e tyre të bëhen të sinqertë, nuk kanë mënyrë tjetër veçse të bëhen edhe vetë të sinqertë. Kjo duhet të udhëhiqet përmes shembullit.

Russeli shkruan:

“Nëse dëshironi që fëmija juaj të mos e fitojë shprehinë e gënimit, atëherë metoda e vetme është që gjithmonë t’ia thoni të vërtetën në praninë e tij.” (Dar tarbiat, f. 148).

Kisha pasur dëshirë sikur Russeli të kishte thënë: “Përvetësojeni singëritetin në prezencën e fëmijëve si dhe të tjerëve” Natyra e fëmijës ndikohet nga e pavërteta, edhe nëse është e fshehur.

Imam Sadiku, ka thënë:

“Bëjuni thirrje njerëzve për mirësi pa e përdorur gjuhën tuaj. Njerëzit duhet të shohin devocionin, zellin, namazin dhe veprat e mira tuajat që e kanë rolin e modelit për ata.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 780).

2. Fëmija sipas natyrës nuk gënjen. Instinkti i tij natyral e nxit atë që ta mbështesë të vërtetën. Atij i duhet një arsye e fortë të thotë të pavërtetën. Nëse prindërit depërtojnë në thellësinë e arsyes për të pavërtetën dhe i largojnë këto arsye, atëherë fëmija do të bëhet i singërtë. Një arsye që mund ta bëjë fëmijën për të gënjyer është frika nga qortimi i prindërve. Kur e pyet se a e ka thyer xhamin e dritares, ai do të thotë - ‘Jo’. Mbajeni në mend, arsyeja për shqiptimin e gënjeshtërsë është frika prej prindërve. Pastaj, ai e ndryshon përgjegjësinë e xhamit të thyer te ndonjë person tjetër. Nëse prindërit janë të matur e të vëmendshëm, arsyeja e shqiptimit të gënjeshtërsë nuk do të qëndrojë asnjëherë. Gjithnjë mund të ekzistojë mundësia që xhami të thyhet në mënyrë të paqëllimtë. Prandaj, nuk ka arsye për të qortuar fëmijën. Prindërit duhet t’i thonë fëmijës në mënyrë të butë se ata duhet të jenë më të kujdesshëm në të ardhmen.

Nën këto rrethana fëmija nuk meriton të qortohet apo të rrihet, që ai të kërkojë strehë mbrapa gënjeshtërsë. Edhe nëse e ka thyer xhamin e dritares dhe është duke mohuar zhurmshëm këtë vepër, ndëshkimi i rëndë nuk

është zgjidhja e problemit. Fëmija nuk mund të reformohet përmes rrahjes dhe ndëshkimit. As nuk ka ndonjë garantim se fëmija nuk do të kryejë veprën e ngjashme prapë. Në rrethanat e tilla prindërit duhet të kenë ndërmend se fëmija nuk është agresiv sipas natyrës. Gjithmonë ekziston një arsye e jashtme për këtë sjellje. Prandaj, ata duhet të hulumtojnë çështjen me kujdes gjatë përcaktimit të arsyes aktuale dhe shkaqeve të aktit të shkatërrimit. Kur të përcaktohet arsyeja e thyerjes së xhamit, atëherë nuk do të ketë më motivacion ta përsërisë veprën e njëjtë edhe njëherë. Ndoshta, akti vandal ishte rezultat i drejtpërdrejtë i ndonjë ofendimi i shkaktuar ndaj fëmijës nga ana e ndonjërit. Ndoshta, fëmija nuk ka pranuar kujdesin e duhur dhe e nxjerr jashtë mërzinë e tij duke i shkaktuar dëm dritares. Mund të jetë reaksioni i ndonjë ndëshkimi të pamërituar që e ka pranuar fëmija prej prindërve të tij. Nëse prindërit bëjnë përpjekje ta largojnë kompleksin psikologjik nga mendja e fëmijës, atëherë sipas të gjitha gjasave ai do të qetësohet. Nëse arrihet një rezultat i tillë, atëherë nuk do të ketë nevojë për veprime ndëshkuese. Atëherë, fëmija do të përmbahet prej akteve shkatërruese dhe më nuk do të ketë nevojë të bërtasë apo ta rrahë atë.

3. Nëse mësoni se fëmija juaj ka bërë ndonjë gabim dhe dëshironi ta udhëzoni atë në rrugën e drejtë, atëherë mos e merrni në pyetje sikur policët. Është e mundur se me qëllim të mbrojtjes së egos së tij, fëmija mund të devijojë kah gënjeshtër. Në rrethana të tilla është më mirë të mos e merrni në pyetje dhe t'i thuhet p.sh. se duhet të shkojë të lexojë librat që i ka huazuar prej shokut. Tregoni atij se nuk është e drejtë të mbahen gjërat e të tjerëve për një kohë më të gjatë. Kthejani librin e shokut duke kërkuar falje.

4. Mos e kërcënoni fëmijën me ndonjë ndëshkim që nuk keni ndërmend ta bëni. P.sh, mos i thoni se nëse e bën edhe njëherë atë apo këtë gjë, do ta rrihni apo do t'ia

dorëzoni policit, apo edhe do ta largoni nga shtëpia. Gjithashtu, mos i thoni kur është i zemëruar se ju nuk do ta merrni në ndonjë gosti të cilën mezi e pret. Me kërcënime të tilla boshe ju do ta mësoni fëmijën të gënjejë. Ju duhet t'ia shqiptoni fëmijës vetëm ato gjëra që kenë ndërmend t'i bëni, dhe për të cilat mendoni se janë të drejta sipas tij.

5. Prindërit që janë të rreptë ndaj fëmijëve të tyre dhe që presin prej tyre më shumë sesa që kanë aftësi, janë ndoshta duke i shtyrë ata të gënjejnë. P.sh, fëmijës nuk i shkojnë mirë mësimet dhe duke e harruar këtë prindërit e tij insistojnë që ai të bëhet i pari në klasë, e bezdisin atë çdo ditë për mësimet dhe i bërtasin atij. Për shkak të aftësive të kufizuara, fëmija me të gjitha përpjekjet nuk do të jetë në gjendje ta arrijë këtë. Mbasi që fëmija dëshiron dashamirësinë e prindërve, ai mund të kërkojë strehë mbrapa gënjeshtërisë. Apo, do të shpikë një arsyetim që gjatë kohës së provimeve të ketë dhimbje koke. Ndonjëherë do të thotë se mësuesi nuk e pëlqen atë dhe se ia ka dhënë notën më të dobët.

Nëse prindërit i kanë vlerësuar mirë aftësitë e fëmijëve, ata nuk do të bien në atë pozitë që fëmija të detyrohet të sjellë arsyetime të pavërteta.

6. Ekzistojnë prindër që të gjitha veprimet e gabuara të fëmijës ua ngarkojnë shokëve të tjerë të shkollës apo të lojës. Ndonjëherë i fajësojnë edhe kafshët dhe bimët për gjëra të tilla. P.sh: ata mund të thonë se macja apo miu është përgjegjës për të. Këta prindër të papërgjegjshëm mendojnë se janë duke bërë diçka të mirë, duke mos ua atribuar fëmijëve të tyre veprat dhe gabimet që me të vërtetë ata e kanë kryer. Janë dy dobësi të theksuara në lidhje me këtë: e para, ata janë duke e nxitur fëmijën të gënjejë dhe e dyta, fëmija do të mësojë ta fajësojë tjetrin për veprat e veta.

7. Nëse ndonjëherë fëmijët tuaj flasin gënjeshtër padashur, hulumtojini arsyet e kësaj dhe mundohuni ta gjeni shërimin. Ky eksplorim duhet të bëhet në mënyrë të butë, që fëmija të mos mendojë se është duke u bërë një hetim kundër tyre.

Kapitulli i dyzeteshtatë

Mbajtja e premtimeve

Shoqëria njerëzore nuk mund të funksionojë pa institucionin e premtimit apo zotimit dhe të plotësimit të tyre. Njerëzit që i themelojnë familjet dhe fiset, i bëjnë marrëveshjet dhe kontratat ndërmjet veti. Marrëveshjet bëhen edhe ndërmjet qyteteve që dëshirojnë të bashkohen apo të bashkëpunojnë në mes veti. Njerëzit i japin rëndësi të madhe kontratave të këtilla sepse ato janë bazat e jetës së tyre kolektive. Mbajtja e premtimeve është veti e rëndësishme e jetës së njeriut dhe çdo person e konsideron shkeljen e premtimit si diçka shumë të keqe. Çdo person apo grup që hyn në marrëveshje me një person apo grup tjetër, pret që termet e kontratës të plotësohen në mënyrë të përpiktë. Çdo grup që i përmbahet termeve të kontratës së tyre, do të konsiderohet si një njësi e organizuar mirë. Arsyeja e mirëvajtjes së tyre shtrihet në faktin se ata do të kenë besim të mirëfilltë në mes veti pa pasur ndonjë arsye për mosmarrëveshje. Jetët e personave të tillë do të jenë të suksesshme dhe të përmbajtur. Në të kundërtën, nëse njerëzit e një grupi apo rajoni nuk i përmbahen kontratës ndaj njerëzve të një grupi apo rajoni tjetër, ata do të vuajnë nga ndjenja e josinqeritetit dhe e shqetësimit. Ata do të jenë viktima të konflikteve të përhershme. Çdo individ i shoqërisë që i respekton marrëveshjet e lidhura me të tjerët, do të ketë respektin dhe besimin e të tjerëve. Ata që nuk i përmbahen kontratave të tyre, do të jenë të urreyer dhe do të shikohen me neveri nga të tjerët. Islami është një religjion me një natyrë të tillë që ia vë theksin e veçantë plotësimit të premtimeve.

Allahu në Kuranin e Shenjtë thotë:

“...dhe plotësoni zotimet tuaja, sepse çdo zotim do të pyetet (në Ditën e Gjykimit).” (Kuran, 17:34).

Në një vend tjetër në Kuran, thuhet:

“Ata që i ruajnë me kujdes ato që u janë besuar edhe premtimet e tyre.” (Kuran, 23:8)

Profeti i Islamit ka thënë:

“Personi që nuk e mban premtimin, nuk ka besim.”
(Bihar al-anvar, v. 75, f. 96).

“Çdokush që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, duhet t’i plotësojë premtimet e veta”
(Usul al-Kafi, v. 2, f. 364).

Aliu i ka thënë Malik Eshterit:

“Thyerja e premtimit i hidhëron të tjerët, e bashkë me këtë do të hidhërohet edhe Allahu.” (Bihar al-anvar, v. 77, f. 96).

“Aty ku nuk mund të mbash fjalën, mos premo. Aty ku nuk mund të plotësosh garantimin, mos e jep”
(Gharar al-hukm, f. 801).

Për të përjetësuar shprehinë e mbajtjes së premtimit dhe të përmbajtjes së marrëveshjes, është e pëlqyeshme që njerëzit të trajnohen qysh prej fëmijërisë së tyre, dhe t’i qëndrojnë besnikë fjalës së dhënë. Ky trajnim fillon që nga fëmijëria në mjedisin e familjes. Fëmija i imiton fjalët dhe veprat e prindërve. Prindërit mund të bëhen shembull për fëmijët. Sipas natyrës, fëmijët presin që premtimet do të plotësohen. Kur prindërit i plotësojnë premtimet e vogla, fëmija do të fitojë trajnimin adekuat në këtë aspekt të rëndësishëm të jetës. Por, nëse premtimeve të tyre të vogla nuk i kushtojnë rëndësi dhe i neglizhojnë, atëherë fëmija do të përvetësojë shembullin negativ dhe do ta zhvillojë shprehinë e mosmbajtjes së fjalës. Ata do të fillojnë të besojnë se premtimet jepen për t’i thyer ato.

Nëse prindërit i japin premtimet e pavërteta sa për ta qetësuar fëmijën, ata janë duke e mësuar fëmijën e tyre të bëjë premtime të pavërteta, pa qenë të vëmendshëm për një gjë të tillë. A mund të rriten fëmijët e tillë në individë të

nderuar? Për ta qetësuar fëmijën, nëna i premtton se do t'i blejë ëmbëlsira, akulllore, lodra, etj. Ndonjëherë, i bën këto premtime sa për t'ia dhënë ilaçin apo vaksinën. Ajo e frikon atë duke i thënë se nëse e bën një gjë të caktuar, ajo do ta dërgojë atë në polici, do t'i tregojë babait apo nuk do t'i blejë rroba të reja për festë. Nëse ju i merrni parasysh jetët e njerëzve përreth jush, apo edhe tuajat, atëherë do të vëreni shembuj të panumërt të premtimeve të tilla të kota dhe kërcënimeve që u bëhen fëmijëve të pafajshëm. A mendojnë prindërit e tillë ndonjëherë se çfarë ndikimi janë duke ua bërë mendjeve të ndjeshme të fëmijëve? Kjo padrejtësi është duke depërtuar te fëmijët e pafajshëm pa u vërejtur fare.

Prindërit injorantë nuk e dinë se ata janë duke bërë mëkat, për shkak të premtimeve të kota që janë duke i bërë, dhe janë duke i trajnuar fëmijët që t'i ndjekin hapat e tyre.

Kjo është arsyeja që Islami kërkon nga prindërit që t'i mbajnë premtimet që ua kanë dhënë fëmijëve. I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Dashurojini fëmijët tuaj. Trajtoni ata me dhembshuri dhe nëse u jepni ndonjë premtim, atëherë plotësojeni atë. Fëmijët mendojnë se ju e siguronit furnizimin për ata.” (Vasail al-shiah, v 15, f. 101, Bihar al-anvar, v104, f. 92).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve thotë:

“Sa herë t'u premtoni diçka fëmijëve, patjetër plotësojeni atë.” (Mustadrak al-vasail, v 2, f. 106).

Kapitulli i dyzetetë

Zotërimi

Dashuria për nënën është pjesë e natyrës së njeriut. Njeriu dëshiron t'i zotërojë gjërat që i nevojiten. Ai mendon se është zotëruesi i këtyre gjërave. Ai gjithashtu pret nga të tjerët që t'i respektojnë ndjenjat e tij në lidhje me gjërat që i takojnë. Ky instinkt i zotërimit nuk mund të shuhet plotësisht në natyrën njerëzore. Në cilëndo mënyrë të frenohet, prapëseprapë do të paraqitet. Zotërimi, edhe pse joreal, është fenomen i tillë që e ka veshur petkun e realitetit. Pa këtë ndjenjë të zotërimit, rrjedha e jetës së njeriut duket e pamundshme. Që nga koha kur fëmija fillon ta njohë vetveten dhe t'i identifikojë nevojat e veta, në mënyrë instiktive ai do të mendojë se i zotëron ato.

Kur fëmija të gjejë diçka në dysheme apo ta marrë prej dorës së ndonjërit, ai mendon se i takon atij. Ai nuk do ta ndajë atë me dikë tjetër. Ai e di se nuk është zotëruesi i rrobave, këpucëve, lodrave dhe gjërave tjera, por nuk ka dëshirë që të tjerët t'i përdorin ato.

Ju sigurisht keni vërejtur se fëmijët i duan lodrat e tyre, pa marrë parasysh gjendjen dhe formën e tyre. Ato i mbrojnë, madje edhe luftojnë për to. Ata e kanë krenarinë e zotërimit në natyrën e tyre. Nëse ndonjëri ngrihet për t'i mbrojtur të drejtat e tij, ai nuk duhet të llogaritet si i lig. Ndjenja e zotërimit nuk është instinkt negativ. Prindërit duhet të pranojnë instinktin natyral të fëmijës.

Shpesh ndodh që fëmijët të shkelin të drejtën e zotërimit të fëmijëve tjerë dhe mundohen t'i uzurpojnë lodrat e tyre. Prindërit duhet t'i parandalojnë veprimet e tilla. Nëse fëmija më i madh i frikëson fëmijët e vegjël, prindërit duhet të intervenojnë në mënyrë të drejtë. Ata duhet të binden se nuk duhet t'i marrin lodrat e vëllezërve dhe motrave më të vogla me forcë. Nëse ai vazhdon me

këtë qëndrim edhe më tutje, fëmija duhet të paralajmërohet në mënyrë më serioze për mirësjellje. Nevojat e njerëzve janë në rritje e sipër. Ato mund të jenë edhe shkaqet e shkatërrimit të një personi.

Koncepti i zotërimit nevojitet për plotësimin e nevojave legjitime të njerëzve. Puna konsiderohet si esenciale për arritjen e zotërimit. Dashuria për pasuri, në kufijtë legjitimë, konsiderohet e mirë. Por, nëse i kalon kufijtë e caktuar, mund të shkojë në kategorinë e kopracisë dhe të dorështrënguarit. Ekzistojnë shumë njerëz që mund t'i emërtojmë adhurues të pasurisë. Ata vrapojnë mbas pasurisë në mënyrë të palodhshme. Ata e komprometojnë edhe pushimin, vetë-respektin dhe nderin e tyre në këtë kërkim të pavlerë për pasuri. Është një lloj i çmendurisë. Ata vetëm dëshirojnë të krijojnë grumbuj të pasurisë që nuk janë të dobishëm as për vete as për të tjerët. Për këta persona nuk mund të thuhet se janë të mençur.

Prandaj, prindërit duhet ta inkurajojnë ndjenjën e zotërimit të fëmija dhe ta mësojnë të bëhet i kënaqur me atë që mund ta sigurojë në mënyrë legjitime. Ai duhet të ketë lodra, por jo shumë. Lodrat duhet të jenë të mjaftueshme për të luajtur dhe për të mësuar, dhe jo për të krijuar rezerva. Nëse fëmija ka shumë lodra të reja që rrinë në raft, më mirë është që prindërit t'ua japin fëmijëve të tjerë. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të matur duke i thënë fëmijës se ai ka shumë lodra ndërsa fëmijët tjerë nuk kanë asnjë; nëse ia jep ndonjë lodër fëmijës tjetër, ai do të gëzohet dhe me këtë do të fitosh kënaqësinë e prindërve dhe të Allahut. Fëmija do të gëzohet për këtë ndarje të lodrave. Ai ka dëshirë që prindërit e tij të jenë të kënaqur prej tij. Ky instinkt e inkurajon atë të jetë i dëgjueshëm ndaj prindërve dhe të marrë pjesë në ndarjen e asaj që zotëron. Në këtë mënyrë shprehia e ndarjes së gjërave, do të kultivohet te fëmija. Ndonjëherë, prindërit mund të inkurajojnë fëmijën t'i

huazojë lodrat e tij fëmijëve të tjerë për të luajtur dhe për t'i kthyer. Në këtë mënyrë do të kultivohet shpirti i kooperimit te fëmija.

Thënë shkurt, prindërit duhet të mbajnë në mend se ekziston përmbajtja në çdo aspekt të rritjes së fëmijës. Ata duhet të përkrahin ndjenjën e zotërimit te fëmija dhe të kujdesen që të mos i kalojë kufijtë e caktuar. Ata duhet të sigurohen që fëmija të mos bëhet dashurues i verbër i begatisë gjatë jetës së tij.

Kapitulli i dyzetënëntë

Zemërgjerësia

Zemërgjerësia dhe fisnikëria janë tiparet e shkëlqyeshme të një personi. Njeriu fisnik përpiqet shumë të mbledhë pasuri, por nuk do të jetë tepër i dhënë mbas saj. Ai dëshiron pasuri, por për ta ndarë me të tjerët. Ai nuk beson në grumbullimin e pasurisë. Ai e kalon jetën e tij me familjen e tij dhe përzemërsisht merr pjesë në aktivitetet humanitare të shoqërisë. Ai u ndihmon të varfërve dhe nevojtarëve. Ai e bën përdorimin e drejtë të pasurisë së tij.

Personi dorështrënguar e grumbullon pasurinë. Ai nuk e harxhon atë as për vete as nuk u ndihmon nevojtarëve. Personi i tillë do të jetë pasuri e grumbulluar për brezat e ardhshëm.

Islami e ka dënuar koprracinë dhe e ka lavdëruar zemërgjerësinë shumë qartë.

I Dërguari i Islamit thotë:

“Zemërgjerësia është një pjesë e imanit dhe imani do ta çojë njeriun në Xhenet” (Xham’i al Sa’adat, v 2, f. 113).

“Zemërgjerësia është një dru në Xhenet, degët e të cilëve kanë mbërritur deri në tokë. Kushdo që arrin të kapet në njërën prej atyre degëve, do të mbërrijë në Xhenet.” (Xham’i al Sa’adat, v 2, f. 114).

“Xheneti është shtëpia e njerëzve zemërgjerë.” (Xham’i al Sa’adat, v 2, f. 114).

“Allahu është Bujar dhe Zemërgjerë, dhe i do ata që janë zemërgjerë.” (Xham’i al Sa’adat, v 4, f. 113).

I Dërguari i Islamit thotë:

“Nuk është e drejtë për besimtarin të jetë koprrac dhe frikacak.” (Xham’i al Sa’adat, v 2, f. 112).

Zemërgjerësia dhe fisnikëria i tërheq zemrat dhe ndjenjat. Njerëzit i duan personat zemërgjerë dhe i

respektojnë ata. Me zemërgjerësi dhe fisnikëri zemrat mund të gjunjëzohen.

I Dërguari i Islamit thotë:

“Njeriu zemërgjerë është më afër krijesave të Allahut dhe Xhenetit. Ai është larg prej Xhehenemit. Personi koprrac është larg prej Allahut, njerëzve dhe Xhenetit. Ai është më afër zjarrit të Xhehenemit.” (Al-mahajjatul bayda, v 3, f. 248).

Personi koprrac nuk u përmbahet të drejtave legjitime dhe për këtë arsye e meriton ndëshkimin në Ditën e dhënies së llogarisë. Zemërgjerësia e bën njeriun të mirëpritur në këtë botë si dhe në Xhenet. Kualiteti i zemërgjerësisë është instiktiv siç janë virtytet tjera të njeriut. Prindërit duhet t'i ushqejnë këto kualitete te fëmijët e tyre. Është e vërtetë se çdo fëmijë është i lindur me natyrën e tij individuale, por disa tipa janë të prirë të pranojnë zemërgjerësinë dhe të tjerët koprracinë. Prindërit që i trajtojnë fëmijët mund të kenë ndikim të rëndësishëm në modulimin e natyrës së tyre. Ata mund të ndikojnë te fëmija në frenimin e tendencave të koprracisë, që të mos shtohen më shumë, dhe ta inkurajojnë atë të bëhet më zemërgjerë.

Faktori që ka ndikimin maksimal në përparimin e fëmijës është karakteri i prindërve. Prindërit gjithmonë e luajnë rolin e modeluesit të fëmijëve. Nëse prindërit janë zemërgjerë dhe shpenzojnë në qëllimet e mira, edhe fëmijët do të mundohen t'i imitojnë ata. Gjatë kohës, kjo shprehi e zemërgjerësisë do të lëshojë rrënjë në natyrën e njeriut. Nëse, përkundrazi, prindërit janë koprracë, edhe fëmijët do ta modelojnë veten sipas mostrës së njëjtë. Shprehitë kalojnë një rrugë të gjatë në modulimin e karakterit.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Mësojeni veten të bëheni zemërgjerë, zgjidhni virtytet më të mira dhe këto virtyte do të bëhen shprehitë tuaja.” (Bihar al-anvar, v 77, f. 213).

“Zemërgjersia gjendet në mesin e shprehive të mira.” (Gharar al hukm, f. 17).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Që një person të bëhet mëkatar, mjafton që ai të mos shpenzojë asgjë për familjen e tij.” (Vasail al-shiah, v 15, f. 251).

Prindërit mund të kenë dobi nga porositë e mëposhtme, gjatë kultivimit të shprehisë së zemërgjersisë dhe fisnikërisë të fëmijët e tyre:

1. Inkurajoni fëmijët që të japin pjesë nga gjësendet që i kanë sjellë prindërit dhe motrat e vëllezërit e tij. Fëmija duhet të lavdërohet dhe të falënderohet në mënyrë të përshtatshme për aktet bujare. Në fillim, fëmija mund të ngurrojë për t’i ndarë gjërat që i zotëron, por dalëngadalë do të përvetësojë këtë shprehje të bujarisë. Nëse fëmija është ngurrues gjatë këtij eksperimenti, ai nuk duhet të detyrohet për një gjë të tillë. Kjo mund ta bëjë atë kokëfortë.

2. Ndonjëherë inkurajoni fëmijët që fëmijët tjerë të luajnë me lodrat e tyre. Fëmija duhet të inkurajohet t’u ndajë sheqerkat dhe çokolatat e tij me fëmijët tjerë. Kur ta bëjë këtë, qëllojeni lehtë shpinën e tij, si shenjë përkrahjeje për aktin e bërë.

3. Ndonjëherë inkurajoni të japë një pjesë të të hollave të tij për të varfrit dhe nevojtarët. Apo, kërkoni prej tij të shpenzojë para për ndonjë rast të mirë. Nëse kjo bëhet shprehje, do të ketë efekt të dobishëm në karakterin e fëmijës gjatë rritjes së tij.

4. Kërkoni prej fëmijës t’i thërrasë shokët e tij në shtëpi për drekë dhe të kujdeset për gostitjen e tyre.

5. Prindërit mund t'u japin edhe të holla fëmijëve të tyre për çdo ditë që t'u japin si lëmoshë apo për ndonjë rast të mirë.

6. Diskutoni me fëmijët për vështirësitë dhe brengat e njerëzve të varfër. Nëse ka mundësi, merrini me veti në ndonjë spital, jetimore apo në ndonjë shtëpi ku jetojnë njerëzit e varfër e të moshuar. Në prezencën e tij ndihmoni personat nevojtarë.

Në këtë mënyrë, fëmija mund të nxitet në shprehinë e zemërgjerësisë. Sidoqoftë, ne nuk mund të themi se kjo metodë do të vlejë për të gjithë fëmijët. Prindërit duhet të përpiqen maksimalisht dhe suksesi mund të ndryshojë prej një fëmije në tjetrën. Çdo individ e ka natyrën e tij dhe aftësinë e tij për të pranuar ndryshimin, sepse, shprehitë e fëmijëve vijnë si një faktor gjenetik që trashëgohet prej një gjenerate në tjetrin. Edukimi i kujdesshëm mund të sjellë efekte të mira.

Një grua shkruan:

“Kishim një kopsht të pemëve në një vend të këndshëm. Aty rriteshin me bollëk lloje të ndryshme të pemëve. Nëna dhe gjyshja ime kishin zakon t'u dërgonin të varfërve ndonjë pemë prej atij kopshti. Ata ishin dorëlibër posaçërisht ndaj personave të varfër që shërbenin në familjen tonë. Ata kishin zakon të më besonin mua këtë detyrë. Prej moshës gjashtë apo shtatëvjeçare unë e fitova shprehinë e kësaj pune. Në fshat jetonte një familje prej dy personave të verbër. Zemra ime kishte zakon të ndjente shumë për ta. Çdo ditë i vizitoja ata, i merrja për dore, dilnim bashkë me ata jashtë për ajër të pastër dhe pastaj hynim në shtëpi. U sillja edhe ujë të freskët nga burimi. Këta njerëz të verbër më bekonin dhe luteshin për mua. Kur i tregova nënës dhe gjyshes për këtë, ata u gëzuan shumë. Nëna ime më tha se një njeri i verbër meriton të ndihmohet.

Prindërit e mi kishin shprehi të më inkurajonin për kryerjen e veprave të mira. Kisha zakon që t'i kursej paratë e xhepit dhe t'ua jepja nevojtarëve. Dalëngadalë, fillova të përvetësoja këtë shprehi. Tani jam anëtar i organizatës që kujdeset për 14 familje të nevojtarëve.

Edhe fëmijët e mi janë ndikuar nga ky qëndrim. Një ditë më tha njëri prej tyre: 'Më jep ca para për çdo ditë'. E pyeta për arsyen dhe ai m'u përgjigj: 'Dua ta kursej këtë para'. Fillova t'i jepja çdo ditë para dhe e përkujtoja të mos i humbasë. Mbas disa dite ai erdhi me një kuti të kursimit. Brenda kishte 48 metelikë. Ai tha: 'Nënë, nëse më lejon dua që këto para t'ia fal një personi të verbër. Ai jeton në një shtëpi që gjendet sipër rrugës për në shkollën tonë'. Isha shumë i kënaqur me fëmijën tim. E përqafova dhe e putha".

Kapitulli i pesëdhjetë

Shtrirja e dorës së ndihmës për veprën e mirë

Detyra të caktuara që janë të mëdha dhe të rëndësishme, nuk mund të kryhen pa ndihmën e ndonjërit. Nëse mund të gjendet ndonjë ndihmë, puna e njëjtë mund të kryhet më lehtë. Nëse njeriu vazhdon të punojë vetëm, ai nuk do të arrijë t'i kryejë shumë punë. Rrallë ndodh që një person i vetëm të themelojë dhe të drejtojë një organizatë për mirëqenie sociale. Një individ nuk mund ta udhëheqë spitalin, shkollën, xhaminë, jetimoren, bibliotekën, etj. pa e pasur ndonjërin për ndihmë. Në fakt, vetëm një person as nuk mund të drejtojë një organizatë të tillë në mënyrë individuale. Me ndihmën e të tjerëve dhe kooperimin, puna mund të përfundohet deri në përkryerje. Çdo komb, populli i të cilit e ka shpirtin e ndihmës reciproke dhe të kooperimit, do të jetë një komb i suksesshëm.

Në këtë drejtim, Islami është një sistem gjithëpërfshirës që u bën thirrje njerëzve të bashkohen për të mirën dhe dobinë e të gjithëve. Kurani i Shenjtë thotë:

“Ndihmojeni njëri tjetrin në sinqeritet dhe devotshmëri, dhe mos i ndihmoni njëri tjetrit në mëkat dhe agresion.” (Kuran, 5:4).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Kooperimi me qëllim të mbajtjes së të vërtetës është besnikëri dhe ndershmëri” (Garar al hukm, f. 48).

Shpirti i kooperimit dhe i atmosferës shoqërore lëshon rrënjë vetëm prej fëmijërisë. Fatmirësisht, qeniet njerëzore e kanë natyrën e shoqërimit që prej lindjes. Por, gjithnjë ekziston nevoja e zhvillimit të mëtutjeshëm të këtij instinkti. Prindërit që janë të etshëm për dhënien e rritjes së mirë ndaj fëmijëve të tyre, e inkurajojnë instinktin e shoqërimit tek ata dhe u sigurojnë lodra dhe lojëra që kërkojnë pjesëmarrjen grupore. Ata mund t'u japin lodra

atyre dhe për të luajtur me to duhet të marrin pjesë më shumë se një fëmije. Ata mund t'i inkurajojnë fëmijët që t'i ruajnë bashkërisht paratë dhe t'i përdorin në ndonjë vend të mirë, me udhëzimin e prindërve. Me këtë kursim kolektiv, ata mund të blejnë pemë dhe ëmbëlsira për t'ua shpërndarë të sëmurëve, të varfërve dhe atyre që kanë nevojë. Prindërit mund të shtojnë ndonjë para në këtë sasi dhe t'u ndihmojnë gjatë blerjes dhe shpërndarjes së pemëve. Po ashtu, këto kursime mund t'u japin kohë mbas kohe organizatave humanitare. Ose, mund t'ia dhurojnë ato para ndonjë biblioteke publike me qëllim të blerjes së librave. Prindërit mund t'i inkurajojnë fëmijët të formojnë një kuvend të vogël dhe të iniciojnë vetvetiu ndonjë veprimtari humanitare.

Nëse prindërit janë anëtarë të ndonjë organizate humanitare, ata duhet t'i iniciojnë edhe fëmijët e tyre për aktivitete të tilla. Ata mund t'u japin fëmijëve ndonjë para që të kontribuojnë personalisht në fondin e organizatës dhe ta bëjnë atë anëtar të rregullt.

Humaniteti dhe fëmijët

Të gjithë njerëzit janë pasardhësit e prindërve të njëjtë, Ademit dhe Havës. Në fakt, të gjithë njerëzit i takojnë familjes së njëjtë të madhe. Allahu i ka krijuar dhe i pëlqen të gjithë. Ai ka siguruar furnizim për të gjithë. Allahu ua ka siguruar atyre të gjitha gjërat e nevojshme në këtë botë. Ai ua ka dhënë kontrollin për operimin dhe përdorimin e këtyre gjërave. Ai u ka dhënë atyre urtësi dhe fuqi që t'i shfrytëzojnë gjërat përreth tyre në favor të tyre. Allahu u ka siguruar mundësinë e ngritjes së shpirtit që ta arrijnë përkryerjen në devocion dhe të fitojnë shpërblimin në botën tjetër. Ai ka siguruar mënyrat e udhëzimit në formë të të Dërguarve, të cilët kanë ardhur kohë mbas kohe.

Ai i ka përcaktuar Imamët, dhe pastaj kanë ardhur edhe udhëheqësit fetarë, muxhtehidët dhe marxhat. Të gjitha këto sepse Allahu i do njerëzit dhe se Ai është shumë Bujar. Ai dëshiron që njerëzit të jenë të sjellshëm njëri ndaj tjetrit dhe të përpiqen për mirëqenien e gjithëmbarshme. Ai dëshiron që njerëzit t'i ndihmojnë njëri tjetrit si në kohëra të mira ashtu edhe gjatë rrethanave fatkeqe. Ata që kanë ndërmend mirëqenien e njerëzve dhe që me veprat e tyre punojnë në këtë drejtim, janë njerëzit e zgjedhur të Allahut. Ata do të kenë shpërblime të shumta në Botën e ardhshme. Islami, feja e shoqërueshme, ka vënë theksin e veçantë mbi nevojën për shërbimin e njerëzimit.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Të gjithë njerëzit e hanë ushqimin e siguruar nga ana e Allahut, prandaj, më të pëlqyerit te Allahu janë ata që u japin furnizim të tjerëve dhe që i sjellin kënaqësi ndonjë familjeje.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 317).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Allahu thotë se njerëzit e hanë ushqimin të cilin ua kam dhënë Unë. Njerëzit më të pëlqyer tek Unë, janë ata që janë të sjellshëm ndaj të tjerëve dhe që përpiqen shumë t'u ndihmojnë atyre gjatë kohërave të vështira.” (Bihar al-anvar, v. 73, f. 337).

Disa e pyetën të Dërguarin:

“Kush është më i dashuri i njerëzve tek Allahu?”

I Dërguari, u përgjigj:

“Ai që është më i dobishmi ndaj të tjerëve.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 239).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Mbas besimit, vepra më e mençur për një person është dashuria dhe kujdesi ndaj qenieve tjera njerëzore.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 392).

“Njëri që nuk brengoset për të mirën e myslimanëve, nuk është mysliman” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 347).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Njerëzit e preferuar të Allahut janë ata që u afrohen të tjerëve për të ndihmuar kur janë në nevojë. Këta njerëz të preferuar do të jenë nën kujdesin e Allahut në Ditën e Gjykimit” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 318).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Allahu është i sjellshëm ndaj qenieve të Tij dhe i pëlqen ata që janë të sjellshëm ndaj qenieve tjera” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 339).

Eksitojnë me qindra hadithe të ngjashme prej të Dërguarit dhe prej Imamëve që janë të përfshira nëpër përmbledhje të ndryshme të haditheve.

I Dërguari e ka parë shoqërinë islame si një njësi të vetme dhe ka kërkuar nga ithtarët e fesë të punojnë për të mirën e përgjithshme. Islami është fe shoqërore dhe mirëqenien e individit e konsideron si mirëqenie të shoqërisë. Ai lufton kundër çdo lloji të egoizmit. Myslimani i vërtetë asnjëherë nuk mund të bëhet egoist dhe asnjëherë nuk do shkelë të drejtat e të tjerëve.

Për qeniet njerëzore, shoqërimi është një kualitet më i lartë dhe është i rrënjosur në natyrën e çdo individi. Ky kualitet mund të manifestohet përmes trajnimit. Ndonjëherë mund të ndodhë që ky kualitet i mrekullueshëm të mund të zhduket krejtësisht nga natyra e ndonjë individi. Sikur instinktet tjera që trashëgohen, edhe bazat e këtij instinkti fillojnë të manifestohen gjatë fëmijërisë së hershme dhe nëse nuk kultivohen në mënyrë të duhur, ato mund të mbesin të heshtura apo të tërhiqen plotësisht në vendin e fshehur të mendjes së individit. Është përgjegjësi e prindërve që fëmijët e tyre t'i bëjnë të shoqërueshëm dhe zemërgjerë ndaj qenieve tjera njerëzore. Nëse vetë prindërit

janë zemërgjerë ndaj të tjerëve dhe fëmijët e shohin hijen e zemërgjerësisë në fjalët dhe veprat e tyre, ata mund të pasojnë në mënyrë natyrale rrugën e tyre.

Prindërit e përgjegjshëm dhe të informuar ndonjëherë e përshkruajnë gjendjen e vështirë të njerëzve nevojtarë, të varfërve, invalidëve dhe të vjetërve në prezencën e fëmijëve të tyre. Nëse ka mundësi, ata i çojnë fëmijët e tyre për t'i takuar personat e tillë. Ata u thonë fëmijëve të tyre se këta janë persona të privuar dhe kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmë. Ata u sigurojnë ndihmë personave të tillë në prezencën e fëmijëve, që të bëhet një shembull i mirë për ta, që t'i imitojnë kur të rriten dhe të jenë të aftë për t'i ndihmuar të tjerët. Prindërit ndonjëherë u përshkruajnë fëmijëve tiraninë e padrejtë që bëjnë disa njerëz ndaj personave fatkeqë dhe për kushtet prekëse të të vuajturve të pafat. Ata u flasin fëmijëve të tyre edhe për jetimët që nuk i kanë prindërit që të përkujdesen për ata dhe për atë se personat e tillë meritojnë mbështetjen e plotë prej të tjerëve në shoqëri. Ata i çojnë fëmijët e tyre në jetimore për t'i takuar fëmijët e tillë dhe ndonjëherë i ftojnë edhe në shtëpitë e tyre. E tërë kjo rrugë e gjatë bëhet me qëllim që fëmija t'i kuptojë përgjegjësitë e veta në lidhje me dhënien e ndihmës për ata që kanë nevojë në shoqëri.

Kapitulli i pesëdhjetenjë Drejtësia dhe barazia

Një familje që përbëhet prej disa anëtarëve është një shoqëri e vogël dhe prindërit i drejtojnë çështjet e këtij vendbanimi të vogël. Sikur që udhëheqja e shtetit nuk është e mundur pa drejtësi dhe barazi, ashtu edhe drejtimi i familjes nuk është i mundur pa këta faktorë shoqëruar të ashtuquajtur drejtësi dhe barazi për të gjithë. Dashuria, dhembshuria, vetësakrificimi dhe bashkimi janë të mundur vetëm në një mjedis të drejtësisë dhe të barazisë. Fëmijët do të fitojnë rritjen e duhur në këtë atmosferë. Tiparet e trashëguara të fëmijëve do të vijnë në shprehje dhe ata do të mësojnë të bëhen të drejtë përmes shembujve që i paraqesin prindërit e tyre. Nëse prindërit janë injorantë për nevojën e drejtësisë dhe të respektimit të rregullave, ashtu do të jenë edhe fëmijët.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Sikur që uji i pastër dhe i ftohtë që kërkon njeriu i etshëm, ashtu edhe njerëzit dëshirojnë drejtësinë dhe barazinë dhe shija e tyre është më e ëmbël dhe më e mirë për ata. Nuk ka asgjë më të mirë sesa drejtësia.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 147).

“Tri lloje të njerëzve do të jenë më afër Allahut në Ditën e Gjykimit: Ata që nuk janë të vrazhdë ndaj atyre që janë nën kujdesin e tij gjatë kohës së zemërimit, ata që shkojnë për të ndërmjetësuar në mes të dy palëve që janë në gjyq por nuk veprojnë asgjë në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë, dhe ata që gjithnjë e mbështesin drejtësinë edhe nëse e dëmtojnë vetveten duke e bërë këtë...” (Bihar al-anvar, v. 75, f. 33).

Allahu thotë në Kuran:

“Allahu ju urdhëron për drejtësi dhe paanshmëri.” (Kuran, 16:90).

Prindërit e drejtë i trajtojnë të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë. Ata nuk i japin përparësi të veçantë ndonjë fëmije të caktuar. Qoftë vajzë apo djalë, i bukur apo i shëmtuar, i aftë apo mesatar, prindërit kanë dashuri dhe ndjenja të njëjta për të gjithë. Ata i japin tretman të njëjtë gjithë fëmijëve të tyre.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Mbani drejtësinë për të gjithë fëmijët njëjtë, edhe nëse ndonjëri prej tyre nuk është prezent. Nëse dëshironi t’i trajtoni me drejtësi dhe dashuri të njëjtë të gjithë fëmijët tuaj, atëherë jepuni trajtimin e njëjtë të gjithëve.” (Makarim al ahlak, v. 71, f. 252).

I Dërguari kishte vërejtur një person që ishte i dhënë më shumë mbas një fëmije sesa të tjerët. Ai i tha atij: “Pse nuk e mban në mend nevojën e trajtimit sipas drejtësisë dhe barazisë?” (Makarim al ahlak, v. 11, f. 252).

Një person ishte ulur në shoqëri me të Dërguarin kur arrit djali i tij. Personi e puthi djalin dhe e mori në prehër të tij për t’u ulur. Mbas pak i erdhi edhe vajza dhe ky person e mori të ulet përpara tij. Atëherë i Dërguari e pyeti: “Pse nuk e more në konsideratë nevojën për drejtësi dhe barazi ndërmjet fëmijëve?” (Maxhma al zavaid, v. 8, f. 156).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Shpërndarja e drejtësisë dhe e barazisë në mesin e njerëzve është prej politikave më të mira.” (Gharar al hukm, f. 64).

Një grua erdhi në prezencën e gruas së të Dërguarit, Aishes, bashkë me dy fëmijët e vet. Aisha ia dha tri hurma. Nëna ia dha nga një fëmijëve dhe të tretën e ndau përgjysmë dhe ua dha të dyve. Kur i Dërguari u kthye në shtëpi, Aisha i tregoi për ngjarjen që kishte ndodhur.

I Dërguari tha:

“Pse je çuditur me veprimin e kësaj gruaje? Sepse, për shkak të mbajtjes së drejtësisë dhe të barazisë Allahu, do ta lartësojë gradën e saj në Xhenet.” (Sunan, Ibn Majah, v. 72, f. 1210).

Nëse prindërit i trajtojnë fëmijët e tyre në mënyrë të padrejtë, ata do të formojnë një ndjenjë të dëmshme tek ata:

1. Fëmijët do të pranojnë qëndrimin e padrejtë të prindërve dhe do të sillen në mënyrë të njëjtë me të tjerët. Gjatë kohës, ky qëndrim do të bëhet pjesë e natyrës së tij.

2. Fëmijët që kanë qenë viktimë të padrejtësisë nga prindërit e tyre, do të bartin mllëfin ndaj tyre në mendjet e tyre. Ka mundësi të bëhen të padëgjueshëm dhe të pabindur.

3. Me trajtim të padrejtë dhe të njëanshëm ka gjasa të lajmërohet xhelozia dhe armiqësia në mes të vëllezërve dhe motrave, dhe mund të shkojë deri aty që të dëmtojnë njëri tjetrin.

4. Fëmijët që kanë pranuar trajtimin e padrejtë në duart e prindërve të tyre do të kenë ndjenjat e pikëllimit dhe të shtypjes që do të gdhenden në mendjet e tyre. Është e mundur që më vonë tek ata të paraqitet çrregullimi psikik.

Prindërit do të jenë të përgjegjshëm për të gjitha konsekuencat e trajtimit të padrejtë e të njëanshëm ndaj fëmijëve të tyre.

Ata duhet t'i trajtojnë njëjtë të gjithë fëmijët. Në mosha të ndryshme, fëmijët do të kenë kërkesa të ndryshme. Mbasi që kanë lindur në kohëra të ndryshme dhe janë të gjinive të ndryshme, ata mund të mos kenë gjithmonë kërkesa të njëjta. Edhe ligji i drejtësisë dhe i barazisë nuk është i ashpër në lidhje me trajtimin në rrethana të ndryshme. A do të jetë e drejtë të marrësh fëmijën më të vjetër në prehër, sikur që e merr edhe foshnjën që është ende në djep? Ngjashëm, a do të jetë e drejtë t'i japësh ndonjë sasi të hollave fëmijës së moshës

trevjeçare siç u jep vëllezërve e motrave që janë të moshës tetëmbëdhjetëvjeçare? A mund t'i jepet vajzës liria e njëjtë e lëvizjes siç i jepet djalit të rritur? Drejtësia dhe paanësia nuk zbatojnë ndonjë lëshim të tillë dhe ne gjithashtu nuk rekomandojmë një gjë të tillë?

Prindërit duhet të miratojnë me vëmendje standarde të tilla të drejta të trajtimit të fëmijëve të tyre, që të mos i japin rast paraqitjes së ndjenjës së njëanësisë te ndonjëri prej tyre. Këtë çështje e kemi shqyrtuar më gjerësisht në kapitullin e xhelozisë, ku mund të referoheni.

Një person, në memoaret e tij shkruan:

“Kujtimet e fëmijërisë më janë të hidhura dhe nuk jam në gjendje t'i harroj. Babai kishte zakon të bëjë dallime në mes vëllezërve. Ai pajtohej me të gjitha dëshirat e tyre dhe asnjëherë nuk merrte në konsideratë kërkesat e mi. I trajtonte me respekt vëllezërit e mi ndërsa mua në mënyrë ofenduese. Babai i donte ata më shumë dhe gjithnjë fliste fjalë të ëmbla për ta. Si rezultat i këtij trajtimi, unë fillova të mendoja se babai dhe vëllezërit e mi nuk ishin të mirë. Ndonjëherë, mendoja edhe për hakmarrje ndaj babait për shkak të sjelljes së tij të keqe ndaj meje. Me gjendjen time të brengosur preferoja të qëndroja në vetmi. Fillova të pështyja dhe t'i nxija muret. Për të nxjerrë mërzinë i theyeja xhamat e dritares. Çfarë tjetër zgjidhje kisha? Babai ishte plotësisht i paineresuar për këtë. Ai nuk dinte se shkak i veprave të mia ishte vetëm dëmtimi i interesit të tij.”

Një grua shkruan në ditarin e saj:

“Njëri prej kushërinjve tanë të afërt kishte dy vajza, njëra ishte studente e mirë dhe shumë e zgjuar, ndërsa tjetra ishte mesatare. Të dyja shkonin në shkollën e njëjtë. Vajza më e vjetër, që nuk ishte e zgjuar, merrte zakonisht notat më të ulëta në provime. Vajza më e vogël i kryente me sukses studimet. Nëna e tyre kishte zakon të mburrej me zgjuarsinë e vajzës më të re dhe ta nënçmojë më të vjetrën.

Ajo e lavdëronte së tepërmi vajzën e vogël dhe gjithnjë e kritikonte më të vjetrën, sepse ajo ishte duke i shpenzuar kotë të hollat e shkollimit. Madje, ajo thoshte se edhe shpenzimet për veshmbathje dhe ushqim ishin të kota.

Vajza e vjetër tani është e martuar. Ajo ka disa fëmijë dhe është një shtëpiake e zakonshme. Ajo të jep pamjen e një personi jo të shëndoshë dhe është bërë viktimë e kompleksit të vlerës së ulët. Ajo duket e lodhur dhe e humbur në mendimet e saj. Gjatë gostive ajo shkon në një qoshe dhe nuk bisedon me të tjerët. Kur e nxis të flasë, ajo vetëm më shikon dhe më thotë 'Për çka mund të flas unë?'. Më kujtohet, para martesës së saj e çova te psikiatri. Mbas një sesioni të gjatë, mjeku tha se asaj nuk i mungon asgjë. Në fakt, prindërit e saj janë të sëmurë që nuk e kanë trajtuar mirë dhe e kanë sjellë në këtë gjendje të vështirë.

Njëherë mjeku e pyeti: 'A mund të zieni gjellë?' Ajo filloi të qajë dhe u përgjigj: - 'Po, por sa herë që unë zieja ndonjë gjellë, prindërit më thoshin se motra ime zien më mirë.'"

Kapitulli i pesëdhjetedytë

Respekti ndaj fëmijëve

Edhe fëmija është një qenie njerëzore dhe çdo qenie njerëzore në mënyrë instinktive e do ndonjërin. Ai ka dëshirë që të tjerët ta njohin vlerën e tij dhe ta respektojnë. Kur të tjerët tregojnë respekt, ai ndjen krenari dhe mendon se ai është lavdëruar. Prindërit që i donë fëmijët e tyre, duhet të tregojnë konsideratën dhe respektin e duhur. Tregimi i respektit gjatë formimit të fëmijës konsiderohet si një element shumë i rëndësishëm. Fëmija që pranon respekt dhe vlerësim, do të rritet në një person të matur e të respektuar. Ai gjithnjë mundohet të ruajë besimin e tij dhe do të përmbahet nga të vepruarit keq. Ai mundohet që përmes kryerjes së vepra të mira ta rrisë vlerën e tij te të tjerët. Fëmija që nuk është trajtuar nga ana e prindërve përmes respektit të duhur, mundohet t'i imitojë ata gjatë sjelljes me të tjerët. Fëmija është një njeri në miniaturë dhe si çdo njeri tjetër, edhe ai e do veten. Ai fyhet nëse nuk trajtohet në mënyrë të duhur dhe me respekt. Prindërit që i keqtrajtojnë fëmijët e tyre pa u mërzhitur fare për ndjenjat e tyre të lënduara, krijojnë një inat në mendjet e fëmijëve. Herët apo vonë, fëmijët e tillë do të ashpërsohen dhe do të bëhen kokëfortë të vështirë. Prindërit injorantë, numri i të cilëve fatkeqësisht nuk është i vogël, konsiderojnë se trajtimi i fëmijëve me respekt i prish ata. Ata marrin një qëndrim të ftohtë, shpërfillës dhe të pavlerë kundrejt fëmijëve të tyre. Në këtë mënyrë ata e thyejnë personalitetin e fëmijës dhe i japin rast kompleksit të vlerës së ulët që paraqitet në mendjet e tyre të ndjeshme. Sipas pikëpamjes së edukimit të mirë, ky qëndrim i prindërve dëshmohej si një pengesë e madhe. Nëse prindërit i trajtojnë fëmijët e tyre me respekt, atëherë fëmijët do të mundohen të bëjnë të njëjtën. Fëmija do të kuptojë prej asaj

moshe të ndjeshme se prindërit e trajtojnë në mënyrë njerëzore dhe se ia kushtojnë rëndësi. Prandaj, ai do të heqë dorë nga ndonjë veprim që nuk konsiderohet i mirë në shoqëri.

Ai do të mundohet të bëjë vepra të mira dhe ta ruajë trajtimin e respektuar që e ka pranuar prej prindërve. Është çështje brengosëse se në shoqërinë tonë fëmijët nuk trajtohen me respekt. Ata nuk trajtohen si anëtarë të familjes përderisa të rriten. Gjatë gostive dhe festimeve zakonisht ata nuk thirren dhe shkojnë bashkë me prindërit si shtojcë. Zakonisht rrinë në një qoshe të parëndësishme. Gjatë mbërritjes dhe shkuarjes në gosti atyre nuk u kushtohet vëmendja. Në automobil nuk kanë ndonjë vend të veçantë. Ose qëndrojnë në këmbë ose në prehër të babait. Atyre nuk u lejohet të flasin nëpër gosti. Edhe nëse marrin guximin të flasin, atyre nuk u kushtohet vëmendje prej më të vjetërve. Nëse ndonjëherë edhe i thërrasin, e bëjnë në mënyrë të pahijshme.

Islami i kushton tërë kujdesin nevojës së tregimit të respektit ndaj fëmijëve. I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Respektojini fëmijët tuaj dhe jepuni rritjen e mirë, që Allahu t’ju shpërblejë.”

Aliu, Urdhëruesi i besimtarëve, thotë:

“Personi më i keq është ai që nuk tregon respekt ndaj të tjerëve” (Bihar al-anvar, v. 14, f. 45).

I Dërguari, gjithmonë dhe në çdo vend ka pasur zakon t’i trajtojë fëmijët me respekt dhe dhembshuri. Sa herë që kthehej prej rrugës, fëmijët vraponin për t’u takuar. Ai i puthte dhe i ledhatonte. Disa fëmijë hipnin bashkë me të në kalë. Ai kërkonte nga shokët e tij që edhe ata t’i merrnin fëmijët e tyre dhe t’u hipnin kuajve. Në këtë mënyrë hynte kah porta e qytetit.

Është i ndaluar ofendimi i fëmijëve, qofshin ata edhe foshnja. Um al Fazli thotë:

“Kur Imam Hysejmi ishte foshnje, i Dërguari e mori një ditë e përqafoi, me ç’rast foshnja urinoi në rrobat e tij. Për një moment, shpejtova dhe e mora Hysejmin nga duart e të Dërguarit, me ç’rast foshnja filloi të qajë. I Dërguari më tha: ‘Um al Fazl, qetësohu. Uji i pastron rrobat e mia por kush do ta largojë pakënaqësinë e fëmijës?’ (Hadiya al ahabab, f. 176).

Një zotëri shkruan:

“Unë nuk u kam kushtuar rëndësi prindërve të mi. Jo vetëm që ata nuk më kanë respektuar, por ata gjithnjë më kanë ofenduar dhe qortuar. Asnjëherë nuk lejonin të punoja ndonjë punë. Ata kishin zakon të më ofendonin në prezencën e shokëve të mi. Asnjëherë nuk më lejonin të flas diçka kur të tjerët ishin të pranishëm. Të gjitha këto më kanë bërë të kem ndjenjën e kompleksit të ulët dhe të turpërohem nga vetvetja. Fillova ta konsideroja veten si një person të padobishëm. Tani që jam i rritur vazhdoj që të punoj nën ndjenjat e njëjta të pikëllimit. Nëse përballem me ndonjë detyrë të vështirë, e ndjej veten të paaftë për ta kryer atë. E ndjej që, për shkak të asaj që jam i paaftë të mos kem mendimin tim në lidhje me aftësinë time, të tjerët duhet të kenë mendimin e tyre për mua. E konsideroj veten të parëndësishëm dhe plotësisht të paaftë. Nuk kam fare besim në vetvete. Kur duhet të flas në praninë e të tjerëve, e ndjej veten të humbur. Nëse flas ndonjë fjalë në situata të tilla, mendohem me orë të tëra për atë se a kisha të drejtë apo jo.”

Kapitulli i pesëdhjetetretë

Vetëvlerësimi dhe ekzistenca e kuptimtë

Tërë jeta e shtazëve kalon në ngrënie, fjetje dhe shumim. Inteligjenca dhe njohuria e shtazëve është e papërkryer. Ato nuk janë të afta të dallojnë të mirën prej të keqes. Prandaj, ato nuk kanë kurrfarë përgjegjësia që u është imponuar atyre. Ato nuk do të thirren për të dhënë llogari për veprat e tyre. Nuk ka ndonjë përgjegjësi të parapërgatitur për ato. Por, njeriu që është më i miri ndër krijesat e Allahut, nuk është sikur kafsha. Njeriu ka maturi dhe aftësi. Ai mund të dallojë ndërmjet të mirës e të keqes dhe të bukurës e të shëmtuarës. Njeriu është krijuar për një ekzistencë të përhershme e të vazhdueshme dhe jo për zhdukje. Prandaj, ai e bart përgjegjësinë e madhe për detyrat që i janë parapërgatitur atij. Njeriu është mëkëmbësi dhe i besuari i Allahut në këtë botë. Qëllimi i njeriut në këtë botë nuk është vetëm ngrënia, fjetja, kënaqja e dëshirave dhe shumimi. Por, njeriu duhet të ecë në një rrugë të tillë, që ta dëshmojë veten se është më i lartë sesa engjëjt. Ai është qenie njerëzore dhe ai duhet të përpiqet ta lartësojë njerëzimin e tij. Njeriu duhet të ketë një qëllim në jetën e tij. Qëllimi i tij duhet të jetë ideal. Njeriu përpiqet në çështjet e Allahut dhe t'u shërbejë krijesave të Tij, dhe jo vetëm për t'i arritur lartësitë e kësaj bote. Njeriu duhet të kërkojë të Vërtetën dhe ta pasojë të Vërtetën.

Po, ekzistenca njerëzore është sikur një gur i çmuar që është shumë më i lartësuar sesa të gjitha kafshët. Është turp që shumë njerëz e kanë shkapërderdhur vlerën e tyre të paçmueshme. Ata e kalojnë jetën e tyre tërësisht njëjtë sikur kafshët. Sipas tyre ngrënia, pirja, fjetja, plotësimi i dëshirave materiale, janë qëllimet e vetme të jetës së tyre. Është e mundur që një njeri të jetojë me qindra vite pa e kuptuar veten dhe të vdesë në paditurinë e plotë. Ai vjen në

këtë botë si kafshë dhe do të vdesë si kafshë. Ai do të mbetet i paqëllim dhe bredhës gjatë tërë jetës së tij. Rezultati i tërë kësaj përpjekjeje do të jetë një asgjë.

Njeriu duhet ta njohë veten. Kush është ai? Prej nga vjen? Ku do të shkojë? Cili është qëllimi i lindjes së tij? Çfarë rruge duhet që të kalojë? Çka është qëllimi i vërtetë dhe çka është e mbarë për të?

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Ndriçimi më i mirë i mendjes është që njeriu ta njohë veten, dhe padituria më e madhe është kur personi nuk e njeh vetveten.” (Gharar al hukm, f. 179).

“Njëri që nuk e njeh vetveten, ka devijuar prej rrugës së shpëtimit dhe e ka marrë rrugën e paditurisë e të paqëllimtës.” (Gharar al hukm, f. 77).

“Njeriu më i neveritshëm për Allahun është njëri që ngrëniën, pirjen dhe kënaqjen e dëshirave materiale i konsideron si qëllime të vetme të jetës.” (Gharar al hukm, f. 205).

“Njëri që si qëllim të jetës së tij e ka bërë shpëtimin në Ditën e Gjykimit, do ta arrijë atë.” (Gharar al hukm, f. 693).

Prindërit duhet t’u japin fëmijëve të tyre mësimë për vetë-vlerësimin dhe qëllimin e ekzistencës. Në mënyrë progresive, ata mund të japin karakterin e qëllimit të jetës së fëmijëve. Fëmija, me ndihmën e prindërve, duhet të ndihmohet që ta njohë vetveten. Prej nga ka ardhur? Çka është qëllimi i ekzistencës së tij? Ku do të shkojë përfundimisht? Cilët janë përgjegjësitë dhe detyrat e tij në këtë botë? Me cilin program dhe qëllim duhet ta jetojë jetën e tij? Nëse prindërit e njohin veten dhe e kanë qëllimin përfundimtar në jetën e tyre, atëherë ata do të jenë në gjendje t’i udhëzojnë fëmijët e tyre në rrugën e dëshiruar.

Kapitulli i pesëdhjetekatërtë

Të hyrat dhe shpenzimet e shtëpisë

Në menaxhimin e shtëpisë, aspekti më vital është kontrollimi i kuletës. Çdo shtëpiak i arsyeshëm do të mbajë llogarinë e të hyrave të rregullta dhe të shpenzimeve. Sikur që është thënë, “këmbët zgjati sa e ke jorganin!” Ata përpiqen të harxhojnë në përputhje me vlerën e parave që hyjnë në llogarinë e familjes. Çdo familje duhet të dijë prioritetet e tij dhe të ndajë para për lloje të ndryshme të shpenzimeve gjatë muajit. Familjarët e kujdesshëm gjithnjë mundohen të mos hyjnë në borxh. Në këtë mënyrë do t'i evitojnë brengat e panevojshme që u vijnë në rrugë. Edhe nëse kushtet e tyre ekonomike nuk janë të mira gjatë kohës, ata planifikojnë dhe i tejkalojnë këto vështirësi për ndonjë kohë. Ata e shmangin veten prej statusit të të varfrit përmes menaxhimit të resurseve të kufizuara.

Në të kundërtën e kësaj, disa familje që janë të pakujdesshme në lidhje me menaxhimin e mirë të shpenzimeve të tyre, që janë dorëshpuar dhe që vazhdojnë të jetojnë sipas mënyrës së tyre, bien në shprehinë e huazimit të pandreqshëm. Për të paguar faturat e tyre, ata janë të detyruar të hyjnë edhe në borxhe me kamata të mëdha. Mbas që janë huazues të pandreqshëm, ata nuk ia vënë vëmendjen blerjes së gjërave të shtrenjta me kredit. Familjet e tilla asnjëherë nuk lirohen prej brengave. Ata vijnë në një ngushticë që ndonjëherë nuk janë në gjendje të blejnë gjërat më elementare ditore të jetës. Gjëra të tilla u ndodhin edhe familjeve që të hyrat i kanë mjaft të arsyeshme. Ata do të jenë në rrethanat e kufizuara për shkak se nuk e kanë planin e duhur për shpenzimet. Këta njerëz janë viktimat e shkëlqimit dhe dukjes së rreme. Mirëqenia e familjes varet jo vetëm nga fitimet apo nga

sjelljet e ndonjë shume të parave në shtëpi, por kërkon edhe përmbledhjen e duhur dhe kontrollin e shpenzimeve.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Kur Allahu dëshiron që një familje të përparojë, atëherë Ai ia jep aftësinë e urtësisë dhe të rregullit në jetë.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 88).

“E tërë epërsia është përfshirë në tri gjëra, ku njëra prej tyre është: të kuptuarit dhe matura e menaxhimit të financave të tyre.” (Usul al-Kafi, v. 5, f. 87).

“Teprimi gjatë shpenzimeve është shkaku i varfërisë dhe i mjerimit, dhe përmbajtja në jetë siguron kënaqësi dhe komfor. (Vasail al-shiah, v. 12, f. 41).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Përmes kursimit mund të tejkalohet gjysma e nevojave.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 424).

“Personi që shpenzon shumë i ka tri shenja: 1. Ai dëshiron të hajë atë çka nuk ka; 2. Ai i blen gjërat për të cilët nuk ka para; 3. Ai i bart rrobat të cilat nuk është në gjendje t'i blejë. (Vasail al-shiah, v. 21, f. 41).

Në përcaktimin e çështjeve financiare të familjes me rëndësi thelbësore është që burri dhe gruaja të kenë pikëpamjet e ngjashme. Nëse burri apo gruaja shpenzon pa i pasur ndërmend prioritetet, atëherë menaxhimi i shtëpisë do të shkojë në mënyrë të çoroditur.

Së dyti, edhe fëmija duhet të ketë mirëkuptim për nevojat dhe prioritetet. Nëse fëmija bëhet ndër ata që shpenzojnë shumë, dhe prindërit, për shkak të dashurisë së tyre, ia plotësojnë teket e tij dhe e lejojnë të argëtohet, familja mund të hasë në ndonjë problem financiar.

Prindërit duhet ta informojnë fëmijën për gjendjen financiare të familjes dhe të diskutojnë për buxhetin në prezencën e tij. Kjo do të bëjë që fëmija të kuptojë rëndësinë e kursimit. Ata duhet të dinë se menaxhimi i shtëpisë nuk është një shtrat prej trëndafilave.

Është esenciale se gjatë etapave fëmijët duhet të njihen me punët e përditshme shtëpiake dhe me të hyrat e familjes. Ata duhet të dinë se shtëpia mirëmbahet prej të hyrave të prindërve dhe se përveç tyre nuk kanë mjete tjera. Ata duhet të kuptojnë se të gjitha nevojat e shtëpisë duhet të plotësohen vetëm prej atyre të hollave. Atyre duhet t'u thuhet se disa shpenzime kanë prioritet ndaj shpenzimeve tjera si p.sh. qiraja e shtëpisë, faturat e rrymës, ujit, etj. Në radhë të parë duhet të mbulohen shpenzimet e gjërave elementare dhe pastaj pasojnë kërkesat tjera. Fëmijët duhet të kuptojnë dhe ta zgjerojnë kooperimin e tyre me prindërit në lidhje me këtë çështje.

Që nga fëmijëria e hershme, fëmijët duhet të mësohen që t'i përputhin nevojat dhe kërkesat e tyre me mjetet e familjes. Ata duhet të ndalohen prej shpenzimeve të panevojshme dhe blerjeve të pamenduara. Duhet të njoftohen me shprehinë e kursimit dhe duhet ta konsiderojnë veten si anëtarë të familjes dhe duhet të shpenzojnë brenda mundësive materiale të familjes. Ata nuk duhet të fitojnë mendimin se ata janë prej familjes së pasur dhe se ata mund të shpenzojnë sado që donë ata. Duhet të mësohen t'i kontrollojnë dëshirat e tyre në interes të shpenzimeve esenciale të familjes që nuk mund të mënjahen apo të shtyhen.

Kur të rriten, këta fëmijë do t'i kenë në duart e tyre frerët e shoqërisë. Prandaj, ata duhet të përgatiten për shprehinë e kursimit që prej fëmijërisë së hershme. Sado që të jetë e lehtësuar pozita financiare e prindërve, fëmijët duhet të mësohen për të harxhuar para me vëmendje dhe me maturi. Ata duhet t'u shpjegojnë fëmijëve se të gjithë njerëzit i takojnë një familjeje të madhe të qenieve njerëzore. Prandaj, të fatlumët që janë të pasur duhet që t'u ndihmojnë të varfërve. Nëse të hyrat e familjes janë të pamjaftueshme, ata duhet t'i shkurtojnë shpenzimet e tyre

ditore dhe të mundohen t'i mbulojnë kërkesat e tyre brenda burimeve të tyre të dobëta. Prindërit nuk duhet t'u ankohen fëmijëve të tyre në lidhje me ngushticat financiare në të cilën ndodhen. Në vend të kësaj duhet të japin mësim në lidhje me durimin dhe besimin në Allahun. Përgatitni ata që të përballen me goditjet e jetës së tyre të moshës madhore me kurajë dhe gjakftohtësi. Kur një fëmijë është i aftë për të punuar, nxiteni në punë dhe mbështeteni moralisht. Duhet t'i thuhet fëmijës se nëse fillon të punojë, paga e tij do t'i plotësojë të ardhurat e familjes dhe do të kenë më shumë rehati. Fëmija duhet të inkurajohet të japë një pjesë të fitimit të tij për shpenzimet e shtëpisë. Në këtë mënyrë, tek ai do të rritet vlera e përgjegjësisë së tij ndaj familjes. Anëtar i ri i familjes me rrogë duhet të ndajë para prej pagës së tij, duke i pasur ndërmend shpenzimet dhe kërkesat e shtëpisë.

Kapitulli i pesëdhjetepesë

Respekti për ligjin

Në shoqërinë e civilizuar, njerëzit nuk mund të jetojnë pa ligje. Aty ku mbisundon ligji i xhunglës, aty nuk ka shoqëri të civilizuar. Për udhëheqjen e mirë të administratës shoqërore, të rëndësisë esenciale janë ligjet e përcaktuara në mënyrë të drejtë. Këto ligje shërbejnë për mirëmbajtjen e rendit dhe për të siguruar ndëshkimin e merituar dhe adekuat për fajtorët. Për rehatinë dhe sigurinë e popullatës, ligjet janë plotësisht të nevojshme. Në vendet ku ka mirëkuptim në mes të njerëzve dhe ligjvënësve, ligjet nxirren për leverdinë e njerëzve, prandaj edhe ata i respektojnë këto ligje. Në një shtet mund të ketë mbarëvajtje të përgjithshme nëse populli i atij vendi i nënshtrohet ligjit.

Në vendet ku ligjvënësit punojnë me motive të fshehta egoiste dhe gjatë formimit të ligjit nuk e kanë ndërmend mirëvajtjen e njerëzve, aty njerëzit nuk e nderojnë ligjin dhe në atë shoqëri paraqiten pakënaqësitë. Fatkeqësisht, shteti ynë ishte përballur më herët me një situatë të ngjashme (është fjala për regjimin e Shahut në Iran). Shumica e ligjeve nuk ishin as Islame as për të mirën e njerëzve. Ligjet formuloheshin duke pasur ndërmend rrethin udhëheqës dhe dëshirat e imperialistëve e të kukullave të tyre. Asnjë vëmendje nuk i ishte kushtuar telasheve të punëtorëve dhe popullatës së paprivilegjuar. Ligjvënësit janë munduar ta mashtrojnë dhe ta nënshtrojnë popullin me ligjet shtypëse dhe tiranike. Por, mbasi që populli i Iranit kuptoi se ato ligje joislame ishin kundër interesave të tyre, ata nuk kishin kurrfarë respekti për to. Sidoqoftë, ekzistonin edhe disa ligje që ishin për të mirën e popullit. Por, mbasi që sistemi legal ishte tërësisht antinjerëzor, populli e refuzoi tërë sistemin.

Respekti për ligjet legjitime dhe për të mirën e popullit është esencial dhe prindërit duhet t'ua shpjegojnë fëmijëve këto. Kur fëmija vëren se prindërit e kalojnë rrugën vetëm prej vendkalimit të këmbësorëve, ai do të kuptojë se edhe ai duhet ta bëjë të njëjtën. Ai do të pranojë shprehinë e ndjekjes së ligjeve të sigurisë dhe asnjëherë të mos i shkelë ato.

Prindërit duhet t'ua tregojnë fëmijëve se automobilat dhe mjetet tjera lëvizëse e kanë të drejtën e lëvizjes nëpër rrugë dhe këmbësorët mund të shfrytëzojnë vetëm kalimin e këmbësorëve kur dëshirojnë të kalojnë në anën tjetër të rrugës. Këmbësorët që e anashkalojnë këtë rregull bëjnë kundërvajtje dhe i janë të ekspozuar rrezikut të fatkeqësisë. Kur fëmija të kuptojë përparësinë e veprimt në përputhje me ligjin, ai do të bëhet një qytetar i mirë.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Shprehitë janë natyra e dytë e njeriut” (Gharar al hukm, f. 26).

Kapitulli i pesëdhjetegjashtë Sjellja dhe respekti

Gjithmonë, dëshira e prindërve është që fëmijët e tyre të jenë të sjellshëm. Fëmijët e mirë dhe të edukuar janë burimi i krenarisë për çdo prind. Fëmijët e sjellshëm i përshëndesin bukur personat që i vizitojnë, ia japin dorën, pyesin për shëndetin e tyre, bisedojnë butë, e kufizojnë bisedën në atë çka është e lejuar për ata që të pyesin dhe e shqiptojnë lamtumirën e bukur kur të dalin prej shtëpisë së mikpritësit. Fëmijët e tillë e shfaqin respektin e duhur ndaj të vjetërve, kur të hyjnë më të vjetrit ata ngrihen sjellshëm në këmbë, tregojnë respekt ndaj dijetarëve, figurave religjioze dhe në përgjithësi i respektojnë besimtarët dhe personat e mirë. Gjatë takimeve rrinë të qetë dhe nuk shtrihen, nuk flasin me zë të lartë, i falënderojnë personat që u japin ndonjë gjë, nuk ia ndërpresin fjalën të tjerëve, posaçërisht më të vjetërve. Ata thonë Bismilahun para se të fillojnë të hanë, marrin kafshata të vogla gjatë ngrënies, nuk hanë tepër, nuk gjuajnë ushqimin në tavolinë apo dysheme dhe i përcjellin të gjitha rregullat e duhura të mirësjelljes gjatë ngrënies. Ata kujdesen për rrobat e tyre që të mos njollozen dhe mundohen të mbeten të pastër e të rregullt. Ata do të kenë konsideratë për të tjerët dhe nuk do t'i lëndojnë ndjenjat e të tjerëve. Ata ecin me një ecje të përmbajtur dhe japin përshtypjen e fëmijëve të dëgjueshëm. Ata nuk i përqeshin të tjerët me shaka në kurriz të dikujt tjetër kur ndonjëri të flasë për ata. Ata dëgjojnë me një vëmendje të përqendruar.

Fëmijët e sjellshëm nuk i pëlqejnë vetëm prindërit, por ata janë të dashur edhe prej të gjithëve me të cilët takohen. Fëmijët e pasjellshëm e të paturpshëm janë të urryer nga të gjithë.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Respekti është maja e humanitetit.” (Gharar al hukm, f. 34).

“Respekti (mirësjellja) te njeriu është sikur veshja e bukur” (Gharar al hukm, f. 21).

“Mirësjellja kërkohet nga njerëzit më shumë se ari apo argjendi.” (Gharar al hukm, f. 242).

“Nuk ka stoli më të bukur për njeriun sesa mirësjellja.” (Gharar al hukm, f. 830).

“Trashëgimia më e mirë që mund t’ia lërë një baba djalit të tij është mirësjellja.” (Gharar al hukm, f. 293).

“Një person i pasjellshëm do të ketë më shumë dështime.” (Gharar al hukm, f. 634).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Lejoni që fëmijët tuaj të luajnë deri në moshën shtatëvjeçare, pastaj mësojani mirësjelljen dhe edukatën.” (Bihar al-anvar, v. 104, f. 95).

Profeti i Shenjtë i Islamit, ka thënë:

“Babai ka tri të drejta ndaj fëmijëve të vet: Ai ia zgjedh një emër të mirë për të, ia jep mirësjelljen (edukatën) dhe ia gjen një bashkëshort/e të mirë.” (Vasail al-shiah, v. 15, f. 123).

Shpresa më e dashur e çdo prindi është që fëmijët e tyre të rriten në persona të sjellshëm e të respektuar. Por, shpresa e tij nuk mund të plotësohet pa përpjekje të sinqerta e të vazhdueshme. Nuk do të jetë e mundshme të injektohet ky tipar te fëmija përmes predikimit. Rruga më e mirë për këtë është vendosja e një shembulli ideal përpara fëmijës nga ana e prindërve me sjellje shembullore në jetën e tyre të përditshme.

Ali ka thënë:

“Sjellja më e mirë është ajo të cilën vetë filloni ta praktikoni.” (Gharar al hukm, f. 191).

“Filloni t’i jepni udhëzime vetes dhe pastaj i mësoni të tjerët. Së pari formoni karakterin tuaj të përkryer dhe

pastaj predikoni dhe këshilloni të tjerët.” (Nehxh ul belaga, v3, f. 166).

Fëmijët janë imitues natyralë. Aftësia e tyre kopjuese është shumë e fortë në natyrën e tyre. Fëmijët i imitojnë mënyrat e prindërve dhe të tjerëve përreth tyre. Ai do të flasë sikur ata dhe do të mundohet të ecë sikur ata. Sigurisht që instruksioni është një aspekt shumë i rëndësishëm i trajnimit, por nuk është aq i fortë sikur aftësia imituese dhe e mësimit, posaçërisht në fazat e hershme të fëmijërisë. Prindërit që janë të vendosur se fëmijët e tyre duhet të jenë të sjellshëm e të edukuar, duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë trajnimit të tyre përmes shembujve personalë. Nëse prindërit janë të sjellshëm ndaj njëri tjetrit, natyrisht që edhe fëmijët do ta ndjekin këtë.

Prindërve që u mungon mirësjellja dhe edukimi nuk duhet të presin mirësjellje prej fëmijëve. Ata mund t'i mësojnë fëmijët e tyre njëqind herë për normat e mirësjelljes dhe të edukatës, por fëmijët do të sillen nën përvojën e qëndrimit të prindërve dhe të tjerëve në shtëpi. Nëse prindërit janë të pasjellshëm dhe fyes ndaj njëri tjetrit, ata do t'u japin një shembull negativ fëmijëve të tyre që janë duke u rritur.

Fëmijët e shtëpive të tilla do të sillen keq si edhe prindërit e tyre, apo ndoshta edhe më keq. Çdo përpjekje për t'i korrigjuar ata do të hasë në vesh të shurdhët. Natyrisht, ata do të mendojnë se prindërit e tyre kërkojnë prej tyre të sillen sipas asaj që vetë e praktikojnë.

Gjithmonë shembulli është më i mirë se këshilla. Por, nuk është e drejtë të mendohet se këshillimi do të jetë plotësisht i paefektshëm. Prindërit e mirë që i vendosin shembujt e mirë përpara fëmijëve të tyre mund të flasin gjithnjë për normat e sjelljes së mirë dhe fëmijët e tillë pa dyshim që do t'i pranojnë këshillat e tyre. Edhe këshilla duhet që të jepet në mënyrë të sjellshme. Ekzistojnë prindër

që e shprehin zemërimin e tyre në mënyrë të vrazhdë kur të vërejnë se fëmijët e tyre janë duke bërë diçka gabimisht. Ndonjëherë mund të thonë: "Ti çapkën, pse nuk i mirëprite mysafirët? Pse nuk u the atyre mirëdita? A je memec? Fëmijë i pasjellshëm dhe torollak, pse i ke shtrirë këmbët përpara mysafirëve më të vjetër? Pse s'ke qenë i urtë kur ishin këtu mysafirët dhe shokët e tu? O hajvan, pse po ndërhysh në bisedë?"

Këta prindër të padijshëm mendojnë se janë duke e korrigjuar fëmijën e tyre me biseda të tilla. Ata nuk e dinë se sjelljet e mira nuk mësohen përmes sjelljeve të këqija. Nëse fëmija është fajtor për ndonjë pamatur, ai duhet të paralajmërohet në mënyrë të sjellshme. Në situata të tilla nuk duhet të jenë prezentë të tjerët dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë të qetë dhe shoqërore.

I Dërguari i Islamit kishte zakon t'i përshëndeste fëmijët dhe të thoshte: "I përshëndes fëmijët, që përshëndetja të bëhet shprehi e tyre."

Kapitulli i pesëdhjeteshtatë

Vjedhja dhe kleptomania

Shpesh ndodh që fëmija t'i zgjasë duart të marrë diçka që nuk i takon atij. Ai mundohet shumë për t'i marrë gjërat ushqimore, pemët apo lodrat e fëmijëve tjerë. Vjedhurazi merr diçka prej xhepit të babait apo kuletës së nënës. I merr ëmbëlsirat dhe gjërat tjera nga dollapi pa diturinë e nënës. I merr gjërat vjedhurazi prej dyqaneve në të cilat shkon me prindërit. I merr lapsat, gomat etj. të motrave dhe të vëllezërve dhe shoqeve të klasës pa i informuar ata. Disa fëmijë i bëjnë këto gjëra gjatë fëmijërisë së tyre. Rrallë mund të gjenden fëmijë që nuk e kanë bërë këtë asnjëherë gjatë fëmijërisë së tyre. Disa prindër brengosen shumë kur i shohin se fëmijët e tyre bëjnë gjëra të tilla dhe fillojnë të imagjinojnë të ardhmen e zezë për fëmijët e tyre. Ata mendojnë se fëmijët e tyre mund të shndërrohen në vjedhës apo hajdutë kur të rriten. Me këtë brejtje të ndërjegjes ata vazhdojnë të brengosen.

Së pari, prindërit e tillë duhet të kushtojnë vëmendjen për faktin se ata nuk duhet të brengosen aq shumë dhe të ndjejnë keqardhje për shmangiet e vogla të fëmijët. Vjedhja e gjërave të vogla nga ana e fëmijëve nuk është shenjë se fëmija do të bëhet një vjedhës në të ardhmen. Ata duhet të dinë se fëmija nuk e ka arritur ende fazën t'i vlerësojë të drejtat e pronës së të tjerëve, apo të dallojë në mes asaj se çka u takon të tjerëve dhe çka atij. Fëmija i ka ndjenjat delikate të forta dhe kërcen të rrëmbejë çfarëdo që e tërheq vëmendjen e tij. Fëmija nuk do të bëhet i pabindur nga natyra por ky qëndrim vjen tek ai nga ndikimi i jashtëm. Këto janë fenomenet kalimtare të jetës së tij të hershme. Kur të rritet mund të mos i veprojë ato gjëra. Sigurisht që ka persona besimtarë e të drejtë që kanë kryer vjedhje të paqëllimta në fëmijërinë e tyre. Por, qëllimi i

krejt kësaj që jemi duke treguar nuk është për të thënë se prindërit duhet të injorojnë plotësisht reaksionin ndaj akteve të tilla të fëmijëve të tyre. Unë vetëm dua të largoj frikën se fëmijët e tyre mund të bëhen vjedhës. Në vend se të ndjehen keq në raste të tilla, ata duhet të mundohen në mënyrë të matur që t'i korrigjojnë fëmijët e tyre.

Fëmija i moshës dyvjeçare në veçanti nuk është në gjendje të dallojë se çka i takon atij dhe çka jo. Çfarëdo që i vjen te dora, ai mundohet ta kapë. Çfarëdo që e tërheq atë, ai dëshiron ta ketë. Në këtë fazë, bërthitja dhe rrahja nuk do të kenë asnjë efekt. Qëndrimi më i mirë i prindërve do të ishte të ndalojnë praktikisht që të mos i bëjnë gjërat e tilla nëse ndodhin në prezencën e tyre. Nëse fëmija mundohet të kapë diçka prej fëmijës tjetër, ata duhet të intervenojnë butësisht. Dhe, përkundër gjithë kësaj, nëse fëmija prapë i merr gjërat nga fëmijët tjerë, prindërit duhet t'ia kthejnë pronarit të vërtetë sa më parë. Ato gjëra që dëshirojnë të rrinë larg prej duarve të fëmijëve, duhet t'i mbajnë në vende ku nuk t'i mbërrijnë ato. Kur fëmijët të arrijnë nivelin e caktuar të inteligjencës, ata do të fillojnë të kuptojnë për të drejtën e pronës së të tjerëve. Tanimë nuk do të provojnë për të rrëmbyer gjërat tjera. Sidoqoftë, disa fëmijë e vazhdojnë shprehinë e vjedhjes edhe kur të arrijnë idenë e pronësisë së gjërave. Në situata të tilla prindërit nuk duhet të rrinë sikur shikuesit e pazëshëm. Tani nuk duhet të mendojnë se fëmija do t'i ngrij duart në mënyrë automatike prej kësaj shprehie. Ai mund të shndërrohet në një vjedhës, apo së paku në një kleptoman, që i merr gjërat e të tjerëve vetëm për dreqësi, duke mos ditur se çka është duke bërë. Nuk është e drejtë të injorohet diçka edhe nëse fëmija vjedh diçka që u takon prindërve të tij. Disa prindër i mbrojnë aq shumë fëmijët e tyre sa që nëse ndonjëri tregon se fëmijët e tyre kanë vjedhur diçka të tyre, ata do të fillojnë t'i

mbrojnë padrejtësisht fëmijët e tyre dhe do të fillojnë t'i fajësojnë personat e tjerë me akuza të rreme.

Personat e tillë injorantë, me qëndrimin e tyre negativ, padashur e inkurajojnë fëmijën të vazhdojë zhurmshëm aktivitetin e tij të vjedhjes. Fëmija do të mësojë të vjedhë dhe të mohojë atë që e ka bërë.

Prandaj, prindërit nuk duhet të rrinë të qetë kur të përballen me situata të tilla. Ata duhet të përpiqen të ndalojnë fëmijën prej vjedhjes dhe gënimit. Aty mund të ekzistojë rreziku i rrënjosjes së shprehisë së keqe në natyrën e tij dhe të vështirësohet formësimi i fëmijës.

Aliu, ka thënë:

“Heqja dorë prej shprehive është shumë vështirë.”
(Gharar al hukm, f. 181).

Së pari, prindërit duhet të mundohen t'i largojnë shkaqet e fëmijës që e nxisin të vjedhin. Nëse fëmija kërkon laps, fletë apo gomë, prindërit duhet ta plotësojnë kërkesën e tij. Nëse e neglizhojnë këtë kërkesë të fëmijës, ka gjasa që ai t'i marrë këto gjëra prej shokëve të klasës. Ai mund të marrë para edhe prej xhepit të babait për t'i blerë këto gjëra. Nëse fëmija kërkon një top për të luajtur dhe prindërit refuzojnë t'ia blejnë atë, ai mund ta marrë me forcë topin nga shokët e tij. Apo, ndoshta mund edhe ta vjedhë ndonjë top prej shitores së fqinjit. Prindërit duhet të kujdesen për t'i plotësuar kërkesat e fëmijëve deri sa kanë mundësi. Nëse ndonjë gjë që kërkon është jashtë mundësive të tyre, atëherë ata duhet t'ia shpjegojnë këtë fëmijës në mënyrë të dashur. P.sh ata mund të thonë se për momentin nuk kanë aq shumë para për t'ia blerë atë kuti të lapsave me ngjyra që e ka kërkuar. Ai mund ta huazojë këtë kuti nga ndonjë shok sa për të kryer detyrat e tij të shtëpisë dhe më vonë do t'ia blejnë një të tillë. Qëndrimi i vrazhdë ndaj fëmijëve mund të inkurajohen të vjedhin. Nëse prindërit i mbajnë gjërat ushqimore të mbyllura në dollapin

e ushqimit, fëmija do të planifikojë të arrijë ndonjë mënyrë deri te gjërat ushqimore. Kjo gjë mund të ndodhë në situatën kur prindërit dëshirojnë t'i hanë gjërat ushqimore vetë dhe të mos ua lejojnë të njëjtat fëmijëve të tyre.

Kur prindërit i fshehin paratë prej fëmijëve, fëmija mund të fitojë prirjen për t'i gjetur ato. Është më mirë që prindërit të mos i fshehin aq shumë paratë e tyre prej fëmijëve. Ata duhet t'i mbajnë fëmijët e tyre në besim dhe nuk duhet të japin ndjenjën se gjërat janë duke u fshehur prej tyre. Ata duhet t'i mësojnë fëmijët se jeta duhet të ketë një rregull. Paraja shërben për blerjen e gjërave të domosdoshme dhe nuk duhet të shpenzohet në mënyrë të shkujdesur.

Fëmijëve nuk duhet lejuar t'i shikojnë filmat me tematikë të vjedhjes, grabitjes e të krimit. Edhe librat dhe radio-programet në lidhje me këto tema duhet të anashkalohen. Ka shumë shembuj kur të rinjtë e zënë për krime, kanë pranuar se inspirimin për vepra të tilla e kanë marrë nga filmat e tillë.

Gjëja më e rëndësishme është që prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes të mundohen që mjedisi i shtëpisë të jetë mjedisi i sinqeritetit dhe i ndershmërisë, ku respektohet e drejta e pronës për gjërat e të tjerëve. Askush nuk i merr paratë nga xhepat e prindërve dhe gjërat nuk huazohen pa njohurinë e pronarit. Edhe burri nuk duhet ta kërkojë gardërobën e gruas pa qenë ajo e informuar. Prindërit duhet të respektojnë të drejtën e pronës së fëmijëve të tyre dhe nuk duhet t'i përdorin gjërat pa dijen e tyre.

Prindërit nuk duhet t'i ofendojnë fëmijët e tyre për shkak të keqbërjeve të vogla. Ata nuk duhet t'i bërtasin atij dhe ta quajnë me emrat si vjedhës apo hajdut. Nuk duhet ta kërcënojnë se nëse vjedh do të shkojë në burg. Me ofendime të tilla ata nuk mund t'i reformojnë fëmijët e tyre,

përkundrazi, ai mund të bëhet kokëfortë dhe të vazhdojë me vjedhje. Apo ndoshta, me qëllimin e hakmarrjes mund të kryejë vjedhjen më të madhe.

Metoda më e mirë që prindërit ta ruajnë situatën do të ishte që ata ta trajtojnë fëmijën me dashuri, butësi dhe dhembshuri. Ata duhet t'ia shpjegojnë konsekuencat e mëdha të vjedhjes. Duhet ta bindin që ta kthejë gjënë e vjedhur te pronari dhe të mos e përsërisin edhe një herë.

Edhe nëse dështojnë këto përpjekje për reformimin e fëmijës, atëherë alternativa e vetme do të jetë biseda me të në një mënyrë të hapur e të vendosur.

Kapitulli i pesëdhjetetë Xhelozia

Xhelozia është një tipar negativ i qenies njerëzore. Personi xheloz gjithnjë i lakmon të tjerët që janë të lumtur e të rehatshëm. Kur të vërejë diçka të mirë e tërheqës te të tjerët, ai dëshiron që ata ta humbin atë. Në përgjithësi, personat xhelozë nuk janë në gjendje as ta marrin atë gjë të mirë prej të tjerëve, as ta lëndojnë atë në ndonjë mënyrë. Ai vazhdon të bluajë me mend dhe të rrijë i zymtë. Ai do të digjet në flakët e xhelozisë ditë e natë. Një person lakmues është i privuar prej kënaqësisë dhe rehatisë së kësaj bote dhe, ndjenja e privimit si dhe e mendimit se të tjerët ndjejnë kënaqësi në këtë botë, e bëjnë jetën e tij më të mjeruar.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Personi xheloz është më i palumturi ndër bashkatdhetarët e tij.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 327).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Lakmia e bën jetën e personit xheloz më të zymtë.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 328).

“Personi lakmues nuk ndjen kurrë kënaqësi dhe lumturi.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 327).

Xhelozia ka efekte të dëmshme në nervat dhe në zemrën e një personi dhe e bën atë të dobët dhe të sëmurë.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Personi xheloz është gjithmonë i dobët dhe i molisur.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 328).

Xhelozia i dobëson rrënjët e besimit të njeriut dhe e kthen atë kah mëkati dhe pabesimi. Shumë vrasje, përlëshje dhe krime tjera janë rezultat i lakmisë dhe i xhelozisë. Ndonjëherë, personi lakmues e përgojon personin që e xhelozon dhe i përhap thashethemet dhe fjalët e papërshtatshme në lidhje me të. Ai ndonjëherë i shkakton dëm pronës së personit tjetër.

Imam Muhamed Bakiri, ka thënë:

“Lakmia e dëmton besimin sikur zjarri që e dëmton drurin.” (Shafi, v. 1, f. 173).

Xhelozia është pjesë e natyrës së njeriut. Shumë vështirë mund të gjendet një person që nuk e ka atë instinkt.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Prej tri gjërave nuk është liruar asnjë person: Mendimet e pandershme, veprat e këqija dhe xhelozia.” (al-mahajjatul bayda, v. 3, f. 189).

Prandaj, ky instinkt i padëshiruar duhet të frenohet me të gjitha forcat që i ka në dispozicion personi. Nuk duhet lejuar të ushqehet dhe të zhvillohet. Nëse instinkti i lakmisë lejohet të vazhdojë, mbasi që është një pjesë e natyrës, ai do të zhvillohet përtej kufijve. Do të arrijë proporcionet e tilla saqë luftimi i tij nuk do të jetë i mundur. Koha më e mirë kur sjelljet e mira kultivohen dhe të këqijat eliminohen është fëmijëria e një personi. Edhe elementi i xhelozisë do të jetë prezent te fëmija. Prindërit, me sjelljen e tyre dhe kujdesin e duhur ndaj fëmijës, mund të shërojnë plotësisht bazat e sëmundjes së xhelozisë që manifestohet në sjelljen e tij tani dhe më vonë. Nëse prindërit i trajtojnë njëjtë të gjithë fëmijët e tyre, pa ndonjë favorizim, problemi i lakmisë nuk do të shfaqet. Veshja, ushqimi dhe gjërat tjera që i përdorin fëmijët duhet të jenë të njëjta, të kualitetit dhe të standardit të njëjtë. Ata duhet të kenë ndërmend paanësinë në çështjen e parasë së xhepit dhe të trajtimit të përgjithshëm të fëmijës. Ata nuk duhet t'i krahasojnë aftësitë e fëmijëve në prezencën e tyre, madje edhe në prezencën e të tjerëve, nëse ka mundësi që fëmijët të mësojnë se është bërë krahasimi në lidhje me ata. Qëndrimi i tillë mund të frenojë çfarëdo shkalle të aftësisë që mund ta ketë fëmija i dobët dhe ta bëjë atë plotësisht të paaftë. Këta prindër qëllimshëm por të padijshëm mendojnë se janë duke e trajnuar fëmijën e tyre. Përkundrazi, ata nuk

janë të zotë ta arrijnë qëllimin e tyre dhe janë duke ia shtuar lëndën djegëse zjarrit. Zemra e fëmijëve të pafajshëm e fiton idenë e xhelozisë dhe të urrejtjes. Ai mund të motivohet për të kryer aktet e urrejtjes. Gjithmonë mund të ekzistojë rreziku i nxjerrjes jashtë të ngacmimit ndaj vëllezërve dhe motrave të tij.

Prindërit nuk duhet t'i krahasojnë asnjëherë fëmijët e tyre me të tjerët. Ata kurrë nuk duhet t'i lavdërojnë shumë fëmijët tjerë, posaçërisht në krahasim me fëmijët e tyre. Nuk është e drejtë nëse prindërit i thonë fëmijëve: 'Sa i sjellshëm, i edukuar dhe i zellshëm është fëmija i fqinjit. Sa i dëgjueshëm që është dhe sa i ndihmon nënës së tij në punë. Prindërit e tij janë fatlumë që kanë një fëmijë sikur ai.' Prindërit e tillë duhet të kuptojnë se ky lloj i krahasimit mund ta cenojë egon e fëmijës dhe të ketë ndërlikime të dëmshme. Në vend se të ndreqet fëmija, ai do të bëhet i paepur dhe hakmarrës.

Prindërit duhet të evitojnë plotësisht krahasimin e fëmijëve. Disa fëmijë janë gjithnjë më të zotë, më të hijshëm apo më të mençur se të tjerët. Është e mundur që prindërit të jenë më të lidhur për një fëmijë sesa për të tjerët. Këtu nuk ka ndonjë të keqe. Ky është një instinkt normal. Por, në fjalë dhe në vepra ata nuk guxojnë të bëjnë diskriminime ndërmjet fëmijëve. Ata duhet të sigurojnë trajtimin e barabartë për të gjithë fëmijët. Nëse dëshirojnë t'i japin ndonjë trajtim special ndonjë fëmije të veçantë, ata duhet ta bëjnë këtë kur fëmijët tjerë nuk janë atypari. Edhe nëse prindërit mundohen maksimalisht të japin trajtimin e njëjtë për të gjithë fëmijët, elementi i xhelozisë, që është instinktivisht në natyrën e njeriut, do të jetë prezent te fëmija në një masë të caktuar. Çdo fëmijë dëshiron të bëhet i dashuri i prindërve dhe askush tjetër të mos e ketë këtë privilegj. Kur të vëren se prindërit janë duke e shprehur dashurinë e tyre ndaj vëllezërve dhe motrave, për një

moment do të ndjejë brejtjen e ndërgjegjes së xhelozisë. Fëmija do të kuptojë me kohë se ai duhet ta ndajë dashurinë e prindërve bashkë me vëllezërit dhe motrat. Edhe të tjerët i kanë të drejtat e tyre ndaj prindërve. Prindërit, me trajtimin e matur të situatës, mund të bëjnë që fëmija t'i pranojë vëllezërit dhe motrat dhe në këtë mënyrë të evitojë vazhdimin e ndjenjës së tij të lakmisë.

Nëse djali juaj e lakmon vëllanë apo motrën për ndonjë arsye: i detyron ata, i pickon dhe i përdor fjalët e vrazhda, mundohet t'i privojë ata prej pemëve dhe ëmbëlsirave të tyre, atëherë ai ka nevojë për më shumë vëmendje. Ju nuk duhet t'i mbyllni sytë ndaj këtyre veprimeve të fëmijës. Ju duhet ta bindni atë se ai është duke u rritur dhe se vëllezërve të tij më të vegjël u nevojitet më shumë vëmendje sesa atij. Ju duhet t'i thoni atij se kur ai ishte i vogël, siç është tani vëllai i tij i vogël, edhe ai kërkonte më shumë vëmendje. Në vend se të përpiqeni ta riparoni gjendjen e tij, bindeni atë se fëmijët e vegjël janë vëllezërit dhe motrat e tij. Edhe ata e duan atë. Nëse ai nuk i do ata, kush do t'i dojë ata? Ai duhet t'i mbrojë ata nëse ndonjëri mundohet t'i lëndojë. Allahu i ka dhënë atij vëllezër dhe motra aq të dashura, gjë që duhet të jetë falënderues.

Si përfundim, është e domosdoshme të përmendim se mirëmbajtja e trajtimit plotësisht të barabartë ndaj të gjithë fëmijëve mund të jetë utopi. Si mund të trajtojnë njëjtë prindërit djalin dhe vajzën, më të ri dhe më vjetër, në të njëjtën mënyrë? Fëmijëve më të vjetër, zakonisht u jepet më shumë liri. Por, më të rinjve duhet t'u kushtohet më tepër kujdes. I vjetri merr më shumë para të xhepit. Më të rinjtë kërkojnë më shumë mbrojtje. Djemve zakonisht u jepet më shumë liri të lëvizjes sesa vajzave. Prandaj, duke e mbajtur ndërmend nevojën për barazi dhe liri, prindërit duhet të përvetësojnë trajtime të ndryshme për djemtë dhe

për vajzat. Ky trajtim mund t'i japë fëmijës ndjenja të rënda. Prindërit duhet të shpjegojnë në mënyrë të duhur se ata ndjejnë dashuri të njëjtë për të gjithë fëmijët, por disa norma të sjelljes për njerëzit ndryshojnë sipas moshës dhe gjinisë.

Edhe pse lakmia dhe xhelozia janë tipare të padëshiruara në sytë e Islamit, dhe në fakt konsiderohen si mëkat, shpirti i konkurrimit dhe i rivalitetit janë komponentët e përpjekjeve dhe të mundimeve për përparimin e njerëzimit. Dallimi në mes lakmisë dhe rivalitetit është se personi bëhet rivali i një personi tjetër për t'i ballafaquar të arriturat e tij dhe për të kaluar përpara tij; por personi lakmues ndjen vetëm xhelozia dhe nuk është i aftë të konkurrojë dhe të shkojë përpara. Civilizimi njerëzor do të kishte mbetur në amulli pa konkurrim dhe rivalitet.

Një person shkruan:

“Kam pasur një motër që ishte dy vjet më e vjetër se unë. Prindërit më donin mua më shumë se atë. Çfarëdo që dëshiroja, ata më jepnin. Në çdo rast më lavdëronin, ndërsa neglizhonin plotësisht ta përmendin atë. Motra zakonisht më bezdiste. Kurdoherë që kishte mundësi, ajo më rrihte dhe më pickonte, më thërriste me emra të këqij dhe i thyente lodrat e mia që i pëlqeja. Kurrë nuk më dëshironte të lumtur, për asnjë moment. Unë mendoja për atë se pse po silllet në këtë mënyrë motra ime. Çfarë të keqe i kam bërë asaj? Ajo ishte shumë xheloze ndaj meje dhe ndoshta sjellja e veçantë e prindërve ishte arsyeja e kësaj urrejtjeje. Prindërit asnjëherë nuk e kuptuan se për shkak të sjelljes jo të barabartë, motra ime mendohej të hakmerrej ndaj meje. Tani që prindërit e mi nuk janë më, motra ime silllet mirë me mua. Ajo ndjehet keq nëse unë kam edhe ndonjë parehati më të vogël.”

Kapitulli i pesëdhjetenëntë

Zemërimi

Zemërimi dhe shqetësimi janë pjesë e natyrë së njeriut. Ata janë prezentë në instinktet bazike të çdo personi. Ky fenomen buron prej zemrës dhe mendjes së çdo individi. Pastaj e merr formën e flakës dhe e përshkon tërë trupin. Sytë dhe fytyra bëhen të kuqe, gjymtyrët fillojnë të dridhen dhe shkuma del prej gojës. Ndjenjat dalin jashtë kontrollit të personit. Inteligjenca e personit të zemëruar zhduket për një çast dhe në atë gjendje ka shumë pak dallim në mes tij dhe njeriut të marrë. Në këtë gjendje, si i dehur ai mund t'i kryejë veprimet për të cilat mund të pendohet gjatë tërë jetës së tij.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Qëndroni larg nga zemërimi, sepse fillon me vull dhe përfundon me pendim.” (Mustadrak al-vasail, v. 12, f. 326).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Zemërimi është çelësi i të gjitha sëmundjeve.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 303).

Zemërimi është i dëmshëm edhe për devocionin e një personi. Mund t'i shkatërrojë veprat e tij të mira dhe ta bëjë mëkatar.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Zemërimi e dëmton devocionin e një personi sikur që uthulla e shkatërron mjaltin e mirë.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 302).

Në gjendjen e tërbimit, personi i shqipton fjalët jo të mençura dhe veprat e tij janë të tilla që ai bëhet jo i popullarizuar në sytë e të tjerëve.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Zemërimi është shoku i keq që i ekspozon mangësitë e një personi. Ai e sjell atë më afër të keqes dhe e largon nga e keqja.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 326).

Zemërimi i vazhdueshëm e dëmton zemrën dhe nervat e një personi, dhe i bën ato të dobëta e të molisura. Prandaj, personi që brengoset për nderin e tij, shëndetin dhe devocionin, duhet ta luftojë instinktin e keq të zemërimit me tërë fuqinë e tij dhe ta mbajë nën komandën e tij, para se t'i shkatërrojë nervat, nderin dhe devocionin e tij.

Po ashtu, duhet të mbajë në mend se zemërimi nuk është i panevojshëm dhe i dëmshëm nën të gjitha rrethanat. Në kohëra të caktuara përdorimi i tij është legjitim dhe i leverdishëm. Duhet të përdoret në mënyrë të drejtë, kur situata kërkon një gjë të tillë. Ky instinkt i ndihmon ndonjërit ta mbrojë jetën dhe pronën e tij nga vandalët dhe elementet e padëshiruara. Kur personi duhet ta mbrojë besimin, vendin e tij apo ta mbrojë njerëzimin në përgjithësi, instinkti i zemërimit do të jetë pjesë e kalorësisë së tij. Pa prezencën e këtij instinkti, personi do të jetë në rangun e frikacakëve që e ulin kryet e tyre ndaj çdo ofendimi apo keqtrajtimi prej të tjerëve. Nëse instinkti i zemërimit mbetet nën kontrollin e urtësisë, ai mund të bëhet një pasuri për të.

Lufta për mbrojtjen e vendit të tij, çështja e besimit të ndonjërit (*Emri bil maruf ve nehji anil munker*) dhe mbrojtja e familjes së ndonjërit është legjitime. Instinkti i zemërimit bën që ndonjëri të marrë pjesë në një detyrë të tillë të vështirë.

Myslimani i devotshëm dhe i përgjegjshëm nuk do të mbetet shikues i pazëshëm ndaj tiranisë, padrejtësisë, diktaturës, vazhdimësisë së mëkateve, forcës së imperializmit dhe kolonializmit, etj. Islami u lejon njerëzve të tij të qëndrojnë fuqimisht dhe t'i luftojnë këto forca me guxim dhe gjakftohtësi. Sidoqoftë, në situata të tilla

zemërimi i njerëzve nuk duhet të triumfojë mbi këshillën e mençur.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Nëse bëheni pasues të zemërimit, do t’ju shpie drejt shkatërrimit.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 226).

Nuk është e drejtë të shtypet plotësisht instinkti i zemërimit dhe ta bëjë qenien njerëzore të pandjeshme, të pabrengosur dhe të paturpshme. Ajo çka kërkohet është nevoja për të shmangur shprehjen e tepruar dhe të panevojshme të zemërimit. Kjo është e mundur me rritje të duhur dhe të treguarit e kujdesit ndaj personave të rinj. Sikur instinktët tjera të një personi, edhe zemërimi i ka rrënjët e veta në fëmijërinë e hershme. Sasia e zemërimit të një personi është pasqyrimi i trajnimit që e ka pranuar dhe i rrethanës në të cilën ka jetuar. Nëse prindërit e mirëmbajnë instinktin e zemërimit në një nivel mesatar në çështjet e tyre, edhe fëmija do të mësojë të ndjekë këtë proces. Edhe fëmijët e prindërve nervozë e të xhindosur do të mësojnë të bëhen të ngjashëm në jetën e tyre të mëvonshme.

Fëmija ndonjëherë çirret dhe bërtet gjatë zemërimit, trupi i tij dridhet, ngjyra e fytyrës së tij ndërrohet, i mëshon dyshemesë me këmbë, rrotullohet në dysheme, flet fjalë të inatosura dhe mundohet të shkojë në një kënd për ta fshehur veten. Të gjitha këto sjellje të çuditshme të fëmijës mund të jenë çapkënëri. Ai mund të jetë i zemëruar dhe prindërit duhet ta hulumtojnë shkakun e zemërimit dhe të mundohen për ta larguar.

Zemërimi lajmërohet për shkak të brengës apo parehatisë. Dhembja e tepërt, lodhja, pagjumësia, uria, etja e tepërt, të ftohtit dhe të nxehtit e shqetësojnë fëmijën dhe i japin rast zemërimit. Bërja e gjërave kundër dëshirës së fëmijës, kufizimi i lirisë së lëvizjes, ndjenja e kujdesit të tepërt ndaj fëmijëve tjerë, të ushqyerit e detyruar të tij mund të lodhë fëmijën dhe ta zemërojë. Disa prindër i

mësojnë fëmijët në mënyrë të lehtë që të zemërohen. Ata u bërtasin atyre dhe bëhen tepër të ashpër. Nëse fëmija zemërohet, ata ia kthejnë me zemërim, në vend se të provojnë ta qetësojnë. Në këtë mënyrë fëmija mësohet të bëhet një person i zemëruar.

Nëse fëmija është i uritur dhe i etur, jepini të hajë apo të pijë diçka. Nëse është i lodhur, ndihmoni të flejë. Nëse fëmija është i zemëruar për shkak të veprave tuaja, mundohuni ta qetësoni. Nëse zemërimi i fëmijës është për shkak të mendimeve të shpërndara, qetësojeni me biseda të buta dhe ninulla. Nëse fëmija është i zemëruar sepse kërkon diçka, mundohuni ta zbuloni kërkesën e tij dhe ta plotësoni atë. Kur fëmija të kthehet në gjendje normale, tregoni se ai nuk ka nevojë të qajë dhe të nervozohet për të fituar diçka. Sigurojeni atë se ai duhet vetëm ta kërkojë atë, dhe nëse ajo gjë është e mirë për të, atëherë ajo do t'i jepet atij. Gjithashtu, paralajmërojeni se nëse qan dhe sillet keq në të ardhmen, dëshirat e tij nuk do të plotësohen.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Rruajuni prej zemërimit që të mos dominojë mbi ju dhe të mos bëhet shprehi juaja.” (Gharar al hukm, f. 809).

Fëmijët e ngacmueshëm zemërohen edhe për shkak të pretekstit më të vogël, sepse natyra e tyre nuk është e fortë. Ata nuk janë në gjendje të tolerojnë asnjë gjë të padëshiruar dhe preken edhe nga shqetësimi më i vogël dhe bëhen nervozë.

Kapitulli i gjashtëdhjetë Të folurit e fjalëve të turpshme

Përdorimi i fjalëve të këqija dhe të folurit e fjalëve të turpshme është një shprehi e keqe. Personat që i përdorin sharjet duke folur çfarëdo që u bie ndërmend, rrallë u përmbahen fjalëve të folura. Ata e ndryshojnë shumë shpesh mendjen e tyre. Ata i përdorin fjalët e këqija dhe i gjejnë të metat e të tjerëve pa pasur ndonjë arsye për këtë. Ata u shkaktojnë lëndime të tjerëve përmes fjalëve të tyre të papërgjegjshme.

Përdorimi i fjalëve të këqija është haram dhe konsiderohet një mëkat i madh.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Allahu ua ka ndaluar Xhenetin atyre që i përdorin lapërdhitë. Po ashtu, ekziston edhe mallkimi ndaj atyre që shajnë, që janë të paturpshëm dhe të pafytyrë, dhe atyre do t’u ndalohet hyrja në Xhenet. Çka do që personat e tillë flasin për të tjerët, e bëjnë këtë pa menduar dhe asnjëherë nuk mërzhiten për atë se çfarë mendimi kanë të tjerët për të. (Usul al-Kafi, v. 2, f. 323).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Mallkimi, sharja dhe paturpësia janë shenjat e hipokrizisë (*nifak*) dhe të pabesimit.” (Usul al-Kafi, v. 2. f. 325).

Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë:

“Mjerë për ata që flasin për dobësitë e të tjerëve dhe kënaqen duke i përqeshur të tjerët.” (Kuran, 104:1).

Personat që i përdorin sharjet, në përgjithësi janë inferiorë dhe mendjengushtë. Ata i përfitojnë armiqtë përmes të folurit të tyre të pamatur. Njerëzit i urrejnë ata. Ata mundohen të rrinë larg prej tyre dhe i shmangen shoqërimit të tyre.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Më i keqi ndër njerëzit është ai, fjalët e cilit nuk pëlqehen nga të tjerët dhe nga takimi të cilit i shmangen.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 325).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Kur njerëzit nuk duan as t’i dërgojnë fjalët e një personi, fati i tij do të jetë Xhehenemi!” (Usul al-Kafi, v. 72, f. 327).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Besimtari (*mumin*) nuk tallet, nuk kritikon, nuk fajëson dhe nuk flet keq për të tjerët.” (Al-mahajjat ul bayda, v. 3, f. 127).

Sipas natyrës, fëmija nuk është i prirë për fjalë të turpshme. Ai mund ta mësojë këtë prej prindërve, vëllezërve, motrave, shokëve dhe duke luajtur në shkollë. Por, ndikimi më i madh do të jetë prej qëndrimit të prindërve. Prindërit mund të jenë shembulli më me ndikim për fëmijët. Prindërit jo vetëm që janë përgjegjës për sjelljen e tyre, por kanë përgjegjësi shumë të rëndësishme për trajnimin e duhur të fëmijëve të tyre. Prindërit janë ata që ose i bëjnë fëmijët të sjellshëm e të butë, ose poterexhi të pafytyrë. Disa prindër, duke bërë shaka apo kur janë të zemëruar u flasin fëmijëve të tyre fjalë të këqija. Në këtë mënyrë, ata u japin një trajnim të gabuar fëmijëve të tyre. Janë disa shtëpi ku përdorimi i fjalëve të këqija është praktikë e rëndomtë.

‘Biri i qenit’, ‘nëna e qenit’, ‘idiot’, ‘budalla’, ‘gomar i pandjenjë’, ‘shtazë’, ‘i paturp’ dhe disa fjalë të tjera janë emrat që i emërtojnë njëri-tjetrin personat e shtëpisë gjatë bërjes së shakasë apo gjatë zemërimit.

Prindërit, detyra e të cilëve është parandalimi i gabimeve të fëmijëve të tyre, vetë janë duke kryer vepra të tilla të gabuara dhe duke i inkurajuar fëmijët që ta ndjekin shembullin e tyre. Ata e fyejnë dhe e shajnë njëri tjetrin përpara fëmijëve, pa menduar për pasojat.

Prindërit i përqeshin fëmijët dhe e përdorin gjuhën e pamoralshme me ata. Si mund të presin prindërit e tij që fëmijët e tyre të rriten në persona miqësorë dhe të respektuar. Ata duhet të kuptojnë se fëmija mund të tregohet edhe më i keq sesa vetë ata. Ata duhet të mbajnë në mend se herët apo vonë do të shohin se fëmija është duke e përdorur gjuhën e njëjtë që e ka dëgjuar sa e sa herë prej prindërve të tij. Pastaj, asnjë sasi e predikimit apo e rrahjes nuk mund ta reformojë fëmijën. Mjeti më i mirë i shërimit është që prindërit së pari ta reformojnë me kohë vetveten para se të bëhet tepër vonë.

Shumë herë, fëmija e mëson këtë shprehje të keqe prej shokëve të tij. Prindërit duhet t'i mbajnë të hapur sytë dhe veshët e tyre ndaj sjelljeve të tilla të fëmijët e tyre dhe ta evitojnë para se të lëshojë rrënjë. Ata duhet të kërkojnë prej fëmijëve të tyre që të mos shoqërohen shumë me fëmijët e tillë.

Nëse vëreni se fëmija juaj është duke i shqiptuar fjalët e tilla fyese, atëherë mos qeshni dhe mos rriini të qetë. Edhe përmes britmës dhe kërcënimeve situata e tillë nuk mund të tejkalohet. Kjo metodë mund të dështojë. Mënyra më e mirë për të korrigjuar fëmijën është biseda e butë me fëmijën dhe shpjegimi për efektet e këqija të përdorimit të fjalëve të këqija.

Kapitulli i gjashtëdhjetenjtë **Përgojimi apo bartja e fjalëve (gijbet)**

Përgojimi është një shprehi shumë e keqe dhe fatkeqësisht është shumë e përhapur në shoqëri. Nëse ndonjëri flet diçka kundër tjetrit, përgojuesi i bart fjalët deri te personi tjetër duke thënë filani ka thënë kështu e kështu për ty. Bartja e fjalëve është shenjë e ligësisë dhe e poshtërisë. Kjo formon humnerë në mes shokëve të mirë. Shumë krime, përlëshje, armiqësi, vrasje dhe grindje janë rezultat i moskuptimeve në mes njerëzve për shkak të përgojimit. Qetësia e shumë njerëzve priset për shkak të kësaj praktike të pakëndshme. Burrat dhe gratë ndahen, shokët bëhen armiq, prindërit kthehen kundër fëmijëve të tyre, të gjitha këto kryesisht për shkak të përgojimit nga ana e disa personave të ligë e të pavëmendshëm. Kur të bëhet i njohur përgojuesi, ai do të mallkohet nga ana e të gjithëve dhe njerëzit do të urrejnë për ta parë fytyrën e tij. Njerëzit e mallkojnë përgojuesin dhe ia dëshirojnë shkatërrimin. Më e keqja e përgojimit është përgjimi për interesa të zullumqarëve të ligë. Nëse ndonjëri përgjon për ndonjë zullumqar dhe nëse një person besimtar futet në telashe për shkak të kësaj, pëson dëmtime trupore apo i shkaktohet vdekja, atëherë përgojuesi do të jetë përgjegjës njëjtë sikur ai person i lig që e ka angazhuar atë për të bërë këtë punë të poshtër. Ata, të dytë do të ndëshkohen në Ditën e Gjykimit, edhe pse përgojuesi nuk ishte përzier drejtpërdrejt në torturimin fizik të personit të pafajshëm.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Personi më i keq është ai që i përgjon dhe i përgjon vëllezërit mysliman për mbretin. Ky përgjim është i keq për të, për shokët kundër të cilëve ka raportuar dhe gjithashtu edhe për mbretin.” (Bihar al-anvar, v. 75, f. 266).

Islami e ka definuar aktin e përgjimit dhe të përgojimit si haram (të ndaluar) dhe në lidhje me këtë ekzistojnë shumë hadithe nga ana e të Dërguarit.

Imam Muhamed Bakiri thotë:

“Përgojuesit do t’i ndalohet hyrja në Xhenet.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 369).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Më i urryeri dhe më i ligi prej mesit tuaj janë ata që përgojojnë dhe formojnë dallime në mes shokëve, dhe i tregojnë të metat e të tjerëve.” (Usul al-Kafi, v. 2, f. 375).

Mund të ketë shumë arsye për përgojim. Ndonjëherë armiqësia është shkaku i këtij akti. Përgojuesi mund të jetë në armiqësi me ndonjë grup dhe t’i xhelozojë marrëdhëniet e tyre të mira. Ai do të vazhdojë të tregojë të pavërteta për njëri tjetrin përderisa ata të bien në këtë kurth. Ndonjëherë, si pasojë e shprehisë së tij, përgojuesi transmeton informatat e pavërteta dhe të dëmshme në lidhje me ndonjë person duke krijuar dallime serioze në mes tyre. Me këtë rast, përgojuesi nuk ka ndonjë motiv të mëvonshëm veçse ta kënaqë dëshirën e tij për të bartur fjalë. Religjioni i Islamit ka ndaluar edhe dëgjimin e përgojimit.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Nuk duhet as të përgojoni as të dëgjoni përgojuesin.” (Maxhma al zavaid, v. 8, f. 91).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Përgënjeshtrojeni përgojuesin dhe atë që parashtrohet shumë pyetje” (Garar al hukm, f. 145).

Është e qartë se nëse askush nuk i kushton rëndësi fjalëve të përgojuesit, atëherë ai do të ndalet për ta bërë atë. Kushdo që i bart fjalët e të tjerëve në lidhje me ju, duhet të dini me siguri se ai nuk është shoku juaj. Sikur të ishte shoku juaj, ai do t’ju kishte mbrojtur përderisa të tjerët kishin folur kundër jush. Nëse ndonjëri i tregon tjetrit diçka

në besim, myslimani i mirë kurrë nuk ua tregon atë të tjerëve. Ai do ta mbajë kontrollin mbi gjuhën e tij dhe asnjëherë nuk do të provojë të përgjojë përreth.

Shumë persona e kanë marrë shprehinë e përgojimit nga fëmijëria e tyre. Është një pasqyrim i asaj se çka shohin e dëgjojnë përreth tyre. Prandaj, prindërit e bartin një përgjegjësi të madhe për mbrojtjen e fëmijëve të tyre prej marrjes së shprehisë së keqe të përgojimit. Së pari, vetë prindërit duhet të përmbahen nga të folurit keq për të tjerët. Nëna nuk duhet t'i tregojë babait për disa vepra të fqinjëve si dhe disa relacione tjera. Edhe babai nuk duhet t'i flasë gruas kundër shokëve dhe njohësve të tij. Sepse, nëse prindërit e kanë shprehinë e të folurit të keq për të tjerët prapa shpinës së tyre, edhe fëmijët do të kënaqen me biseda të tilla. Ndonjëherë, fëmija i flet babait të tij kundër nënës së tij dhe motrës së vogël. Në rastet e tilla detyra e babait është të korrigjojë fëmijën dhe t'i thotë se nuk është mirë të përgojë. Ai duhet t'i tregojë atij se nëse dëshiron të thotë diçka në lidhje me nënën apo motrën, le t'ia thotë këtë drejtpërdrejt asaj; ajo, çfarë je duke bërë ti, është përgojim dhe kjo është e keqe. Nëse fëmija mundohet të përgojë, injoroni plotësisht dhe mundohuni të flisni për ndonjë temë tjetër interesante.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Mos ia kushtoni veshin përgojimit.” (Gharar al hukm, f. 125).

Kapitulli i gjashtëdhjetedytë

Kërkimi i të metave

Të kritikuarit e tjerëve dhe kërkimi i të metave të tyre pa ndonjë arsye është ndër shprehitë më të këqija të genies njerëzore. Njerëzit i urrejnë ata që e kanë shprehinë e gjetjes së të metave të tjerëve. Ata mundohen të ikin nga personat e tillë të mundimshëm. Ndonjëherë, këta kërkues të të metave bëhen shkaktarë të armiqësisë dhe të konfliktit. Nëse përmendet e meta e ndonjërit që nuk është i pranishëm, atëherë kjo emërtohet si përgojim. Nëse kjo bëhet në praninë e vetë atij personi, atëherë është një fyerje dhe një gjë e padëshirueshme. Religjioni i Islamit e ka emërtuar përgojimin si një mëkat të madh. Ekzistojnë hadithe të shumta në lidhje me këtë temë:

Duke mbajtur një predikim, I Dërguari i Islamit ka thënë me një ton të theksuar:

“O ju njerëz që deklaroni me gjuhët tuaja se jeni besimtarë, por që besimi ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja, mos i përgojoni dhe mos i kritikoni asnjëherë myslimanët, dhe mos i kërkoni të metat e tyre. Sepse, atij që mundohet për t’i gjetur të metat e të tjerëve, Allahu do t’ia nxjerrë në shesh të metat e tij dhe do ta bëjë atë objekt talljeje për të tjerët.” (Xham’i al sa’da, v. 2, f. 203).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Kushdo që thotë diçka që e lëndon personalitetin e një besimtari, Allahu do ta largojë atë prej grupit të shokëve të Tij dhe do ta dërgojë te grupi i shejtanit, i cili do të refuzojë për ta pranuar atë si shok.” (Xham’i al sa’da, v. 2, f. 305).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kushdo që e përgojon ndonjë besimtar, mashkull apo femër, Allahu nuk do ta pranojë namazin dhe agjërimin

tij për dyzet ditë, përveç nëse kërkon falje prej atij të cilin e ka përgojuar.” (Xham’i al sa’da, v. 2, f. 304).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Përgojimi dhe kërkitimi i të metave janë të ndaluara. Ato i shkatërrojnë virtytet e një personi siç e shkatërrojnë zjarri lëndën djegëse.” (Xham’i al sa’da, v. 2, f. 305).

Fatkeqësisht, një mëkat i tillë i madh është bërë një rutinë e përditshme për njerëzit tanë. E ka arritur shkallën e tillë sa që njerëzit nuk e konsiderojnë si mëkat përgojimin dhe gjetjen e të metave të tjerët. Nëna e kritikon babanë dhe babai gjen të meta të ajo. Fqinjët dhe të afërmit nuk mërzhiten aq shumë kur i numërojnë të metat e njëri tjetrit. Fëmijët e pafajshëm e pranojnë këtë shprehje të urryer prej prindërve të tyre. Fëmijët e bëjnë përgojimin e fëmijëve tjerë. Kur të rriten, do të jetë vështirë për ta që të shmangen prej kësaj shprehje të keqe.

Disa prindër i llastojnë dhe i lëndojnë fëmijët e tyre deri në qiell, e në të vërtetë, ata duhet t’ua sqarojnë atyre mangësitë e tyre. Ndonjëherë, prindërit i lëndojnë në mënyrë të gabuar fëmijët për gjërat të cilat nuk i ka bërë vetë, në mënyrë që të mos duken qesharake gabimet e tij.

Në situata të tilla fëmijët mund të bëhen armiq të prindërve. Apo, mund të fitojnë shprehjen e shqiptimit të të pavërtetave që shihen qartas. Ata mund të bëhen edhe viktimat e kompleksit të vlerës së ulët. Prandaj, është më mirë që prindërit të mos bëjnë biseda të panevojshme për gabimet e fëmijëve në mënyrë ironike.

Kapitulli i gjashtëdhjetetretë

Përleshjet e fëmijëve

Një çështje tjetër për brengosje të lehtë janë dallimet dhe përleshjet në mes të fëmijëve në shtëpi. Kur familja ka më shumë se një fëmijë, ka mundësi për konflikte. Njëri mendon se tjetri ia uzurpon privilegjet e tij dhe se dëshiron të ndajë diçka me të pa pasur nevojë për një gjë të tillë. Ata e shtyjnë njëri tjetrin dhe i rrëmbejnë lodrat prej njëri tjetrit. Kur fillojnë të shkojnë në shkollë, ata i shkarravisin fletoret e njëri tjetrit dhe gjësendet tjera. Ata zbaviten njëri me tjetrin. Kur njëri mundohet të koncentrohet në detyrat e shtëpisë, të tjerët bëjnë zhurmë dhe e shqetësojnë. Çdo fëmijë e dinë për shakatë që mund të luajë me vëllezërit dhe motrat e tij. Në këtë situatë prindërit janë shikues të paaftë. Ankesat për zënkat arrijnë tek ata. Vështirësia fillon për ata kur ndonjëherë prindërit ndërhyjnë për të gjykuar grindjet e fëmijëve. Nëna i thotë babait se ai nuk kujdeset aspak për rritjen e fëmijëve, se fëmijët nuk frikësohen prej tij dhe se për shkak të qëndrimit të tillë të shkujdesur, shtëpia është shndërruar në një arenë të luftës.

Babai i ankohet nënës se sikur ajo të ishte një person më i kujdesur, fëmijët nuk do të ishin bërë kaq çapkënë sikur që janë dhe se mbështetja e saj i ka inkurajuar fëmijët të sillen në këtë mënyrë.

Këtu prindërit duhet të mbajnë në mend se fëmijët janë, fundi i fundit, fëmijë. Nuk mund të presim nga ata të qëndrojnë në një qoshe të qetë, sikur personat e vjetër. Ju duhet të pranoni faktin se grindjet e fëmijëve janë fenomene natyrale. Edhe të vjetrit ndonjëherë grinden. Si mund të pritë prej fëmijëve të rrinë të qetë tërë kohën. Në përgjithësi, fëmijët janë të djallëzuar. Duke luajtur shaka njëri me tjetrin, ata mund të grinden. Por, së shpejti

bashkohen dhe i harrojnë dallimet. Ata nuk mund të qëndrojnë larg njëri prej tjetrit dhe të mbajnë hundët e ngritura. Një psikolog shkruan:

“Është një çështje e rëndësishme që ne asnjëherë nuk duhet të mendojmë se në një shtëpi ku ka shumë fëmijë të mbizotërojnë qetësia e përhershme në mes tyre, që fëmijët të jetojnë miqësisht në mes veti dhe asnjëherë të mos grinden. Me cilindo fëmijë që kemi biseduar, na kanë thënë se nëna dhe babi i tyre presin që ata të jetojnë në mënyrë miqësore në mes veti dhe pa u grindur fare njëri me tjetrin. Por, nëse mendoni në mënyrë pak më serioze për këtë çështje, do të shihni se tendenca e grindjes së fëmijëve nuk është ndonjë problem i madh.” (Ruvan shinasi kudak, f. 286.).

Ne, po ashtu, duhet të dimë se shprehia e fëmijës për t’u përleshur me të tjerët do të zhduket me rritjen e tij. Nëse prindërit e pranojnë përleshjen në mes fëmijëve si një fazë kalimtare e të përkohshme, atëherë nuk do të mërziten aq shumë për këtë.

Një tjetër psikolog shkruan:

“Shumë prej aktiviteteve të fëmijëve, si bërja e shakasë me njëri tjetrin, përleshja dhe munda, do të pakësohen me kalimin e kohës.” (Ruvan shinasi kudak, f. 286.).

Po, është e drejtë se shumica e prindërve nuk mund të eliminojnë plotësisht përleshjen në mes fëmijëve të tyre. Me një manovrim të zgjuar ata mund ta reduktojnë shpeshësinë dhe intensitetin. Prindërit e kujdesshëm asnjëherë nuk mbesin shikues kur fëmijët përleshën. Ata intervenojnë në mënyrë taktike dhe sigurojnë që fëmijët të mos i shkaktojnë dëmtime trupore njëri tjetrit gjatë përleshjeve. Ata duhet së pari të zbulojnë shkakun e përleshjes dhe pastaj të mundohen ta eliminojnë. Një nga arsyt kryesore të dallimeve në mes fëmijëve është ndjenja

e xhelozisë. Është e domosdoshme që, arsyeya e xhelozisë që fillon prej fëmijërisë, të vërehet dhe të shërohet që në fillim.

Fëmija kërkon tërë vëmendja t'i kushtohet atij. Ai nuk pëlqen t'i ndajë ndjenjat e prindërve me fëmijët tjerë. Fëmija që lind i pari zakonisht llastohet prej prindërve. Por, kur të arrijë i dyti, gjendja do të ndryshojë. Natyrisht që prindërit do ta ndajnë përkujdesjen e tyre dhe natyrisht që kujdesin më të madh do t'ia kushtojnë fëmijës së vogël. Tani, fëmija më i vjetër fillon të ndjejë pasiguri. Ai fillon të ndjehet i nënçmuar. Ai mendon se i sapoardhuri është një mysafir i paftuar që ia ka marrë kujdesin dhe dashurinë e prindërve të tij të dashur. Ai fillon ta lakmojë foshnjën, por e di se duhet ta tolerojë atë sepse prindërit janë duke shfaqur një dashuri të madhe ndaj tij. Në situata të tilla, fëmija më i vjetër mund të simulojë, të pretendojë sëmundjen, të mbajë kujdesin e prindërve të koncentruar tek ai, etj. Ndonjëherë, mund të bjerë në dysheme, të refuzojë për të marrë ushqim, apo të qajë dhe të provojë shtirjet tjera në mënyrë që të tërheqë vëmendjen e prindërve. Fëmija i tillë e konsideron veten të privuar dhe zhvillon një natyrë të urrejtjes për vëllezërit dhe motrat e tij. Ai pret rastin për t'u hakmarrë ndaj tyre. Prindërit duhet të eliminojnë paraqitjen e situatave e tilla në mënyrë të matur. Ata duhet ta përgatisin fëmijën për të pranuar vëllanë apo motrën e re para se të lindë. Ata duhet t'i tregojnë se ai apo ajo do të arrijë shumë shpejt. Kur të rritet, do ta dojë dhe do të luajë me të. Kur të përgatisin diçka për të sapolindurin, duhet t'u japin edhe fëmijëve më të vjetër ndonjë dhuratë, që ata të mos ndjehen të nënçmuar. Kur të shkojë nëna në shtëpinë e lindjes për të lindur, babai duhet t'ua japë disa dhurata fëmijëve më të vjetër, në mënyrë që të mos e ndjejnë mungesën e nënës. Babai duhet t'u thotë atyre se këto dhurata u janë dhënë

atyre për të festuar arritjen e vogëlushit në shtëpi. Ai duhet të kërkojë prej tyre që kur të arrijë vogëlushi në shtëpi, mos të bëjnë shumë zhurmë. Prindërit nuk duhet ta lavdërojnë foshnjën aq shumë në prezencën e fëmijëve tjerë. Ata duhet t'ia kushtojnë më shumë vëmendje fëmijëve më të vjetër, që t'u japin atyre ndjenjën e sigurisë se i sapolinduri nuk ka ardhur për t'i privuar ata prej dashurisë së prindërve.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Drejtësia i largon dallimet dhe e përkrah miqësinë.” (Gharar al hukm, f. 64).

“Trajtimi i drejtë është gjithmonë strategjia më e mirë.” (Gharar al hukm, f. 64).

Gjithmonë është e mundur që disa fëmijë të kenë kualitete të veçanta dhe mund të bëhen të dashurit e prindërve. Disa fëmijë mund të jenë më inteligjentë, disa më të bukur dhe disa tjerë më të sjellshëm dhe këta mund të meritojnë vëmendjen e posaçme të prindërve. Një fëmijë mund të tregohet i suksesshëm në shkollë dhe të marrë lëvdata më të shumta nga ana e prindërve.

Këto shprehje të jashtëzakonshme të dashurisë për shkak të kualiteteve speciale të fëmijëve nuk duhet të jenë jashtë atyre të zakonshmeve dhe nuk këshillohet përsëritja e shpeshtë e lavdërimeve të tilla.

Disa prindër, si strategji të nxitjes së konkurrencës ndërmjet fëmijëve, i flasin njëri tjetrit për kualitetet e mira të tjetrit. P.sh. ata mund të thonë: ‘Hasani po punon shumë për të arritur suksesin sa më të mirë në provim, sikur edhe Abasi’ ose ‘Zejnebi, ti duhet ta ndihmosh nënën tënde në punët e shtëpisë, sikur që po e ndihmon nënën Zehraja’, ‘Reza, zbatoji sjelljet e mira të tavolinës, sikur që po i zbaton vëllai yt Aliu. Sa djalë i sjellshëm është ai!’

Ky pozicion i prindërve nuk është i drejtë. Mund të mos sjellë rezultate pozitive dhe të dëshiruara. Përkundrazi, mund të krijojë ndjenja këmbëngulëse dhe xhelozie në mes

vëllezërve dhe motrave. Ata mund të bëhen hakmarrës dhe të shkojnë mbas krahasimeve të panevojshme në mes veti.

Edhe një arsye shumë e rëndësishme për përleshje ndërmjet fëmijëve është se prindërit presin që fëmijët të kenë mirëkuptime në mes veti. Fëmija dëshiron të luajë me lodrat e vëllezërve dhe motrave të tij; prindërit e ndalojnë prej kësaj. Kjo do të nxisë përleshjen në mes tyre. Në këtë moment prindërit duhet të intervenojnë. Së pari, duhet të provojnë t'i bindin fëmijët në mënyrë të butë që të qetësohen. Nëse mosmarrëveshja ende vazhdon, atëherë do të kërkojnë nga fëmijët që t'i kthejnë lodrat prej atyre që i kanë huazuar. Do t'i thoni se lodrat janë të atij, në emër të të cilit janë blerë fillimisht. Lodra nuk është pronë jotja. Nëse ende vazhdon të mos ia kthejë vëllait, atëherë prindërit më nuk do ta duan dhe nuk do t'i blejnë atij lodra tjera.

Fëmija do të mbetet pa përkrahje dhe do t'i ndajë lodrat e veta. Ai do të fillojë të mendojë se prindërit janë të padrejtë dhe se vëllai i tij është i keq. Ai do të zhvillojë urrejtjen për të dytë në zemrën e tij. Këtë urrejtje do ta shprehë sa herë që të paraqitet rasti. Kjo është shumë natyrale që një fëmijë të mendojë se lodra i takon atij dhe asnjëri nuk ka të drejtë të luajë me të pa miratimin e tij. Ai mendon se është bërë viktimë e padrejtësisë së prindërve dhe të vëllait të tij. Në këtë gjendje, fëmija ka të drejtë, sepse, së pari, ata nuk e lejojnë atë të luajë me lodrat që ia kanë dhënë vëllezërve dhe motrave të tij për të luajtur. Prindërit e vëmendshëm mundohen të krijojnë një frymë të kooperimit në mes të fëmijëve të tyre. Ata duhet të krijojnë një atmosferë miqësore, që fëmijët t'i ndajnë të gjitha lodrat dhe lojërat e tyre ndërmjet veti.

Ndonjëherë, arsyeja për shfaqjen e diferencave ndërmjet fëmijëve është se prindërit ia besojnë një detyrë një fëmije të veçantë, ndërsa fëmijëve të tjerë asnjë. Kjo

situatë mund të shkaktojë përlëshje. Për t'i evituar situatat e tilla, prindërit duhet t'u japin punë edhe fëmijëve të tjerë. Atëherë, nuk do të kenë ndjenjën e nënçmimit.

Ndonjëherë, edhe përlëshjet ndërmjet prindërve i inkurajojnë fëmijët të ndjekin shembullin e tyre. Kur fëmijët e pafajshëm shohin se prindërit e tyre janë grindavecë të pandreqshëm, ata do të fillojnë të mendojnë se përlëshjet janë mënyra e jetës. Gjatë imitimit të prindërve të tyre ata do të kërkojnë arsye për të filluar përlëshjen.

Prandaj, prindërit që janë të ngopur prej përlëshjeve të vazhdueshme të fëmijëve të tyre, duhet ta bëjnë analizën dhe reformimin e vetvetes. Ata duhet t'ia kushtojnë vëmendjen rregullimit të marrëdhënieve të drejta në mes të fëmijëve. Vështirë është të gjendet një familje që nuk kanë dallime të mendimeve në mesin e anëtarëve të saj. Por, nëse prindërit kujdesen që dallimet e tyre të mos vërehen në praninë e fëmijëve, atëherë fëmijët nuk do të inkurajohen për përlëshje dhe fjalosje. Edhe nëse ka ndonjë përlëshje të vogël në mes të fëmijëve, prindërit duhet të intervenojnë me maturi dhe ta zgjedhin çështjen në kënaqësinë e të gjithëve.

Në fund, dëshirojnë t'ju paralajmërojnë se përkundër të gjitha porosive, familja juaj mund të mos lirohet plotësisht prej përlëshjeve ndërmjet fëmijëve. Së fundi, fëmijët janë qenie njerëzore dhe instinkti për të luftuar ekziston te çdo individ. Në fakt, në përgjithësi fëmijët janë hiperaktivë dhe përlëshja mund të jetë një mënyrë e harxhimit të energjisë. Prindërit duhet të jenë të kujdesshëm që gjatë përlëshjeve, fëmijët të mos u shkaktojnë lëndime trupore njëri tjetrit si dhe gjësendeve përreth tyre. Ata nuk duhet të brengosen aq shumë nëse ndonjë fëmijë ka më shumë prirje për përlëshje. Kjo është një shprehje kalimtare dhe gjatë kohës do të zhduket.

Kapitulli i gjashtëdhjetekatërtë Shokët dhe miqësimi

Shoku i mirë është dhurata më e madhe nga Zoti. Gjatë kohërave të vështira, shoku është strehim për një person dhe ngushëllim për zemrën dhe shpirtin e tij. Në këtë botë, që është i mbushur plot me vështirësi dhe pengesa, prezenca e shokut të vërtetë është patjetër e nevojshme për çdo person. Ai që nuk ka asnjë shok, do të jetë sikur personi që rri i vetmuar larg shtëpisë. Ai nuk do të ketë askënd për ta ngushëlluar atë në kohërat e vështira.

Imam Musa Xhaferi ishte pyetur për burimin ideal të rehatisë në këtë botë. Imami tha:

“Një shtëpi e gëzuar dhe shumë shokë.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 177).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Personi më i dobët është ai që nuk mund të përfitojë askënd si shokë dhe vëlla.” (Nehxh ul belaga, v. 74, f. 154).

“Mospasja e shokëve është sikur të jesh i huaj në vendin tënd dhe vetmitar.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 179).

Sikur që njeriu i rritur ka nevojë për shokë, ashtu edhe fëmijët i dëshirojnë ata. Fëmija që nuk ka shokë, gjithnjë do të jetë i vetmuar dhe i braktisur. Sipas natyrës, fëmija ka nevojë për shoqëri dhe ai nuk mund ta mohojë këtë nevojë natyrale. Ekziston edhe një dallim i vogël në mes shokut dhe të njohurit. Ndoshta, fëmija mund të ketë të njohur por jo edhe shokë. Ndonjëherë, fëmija e zgjedh shokun nga shokët e klasës apo fëmijën e fqinjit. Shkaku për zgjedhjen e një shoku të veçantë mund të mos jetë i qartë. Ndoshta, ngjashmëria shpirtërore në mes tyre i ka sjellë ata së bashku.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Zemrat e njerëzve janë sikur nomadët shtegtarë; cilido që i dashuron ata, do t’i bashkëngjiten atij.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 178).

Shoku nuk mund t’i imponohet asnjërit. Prindërit nuk mund ta shtrëngojnë shumë fëmijën që të pranojë personin e caktuar si shok. Fëmija duhet të jetë i lirë për ta zgjedhur shokun. Kjo liri do të ketë disa kushte dhe kufizime. Karakteri dhe sjellja e shokut duhet të merren parasysh nga ana e prindërve para se të japin leje për zgjedhjen e shokut. Nëse fëmija zgjedh një shok të sjellshëm, ai do të përfitojë duke ia marrë shprehitë e tij të mira. Përkundrazi, nëse shoku i tij i ka shprehitë e padëshiruara, natyrisht që fëmija do të marrë disa shprehi prej tij. Janë plot fëmijë dhe të rinj që kanë rënë në moçalin e mëkatit për shkak të zgjedhjes së pavend të shokut.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Njeriu e ndjek besimin, rrugët dhe shprehitë e shokut.” (Usul al-Kafi, v. 72, f. 375).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Më të fatlumët janë ata që kanë lidhje me njerëzit e mirë.” (Gharar al hukm, f. 189).

Për këtë arsye feja e Islamit i nxit pjesëtarët e tij të përmbahen prej shokëve të këqij.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Shmanguni nga shoqërimi me personat mëkatarë, sepse e liga krijon të ligën.” (Bihar al-anvar, v. 74, f. 199).

Imam Zejnel Abidini i ka thënë djalit të tij, Imam Muhamed Bakirit:

“O djali im! Qëndro larg nga shoqërimin me pesë persona:

1. Mos u shoqëro me gënjeshtarin sepse ai do të jetë sikur vegimi dhe do të të mashtrojë. Kur një gjë është larg, ai do të thotë se është afër, dhe kur është afër dorës, ai do të thotë se është larg.

2. Mos u shoqëro me mëkatarin, sepse mund të të shesë për një çmim të ulët.

3. Mos u shoqëro me koprracin, sepse nuk do të të ndihmojë në kohërat e vështira.

4. Mos u shoqëro me njeriun e pamend, sepse do të të shkaktojë dëm me pamundësinë e tij. Ai mund të ketë qëllimin e mirë por veprimet e tij do të jenë të pamatura.

5. Mos u shoqëro me atë që i shkel të drejtat e të afërmeve të tij, sepse personat e tillë janë të dëbuar nga mëshira e Allahut dhe janë të mallkuar.” (Usul al-Kafi, v. 72, f. 376).

Prindërit e përgjegjshëm e të vëmendshëm nuk do të jenë plotësisht të shkujdesur për llojet e shokëve që fëmijët e tyre i kultivojnë. Duke ditur për llojin e shokëve që fëmijët i kanë, ata nuk duhet të paraqiten sikur po përzihen në çështjet e tyre personale.

Nëse prindërit mund t’ia sigurojnë një shok të mirë fëmijës së tyre, ata i kanë dhënë një kontribut të madh të ardhmes së tij morale. Por, kjo nuk është një punë e lehtë. Mënyra më e mirë është njoftimi i fëmijës me atë se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe për të kur ta arrijë moshën e të kuptuarit. Ata duhet t’ua shpjegojnë fëmijës për anët negative që mund të paraqiten nga shokët e padëshirueshëm.

Prindërit duhet t’i përcjellin veprimet e fëmijëve dhe të shokëve të tij nga një distancë. Nëse vërejnë se shokët janë të mirë, duhet t’i çmojnë ata. Ata duhet t’i japin mundësi fëmijës të njoftohet me shokë të tillë. Nëse ata vërejnë se fëmija e ka zgjedhur shokun e padëshiruar, atëherë duhet të mundohen me maturi që ta ndërpresin shoqërimin me të. Nëse fëmija këmbëngul për një shoqërim të tillë, atëherë merreni çështjen më me seriozitet.

Prindërit mund t’i ndihmojnë fëmijës për gjetjen e shokëve të mirë me një metodë tjetër. Ata duhet t’i

zgjedhin fëmijët e fqinjëve me sjellje, karakter dhe mjedis të mirë. Krijoni mundësi që fëmijët të takohen dhe të luajnë njëri me tjetrin. Nëse bëhen shokë, atëherë përforconi shoqërimin. Në këtë mënyrë, edhe nëse ka ndonjë të metë të vogël tek ata fëmijë, ata mund të tërhiqen në shoqërinë e fëmijëve të mirë. P.sh nëse fëmija është i turpshëm, ai mund ta tejkalojë druajtjen e tij duke u bërë shok me fëmijët guximtarë.

Prindërit nuk duhet të bëhen plotësisht të pavëmendshëm për llojin e shokëve të fëmijës, posaçërisht kur fëmija është në pragun e rinisë. Kjo është periudha e jetës së tij kur shprehitë fillojnë të lëshojnë rrënjë. Çdo neglizhencë nga ana e prindërve, mund të rezultojë me dëmtimin e pariparueshëm të karakterit dhe të sjelljes së fëmijës, nëse ai këmbëngul në shoqërimin me shokët e këqij. Ata duhet ta mbajnë në mend thënien: Parandalimi është më mirë sesa shërimi.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Çdo gjë e ka fatkeqësinë (kiametin) e vet, dhe fatkeqësia e virtytit është shoku i keq.”

Një zotëri shkruan:

“Prindërit asnjëherë nuk më lejonin të takohem me shokët e mi. Nëse ndonjëherë shokët e mi më vizitonin, unë mundohesha t’i largoja sa më shpejt mbas një bisede të shkurtër me ata. Një shok imi jetonte afër shtëpisë sonë. Prindërit e mi e njihnin mirë por nuk më lejonin ta vizitonim njëri tjetrin. Unë dëshiroja të kisha shokë, t’i takoja dhe të luaja me ta. Por, prindërit e mi ishin pengesë dhe unë isha shumë i pikëlluar për këtë. Njëherë vendosa ta vizitoja atë shok, pa marrë parasysh çmimin. I thashë nënës se më duhet të shkoj në një provim. Mora leje për të shkuar në provim, por unë shkova drejt te shtëpia e shokut tim. Aty kishin ardhur edhe fëmijët e tjerë dhe u kënaqëm duke luajtur bashkë. Kur u ktheva në shtëpi, nëna më pyeti se pse

isha vonuar aq shumë. Për të fshehur një gënjeshtër, unë e shqiptova edhe një tjetër. Tani, pyetem se a ishte nëna ime e vetëdijshme se edhe fëmijët kanë nevojë për shoqërim dhe shokë. Pse më kanë shtrënguar aq shumë?”

Një vajzë shkruan:

“Njëherë pata thirrur disa shoqe të klasës në shtëpi. Pata kursyer ca para nga paratë e xhepit dhe me këto vrapova te dyqani ushqimor dhe i bleva disa akullore. Nëna ime nuk ishte në shtëpi. Përderisa ishim duke ngrënë akullore, ajo u kthye dhe unë u frikësova shumë se mos po më qorton. Pa menduar fare për ndjenjat e mia, ajo u drejtua kah shoqet e mia me zemërim dhe tha: ‘Ju vajza, keni ardhur këtu dhe po i shpenzoni paratë e Saimes’. Shoqet e mi përnjëherë u ngritën dhe dolën jashtë. Nëna ime nuk u ndal me kaq. Të nesërmen ajo e vizitoi shkollën dhe iu ankua mësueses se shoqet e mi kanë vizituar shtëpinë dhe më patën nxitur të shpenzoja para për të blerë akullore. Shoqet thanë ‘Ne jemi të gatshme të paguajmë çmimin e akullores që e kemi ngrënë dje në shtëpinë tuaj’. E ndjeva veten shumë të turpëruar dhe të zhvleftësuar saqë dëshiroja që toka të çahet dhe të hyja nën të. Prej asaj dite më nuk shkova në shkollë. Të gjitha shoqet e mi përparuan në studime. Sot jam një person i vetmuar dhe i dëshpëruar, i mbetur prapa të gjitha pozitave shoqërore.”

Kapitulli i gjashtëdhjetepesë Fëmija dhe edukata fetare

Qeniet njerëzore tërhiqen në mënyrë instinktive drejt Zotit dhe religjionit. Burimi i këtij instinkti është në brendinë e natyrës së njeriut.

Allahu, në Librin e Shenjtë thotë:

“Drejtoje fytyrën tënde kah religjioni i drejtë, me devocionin natyral ndaj së vërtetës, duke e ndjekur natyrën që është dhënë nga ana e Zotit dhe sipas së cilës i ka krijuar njerëzit.” (Kuran: 30,30).

Sipas natyrës, çdo fëmijë është adhurues i Zotit, por ndikimi i mjedisit të jashtëm mund t’i shkaktojë ndryshime gjendjes së tij; siç ka thënë i Dërguari i Islamit:

“Çdo fëmijë ka lindur me natyrën Islame, por më vonë prindërit e tij mund ta bëjnë hebre, të krishterë apo zoroastrian.” (Bihar al-anvar, v. 3, f.281).

Është përgjegjësi e prindërve të lindin fëmijën në një mjedis të tillë që instinkti natyral i religjionit që i është dhënë çdo njeriu, të zhvillohet në mënyrë të duhur. Prej asaj dite që fëmija vjen në këtë botë, ai tërhiqet drejt Fuqisë që do t’ia sigurojë nevojat e tij. Por, fëmija nuk do ta ketë të zhvilluar të kuptuarit për të shprehur ndonjë gjë për Fokusin e vëmendjes së tij. Gjatë kohës, të kuptuarit lind te fëmija. Fëmija që rritet në një familje fetare, fillon ta njohë Allahun përafërsisht prej moshës katërvjeçare. Kjo është mosha kur pyetjet e shumta fillojnë të qarkullojnë rreth mendjes së tij. Ndonjëherë e përmend emrin e Allahut. Pyetjet e tij tregojnë se natyra e tij është duke u zgjuar dhe lakmon të mbledhë sa më shumë informata.

Fëmija mendon për këto:

- Kush e krijoi Diellin?
- Kush e ka krijuar Hënën dhe yjet?

- A më do Allahu mua?
- A i do Allahu gjërat e ëmbla?
- Kush e sjell shiun?
- Kush e ka lindur babanë tim?
- A e dëgjon Allahu të folurit tonë?
- Ku jeton Allahu?
- Si duket fytyra e Tij?
- A jeton Allahu në qiell?

Që nga mosha katërvjeçare fëmija fillon të parashtrorë mijëra pyetje të tilla. Prej këtyre pyetjeve është e qartë se instinkti i besimit është duke u zgjuar tek ai. Duke i parashtruar këto pyetje, ai mundohet ta shuajë etjen e tij për njohuri. Nuk është e njohur se çfarë mendimi për Allahun ka fëmija në atë moshë. Ai ndoshta mendon se Allahu është sikur babi i tij, porse është më i madh dhe më i fuqishëm. Me rritjen e tij, do të rritet edhe kuptimi i tij për Allahun. Prindërit bartin barrën e madhe të përgjegjësisë në këtë moshë. Ata duhet të luajnë rolin kritik në formimin e besimit të fëmijës. Nëse prindërit janë të pakujdesshëm në këtë moshë, ata do të jenë subjekt i ndëshkimit të rëndë në Ditën e Gjykimit. Ata duhet t'u përgjigjen me kujdes të gjitha pyetjeve që i parashtron fëmija i tyre. Nëse i shmangen përgjigjes në ndonjë pyetje për ndonjë arsye, ata mund të shuajnë dëshirën e fortë të fëmijës për hulumtim. Por, mund të jetë vështirë për t'u dhënë përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve. Përgjigjet duhet të jenë korrekte, të shkurtër dhe të treguara me fjalë të thjeshta. Me rritjen e tij ai do të bëhet i aftë t'i kuptojë informatat më të vështira. Prindërit duhet ta përgatitin veten për t'u përgjigjur pyetjeve të mundshme që fëmija mund t'ua parashtrorë atyre. Ata nuk duhet t'i japin fëmijës ndonjë informatë që është jashtë të kuptuarit të tij. Përgjigjet e tilla mund ta hutojnë fëmijën, në vend se ta shuajnë etjen për njohuri.

Edukimi fetar i fëmijës duhet të jetë i tillë që të jetë në gjendje ta kuptojë me lehtësi.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Kur fëmija e arrin moshën trevjeçare, mësojeni të thotë ‘La ilahe ilallah’. Pastaj, mësojeni të qetë. Kur fëmija e arrin moshën tri vjet e shtatë muaj e njëzetë ditë, mësojeni të thotë ‘Muhammed resulallah’. Mësojeni të qetë derisa t’i mbushë katër vjet dhe pastaj mësojeni salavatën e të Dërguarit” (Makarim al ahlak, v. 1, f. 254).

Mësojeni fëmijën tuaj recitimin e disa vargjeve në lidhje me çështjet fetare. Ky do të jetë një ushtrim interesant për të. Mësojeni për të Dërguarin dhe Imamët. Së pari duhet t’i tregoni atij se Allahu e ka dërguar të Dërguarin për të udhëhequr njerëzimin. Pastaj, duhet t’i tregoni për cilësitë e tij të larta dhe për mënyrën shembullore të jetës së tij. Tregoni për disa ngjarje interesante nga jeta e të Dërguarit. Pastaj, duhet t’i tregohet për pasardhësit e të Dërguarit dhe për vazhdimësinë e udhëheqjes së drejtë të njerëzve mbas vdekjes së tij. Të gjitha njohuritë duhet që t’i tregohen fëmijës në formën e tregimeve të shkurtra, në mënyrë që ta mbajë interesimin e tij të vazhdueshëm.

Në lidhje me vdekjen dhe ringjalljen (Kiametin), fëmija nuk i kushton aq vëmendjen në atë moshë. Ai mendon se prindërit e tij do të jetojnë në lumturi gjithmonë. T’i flasësh fëmijës për vdekjen në atë moshë të ndjeshme, mund të mos jetë e dëshirueshme. Fëmija mendon se njerëzit që vdesin shkojnë në një rrugëtim të gjatë. Ndonjëherë, ndodhin tragjeditë nëpër familje, përderisa fëmijët janë ende të vegjël. Nën këto rrethana, prindërit duhet t’ua përmendin temën e vdekjes atyre. Nëse, fatkeqësisht, i vdes gjyshi i tij, ai mund të pyesë: ‘Nënë, ku ka shkuar gjyshi?’

Në situata të tilla, duhet t'i shpjegohen fëmijës faktet. Fëmijës mund t'i thuhet se gjyshi më nuk është. Ai ka shkuar në botën tjetër. Çdokush që vdes do të shkojë në atë botë. Nëse është person i mirë në këtë botë, ai do të pushojë në Xhenet, ku ekzistojnë kopshte të bukura. Nëse personi që vdes ka qenë i keq gjatë jetës së tij, ai do të shkojë në Xhehenem, që është i mbushur plot me zjarr. Fëmija duhet të informohet ngadalë për pashmangshmërinë e vdekjes. Atij duhet t'i tregohet se kjo botë është e kalueshme dhe se çdokush do të shkojë në botën tjetër.

Kjo mënyrë e thjeshtë e shpjegimit duhet të vazhdojë përderisa fëmija ta kryejë shkollën fillore dhe të mesme.

Kapitulli i gjashtëdhjetegjashtë

Fëmija dhe obligimet fetare

Është e vërtetë se fëmija e arrin fazën e përgjegjësisë në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare dhe vajzat në moshën nëntëvjeçare. Kjo është moshë kur normat juridike bëhen të detyrueshme për ata. Kryerja e obligimeve fetare nuk mund të shtyhet përderisa fëmija ta arrijë në atë moshë. Ata duhet të inkurajohen për t'i kryer obligimet fetare qysh prej fëmijërisë së hershme, që kur të bëhet e detyrueshme, veç e kanë të përvetësuar shprehinë e plotësisimit të tyre. Fatmirësisht, në familjet fetare, fëmija fillon t'i imitojë fëmijët gjatë kryerjes së riteve fetare. Ndonjëherë, e shtrin sexhaden në tepih dhe ndonjëherë e vendos kokën në tokë duke u falur bashkë me prindërit. Ai përsërit Allahu Ekber dhe La ilahe ilallah me prindërit e tij. Ai do të recitojë suret e shkurtra bashkë me nënën. Prindërit e vëmendshëm e shfrytëzojnë pozitivisht këtë instinkt natyral të fëmijës për të imituar. Nëse fëmija i bën këto gjëra, prindërit do t'i japin buzëqeshjen e çmuarjes. Nuk duhet të përdoret elementi i forcës, në mënyrë që të detyrohet fëmija t'i mësojë ritet religjioze. Prindërit nuk duhet t'i fillojnë mësimet formale të religjionit në fëmijërinë e hershme. Në moshën pesëvjeçare, fëmija mund të mësojë recitimin e sures Fatiha të Kuranit të Shenjtë. Kjo duhet të bëhet ngadalë gjatë disa ditëve, në mënyrë që të mbahet interesimi i fëmijës për recitim. Në moshën shtatëvjeçare, prej fëmijës duhet të kërkohet kryerja e namazeve të rregullta. Vetë prindërit duhet të bëhen shembull për fëmijët, që ata t'i falin pesë kohët e namazit, rregullisht dhe në kohën e vet hyrëse. Në moshën nëntëvjeçare detyroni fëmijët t'i falin namazet e rregullta. Ata duhet t'u shpjegojnë fëmijëve se namazet janë të obliguara kur janë në shtëpi dhe kur janë në udhëtim. Nëse

fëmija nuk falet, atëherë prindërit duhet të merren me të seriozisht. Nëse prindërit e falin rregullisht namazin, ata mund ta mësojnë lehtë fëmijën që t'i pasojë ata. Kur fëmijët e arrijnë moshën e përgjegjësisë, ata do të kryejnë me rregull namazet e obliguara. Nëse prindërit e arsyetojnë fëmijën se është ende i vogël, dhe se do ta mësojnë të falet kur të rritet, atëherë do të jetë shumë vështirë për të iniciuar namazin e rregullt të fëmija. Është një besim i përgjithshëm se shprehinë ndërrohen vështirë. Për këtë arsye i Dërguari i Islamit dhe Imamët e Shenjtë kanë kërkuar prej prindërve që të iniciojnë faljen e namazit prej moshës gjashtë apo shtatëvjeçare.

Imam Muhamed Bakiri, ka thënë:

“Ne i inkurajojmë fëmijët tanë të fillojnë faljen e namazit prej moshës pesëvjeçare, dhe prej moshës shtatëvjeçare ne i urdhërojmë ata që të falen pesë herë në ditë.” (Vasail al-shiah, v. 3, f. 12).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kur fëmijët tuaj e arrijnë moshën gjashtëvjeçare, urdhërojini ata të falen. Kur bëhen shtatëvjeçarë, kërkonin prej tyre më me përpikëri faljen e rregullt. Nëse është e domosdoshme, ndëshkojini ata nëse nuk e falin rregullisht namazin.” (Mustadrak al-vasail, v. 1, f. 171).

Imam Muhamed Bakiri apo Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Kur fëmija bëhet shtatëvjeçar, kërkonin ta lajë fytyrën, këmbët dhe duart para se ta falë namazin. Kur ta arrijë moshën nëntëvjeçare, mësojani mënyrën e saktë të marrjes së abdesit. Kjo është koha kur fëmija duhet të udhëzohet për faljen e rregullt të namazit.” (Vasail al shiah, v. 3, f. 13).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Kur fëmija të arrijë moshën gjashtëvjeçare, atëherë është e domosdoshme të mësojë faljen e namazit dhe nëse

ka aftësi fizike, duhet të inkurajohet të agjërojë gjatë muajit të Ramazanit.” (Vasail al shiah, v. 3, f. 12).

Fëmija duhet të nxitet ngadalë për të agjëruar gjatë Ramazanit.. Fëmija që është fizikisht i aftë për të agjëruar, duhet të ngrihet për syfyr, ta hajë atë në vend të mëngjesit në kohën e rregullt të mëngjesit. Nëse fëmija është i disponuar të agjërojë tërë ditën, inkurajojeni që ta kompletojë. Por, nëse gjatë ditës fëmija ndjen dobësi, mund t’i lejohet ta ndërpresë agjërimin para kohe. Numri i ditëve të agjëruara të fëmijës mund të rritet gradualisht për çdo vit. Kur fëmija e arrin moshën e kuptimit, ai duhet të udhëzohet se është i obliguar t’i falë pesë kohët e rregullta të namazit dhe të agjërojë gjatë tërë ditës në muajin e Ramazanit. Nëse nuk është i rregullt në pajtim me këtë, ai do të jetë mëkatar dhe do ta meritojë ndëshkimin nga ana e Allahut. Prindërit duhet t’ia shpjegojnë fëmijës përparësitë dhe shpërblimet e agjërimit gjatë muajit të Ramazanit. Kjo do ta inkurajojë atë më shumë për të agjëruar. Gjatë ditëve të fundit të Ramazanit, lehtësoni detyrat tjera të tij. Atij duhet të lejohet pushimi më i madh gjatë ditës. Në fund të periudhës agjëruese, fëmijës duhet t’i jepet ndonjë dhuratë si inkurajim për përpjekjet e tij. Gjatë periudhës agjëruese, prindërit duhet të kujdesen që fëmijët të mos tentojnë të hanë diçka fshehtas nga të tjerët.

Është e domosdoshme që prindërit t’i udhëzojnë fëmijët në kohën e duhur në lidhje qitjen e spermës në gjumë që e arrijnë në pubertet. Atyre duhet thënë të marrin *gusl*-in (larja e obligueshme mbas daljes së spermës) dhe të bëjnë *intinxha* (larja e organit gjenital me ujë mbas urinimit).

Është e domosdoshme të përmendim këtu se, nëse dëshirojnë që fëmijët e tyre të bëhen vizitorë të rregullt të xhamive dhe institucioneve fetare, atëherë ata duhet ta mësojnë fëmijën me këtë shprehi që nga fëmijëria. Ata

duhet t'i çojnë në xhamia dhe në vende ku mbahen ligjërata fetare. Këto vizita do të krijojnë një interesim te fëmija për të shkuar në namazin e përbashkët.

Në fund, nuk do të jetë e tepërt që të përkujtojmë se para arritjes së moshës së të kuptuarit, nuk është e detyrueshme që fëmija t'i bashkohet riteve të detyrueshme fetare. Nëse nuk mund t'i kryejë ritet e caktuara në kohë të caktuar, ai nuk është duke bërë ndonjë mëkat.

Nuk është e drejtë për prindërit që t'i lënë fëmijët plotësisht të pavarur për të bërë çfarëdo që dëshirojnë vetë. P.sh. fëmijës duhet t'i thuhet se nëse ai, në pafajësinë e tij, u shkakton ndonjë dëm trupor të tjerëve, ai duhet të paguajë gjobën për këtë, kur ta arrijë moshën e të kuptuarit. Në anën tjetër, nëse fëmija lihet krye në vete, pa ndonjë kontroll apo ngjashëm, ai mund të fitojë shprehinë e kryerjes së mëkatit dhe të veprimeve të gabuara. Një thënie thotë: "Shprehitë e vjetra vdesin vështirë." Shprehitë e kultivuara gjatë fëmijërisë mbesin brenda personit, sado që ndonjëri mundohet t'i zhdukë ato. Prandaj, është e domosdoshme që prindërit t'i udhëzojnë fëmijët për të lejuarat dhe të ndaluarat prej ditëve më të hershme të tij. Ata duhet ndalur nga kryerja e veprave të ndaluara dhe t'i inkurajojnë për veprat e mira.

Kapitulli i gjashtëdhjeteshtatë

Mendimi politik dhe social

Fëmijët e sodit janë rinia e së nesërme. Ata do t'i udhëheqin çështjet e shoqërisë në të ardhmen. Të kuptuarit dhe vetëdija e tyre për obligimet ndaj shoqërisë do të jenë të një rëndësie madhore për ta. Ata do të jenë ruajtësit e begatisë kulturore dhe ekonomike të kombeve. Ata do të duhet të përpiqen për të mirëmbajtur dhe përparuar madhësitinë e vendlindjes së tyre. Ata do të duhet të përballen me agresorin imperialist dhe të luftojnë kundër makinacionit të tyre. Prandaj, fëmijët duhet të përgatiten që nga ditët e hershme për t'i shërbyer vendit të tyre. Përgjegjësia më e madhe për përgatitjen e tyre do të bjerë mbi supet e prindërve.

Edhe bazat e trajnimit politik dhe social duhet të vendosen në fëmijërinë e një personi. Gjatë kohës, fëmija e arrin fazën e rinisë dhe ai duhet të jetë i vetëdijshëm për problemet sociale dhe politike të shoqërisë në të cilën jeton. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm për varfërinë dhe prapambetjen e vendit. Cilësitë e mira dhe dështimet e udhëheqësve aktualë, duhet t'u tregohen fëmijëve që janë në pragun e rinisë. Ata duhet të njoftohen me pikat e dobëta të udhëheqjes së shoqërisë. Ai duhet të dijë për kushtet e përgjithshme që mbizotërojnë në qytete dhe fshatra. Fëmija mund të mos e ketë ende të drejtën e votimit dhe mund të mos e hedhë votën. Prindërit duhet t'i shpjegojnë atij qëllimin e zgjedhjeve dhe mbajtjen e tyre. Ata duhet t'i shpjegojnë atij se si duhet ta zgjedhë kandidatin më të mirë prej listës konkurruese të atij rajoni. Prindërit duhet t'u japin fëmijëve shembullin e tyre personal, që ata kanë votuar për ndonjë kandidat të posaçëm për shkak të kualiteteve të veta që i ka. Fëmija mund të marrë pjesë në mbledhjet zgjedhore dhe në tubime. Ai mund t'u bashkohet

sloganeve lartësuese të kandidatëve. Ai mund të shpërndajë pamfletet e kandidatëve për të cilët mendon se meritojnë të zgjidhen. Kjo punë do ta nxisë vetëdijesimin e tij. Revolucioni i Iranit ka dëshmuar se fëmijët dhe rinia mund të kontribuojnë shumë në proceset politike të një vendi. Ishin të rinjtë ata që me sloganet, mbledhjet, protestat dhe pjesëmarrjet aktive kanë ndikuar në kapitullimin e regjimit shtypës. Ata e kanë çliruar popullin e shtypur të Iranit nga kthetrat e agjentëve puthadorë të Shahut. Bota e di se revolucioni i Iranit ka arritur sukses për shkak të sakrificave të mëdha të rinisë.

Është e domosdoshme që fëmijët të studiojnë situatën politike të vendit të tij, në veçanti, dhe të botës, në përgjithësi. Ata mund ta bëjnë këtë duke e kultivuar shprehinë e leximit të gazetave të mira për çdo ditë. Po ashtu, mund të shikojnë dhe të dëgjojnë buletin e lajmeve në televizion dhe në radio. Ata mund të kenë diskutime grupore me prindërit dhe shokët. Në këtë mënyrë, ata mund të zhvillojnë interesimin për mirëqenien e shtetasve dhe të vetvetes. Ky proces do të ndihmojë që fëmija të zhvillojë vetëdijen e mirë politike dhe sociale. Padyshim, e ardhmja e shtetit do të jetë në duart e tyre dhe të të rinjve tjerë të shumtë të atij vendi. Fëmijët duhet të dinë se jeta e kësaj bote nuk mund të ndahet prej asaj të ardhshmes dhe, ngjashëm, feja asnjëherë nuk mund të ndahet nga proceset politike. Rinia e vendit duhet të lidhet aktivisht me ndodhitë politike dhe shoqërore të vendit. Rinisë duhet t'i jepet më tepër liri e zgjedhjes për të marrë pjesë në proceset politike të vendit.

Kapitulli i gjashtëdhjetetë Fëmija dhe radioja e televizioni

Radioja, televizioni dhe kinemaja janë zbulime shumë të dobishme. Ato mund të jenë vegla shumë të mira për trajnim dhe edukim. Parimet e besimit dhe të moralit mund të përhapen përmes këtyre medieve. Mendimet e njerëzve mund të forcohen përmes këtyre medimeve. Informatat në lidhje me zhvillimet e agrikulturës dhe të industrisë mund të përhapen përmes tyre. Edhe informatat për aspektet e shëndetit dhe të higjienës mund të popullarizohen përmes tyre.

Njeriu mund të nxjerrë dobi të shumta prej këtyre medieve elektronike. Mirëpo, përderisa i kanë dobitë e tyre, ato mund të kenë edhe dëmet e tyre. Kur këto medie bien në duart e afaristëve të papërgjegjshëm, ato mund t'i keqpërdorin dhe të krijojnë probleme të tmerrshme për shoqërinë. Për përfitimet sa më të mëdha të tyre personale, ata i prezantojnë programet që janë të dëmshme për shëndetin, moralin, besimin dhe për ekonominë e përgjithshme të shoqërisë. Radioja dhe televizioni përdoren me të madhe ditëve të sodit. Shumica e njerëzve i konsiderojnë ato si burime të argëtimit dhe të rekreacionit. Fëmijët dhe rinia janë të lidhur, në kuptimin e plotë të fjalës, për këtë kuti idiote.

Njerëzit e informuar mirë janë të mendimit se fëmijët iranianë janë më shumë të lidhur për televizionin sesa fëmijët e vendeve të zhvilluara si, Amerika, Franca, Britania e Madhe dhe Japonia. Në Iran 40 % e shikuesve janë fëmijët, 20 % rinia dhe të tjerët janë të moshuarit. Duhet të mbahet në mend se fëmijëria dhe rinia janë kohërat e lulëzimit të edukimit dhe të mësuarit. Qofshin programet e radios e të televizionit, të mira apo të këqija, ato do të kenë ndikim në mendjet e ndjeshme të fëmijëve.

Shikimi i këtyre programeve nuk duhet të konsiderohet si kalim i padëmshëm i kohës. Fëmijës nuk duhet t'i jepet liria e shikimit apo e dëgjimit të programeve sipas dëshirës së tyre. Padyshim që shumë programe do të jenë të dëmshme për psikologjinë e fëmijëve. Producentët e programeve të radios dhe të televizionit duhet t'ia bëjnë analizën vetvetes në lidhje me dëmet që u shkaktojnë mendjeve delikate të fëmijëve, duke i prezantuar programet që janë shumë të dëmshme për fëmijët dhe rininë. Për ata mund të jetë liria e të shprehurit ajo që i nxit për t'i bërë ato akte të papërgjegjshme, por për fëmijët dhe rininë, shikimi i këtyre programeve me interesim të madh do të jetë një humbje e madhe. Edhe prindërit mbajnë përgjegjësi dhe ata duhet t'i mbikëqyrin me kujdes fëmijët e tyre të mos i shikojnë programet e tilla, dhe t'i ndalojnë t'i shikojnë programet e këqija.

Pjesa më e madhe e programeve televizive përmbajnë filmat dhe seritë që kanë të bëjnë me tregimet për krimet, tmerrret, vrasjet, luftimet, mashtrimet, plaçkitjet, etj. Fëmijët i shikojnë programet e tilla me interesim të madh. Këto tregime mund të jenë të dëmshme për fëmijët në shumë mënyra, për shembull:

1. Mendjet e ndjeshme të fëmijëve janë shumë të hapura ndaj ndikimit të jashtëm. Shikimi i programeve të tilla te fëmijët mund të zhvillojë shqetësimin, frikën dhe tmerrin në mendjet e tyre. Ata mund të kenë gjumin e trazuar gjatë natës dhe të zgjohen duke bërë mbasi që i kanë parë ëndrrat e këqija. Ata mund të fitojnë dhimbje kronike të kokës. Në rastet ekstreme, mbas shikimit të filmave të tmerrit atyre mund t'u bjerë të fikët dhe ta humbin vetëdijen.

2. Filmat e tillë mund të kenë efekte të dëmshme në moralin e fëmijës që i shikon ata filma. Këta filma mund të motivojnë fëmijën të kryejë krime dhe mëkate. Ndonjëherë

fëmijët janë aq shumë të impresionuar me mburrjet e heroit të filmit sa që mundohen ta imitojnë atë në jetën reale dhe të hidhen në telashe.

UNESCO-ja ka regjistruar në njërin prej raporteve të tij se 27 % e të rinjve të dënuar janë motivuar për aktet e tilla mbas shikimit të akteve të ngjashme nëpër filma. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mesin e krimeve të kryera nga ana e të rinjve që janë dënuar nga gjykata, 10 % e djemve dhe 25 % e vajzave kanë pranuar se për kryerjen e atyre krimeve janë motivuar prej filmave që i kanë shikuar. (Majxhalla Maktab Islam, v. 15, No.1).

Duke u bazuar në një hulumtim tjetër, prej 49 % të krimeve të kryera me armë zjarri, 28 % janë kryer nga ana e vjedhësve ndërsa 21 % nga ana e atyre që janë inspiruar prej filmave që i kanë shikuar. Po ashtu, është raportuar se 25 % e grave që i bëjnë shëtitjet nëpër rrugë, inspirimin e kanë marrë nga filmat që i tregojnë tregimet e tilla. 54 % e femrave kanë shkuar nëpër shtëpi me reputacion të keq duke i imituar aktorët e famshëm të kinemasë. (Maxhalla Maktab Islam, v. 15, No 11).

Profesori i Universitetit të Los Angelesit, Walsman, thotë:

“Rrezatimi që e emeton ekrani i televizionit është shumë i dëmshëm për organet e njeriut. Rrezet që dalin nga televizioni dhe nga aparatet tjera elektronike të shtëpisë janë prej morisë së valëve të shkurtra dhe efekti i parë negativ është se ato u shkaktojnë dhimbje koke atyre që u janë të ekspozuar për një kohë më të gjatë. Kapaciteti mendor i njeriut do të frenohet, tensioni i gjakut do të bëhet jonormal dhe rruazat e bardha të gjakut do të dëmtohen. Këto valë do të kenë ndikim të madh në nerva dhe do të shkaktojnë disa sëmundje.” (Maxhalla Maktab Islam, v. 18, No 1).

Dr. Aleksis Karl shkruan:

“Radioja, televizioni dhe lojërat e papërshtatshme kompjuterike i shkatërrojnë emocionet e fëmijëve.” (Maxhalla Maktab Islam, v. 15, No 3).

Në numrin 15743 të gazetës “*Daily Ittelaat*” është paraqitur raporti për një nxënës evropian:

“Një nxënës 18 vjeçar i kolegjit është burgosur dhe është paraqitur në gjykatë. Ai akuzohej se e kishte kidnapuar djalin e një aktori të një filmi, ku për lirimin e tij kërkonte 50.000 \$ dhe se kërcënonte se do ta vriste nëse kjo shumë e të hollave nuk i paguhej. Në deklaratën e tij të dhënë në gjyq, i akuzuari pranoi se idenë për kryerjen e këtij akti e ka marrë nga një film që e kishte shikuar në televizion me një skenar të ngjashëm.

Policia ishte e mendimit se në disa raste të tilla motivacionin për kryerjen e krimeve, rinia e merr duke i shikuar filmat në televizion. Një djalosh dhjetëvjeçar në Meshhed, mbasi që kishte shikuar një film karate, e kishte goditur shokun e vet aq rëndë, saqë shoku i tij ishte rrëzuar dhe kishte vdekur në vend.” (Maxhalla Maktab Islam, v. 15, No 11).

Zëvendësministri i arsimit, z. Safi Nija, thotë:

“Kur është televizioni aty për t’i siguruar mësimet e liga, edhe arsimtarët më të mirë nuk mund të bëjnë asgjë.” (Maxhalla Maktab Islam, v. 18, No 1).

Një djalosh kubanez, Roni Zamora, kishte mbytur një grua 83 vjeçare. Ai e bëri këtë krim në Florida dhe tani është duke e vuajtur atje dënimin me burgim të përjetshëm. Prindërit e tij e kanë paditur një kanal televiziv amerikan, duke kërkuar dëmshpërblim në shumën prej 2.500.000 \$, me pretekstin se ai kanal e ka prodhuar dëshminë me të cilën djaloshi është mësuar për vrasjen pa paramendim nga programi i këtij kanali televiziv. Në shtatorin e kaluar ishte mbajtur dëgjimi në lidhje me këtë rast. Në gjykatë u përmend se ky djalosh kishte dëshirë të madhe të shikojë

televizionin dhe kishte zakon të ulej para televizionit tetë orë. Një natë para krimit, i riu kishte shikuar një film në televizion në të cilin ishte përshkruar plaçkitja në shtëpinë e një gruaje të pasur.

Një vajzë 15 vjeçare me emrin Razaia kishte shikuar një film të tmerrit. Ajo ishte tmerruar aq shumë duke e shikuar atë film sa që ra në tokë dhe vdiq. Kur kishte parë në film se si një person i bardhë ishte duke ia hequr lëkurën e kokës së një vajze zezake, ajo bërtiti e tmerruar dhe zemra e saj përmjeherë u ndal së rrahuri. Mjekët thanë se ajo kishte gjakderdhje në kokë.

Dr Xhelal Baremani, një ekspert i psikiatrisë, thotë:

“Filmat e tmerrit dhe të aventurave kanë ndikim negativ në mendjet e fëmijëve. Është vërejtur se një fëmijë që e shikon një film ku përshkruhet dhuna, do të provojë të imitojë heroin dhe do ta rrahë vëllanë apo motrën e vet. Filmat e tillë mund të kenë ndikim shumë negativ në personalitetin e ardhshëm të fëmijës. Duke i shikuar filmat e tmerrit, fëmija mund të bëhet frikacak dhe i turpshëm. Filmat e dhunës i motivojnë të bëhen të dhunshëm. Ndikimi i këtyre ekspozimeve do të jetë në mendjet e personave, dhe ata vetë mund të motivohen t’i kryejnë aktet e dhunës.

Një psikiatër tjetër, Dr Shukr Allah Tarikati, thotë:

“Ndikimet e shikimit të filmave të këqij nuk mund të mohohen në mendjet e fëmijëve. Këta filma kanë aq shumë ndikime negative te fëmijët, sa që kur të rriten, ata mund të kryejnë akte të gabuara nën ndikimin e filmave që i kanë shikuar shumë më herët. Prandaj, unë i këshilloj prindërit që të mos i lejojnë fëmijët t’i shikojnë filmat që janë prodhuar dhe certifikuar për t’i shikuar vetëm të rriturit. Ata duhet të sigurojnë që fëmijët të mos i shikojnë filmat në televizion mbas orës 10 të mbrëmjes sepse, në përgjithësi, këta janë filma për të rriturit.”

Profesori i Universitetit të Teheranit dhe ekspert i kriminalistikës, Dr Reza Mazlumi, thotë:

“Shumica e filmave që shfaqen në televizion dhe kinema janë të dëmshëm për shoqërinë tonë. Efektet e tyre janë aq të rrezikshme sa që duke e shikuar filmin, vajza e humb jetën e saj për shkak të sulmit në zemër mbasi të shikojë një film të tmerrit. Unë mund të them me guxim se shumica e krimeve dhe akteve të terrorit në këtë botë, janë drejtpërdrejtë të lidhur me efektet e shikimit të filmave.” (Daily Ittelaat, 10 Aban, 1352).

Dr Arnold Fremani, që punon në një spital të Nju Jorkut, ka dëshmuar përmes pajisjeve elektronikës më të sofistikuar se dhimbjet e kokës dhe dobësitë nervore të një personi janë pasojë e dëgjimit të muzikës së gjëmuar nga FM radio stacionet.” (Maxhalla Maktab Islam, v. 15, No 3).

Gazeta “The Times”, në njërin prej numrave të tij të vitit 1964, shkruan:

“Një pediatër ka bërë vrojtime në dy baza të forcave ajrore te fëmijët e stafit që punonin aty. Ata ishin ndarë në grupe prej 3 deri 12 vjeçar dhe vazhdimisht ankoheshin prej dhimbjes së kokës, pagjumësisë dhe problemeve të stomakut si diarreja. Nga aspekti mjekësor, ata nuk ishin në gjendje të gjejnë shkakun e simptomave. Mbas një hulumtimi të detajuar është gjetur se fëmijët kalojnë shumë kohë përpara televizionit. Mjekët rekomanduan se fëmijët duhet të ndalohen nga të shikuarit e televizionit. Ky regjim ishte efektiv dhe ankesat si, dhembjet e kokës, të përzierit, vjellja dhe diarreja e fëmijëve ishin pakësuar. (Paivandai Kudak va Hanvada, f. 131).

Prindërit e kujdesshëm që i duan fëmijët e tyre, nuk duhet t'i lejojnë fëmijët të shikojnë televizionin me orë të gjata, posaçërisht gjatë natës. Ata duhet t'i lejojnë të shikojnë vetëm ato programe që nuk janë të dëmshme për mendjen dhe shpirtin e tyre.

Kapitulli i gjashtëdhjetenëntë

Problemet e gjinisë

Tërheqja ndaj seksit është instinkti më i ndjeshëm i natyrës njerëzore. Në fakt, ky është instinkti më dobiprurës i racës njerëzore. Ai i ka efektet negative dhe pozitive në jetën psikologjike dhe fiziologjike të qenies njerëzore. Shumë akte të qenies njerëzore dhe shkaqet e disa sëmundjeve fizike dhe psikologjike mund t'i atribuohen këtij instinkti. Nëse rritja e një individi bëhet në mënyrë të matur e të duhur, instinkti i seksit mund të dëshmojë një lehtësi për mbarëvajtjen dhe kënaqësinë e një personi. Por, nëse rritja bëhet në një atmosferë të shturjes, epshores dhe jashtë mase, atëherë ka gjasa që instinkti i tërheqjes ndaj seksit të bëhet shkak i shumë mangësive fizike dhe psikologjike, që mund të bëhen shkaqe të shkatërrimit përfundimtar të një personi në jetën e kësaj bote dhe të ardhshme.

Nuk është e drejtë të mendohet se instinkti i tërheqjes ndaj seksit e manifeston veten vetëm mbas pubertetit. Instinkti do të jetë prezent te çdo person prej lindjes; sidoqoftë, ai rri i përgjumur për një kohë. Pastaj, e manifeston veten në kohë të ndryshme gjatë fëmijërisë në një mënyrë të lehtë. Ndonjëherë, fëmijët e vegjël i ledhatojnë gjenitalet e tyre dhe ndiejnë kënaqësi. Kjo krijon tek ata një lloj të emocionit. Ata e ndiejnë kënaqësinë kur prindërit i puthin dhe kujdesen për ata. Ata ndiejnë tërheqje kundrejt personave dhe gjërave të bukura, dhe ndonjëherë i shprehin këto ndjenja edhe me fjalë. Në moshën dy apo trevjeçare fëmija fillon të dallojë dukjen e vajzave dhe të djemve, dhe të shikojnë në pjesët intime të tjetrit me interesim të madh. Kur të rriten pak, ata tërhiqen pas fotografive të bukura. Fotografitë i shikojnë me habi. Ndonjëherë mund të flasin fjalë të këqija. Mundohen të

tërheqin vëmendjen e personave të gjinisë së kundërt. Fillojnë të tregojnë prirje kundrejt gjinisë së kundërt. Ndonjëherë, edhe u parashtrojnë pyetje prindërve në lidhje me seksin. Mundohen t'i përgjojnë pëshpëritjet e prindërve. U pëlqen të rrinë në ndonjë qoshe me ndonjë shok dhe t'i shkëmbejnë sekretet. Të gjitha këto na dëshmojnë se fëmijët e kanë në brendinë e tyre instinktin e fshehtë të seksit që mundohet të shprehur përmes veprave të tyre. Pa udhëzimin dhe njohurinë e duhur, instinkti i drejton fëmijët. Ata nuk do të dinë se çfarë po kërkojnë. Vëmendja e tyre e vetme është të përftoj kënaqësi prej çfarëdo burimi. Por, ata nuk dinë si ta marrin këtë kënaqësi. Deri në moshën 12 vjeçare fëmijët vazhdojnë me këtë gjendje të pasigurisë. Prej moshës 12 deri 15 vjeçare, instinkti i tërheqjes ndaj seksit ngjallet tek ata me shpejtësi.

Prindërit e përgjegjshëm nuk duhet të jenë të pavëmendshëm ndaj këtij instinkti të fëmijët e tyre. Ata nuk mund të vazhdojnë pa një strategji të mirëfilltë që e shqyrtojnë në mënyrë të duhur këtë çështje. Edukata seksuale është ndër dukuritë më të vështira dhe më delikate të edukatës së fëmijës. Edhe gabimi më i vogël apo neglizhenca në pjesën e prindërve, mund t'i shtyjë fëmijët në shkatërrim apo greminë.

Prindërit duhet ta fokusojnë vëmendjen e tyre drejt faktit që para pubertetit fëmija nuk do të ketë aftësinë e lindjes. Prandaj, Zoti e ka mbajtur të përgjumur këtë instinkt brenda tyre. Është në interesin më të mirë të fëmijëve që instinkti i tyre i tërheqjes ndaj seksit të mos zgjohet më herët. Nëse kjo ndodh, fëmija do të vuajë prej shumë llojeve të njollosjeve shoqërore dhe të sëmundjeve trupore.

Prindërit duhet të heqin dorë prej të gjitha atyre gjërave që mund ta provokojnë instinktin e seksit të fëmija. Ata duhet t'u sigurojnë atyre një mjedis të shëndoshë, që

mendjet e tyre të mos devijojnë drejt shprehjes së mëhershme të instinktit të seksit. Prindërit e vëmendshëm mund të vendosin vetë çfarë është e dëshirueshme për fëmijët dhe çfarë jo. Këtu do të përmendim vetëm disa gjëra që prindërit do të kishin dëshirë t'i mbajnë në mendjet e tyre. Ata duhet të sigurojnë me maturi që fëmijët të mos i prekin pjesët e tyre intime, mos t'i shikojnë fotografitë e modeleve nëpër magazina, mos t'i dëgjojnë këngët e dashurisë dhe mos t'i shikojnë filmat romantikë, mos ta lavdërojnë pamjen e bukur dhe bukurinë e të tjerëve, mos t'ua ngulin sytë fytyrave të bukura dhe gjymtyrëve të ekspozuar të të tjerëve, mos t'i dëgjojnë me qëllim shakatë e pamoralshme apo fjalët metaforike të prindërve dhe të më të vjetërve. Këto dhe shumë tërheqje tjera mund të shkaktojnë dridhje në instinktin e seksit të fëmijës.

Prindërit nuk duhet t'u lejojnë fëmijëve të moshës 5 apo 6 vjeçare të jetojnë pa mbikëqyrje. Ata mund të luajnë ndonjëherë me pjesët intime të të tjerëve dhe mund të zgjohen emocionet tek ata. Fëmija nuk duhet lejuar të rrijë i shtrirë në shtratin e tij kur të zgjohen. Shtretërit e fëmijëve 6 vjeçar duhet të jenë të ndarë. Nëse fëmijët flenë në shtratin e njëjtë, trupat e tyre mund të fërkohen dhe ta zgjojnë instinktin e seksit. Fëmijët e moshës 5 apo 6 vjeçare nuk duhet të flenë me prindërit e tyre në shtratin e njëjtë. Kjo posaçërisht vlen për fëmijët e gjinisë së kundërt me të prindërve. Edhe nëna nuk duhet ta fërkojë trupin e vet me trupin e vajzës së saj 6 vjeçare.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kur fëmija të arrijë moshën shtatëvjeçare, ndajeni shtratin e tij.” (Makarim al ahlak, v. 1, 256).

Imam Sadiku transmeton prej paraardhësve të tij:

“Fëmijët e moshës mbi dhjetëvjeçare duhet të ndahen prej shtratit të gruas” (Vasail al shiah, v. 14, f. 268).

“Nëse nëna e fërkon trupin e saj me trupin e vajzës së vet, ajo është duke bërë njëfarë ngacmimi” (Vasail al shiah, v. 14, f. 170).

“Një burrë nuk duhet ta puthë vajzën e vet 6 vjeçare, dhe një grua nuk duhet ta puthë djalin e vet 7 vjeçar.” (Vasail al shiah, v. 14, f. 170).

Është praktikë e shumë shtëpive që gruaja të shëtitet me rrobat pjesërisht të shpaluara. Edhe shumë burra nuk mbesin shumë mbrapa kësaj. Ata i vendosin pecet e tyre rreth rrobave pjesërisht të shpaluara dhe do të lëvizin nëpër shtëpi në prezencën e djemve dhe të vajzave. Ata do të mendojnë se të gjithë janë anëtarët e familjes së njëjtë dhe janë të ndaluar (*mahrem*) për njëri tjetrin, apo të afërm prej të cilëve gruaja nuk ka nevojë të mbulohet.

Prindërit po ashtu mendojnë se gjymtyrët e tyre të ekspozuar nuk do të ndikojnë te fëmijët e tyre dhe se ata janë ende të rinj të jenë të vetëdijshëm për gjëra të tilla. Ata mendojnë se gjokset e vajzave që nuk janë të mbuluara me mbështjellëse dhe gjymtyrët e tyre të ekspozuara nuk do të ndikojnë te djemtë e tyre në asnjë mënyrë. Ata mendojnë kështu sepse janë vëllezër e motra në mes veti. Ky nuk është të menduarit e mirë. Instinkti i seksit është njëri prej instinkteve më të forta dhe kur të zgjohet mund të mos e lejojë personin të mendojë për asnjë afërsi.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Është shumë e mundshme që instinkti i dashurisë e i seksit të zgjohet përnjëherë” (Gharar al hukm, f. 416).

Dëshirat e forta të tilla mund të bëhen shkaqet e konsekuencave të mëdha ndaj fëmijëve të pafajshëm. Ndoshta në rrethanat e tilla fëmija edhe mund të bëjë dhunim. Në këtë situatë, prindërit do të jenë përgjegjës të plotë për shkak të qëndrimit të tyre të pakujdesshëm.

Këtu do të jetë me vend të citojmë shkrimet e një intelektual:

“Për mirëvajtjen psikike të fëmijëve, ne nuk duhet t’u ekspozojmë atyre trupin tonë. Ndonjëherë fëmija mund të shikojë vjedhurazi prej vrimës së çelësit të derës së banjës përderisa jemi duke u larë apo duke i ndërruar rrobat tona. Ne duhet të sigurohemi që fëmijët të mos e zhvillojnë një shprehi të tillë.” (Paivand hai Kudak va Hanvada, f. 177).

Është e vërtetë se prindërit janë të ndaluar (*mahrem*) për fëmijët e tyre dhe se mund të jetojnë në shtëpinë e njëjtë bashkë. Por, prindërit nuk duhet t’i sakrifikojnë të drejtat kolektive të fëmijëve për kënaqësitë dhe liritë e tyre. Në këtë mënyrë, ata do t’ia ekspozojnë fëmijët e tyre prishjes. Si pasojë, jeta e tyre do të jetë e dënuar për turp dhe rënie shpirtërore.

Kofsha e një personi ishte shpaluar jashtë rrobave të tij. I Dërguari e vërejti këtë dhe tha:

“Fshehe kofshën tënde, sepse është një gjë që nuk duhet t’u ekspozohet të tjerëve.” (Mustadrak al-vasail, Hakim, v. 4, f. 181).

Nuk është e drejtë që djali 4 vjeçar të lahet bashkë me nënën. Ngjashëm, vajza 4 vjeçare nuk duhet të lahet bashkë me babanë. Fëmijët dhe rinia nuk duhet lejuar të rrinë të vetmuar dhe të mos bëjnë asgjë. Vetmia mund të krijojë dëshirën për masturbim. Pjesët intime të djalit të vogël duhet të mbahen të mbuluara, jo të ekspozuara motrave dhe vëllezërve të tij. Kurrë mos i përdorni sharjet fyese me fëmijët. Burri dhe gruaja nuk duhet të flenë në një shtrat në praninë e fëmijëve të tyre. Ata nuk duhet të bëjnë çapkënlleqe kur fëmijët janë prezentë.

Problemi i një qiftit që ka fëmijë është marrëdhënia seksuale në mes burrit dhe gruas. Është e drejtë e qiftit të flenë bashkë. Por, kur janë disa fëmijë në familje, mbetja në vetmi do të jetë problem. Sidoqoftë, ata duhet ta vazhdojnë marrëdhënien e tyre private pa e hetuar këtë

fëmijët. Përndryshe, do të ketë rrezik për paraqitjen e dëshirës së fortë seksuale të fëmijët dhe në atë moshë do të ketë për ata pasoja të tmerrshme.

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Burri nuk duhet t’i afrohet gruas përderisa fëmijët janë në dhomën e tyre të fjetjes. Përndryshe, do të jetë sikur kryerja e ndonjë dhunimi.” (Vasail al shiah, v. 14, f. 94).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Betohem në Allahun! Nëse ndonjëri është duke kryer marrëdhënie seksuale me gruan e tij përderisa fëmijët janë në dhomën e tij, dhe fëmija i sheh e i dëgjon ata, atëherë ai fëmijë nuk do të përparojë kurrë. Qoftë djalë apo vajzë, të dy do të njollosen kur të rriten (për shkak të shikimit të aktit)”.

Sa herë që Imam Zejnel Abidini dëshironte t’i afrohej gruas së tij, ai i largonte shërbyesit e tij, e mbyllte derën nga brenda dhe i lëshonte perdet. (Vasail al shiah, v. 14, f. 94).

I Dërguari i Islamit ka ndaluar që mashkulli t’i afrohet gruas kur foshnja është duke i shikuar nga djepi.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 546).

Prandaj, burri dhe gruaja që kanë fëmijë, nuk duhet të jenë të pakufizuar siç kanë qenë para se të kishin fëmijë. Për të mbrojtur dëlirësinë e fëmijës, qifti duhet ta mbajë larg prej shikimit të fëmijëve jetën e tyre seksuale. Kjo mund të mos jetë një punë e lehtë, por ata nuk kanë tjetër alternativë. Ata nuk duhet të mendojnë se fëmija është i padëmshëm dhe se nuk do të kuptojë asgjë në atë moshë. Përkundrazi, fëmijët janë shumë mendjemprehtë. Ata do t’i nxjerrin përfundimet e tyre nga ajo se çka shohin. Ata do të jenë kureshtarë për të ditur se çka janë duke bërë prindërit në vetmi. Ndonjëherë, bëhen sikur flenë për të kuptuar dhe për të parë se çfarë është duke ndodhur. Po ashtu, mundohen të shikojnë vjedhurazi mbrapa derës apo perdes.

Më mirë është që prindërit të kenë një dhomë vetëm për ata. Sa më shumë që është e mundur, kjo dhomë duhet të jetë sa më larg prej dhomës së fëmijëve. Prindërit duhet t'i mësojnë fëmijët të paralajmërojnë ardhjen e tyre kur të hyjnë në dhomën e prindërve. Prindërit duhet të përmbahen nga aktet seksuale kur fëmijët ndodhen përreth në shtëpi, apo, përderisa të hyjnë në gjumin e thellë.

Një intelektual perëndimor shkruan:

“Shumë banesa bashkëkohore janë të ndërtuara në atë mënyrë që planifikuesit nuk e marrin parasysh privatësinë për marrëdhëniet seksuale të bashkëshortëve. Në fakt, shtëpitë e ditëve të sodit mund të emërohen si banesa që janë kundër kërkesave seksuale të banuesve. Shumica e shtëpive apo banesave janë të tilla që nuk kanë kushte për dhoma të ndara të gjumit për prindërit. Edhe nëse ka, muret e dhomave janë aq të holla sa që fëmijët në dhomën tjetër mund të dëgjojnë edhe pëshpëritjen e prindërve. Është një fakt i hidhët se për shkak të mospasjes së vendit të duhur për jetën e tyre seksuale, prindërit do të kenë një jetë që u zihet fryma.” (Paivand hai Kudak va Hanvada, f. 176).

Një e metë e fjetjes së prindërve nëpër dhoma të ndara është se prindërit nuk do të dinë se çfarë janë duke bërë fëmijët, posaçërisht, kur janë më të rritur dhe janë të përzier në gjini. Në këtë situatë, lënia e fëmijëve në një dhomë bashkë, nuk është e këshillueshme. Në situata të tilla, prindërit do të duhet të sakrifikojnë rehatinë e tyre. Nëse prindërit duhet të flenë bashkë me fëmijët e tyre, ata duhet të përdorin shtretër të ndarë. Për plotësimin e nevojave të tyre seksuale, duhet të gjejnë një qoshe të qetë gjatë natës, kur të gjithë fëmijët janë duke fjetur. Kur prindërit janë persona të përgjegjshëm dhe kanë dëshirë, ata mund të gjejnë zgjidhje për problemin pa shumë vështirësi.

Allahu, në Kuranin e shenjtë thotë:

“O ju besimtarë! Ata që janë nën pronësinë tuaj (shërbëtorët) dhe fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë le të kërkojnë leje nga ju për të hyrë në dhomën e fjetjes (apo të vijnë në prezencën tuaj) në këto tri kohë: para namazit të mëngjesit, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Pos atyre tri kohëve nuk është mëkat as për ju as për ata, të vizitoni njëri-tjetrin. Kështu Allahu ua sqaron argumentet e veta. Allahu është i dijshtmi i urti.” (Kuran, 24:58).

Para pjekurisë, fëmijët parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo indirekte për seksin. Disa prindër u shmangen pyetjeve të tilla. P.sh. ata thonë: ‘Shukatni, mos parashtroni pyetje të tilla’, ‘Këto gjëra nuk kanë të bëjnë me ju’, ‘Do të kuptoni kur të rriteni’.

Ata mund t’i shukatni fëmijët vetëm për një kohë me anë të këtyre përgjigjeve të paqarta. Disa prindër u përgjigjen pyetjeve, por edhe këto përgjigje janë të gabuara dhe të kundërta me faktet. Fëmija do të kuptojë lehtë se prindërit nuk janë duke ia treguar të vërtetën.

Të dy qëndrimet e lartcekura janë të gabuara. Fëmija është duke parashtruar pyetje për shkak se është i etshëm për dituri, dhe nëse nuk i jepet përgjigja e duhur, ai mund të bëhet më kureshtar dhe mund të marrë informatat prej mjediseve tjera që mund të mos jenë në leverdinë e tij më të mirë. Fatmirësisht, pyetjet që i parashtron fëmija në lidhje me seksin, para moshës së pjekurisë, nuk janë aq të komplikuar dhe nuk do të jetë shumë vështirë për prindërit që t’i përgjigjen. Një pyetje që e bezdis çdo fëmijë është dallimi në mes pjesëve intime të vajzave dhe djemve. Fëmija djalë kupton shumë mirë se ekziston dallimi në mes pjesëve të tij intime dhe të motrës së vet, por ai dëshiron ta dijë pse? Ndonjëherë, frikohet se mos ka ndonjë të metë te vetvetja sepse nuk është sikur motra. Në raste tjera do të

mendojë se motra ka të meta. Ai dëshiron ta dijë shkakun e dallimit dhe do të kërkojë sqarim prej prindërve. Është detyrë e prindërve që t'u japim përgjigje të kënaqshme fëmijëve. Ata duhet të thonë se të gjithë djemtë janë krijuar sikur ai dhe të gjitha vajzat sikur motra jote. Pastaj, fëmijët do të rriten dhe do të bëhen baballarë ndërsa vajzat do të bëhen nëna. Ata do të kenë fëmijë të tyre dhe në këtë mënyrë do të përsëritet i tërë cikli.

Ju nuk duhet të paramendoni se fëmija për momentin dëshiron t'i dijë të gjitha faktet për seksin. Ai dëshiron të marrë përgjigje vetëm për atë gjë që e ka në mendjen e tij. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Para se fëmija ta arrijë moshën e të kuptuarit, ai duhet të informohet sa më shumë në lidhje me seksin, që është e domosdoshme, dhe në një mënyrë sa më të lehtë e të kuptueshme për fëmijën. Nëse nuk i përgjigjet pyetjeve të tija, atëherë ai mund të marrë detaje të dëmshme prej fëmijës çapkën më të madh të fqinjit apo prej fëmijëve tjerë të shkollës. Nëse e udhëzon në mënyrë të duhur fëmijën, ai do të jetë i sigurt nga informatat e gabuara prej të tjerëve.

Kur fëmija juaj e arrin pubertetin, dhe ju e dini se instinkti i tij seksual është zgjuar deri në maksimum, si dhe ekziston metamorfoza e shpejtë tek ai, atëherë në momentin e duhur informojeni në këtë mënyrë:

-Kur të rriten fëmijët, ata do të kenë dëshirë të kenë shokë. Vajzat i dëshirojnë djemtë për shoqërim ndërsa djemtë i dëshirojnë vajzat. Këtu nuk ka asgjë të keqe vetëm nëse shoku është besimtar dhe i butë. Atëherë do të jetë fat i mirë si për djalin ashtu edhe për vajzën. Në të kundërtën, shoku i keq për një person mund të bëhet mallkim për djalin apo për vajzën.

-Mbas martesës, obligimet shumëfishohen. Shpenzimet do të rriten, duke filluar për gruan e më vonë edhe për fëmijët. Të gjitha këto përgjegjësi duhet të barten

nga ana e burrit. Edhe ti duhet ta përfundosh arsimimin sa më mirë, që të gjesh një punë të mirë. Pastaj, mund ta përgatisim martesën tënde. Mundohu shumë gjatë studimit. Nëse je person i aftë, njerëzit do të pëlqejnë dhe ti mund të gjesh një nuse të mirë për veten.

-Ruaju nga masturbimi. Është një mëkat dhe është i dëmshëm për shëndetin e një personi. Personi që e bën këtë, mund të mos jetë i përshtatshëm për t'u martuar më vonë.

-Largohu prej shoqërisë së keqe dhe mos i merr shprehitë e shokëve të këqij. Disa prej këtyre shprehive e shkatërrojnë personin.

Kur fëmija të rritet, atij i fillojnë t'i dalin qimet nën sqetull dhe përreth vendeve intime. Fëmija mund të frikohet kur t'i shohë ato për herë të parë. Udhëzoheni në mënyrë të duhur. Shpjegojani atij largimin e qimeve të tepërta. Vajzat do të fitojnë menopauzën. Kur të shohë ajo gjakun në rrobat e veta, ajo do të fillojë të frikësohet. Udhëzoheni për periudhat e menstruacionit që vajza i fiton mbas pubertetit. Gjijnjtë e saj fillojnë të rriten dhe disa vajza fillojnë të brengosen për këtë.

Ngjashëm, kur djali fillon t'i tregojë shenjat e pubertetit, ai do të shohë ëndrra shqetësuese në gjumë. Gjatë ëndrrës emocionet e tij do të shtohen dhe do të vijë deri te dalja e spermës. Ndonjëherë, fëmijët e pafajshëm dhe të paditur, mendojnë se kanë ndonjë sëmundje të rrezikshme. Ndonjëherë mendojnë se janë duke kryer mëkat. Ata brengosen dhe e mbajnë këtë çështje të fshehur në vetvete. Në kohëra të tilla, është detyrë e prindërve ta përgatisin fëmijën paraprakisht. Nëna duhet ta marrë vajzën në një vend të vetmuar dhe t'i shpjegojë asaj se dalja e qimeve në vende të caktuara të trupit dhe periudhat e rrjedhjes së gjakut gjatë pubertetit janë fenomene normale për një vajzë. Ajo duhet ta mësojë vajzën për higjienën

personale gjatë këtyre periudhave dhe për mënyrën e pastrimit mbas përfundimit të periudhës. Asaj duhet t'i tregohet se gjatë këtyre periudhave nuk duhet të agjërojë dhe nuk duhet ta falë namazin. Ditët e Ramazanit që nuk i ka agjëruar do t'i kompensojë më vonë, kur të lehtësohet. Edhe babai duhet t'i tregojë djalit se tani më është bërë person i rritur. Atij do t'i dalin qimet nën sqetull dhe përreth vendit intim. Ai do të përjetojë ëndrrat emocionale me dalje të spermës. Ai nuk duhet të bryngoset për këtë. Sa herë që të dalë sperma në gjumë, duhet ta bëjë larjen e obligueshme (*gusll*). Babai duhet t'i sqarojë djalit mënyrën e larjes së trupit. Në këtë mënyrë, prindërit mund t'i ngulin në mendjet e fëmijëve njohuritë e duhura, përderisa janë ende në pragun e jetës madhore.

Kapitulli i shtatëdhjetë Shprehia e leximit të librave

Librat janë një prej veglave më të mira për trajnim dhe rritje. Libri i mirë gjithnjë ka efekte të dobishme për mendjen e lexuesit. Ai do ta lartësojë shpirtin dhe mendjen. Ai do ta shtojë sasinë e diturisë. Librat ndihmojnë në korrigjimin e moralit të pahijshëm. Posaçërisht, në këto ditë të ekzistencës mekanike, kur njerëzit kanë shumë pak kohë për të marrë pjesë në simpoziume dhe mbledhje. Burimi më i mirë i përfitimit të diturisë fetare dhe të përgjithshme janë librat që mund të lexohen sa herë që një person të gjejë ndonjë kohë të lirë. Është e mundur që leximi i librave të ketë ndikim më të thellë në mendjet e lexuesve sesa burimet tjera të përfitimit të njohurisë. Ndonjëherë, leximi do të shpjerë kah ndryshimi revolucionar në botëkuptimin e një personi. Shprehia e leximit të librave është kalimi më i mirë i kohës. Ai mund ta mbajë të zënë personin kur nuk ka asgjë tjetër për të bërë. Personat që e kanë shprehinë e leximit të librave, jo vetëm që e shfrytëzojnë më së miri kohën e lirë por ata i mbajnë mendjet e tyre larg nga brengat që mund t'i ndjekin ata nëse rrinë duke mos punuar asgjë dhe duke bluar mendjen. Një libër i mirë për një lexues është më mirë sesa vizita e kopshteve apo vendeve piktoreske më të mira.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Personi që është i zënë me librat, kurrë nuk do ta humbë qetësinë e mendjes.” (Garar al hukm, f. 636).

“Përfitimi i diturisë së freskët e largon lodhjen dhe turbullirat e zemrës. Sepse, zemra, sikur edhe trupi, e ndjen lodhjen.” (Usul al-Kafi, v. 1, f. 48).

Masa matëse e përparimit dhe e civilizimit të një kombi është kualiteti dhe numri i librave të lexuar, si dhe numri i personave që e kanë shprehinë e të lexuarit të

librave. Edukimi i rregullt nuk është kriter i gjykimit të diturisë së një personi. Personi me të vërtetë i ditur është ai që është i angazhuar në leximin kuptimplotë dhe në hulumtim. Fatkeqësisht, ne kemi shumë persona me diploma të shkollave dhe të universiteteve, por shumë dijetarë të ditur dhe hulumtues. Shumica e fëmijëve, kur të përfundojnë shkollimin e rregullt, i lënë anash librat dhe merren me aktivitete tjera të jetës. Shtimi i diturisë së një personi fillon të stagnohet prej asaj kohe. Kriteri i tyre i kërkimit të arsimimit për të gjetur punë, është arritur. Ata mendojnë se më nuk ka dobi prej përfitimit të diturive të mëtutjeshme. Në fakt, arsimimi duhet të bëhet për arritjen e përkryerjes në fushën e zgjedhur të diturisë. Arsimimi është një proces i vazhdueshëm dhe shkon deri te fryma e fundit e një personi. Edhe Religjioni i Islamit i ka nxitur pasuesit e tij të ndjekin rrugën e diturisë prej djepit deri te varri.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kërkimi i diturisë është obligimi i çdo myslimani. Allahu i do kërkuesit e diturisë.” (Usul al-Kafi, vëll. 1, f. 30).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Edhe nëse shokët e mi janë të motivuar të kërkojnë dituri nën kërcënimin e rrahjes me kamxhik, unë do ta kisha miratuar atë.” (Usul al-Kafi, v. 1, f. 33).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Përveç dy personave, nuk ka shpërblim për asnjë tjetër: dijetari dhe ai që kërkon dituri.” (Usul al-Kafi, v. 1, f. 33).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Njerëzit ndahen në tri lloje: Dijetari, Kërkuesi i diturisë dhe Ata të cilët janë vetëm një grumbull i mbeturinave.” (Usul al-Kafi, v. 1, f. 34).

I Dërguari Llukman, i tha birit të tij: “Ndaje një kohë gjatë ditës dhe natës për të lexuar dhe kërkuar dituri.

Nëse ndalesh së lexuari, dituria jote do të zhduket” (Bihar alanvar, v. 1, f. 169).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Kërkimi i diturisë në të gjitha kushtet është absolutisht i domosdoshëm.” (Bihar al-anvar, v. 1, f. 172).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kërkimi i diturisë është obligim i çdo myslimani dhe myslimaneje.” (Bihar al-anvar, v. 1, f. 177).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Sikur njerëzit të kishin ditur dobinë e diturisë, ata do të kishin për ta përvetësuar edhe me çmimin e jetës së tyre. Për këtë qëllim do të kishin ndërmarrë udhëtime të rrezikshme.” (Bihar al-anvar, v. 1, f. 177).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Nëse e kaloj një ditë pa e shtuar diturinë time, atë ditë do ta konsideroja si të pafat për mua.” (Maxhma al zavaid, v. 1, f. 127).

Është detyrë e prindërve që t’i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë për të përfituar diturinë e leximit dhe të shkrimit. Islami i ka udhëzimet e qarta në lidhje me këtë për ndjekësit e fesë.

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Fëmija luan për shtatë vjet, studion për shtatë vjet dhe për shtatë tjera mëson se çka është e lejuar (*halal*) dhe çka është e ndaluar (*haram*).” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 645).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Fëmija ka tri të drejta nga ana e babait: Babai duhet t’ia zgjedhë një emër të bukur për të; Babai duhet ta mësojë shkrim-leximin, dhe; Kur të rritet, ta martojë” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 625).

“Kur fëmija të çohet në shkollë dhe mësuesi e mëson të thotë Bismilah, Allahu do t’i ruajë prindërit e

fëmijës nga zjarri i Xhehenemit.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 625).

“Të mjerët fëmijët e Epokës së Fundit, për atë se çfarë u kanë sjellë stërgjyshërit e tyre. Edhe pse prindërit e tyre do të jenë myslimanë, ata nuk do t’ua mësojnë fëmijëve rregullat fetare.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 625).

Përgjegjësia tjetër e prindërve është se ata i rrisin fëmijët në atë mënyrë që e kultivojnë shprehinë e leximit të librave dhe bëhen kërkues të diturisë. Atmosfera në shtëpitë e tyre duhet të jetë ajo e arsimimit dhe e mësimimit. Ata duhet t’i motivojnë fëmijët me fjalë dhe vepra për të kultivuar shprehinë e leximit. Para se ta fillojë fëmija arsimimin e rregullt, ai duhet të njoftohet me librat. Në fillim, prindërit duhet t’ua lexojnë librat fëmijëve. Ata duhet t’i lexojnë tregimet e shkurtra e interesante dhe fabulat, në mënyrë që të zgjohet interesimi të fëmija. Jepuni fëmijëve libra me piktura shumëngjyrëshe dhe ilustrime. Çdo ditë, prindërit dhe vëllezërit e motrat më të mëdha duhet t’ia lexojnë fëmijës një pjesë të librit për ta mbajtur në këmbë interesimin e tij. Ata duhet t’i shpjegojnë fëmijës për atë se çka paraqesin ilustrimet e librit. Atëherë, fëmija duhet të pyetet për ta përsëritur tregimin dhe të tregojë për ilustrimet e shtypura brenda tregimit. Në këtë arsimimin joformal, prindërit nuk duhet t’ia bëjnë të mërzitshëm mësimin dhe t’i japin libra që janë jashtë të kuptuarit e tij. Së pari, ata duhet ta bëjnë fëmijën të interesuar për t’i dëgjuar tregimet dhe pastaj për t’i lexuar librat.

Vazhdoni me këtë proces derisa fëmija të mësojë vetë shkrimin dhe leximin. Atëherë, lërxani fëmijës punën e leximit të librave. Ndonjëherë parashtroni pyetje për librin e rinj që i ka lexuar. Diskutoni për përmbajtjen e librit bashkë me të. Vazhdoni me përkushtimin e vëmendjes së fëmijës përderisa të fitojë shprehinë e leximit të librave.

Këtu prindërit duhet të përkujtohen për disa çështje:

1. Fëmijët i pëlqejnë tregimet dhe fabulat, dhe e kuptojnë mirë përmbajtjen e tyre. Prandaj, është e dobishme që materiali që u sigurohet atyre të jetë në formë të tregimit.

2. Çdo fëmijë do të ketë personalitetin e vet. Edhe aftësitë dhe prirjet do të ndryshojnë nga një person në tjetrin. Prirjet e personit do të ndryshojnë me kalimin e viteve. Prandaj, prindërit duhet së pari të provojnë ta masin prirjen dhe aftësinë e fëmijës së tyre dhe sipas asaj t'i sjellin librat në përputhje me kërkesat e tij. Mos insistoni në librat me përmbajtje të mërzitshme e të vështirë. Kjo mund të ndikojë negativisht në shprehinë lexuese të fëmijës.

3. Mbasi që fëmija është në procesin e zhvillimit të personalitetit të tij, dhe librat mund të kenë ndikim të thellë në këtë proces, kujdesi duhet të përkushtohet në zgjedhjen e librave me përmbajtje të përshtatshme për të. Prindërit duhet ta lexojnë vetë atë libër dhe pastaj të vendosin për përshtatshmërinë e tij. Fëmija nuk duhet të lexojë diçka të padëshiruar që mund të ketë ndikimin negativ në mendjen e tij të ndjeshme. Nëse e fiton shprehinë e leximit të librave të tillë, do të jetë vështirë të largohet nga ai kjo shprehi.

4. Fëmijët tregojnë më shumë interesim për të lexuar libra për krimin dhe aventurat. Këta libra mund të kenë efekte të dëmshme në psikikën e fëmijës. Ngjashëm, librat që i japin shtytje instinktit seksual të fëmijës duhet të mbahen larg nga duart e tij. Një person shkruan në kujtimet e veta: "Gjyshja më donte shumë. Unë flija me të gjatë natës. Gjithmonë kërkoja nga ajo të më tregojë ndonjë tregim para se të flija. Kështu, për çdo natë gjyshja më tregonte nga një tregim. Ajo tregonte edhe tregime të tmerrshme si ajo për "Xhin Babën" dhe të tjera. Këto tregime kanë lënë një njollë në psikikën time. Atyre netëve që i dëgjoja tregimet e tilla, unë flija me ndjenjën e tmerrit.

Fillova t'i shihja ëndrrat e këqija. Gjatë kohës u shndërrova në një person frikacak e të turpshëm. Gjithmonë kisha frikë të rrija i vetëm. U bëra i ndjeshëm dhe nervoz. Kjo gjendje vazhdon ende. Sa shumë dëshiroj që prindërit dhe më të vjetrit të mos u tregojnë tregime të tilla fëmijëve të tyre të ndjeshëm. Kam vendosur të mos u tregoj tregime të tilla fëmijëve të mi. Zakonisht u tregoj tregime nga Kurani i Shenjtë dhe tregime tjera të bukura.”

5. Shprehia e leximit nuk është vetëm për të kaluar koha. Qëllimi kryesor i kësaj është përfitimi i diturisë dhe kuptimi i përmbajtjes së librit. Nuk është me rëndësi se sa libra i lexon fëmija, por me rëndësi është se si i lexon ato. A është duke lexuar në mënyrë të shpejtë e të përciptë? A është duke lexuar me interesim të zgjuar dhe duke e kuptuar përmbajtjen? Prindërit duhet të kujdesen shumë për këtë aspekt. Kohë pas kohe, duhet të kërkojnë nga fëmijët të tregojnë për esencën e librit që e kanë lexuar. Ata duhet të nxjerrin përfundimin se a e ka kuptuar fëmija përmbajtjen e librit në mënyrë të duhur apo jo. Nëse nuk e ka kuptuar mirë, atëherë duhet ta korrigjojnë këtë.

6. Në përgjithësi, fëmijët i pëlqejnë librat me tregime imagjinare. Disa intelektualë inkurajojnë të lexohen libra të tillë. Ata mendojnë se librat e tilla do të inkurajojnë aftësitë imagjinuese të fëmijëve. Autori i këtij libri është i mendimit se leximi i tregimeve imagjinuese dhe fiktive mund të nxisë shprehinë e gënjimit të fëmija. Mendja e tij do të bëhet depoja e mendimeve të gabuara. Kur të rritet, ai mund ta përdorë të pavërtetën në mënyrë që t'i plotësojë dëshirat dhe kërkesat e tij.

7. Është e vërtetë se fëmija preferon t'i lexojë tregimet më shumë sesa temat tjera. Por, vëmendja duhet të kushtohet që atij t'i jepen librat e përzgjedhur në mënyrë të kujdesshme dhe që kanë të bëjnë me tema të ndryshme dhe jo vetëm librat e tregimeve përrallore. Fëmija duhet

ngadalë ta zhvillojë interesimin për leximin dhe kuptimin e librave me tema të ndërlikuara.

8. Nuk është e vërtetë se fëmijët i duan vetëm librat me tregime fiktive. Ata do të tregojnë interesim të madh edhe për leximin e librave për personalitetet e mëdha, për jetën dhe të arriturat e tyre. Ata mund t'i marrin këta persona në rolin e modelit të jetës së tyre dhe ta modelojnë jetën sipas jetës së personave të mëdhenj.

Kapitulli i shtatëdhjetenjtë

Fëmijët me të meta fizike

Disa fëmijë janë me të meta fizike që nga lindja, ndërsa të tjerët mund të fitojnë mbas ndonjë fatkeqësie. Ekzistojnë shumë pamundësi fizike si, verbëria, çalimi, shurdhëria, etj. Ekzistojnë edhe fëmijë tjerë që mund të mos i kenë këto anomali fizike por mund të jenë të shkurtër, të trashë, me dhëmbë të dalë, sy të vegjël e të zhytur, dhe disa tipare tjera.

Individi nuk ka faj për këto të meta. Allahu i ka dhënë të tillë ashtu siç janë. Të gjitha krijesat e kanë bukurinë e tyre. Është të menduarit tonë ajo që i krijon standardet për të gjykuar pamjen e bukur.

Mbasi që personat e paaftë do të jenë të ndërgjegjshëm për paaftësinë e tyre, ata do të jenë të pikëlluar dhe subjekt të kompleksit të vlerës së ulët. Nëse nuk bëhen përpjekje për ta hequr këtë ndjenjë, ai gjithmonë do të jetë i pikëlluar dhe i zyrtë. Me këtë kompleks brenda tij, personi e humb personalitetin kumbues. Ata fillojnë të mendojnë se nuk janë të aftë për asgjë. Ata do të ngurrojnë t'i pranojnë përgjegjësitë dhe nuk do të ofrohen për të punuar me zell. Thënë ndryshe, ata dorëzohen në mënyrë të turpshme. Ata mund të mendojnë edhe mendime dëshpëruese dhe indinjatë për shkak të gjendjes së tyre në shoqëri.

Të paaftët janë për keqardhje. Është detyrë e anëtarëve tjerë të shoqërisë t'u ndihmojnë personave të tillë me të meta fizike. Ata duhet t'i trajtojnë njëjtë sikur personat normalë. Ata nuk duhet t'i bëjnë të vetëdijshëm për të metat e tyre përmes ndonjë veprimi të hapur apo të mbyllur. Disa persona bëjnë shaka me personat e tillë, duke i bërë ata subjekte të talljes. Kjo do të jetë sikur shpimi e zemrës së tyre me shigjetë. Islami ndalon rreptësisht

përqeshjen e të metave fizike të të tjerëve. Kjo llogaritet ndër mëkatet e mëdha që mund të kryejë një person. Është një urdhër në lidhje me këtë çështje, ku nga besimtari kërkohet as që mos ta përmendë të metën e personit të tillë.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Mos ua ngulni sytë njerëzve që kanë vuajtje dhe atyre që janë të gërbulur, sepse të shikuarit tuaj e ngjallin ndjenjën e pikëllimit dhe të turpit në zemrat e tyre.” (Bihar al-anvar, v, 75, f. 15).

Është përgjegjësi e myslimanëve që t’u kushtojnë më shumë vëmendje dhe kujdes personave të tillë me qëllim të përmirësimit të ndjenjave të pikëllimit. Ata duhet t’i inkurajojnë personat me të meta fizike që të jetojnë sa më normalë që të munden. Prindërit e tyre janë duke bartur një përgjegjësi të rëndë. Ata duhet të mbajnë në mend se edhe personat me të meta fizike kanë aftësi për t’u shquar. Nëse prindërit mundohen të kuptojnë prirjen e tyre dhe të ndihmojnë në shfrytëzimin e aftësive të tyre në mënyrë të duhur, ata mund të formohen në persona të aftë e efikas. Ata mund të shqyhen në fushat e shkencës dhe të teknikës. Në këtë mënyrë mund të arrijnë pozitat e respektuara në shoqëri. Ekzistojnë shembuj të panumërt të personave me të meta fizike që e kanë arritur majën e suksesit përmes aktiviteteve të mëdha përkundër mangësisë së tyre. Prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për të metat e fëmijëve të tyre dhe të përmbahen që të mos ia përmendin atë askujt, posaçërisht në prezencën e vetë fëmijës apo vëllezërve e motrave të tij. Ata nuk duhet ta përmendin të metën e fëmijës edhe në formën ngushëlluese. Trajtimi i këtij fëmije nuk duhet të dallohet aspak prej trajtimit të fëmijëve tjerë normalë. Nëse fëmija me të meta e shpreh brengën e vet për të metën që ka, prindërit duhet ta qetësojnë. Përkujtoni dhe lavdëroni aftësitë tjera që i ka dhe inkurajoni që të mundohet për t’i shfrytëzuar ato, në

mënyrë që ta dëshmojë veten si një anëtar të dobishëm të shoqërisë.

Prindërit duhet t'i studiojnë aftësitë e fshehura të fëmijëve me të meta dhe pastaj të konsultohen me persona të mirinformuar dhe të kërkojnë këshillën e tyre për drejtimin e duhur të veprimit. Pastaj, duhet ta inkurajojnë fëmijën që t'i zhvillojë shkathtësitë e zgjedhura. Në këtë mënyrë, prindërit do t'ia bëjnë një shërbim të madh shoqërisë duke e bërë fëmijën e tyre me të meta fizike një anëtar të dobishëm të shoqërisë.

Kështu, personi me të meta fizike, në një mënyrë, do ta tejkalojë të metën e tij dhe do të përdorë më së miri talentin që ia ka dhuruar Allahu atij.

Një vajzë, në letrën e saj shkruan:

“Një shoqe më ka treguar tregimin e jetës së vet me këto fjalë:

‘Isha 13 vjeçare, kur një ditë rashë prej tarracës në tokë. Shtylla kurrizore më qe thyer dhe prej asaj dite u bëra person me të meta fizike përjetësisht. Për një kohë u mjekova në spital. Edhe pse kisha dhimbje të mëdha, më vonë e kuptova se ditët në spital ishin më të mira për mua sesa kur u ktheva në shtëpi dhe kur filloi për mua vuajtja. Sapo mbërrita në shtëpi, prindërit filluan të më trajtonin si një armik të përbetuar. Ata më thoshin: ‘Ti je shkaktare e trupit dhe e fatit të keq për ne. Si mund t’u themi ne të tjerëve se ne jemi prindërit e një vaje të gjymtë? Ti do të mbetesh nën kujdesin tonë përgjithmonë.’ Në vend se të më ngushëllonin për shkak të gjendjes sime të vështirë, ata talleshin me mua ditë e natë. Asnjëherë nuk menduan as për një moment se unë isha viktimë e një fatkeqësie dhe nuk isha fajtor për atë që më ndodhi mua. I lutesha çdo ditë Zotit të ma marrë shpirtin dhe të më shpëtojë nga kjo jetë që isha duke jetuar. Me këmbët e mia të paralizuara, unë zvarritesha në shtëpi dhe punoja. Asnjëri nuk u mërzi

asnjëherë për shërimin tim. Në fakt, prindërit e mi nuk më konsideronin as si vajzë të tyre. Rinia ime kaloi në dhimbje dhe pikëllim. Në moshën 15 vjeçare e kisha pamjen një gruaje 50 vjeçare. Prindërit vdiqën dhe vëllezërit e motrat e mia nuk u mërzitën për mua. Mbas një kohë u martova. Burri im ishte një person shumë i këndshëm. Ai më donte shumë. Para kësaj, unë pata harruar se çka është dashuria dhe dhembshuria. Tash gjendja ime filloi të më përmirësohet çdo ditë e më shumë. Tash jam një person i shëndoshë e i fuqishëm. Allahu më ka dhënë fëmijë. Tash jam duke e çuar jetën e lumtur dhe të kënaqur.”

Kapitulli i shtatëdhjetedytë

Ndëshkimet fizike

Shumica e prindërve u japin ndëshkime fizike fëmijëve të tyre me qëllim të rritjes së duhur. Edhe disa arsimtarë kontribuojnë në këtë drejtim. Ata besojnë se dreqi nuk mund të zbutet vetëm me fjalë. Shumica e njerëzve në të kaluarën kanë besuar në këtë thënie. Gjatë atyre ditëve, zinxhirët, thuprat dhe kamxhikët konsideroheshin si vegla të rëndësishme të punës nëpër shkolla. Dëshira e prindërve për një rritje të mirë të fëmijëve të tyre, asnjëherë nuk ka ngelur mbrapa prej rrahjes së tyre, kur është kërkuar një gjë e tillë. Por, shumica e intelektualëve e konsiderojnë këtë metodë tiranike si të prapambetur e të dëmshme për fëmijët. Në shumë vende të zhvilluara të botës, ekziston ndalimi i plotë i ndëshkimit fizik për korrigjimin e fëmijëve.

Fëmija nuk mund të reformohet përmes ndëshkimeve fizike. Ndoshta, mund të ketë efekt të përkohshëm te fëmija, por do të jetë i dëmshëm nëse përdoret më gjatë. P.sh:

1. Kur të rrihet fëmija, ai do të fitojë shprehinë e përkuljes së kokës ndaj torturës dhe forcës. Ai ndoshta do të fillojë të mendojë se forca është çelësi i vetëm i suksesit. Po ashtu, do të fillojë të mendojë se kur është i zemëruar, ai duhet të rrahet. Duke ia dhënë ndëshkimin fizik fëmijës, prindërit u japin një shembull atyre për t'i adaptuar ligjet tiranike të xhunglës në jetën e tyre të ardhshme.

2. Fëmijët që rrihen, e zhvillojnë urrejtjen dhe armiqësinë kundër prindërve të tyre. Fëmijët kurrë nuk e harrojnë trajtimin e vrazhdë të cilin e kanë pranuar nga ana e prindërve të tyre. Fëmijët e tillë mund të bëhen edhe të pabindur.

3. Rrahjet e përsëritura mund ta bëjnë fëmijën frikacak dhe të turpshëm. Edhe personaliteti i fëmijës mund të shtypet me ndëshkimet fizike. Më vonë, ai mund të bëhet viktimë e sëmundjeve psikologjike.

4. Në të shumtën e rasteve, ndëshkimet fizike rrallë e përmirësojnë fëmijën. Nuk e krijon te fëmija dëshirën për të korrigjuar sjelljen e vet. Ai ndoshta do të tregojë ndonjë shenjë të përkohshme të ndryshimit për shkak të frikës nga rrahja, por nuk ka garanci se ai nuk do ta përsërisë aktin e njëjtë përsëri. Mangësia e tij bazike do të insistojë në nënndërgjegjen e mendjes së tij. Do ta manifestojë veten më vonë në ndonjë formë tjetër.

Një person shkruan:

“Djali im 12 vjeçar kishte marrë pak para nga çanta e gruas. Kur e kuptova këtë, e ndëshkova me thupër. Prej asaj kohe, ai nuk i është afruar asnjëherë çantës së gruas.”

Është e vërtetë se djali nuk ka marrë më asgjë prej çantës së gruas. Në dukje, babai kishte arritur sukses duke e përdorur ndëshkimin fizik ndaj fëmijës. Por, çështje nuk ishte aq e lehtë. Tregimi vazhdon më tutje. Djali kishte gjetur një dredhi tjetër për t'i vazhduar veprimet e veta të këqija. Ai filloi t'i hipë autobusit dhe të mos ia paguajë fare biletën konduktorit. Kur nëna e tij kërkonte të blejë diçka në dyqanin ushqimor, ai vidhte prej kusurit. Më vonë filloi të vjedhë edhe prej shokëve. Përfundimi i tregimit është se kur është rrahur fëmija për një gabim, me mençuri ai nuk e përsëriti atë vepër. Por, në ndërkohë mendja e tij kishte punuar jashtë orarit dhe i shpiku metodat tjera të kryerjes së vjedhjes.” (Ruvan Shinasi Tajrubi Kudak, f. 263).

Një intelektual shkruan:

“Fëmijët që pranojnë rrahje korrigjuese ndëshkuese, bëhen persona të dobët e të padobishëm. Ose, shndërrohen në persona kokëfortë dhe mashtrues. Siç duket, ata janë duke u hakmarrë për shkak të keqtrajtimit që e kanë

pranuar në fëmijërinë e tyre.” (Ruvan Shinashi Tajrubi Kudak, f. 266)

Z. Russeli shkruan:

“Sipas mendimit tim, ndëshkimi fizik i fëmijëve nuk është e drejtë në asnjë mënyrë.” (Dar Tarbiat, f. 169).

Edhe Islami e ka emëruar ndëshkimin fizik si të dëmshëm e të ndaluar.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Njeriu inteligjent e pranon udhëzimin përmes butësisë, vetëm shtazët nuk mund të korrigjohen pa rrahje.” (Gharar al hukm, f. 236).

Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Kushdo që e rrah një person tjetër njëherë, Allahu do ta lëshojë kamxhikun e zjarrtë kundër tij.” (Vasail al shiah, v. 19, f. 14).

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Përdorni dashurinë dhe dhembshurinë në edukimin dhe rritjen e fëmijës, dhe mos anoni kah dhuna, sepse mentori i mençur është më i mirë sesa mentori i ashpër.” (Bihar al-anvar, v. 77, f. 175).

Një person tha se ishte ankuar te Imam Musa bin Xhafer për shkak të djalit të tij. Imami iu përgjigj: ‘Mos e rrah asnjëherë por mbaje një distancë nga ai, dhe kjo distancë nuk duhet të mbahet shumë gjatë.’ (Bihar al-anvar, v. 104, f. 99).

Ndëshkimet fizike janë shumë të dëmshme për rritjen e fëmijës dhe ato duhet të shmangen. Por, nëse nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të korrigjuar fëmijën, shfrytëzoheni si masë të fundit. Edhe këtë e lejon Islami nën kushte të caktuara.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

“Kërkoni prej fëmijëve të fillojnë faljen e namazit në moshën 6 vjeçare. Nëse nuk i dëgjojnë vërejtjet e përsëritura, ata mund t’i rrihni në mënyrë që të bëhen falës

të rregullt të namazit kur ta arrijnë moshën 7 vjeçare.” (Mustadrak al-vasail, v. 1, f. 171).

Në një traditë tjetër, Imam Xhafer Sadiku thotë:

“Kur fëmija e arrin moshën 9 vjeçare, mësojani abdesin; urdhëroni të marrë abdes dhe ta falë namazin. Nëse fëmija nuk ju dëgjon, rriheni dhe bëjeni ta falë namazin.” (Vasail al shiah, v. 3, f. 13).

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, thotë:

“Sikur që e qortoni djalin tuaj, ju mund të qortoni edhe një jetim. Dhe për arsyen që mund ta rrihni djalin tuja, për të njëjtën arsye mund ta rrihni edhe jetimin” (Vasail al shia, v. 15, f. 197).

“Nëse robi juaj nuk i bindet Allahut, rriheni. Nëse nuk ju bindet juve, faleni.” (Gharar al hukm, f. 115).

Një person erdhi në prani të të Dërguarit dhe tha se një jetim ishte nën kujdesin e tij. Ai dëshironte të dinte se a mund ta rrihte me qëllim të korrigjimit. I Dërguari iu përgjigj:

“Në situata kur mund ta rrahësh djalin tënd, mund ta rrahësh edhe jetimin në situata të tilla, që kjo rrahje të jetë për të mirën e tij.” (Mustadrak al-vasail, v. 2, f. 625).

Gjithnjë është më mirë të rrimë larg nga ndëshkimi fizik i fëmijëve, sa më shumë që është e mundur. Dhe, kur të bëhet e domosdoshme, përmbahuni sa më shumë që mundeni. Ndëshkimi duhet të mendohet mirë dhe të jetë i përshtatshëm për rastin.

Një person e pyeti të Dërguarin e Islamit:

“Anëtarët e familjes sime nuk më binden. Si duhet t’i reformoj ata?”. I Dërguari iu përgjigj: “Fali ata”. Njeriu përsërit këtë pyetje edhe dy herë dhe i Dërguari iu përgjigj njëjtë, por mbas herës së tretë ai shtoi: “Nëse dëshiron t’i dënosh njerëzit e tu, atëherë duhet ta kesh ndërmend se ndëshkimi nuk duhet të jetë më shumë veçse veprim i keq

ndaj tyre. Po ashtu, duhet të përmbahesh nga rrahjet në fytyrën e tyre” (Maxhma al zavaid, v. 8, f. 106).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë:

“Nëse ka nevojë, mos e goditni më shumë se 5 apo 6 herë fëmijën apo shërbëtorin, dhe këto goditje nuk duhet të jenë të ashpra.” (Vasail al shiah, v. 18, f. 581).

Kur e ndëshkoni fëmijën, mos e bëni këtë në prezencën e të tjerëve. Prezenca e të tjerëve mund t’u shkaktojë mundime mendore fëmijëve tjerë dhe mund t’i dëmtojë ata. Nëse rrahja është e tepërt, atëherë ekziston gjoba e caktuar në Islam për atë që e bën ndëshkimin e tepërt. Prandaj, duhet të ushtrohet kujdesi gjatë rrahjes së fëmijëve me qëllimin e korrigjimit të tyre. Sipas ligjeve Islame, nëse fytyra e një personi nxihet gjatë rrahjes, gjoba është gjashtë dinarë të arit. Nëse fytyra mavijohet, tre dinarë dhe nëse skuqet, një dinar e gjysmë të arit. (Vasail al shiah, v. 19, f. 295).

Prindërit nuk kanë të drejtë të sillen si despotë ndaj fëmijëve të tyre. Ata nuk duhet ta shkelmojnë, apo ta rrahin me grusht, me zinxhir apo me shkop.

Islami lejon rrahjen dhe qortimin e fëmijës me qëllim të korrigjimit, dhe në fakt, edhe urdhëron një gjë të tillë. Ne vërejmë se shtetet perëndimore devijojnë nga rruga për shkak të lirisë së tepërt që u jepen atyre.

Kapitulli i shtatëdhjetetretë

Ndëshkimet jo-fizike

Shumica e prindërve i preferojnë ndëshkimet jo-fizike ndaj fëmijëve të tyre kur të paraqitet nevoja për një gjë të tillë. P.sh. nëse fëmija sillet keq, ai do të mbyllet në një dhomë të errët apo sënduk të madh. Ndonjëherë, prindërit bërtasin dhe i përdorin sharjet gjatë zemërimit kur fëmija bën ndonjë gabim. Ndikimi i ndëshkimit të tillë mund të mos jetë aspak më i vogël sesa ndëshkimi fizik për të cilin u cek në kapitullin e mëparshëm.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Ekzistojnë shumë lloje të ndëshkimeve që kanë ndikim më të madh sesa goditjet fizike.” (Gharar al hukm, f. 415).

Është e mundur që këto ndëshkime të jenë më të ashpra në mendjet e fëmijëve sesa ndëshkimet fizike. Këto ndëshkime do të dëmtojnë personalitetin e fëmijës dhe do të krijojnë elementet e frikës dhe të shqetësismit në natyrën e tij. Ka ndodhur shumë herë që kur është mbyllur fëmija në vetmi në një dhomë të errët, ndikimi në nervat e tij ka qenë aq i ashpër saqë kjo nuk ka qenë e mundur të fshihet nga mendja e tij për një kohë të gjatë. Ndonjëherë, ndonjërit prej viktimave të tilla të nervozizmit u bie të fikët prej ndëshkimit të tillë. Prandaj, prindërit duhet t'i përmbahen dhënies së ndëshkimeve të tilla ndaj fëmijëve. Britma dhe sharja ndaj fëmijëve është e ndaluar (haram) dhe do të ketë ndikim dëmtues në rritjen e tyre. Kjo mund t'i motivojë fëmijët ta mësojnë gjuhën e sharjes dhe ta përdorë atë kur të rritet.

Ekzistojnë edhe disa ndëshkime jo-fizike që nuk do të kenë ndikim negativ në mendjet e fëmijëve, dhe njëkohësisht janë shumë efektive në korrigjimin e tyre. P.sh. nëse fëmija sillet keq ose nuk i kushton vëmendje mësimi

të tij, prindërit duhet të mos flasin me të për një kohë ose mos ta marrin me vete në piknik. Ndonjëherë, si ndëshkim, prindërit nuk i marrin fëmijët me vete në gosti kur thirret e tërë familja. Ndonjëherë, mund të mos i jepet dreka apo darka. Në kohëra tjera, mund t'i jepet ndonjë detyrë e vështirë. Këto ndëshkime të përdorura në mënyrë të matur mund të jenë shumë efektive në kontrollimin dhe korrigjimin e fëmijëve. Ato nuk do të shoqërohen me efekte të dëmshme në mendjet dhe nervat e fëmijëve, por ndëshkimet janë ndëshkime. Ekziston një e metë e ndëshkimit që nuk është aq efektiv në korrigjimin e të metave të brendshme të natyrës së fëmijës. Prej frikës, nga ndëshkimi, fëmija mundet të sillet për një kohë në mënyrë të duhur dhe urtë. Ose, me maturi mund të mos e përsërisë gabimin e njëjtë haptas. Por, kur të gjejë ndonjë mundësi të përshtatshme, ai mund ta bëjë prapë atë sjellje për të cilën është qortuar më herët. Prandaj, ndëshkimet nuk e ndërpresin shkakun e veprimit të keq të fëmijës. Është e mundur që ndonjëherë fëmija të kërkojë strehë mbrapa gënjeshtres dhe vjedhjes. Këtu do të përmendim disa pika interesante që u sugjerohen prindërve dhe mentorëve të fëmijëve me qëllim që ndëshkimet jo-fizike të jenë më efektive dhe më të matura:

1. Ndëshkimet duhet të jenë të menduara mirë dhe në përpjesëtim me veprimin e keq të fëmijës. Sigurohuni që ndëshkimi nuk është më i madh sesa veprimi i keq i fëmijës. Nëse fëmija mendon se ndëshkimi ishte i padrejtë, ai mund të reagojë në mbrojtjen e tij dhe të fillojë të kundërvihet e të bëhet kokëfortë.

2. Ndëshkimi nuk duhet të jetë i tillë që fëmija të fillojë të mendojë se prindërit e tij janë armiqtë e tij dhe se nuk e duan atë.

3. Nëse fëmija ka bërë ndonjë gabim të paqëllimtë, ai nuk duhet të ndëshkohet. Nëse, përkundër kësaj, fëmija

ndëshkohet, mund të ketë ndikim negativ në ndjenjat dhe mendjen e tij.

4. Ndëshkimet nuk duhet të bëhen çështje të përditshme, nëse prindërit dëshirojnë që ato të jenë efektive. Nëse ndëshkimet përsëriten shpesh, fëmija mund të shndërrohet në një kundërvajtës të pandreqshëm. Atëherë, ndëshkimi nuk do të ketë kurrfarë efekti tek ai.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

“Ndëshkimi dhe qortimi i tepërt mund të çojë te kokëfortësia.” (Guraraal hakm, f. 70).

5. Fëmija mund të ndëshkohet për një veprim të vetëm dhe jo edhe për të gjitha sjelljet e këqija të së kaluarës. Përndryshe, fëmijës mund t’i ngatërrohet se për çka është ndëshkuar. Ai nuk do të përsërisë një veprim, vetëm nëse e di se është ndëshkuar për të. Më mirë është që ndëshkimi të pasojë menjëherë pas kryerjes së aktit.

6. Sa më shumë që është e mundur, përpjekjet duhet të bëhen që ndëshkimi të jetë në përputhje me gabimin e bërë. P.sh. nëse fëmija nuk i ka kryer detyrat e shtëpisë nga matematika, atij duhet urdhëruar t’i kryejë ato dhe jo ta shkruajë tërë librin e matematikës prej fillimit deri në fund. Nëse fëmija e ka vërvitur çantën e tij shkollore në mënyrë të pakujdesshme, mbasi që është kthyer nga shkolla, duhet të kërkohet nga ai që menjëherë ta vendosë në vendin e duhur. Si ndëshkim për këtë sjellje të keqe, ai nuk duhet të kërcënohet se nuk do të merret në një gosti ku janë ftuar të gjithë. Nëse fëmija nuk ka qenë i urtë në gosti, ndëshkimi i tij mund të jetë mosmarrja në gostinë e ardhshme dhe jo ndalimi i parasë së tij të xhepit. Nëse fëmija e harxhon pa hesap paranë e tij të xhepit, atëherë si dënim mund të mos i jepet vlera e njëjtë e parasë që i është dhënë më herët.

7. Mbas ndëshkimit, prindërit nuk duhet ta përmendin gabimin e tij pandërprerë. Një person u ankua te Imam Musa Xhaferi në lidhje me djalin e tij. Ai i tha: “Mos

e rrah atë, vetëm kundërshtojë atë. Por, ky qëndrim nuk duhet të zgjasë shumë.” (Ghërar al hukm, f. 70).

8. Nëse dëshiron ta ndëshkosh fëmijën, mos e krahaso me fëmijët e tjerë. Mos ia numëro atij cilësitë e fëmijëve të tjerë. Nuk mund ta reformosh fëmijën përmes këtij qëndrimi. Kështu mund ta ngjallni ndjenjën e xhelozisë në mendjen e fëmijës.

Një person, në memoaret e tij shkruan:

“Gjatë fëmijërisë sime, babai im më bërtiste shumë. Ai kishte zakon të më ofendonte përpara shokëve dhe të afërmeve. Gjithnjë i numëronte të arriturat e të tjerëve përpara meje. Gjithnjë kërkonte ndonjë rast për të më përulur. Më konsideronte një person të dobët. Sa më shumë që më ofendonte, aq më kokëfortë bëhesha. E humba interesimin për shkollën. E zhvillova kompleksin e vlerës së ulët. Fillova ta dredhoj punën. Nuk isha i gatshëm të pranoja asnjë përgjegjësi. Personaliteti im që dëmtuar për shkak të bezdisjeve të pandërprera të babait tim. Sot jam një person përtac dhe i vetmuar.”

Kapitulli i shtatëdhjetekatërtë

Inkurajimi dhe shpërblimi

Një metodë shumë e mirë e rritjes së mirëfilltë është ngritja e vlerës dhe inkurajimi kur fëmija vepron mirë. Kjo do të ketë një ndikim të dobishëm në mendjen e fëmijës. Do t'ia sigurojë një arsye për të vepruar edhe më mirë në të ardhmen. Çdo njeri e do veten. Në mënyrën e tij, ai mendon për zhvillimin dhe përparimin e personalitetit të tij. Ai dëshiron që të tjerët ta njohin dhe ta çmojnë personalitetin e tij. Nëse inkurajohet nga ana e të tjerëve, ai do të përpiqet për përmirësime të mëtutjeshme, por nëse dekurajohet, entuziazmi i tij do të shuhet. Këtu do të japim disa sugjerime për arritjen e rezultateve më të mira:

1. Veprimet e fëmijës mund të çmohen, por jo shumë shpesh, sepse, nëse çmohen shumë, atëherë çmuarja mund ta humbë rëndësinë në sytë e fëmijëve. Ai mund ta pranojë çmuarjen si një çështje rutine.

2. Çmuarja e fëmijës duhet të bëhet në vendin dhe kohën e duhur, që ai të kuptojë pse dhe për çka po lavdërohet. Atëherë, ai do të mundohet të veprojë më mirë dhe të fitojë lavdërimin edhe në ndonjë rast tjetër. Për këtë arsye, çmuarja e përsëritur dhe e panevojshme nuk është e këshilluar. P.sh. nëse vazhdimisht lavdërohet fëmija se është një individ i mirë e i sjellshëm, ajo mund të mos ketë asnjë rëndësi për të. Fëmija nuk do të jetë në gjendje të kuptojë arsyen e çmuarjes.

3. Gjithashtu është e domosdoshme që veprat dhe puna e mirë e fëmijës të çmohen dhe jo personi i tij. Në këtë mënyrë do të kuptojë se ai lavdërohet për atë çka është duke bërë, dhe jo për atë se çka është. Rëndësia e çdo person qëndron te të arriturat e tij.

4. Gjatë lavdërimit të fëmijës, asnjëherë mos e krahasoni me ndonjë fëmijë tjetër. P.sh. babai nuk duhet t'i

thotë djalit të tij: 'Ti je një djalë i mirë dhe i sigurtë, jo sikur Hasani që është gënjeshtar'. Ky qëndrim mund ta bëjë që ai të ketë një mendim të varfër për atë djalë. Duke i krahasuar fëmijët, prindi është duke bërë rritjen e gabuar të fëmijës së mirë.

5. Lavdërimi i fëmijës duhet të jetë brenda kufijve të caktuar. Tejkalimi i tyre mund ta bëjë fëmijën mburracak dhe mendjemadh.

Aliu, Urdhëruesi i Besimtarëve, ka thënë:

"Shumica e njerëzve e zhvillojnë mendjemadhësinë për shkak të lavdërimit me të cilin e mbulojnë atë." (Bihar al-anvar, v. 72, f. 295).

"Mos e teproni gjatë lavdërimit në prani të të tjerëve." (Gharar al hukm, f. 209).

Një mjet shumë efektiv për rritjen dhe formimin e fëmijës është dhënia e shpërblimit. Shpërblimet nuk janë metodë e keqe për inkurajim nëse ato janë spontane dhe nuk janë plotësimi i ndonjë premtimi të mëhershëm që nëse fëmija e arrin gjënë e caktuar, atij do t'i jepet dhurata e veçantë. Nëse premtimet i janë bërë fëmijës paraprakisht, mund të ketë ndikim negativ tek ai. Fëmija do të fillojë të presë dhuratë për çdo gjë të mirë që kryen. Kjo do të bëhet një lloj kënaqësie dhe fëmija nuk do të përpiqet të përparojë nëse këto dhurata nuk i jepen më.

Personi duhet ta ketë shprehinë e punimit të veprave të mira. Ai duhet t'i kryejë ato me qëllim të përfitimit të kënaqësisë së Allahut dhe t'i shërbejë njerëzimit, dhe jo me qëllimin e fitimit të të mirave materiale. Nëse fëmija mësohet të pranojë dhurata për çdo arsye të vogël, ai mund të bëhet mendjengushtë dhe vetjak. Ai mund të mos mendojë se e ka për detyrë të bëjë diçka për të tjerët, përveç nëse nuk fiton diçka si kundërshpërblim për mundin e tij. Ai do të provojë sa më shumë për të ikur nga bërjet e veprave të mira ndaj të tjerëve. Ky qëndrim është një gabim

shumë i madh për një person dhe për një shoqëri. Prandaj, shpërblimi për ndonjë punë të mirë për fëmijën duhet të jetë i vogël dhe i zgjedhur mirë, që pranimi i dhuratave të tilla të mos bëhet natyra e dytë e tij. Kur fëmija e fiton shprehinë e kryerjes së detyrave me iniciativën e tij, zvogëloni dhënien e dhuratave dhe të shpërblimeve. Inkurajojeni të punojë. Shumë prindër u japin dhurata fëmijëve kur fitojnë nota të larta në provime. Në këtë mënyrë e inkurajojnë të mundohen më shumë në mësimet e tyre. Ndoshta, kjo metodë është efektive deri në një masë, por ka një të metë të madhe në këtë. Ajo e dëmton ndjenjën e përgjegjësisë së fëmijës. Fëmija do të mësojë shumë vetëm pse e di se do të pranojë ndonjë dhuratë duke i marrë notat e larta, në të kundërtën, ai nuk do të mundohet aq shumë. Për çfarëdo që bën, ai pret një dhuratë.

Një person shkruan:

“Qesh pranuar në shkallën e katërt të Shkollës Fetare. Isha shumë i dobët në recitimin e Kuranit të Shenjtë. Shokët e mi të klasës ishin shumë të mirë në këtë. Në orën e parë të mësimin, arsimtari më pyeti: ‘A mund ta recitosh Kuranin?’ - Unë iu përgjigja me nervozizëm - ‘Jo’. Ai më ktheu: - ‘Mos u mërzit, unë do të të mësoj. Unë e di se ti mund të bëhesh një student i mirë i klasës. Çfarëdo dyshimi që ke, mos hezito të më pyesësh’. Këto fjalë të këndshme të arsimtarit më inkurajuan dhe fillova të punoj me vendosmëri. Në fund të vitit unë qesh shquar në leximin e Kuranit. E arrita atë shkallë të zotësisë saqë në mungesën e arsimtarit, kërkonte prej meje ta zëvendësoja. Gjithashtu, u caktova edhe si përgjegjës për recitimin e vargjeve të Kuranit para fillimit të orëve të mësimin.”

Një vajzë, në memoaret e veta shkruan:

“Babai im ishte një person përparimtar. Një ditë, kur nëna nuk ishte në shtëpi, ai i thirri disa prej shokëve të tij në shtëpi për drekë. Ai i solli artikujt ushqimorë dhe m’i

dorëzoi mua. Unë fillova të punoja në kuzhinë me entuziazëm. Në drekë arriti babai me shokët e tij. Kur e derdha ushqimin në enë, e vërejta se nuk ishte zier mirë. Pula ishte gjysmë e pjekur dhe orizi ishte bërë i butë për shkak të ujit të tepërt që ia kisha shtuar gjatë zierjes. E tërë kjo ishte sepse nuk kisha mësuar ende zierjen në mënyrë të duhur. Isha duke pritur qortimin e babait në çdo moment. Përkundur pritjes sime, babai më lavdëroi përpara shokëve të vet. Ai tha: 'Këtë ushqim e ka zier vajza ime e dashur. Është shumë e lezetshme.' Edhe mysafirët e miratuan këtë dhe më lavdëruan për mundin tim. Më vonë babai im më goditi lehtë shpinën. Këto fjalë inkurajuese më entuziazmuan të filloja të mësoja mjeshtrinë e zierjes. Sot jam një njohëse e përgatitjes së gjellëve shumë të mira."

	Parathënie	3
1	Përgjegjësia e prindërve	6
	Dituria dhe kooperimi i dyanshëm i	
2	edukuesve	12
	Formimi përmes veprave, jo vetëm përmes	
	fjalëve	15
	Përmbajtja nga dallimet ndërmjet	
3	bashkëshortëve	20
4	Fillimi i jetës si nënë	27
	Mirëqenia e embrionit (fetusit) varet nga të	
5	ushqyerit e nënës	30
6	Efektet e ushqimit të nënës në fetus	32
7	Ushqimi i nënës	33
8	Përdorimi i duhanit	37
9	Të sëmuret e gruas shtatzënë	39
	Ndikimet e gjendjeve psikologjike të nënës	
10	në embrion	41
11	Këshilla për nënat shtatzëna	44
12	Mjedisi i pastër	45
13	Aborti	46
14	Lindjet e vështira	50
15	Mbas lindjes	55
16	Qumështi i nënës - Ushqimi më i mirë	57
17	Shtojca qumështit të nënës	61
18	Ndërprerja e qumështit nga gjiri i nënës	62
19	Orari i dhënies gjii	63
20	Nëse nëna nuk ka qumësht të mjaftueshëm	68
21	Ndarja e fëmijës prej gjirit	70
22	Vajzë apo djalë	72
23	Emërtimi i foshnjës	75

24	Shëndeti dhe higjiena	79
25	Gjumi i fëmijëve dhe liria e lëvizjes	83
26	Periudha më e ndjeshme (delikate) e jetës	85
27	I sapolinduri dhe ngritja morale	88
28	Ngritja religjioze e të sapolindurve	91
29	Ndjenja e varshmërisë	94
30	Kur fëmija fillon të shohë botën përreth tij	98
31	Dashuria	100
32	Shprehja e dashurisë dhe e dhembshurisë	105
	Dashuria, jo si një instrument i arritjes së	
33	qëllimeve	108
	Dashuria nuk duhet të bëhet pengesë për një	
34	rritje të mirë	109
35	Fëmija i lastuar	111
36	Thithja e gishtit të madh	117
37	Frika	119
	Frika e pakuptimtë	119
	Frika e kuptimtë	123
38	Loja dhe argëtimi	126
39	Mendjemadhësia apo krenaria	133
40	Imitimi (taklid)	135
41	Kërkimi për të vërtetën	138
42	Besimi në vetvete	142
43	Pavarësia	149
44	Kokëfortësia	155
45	Puna dhe kryerja e detyrave	160
46	Ndershmëria	167
47	Mbajtja e premtimeve	173
48	Zotërimi	176
49	Zemërgjerësia	179

50	Shtirirja e dorës së ndihmës për veprën e mirë	184
	Humaniteti dhe fëmijët	185
51	Drejtësia dhe barazia	189
52	Respekti ndaj fëmijëve	194
53	Vetëvlerësimi dhe ekzistenca e kuptimtë	197
54	Të hyrat dhe shpenzimet e shtëpisë	199
55	Respekti për ligjin	203
56	Sjellja dhe respekti	205
57	Vjedhja dhe kleptomania	209
58	Xhelozia	214
59	Zemërimi	219
60	Të folurit e fjalëve të turpshme	223
61	Përgojimi apo bartja e fjalëve (gijbet)	226
62	Kërkimi i të metave	229
63	Përleshjet e fëmijëve	231
64	Shokët dhe miqësimi	237
65	Fëmija dhe edukata fetare	242
66	Fëmija dhe obligimet fetare	246
67	Mendimi politik dhe social	250
68	Fëmija dhe radioja e televizioni	252
69	Problemet e gjinisë	258
70	Shprehia e leximit të librave	269
71	Fëmijët me të meta fizike	276
72	Ndëshkimet fizike	280
73	Ndëshkimet jo-fizike	285
74	Inkurajimi dhe shpërblimi	289

